UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË

DISERTACION

Për mbrojtjen e Gradës Shkencore
"DOKTOR"

EDUKIMI KLINIK-LIGJOR
SI PJESË PËRBËRËSE E EDUKIMIT JURIDIK,
VËSHTRIM KRAHËSUES

Disertanti:
Alban KOÇI

Udhëheqës shkencor:
Prof. Dr. Altin SHEGANI

Tiranë, 2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS PENALE
PROGRAMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË TË DREJTËN PENALE

DISERTACION

Paraqitur nga:

z. ALBAN KOÇI

për marrjen e gradës shkencore "DOKTOR"

Tema:

EDUKIMI KLINIK-LIGJOR SI PJESË PËRBËRËSE E EDUKIMIT JURIDIK, VËSHTRIM KRAHËSUES

Specialiteti: _____

Mbrohet më datë / / 2014, para Komisionit të përbërë nga:

1._____ Kryetar

2._____ Anëtar / oponent

3._____ Anëtar / oponent

4._____ Anëtar

5._____ Anëtar

Falenderim

Falenderoj për udhëheqjen gjatë realizimit të këtij punimi shkencor si dhe për mbështetjen e vazhdueshme Prof. Dr. Altin Shegani.

METODOLOGJITË E PËRDORURA

Gjatë hartimit të punimit kam përdorur metodat shkencore bashkëkohore. Si të tilla ashtu kam përfshirë analizën dhe sintezën, (greq. Analysis-zbërthim, ndarje; synthesis-bashkim), që janë dy metodat universale të njohjes. Analiza përfaqeson në punim ndarjen e objektit që studiohet në pjesën e tij përbërëse. Ndërkohë, sinteza përfaqëson një bashkim përmbledhës të elementëve të objektit të studimit. Analiza dhe sinteza në punim janë në unitet me njëra tjetrën. Pa analize, nuk mund të ketë sintezë, ndërsa pa sintezë, analiza nuk do kishte kuptim.

Metoda historike dhe llogjike, të ndjekura gjatë punimit, janë gjithashtu metoda mjaft të rëndësishme. Metoda historike, është një metodë sipas së cilës dukuritë juridike penale apo institutet e së drejtës studiohen në zhvillimin e tyre historik, (nga e shkuara në të tashmen). Ndryshe nga metoda historike, metoda logjike dikton që dukuritë të shpjegohen jo nga historia e tyre por nga ligjet e zhvillimit.

Së fundi, punimi im bazohet edhe mbi metodën krahasuese dhe metodën normative. Metoda krahasuese përbën zemrën e metodologjisë shkencore. Ajo nënkupton konstatimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis dukurive të jetës shoqërore dhe instituteve respective të së drejtës penale. Metoda krahësuese është përdorur kryesisht për të analizuar klinikën e ligjit bazuar në një vështrim krahësues të modeleve më të mira të klinikës në botë.

Me anë të metodës krahasuese dalin në pah të rejat dhe përparësitë e objektit të studimit. Vetëm pas një metode krahasuese, mund të nxjerrim përfundime të sakta dhe të bazuara në argumenta bindës, po ashtu, edhe problematika në lidhje me objektin e studimit.

Po ashtu literatura e përdorur është e gjerë dhe e shumllojshme. Burimet e shfrytëzuara janë legjislacioni penal, artikuj shkencor, komentarë të jurisprudencës apo botime të autorëve të ndryshëm. Kryesisht punimi është bazuar në literaturë të huaj për shkak të faktit se klinika e ligjit përbën një risi në vendin tonë dhe ende nuk ka një praktikë dhe mendim jurdik të konsoliduar në lidhje me të.

Përmbajtja

Hyrje **6**

Kapitulli 1 11

Çfarë është klinika ligjore? 11

1. 1 Një kuptim i përgjithshëm mbi klinikën e ligjit 11

1. 1. 1 Një trajtim i termave kryesorë të klinikës 18

1. 2 Si lindi klinika ligjore? 20

1. 3 Street Law – E drejta e aplikuar në rrugë 21

1. 3. 1 Qëllimet e klinikës Street Law 24

1. 3. 2 E drejta për ndihmë ligjore - standardet ndërkombëtare 29

1. 4 Si të komunikohet me publikun? 32

Kapitulli 2 36

Aplikimi i klinikës në praktikë 36

2. 1 Përfitimet e klinikës ligjore 36

2. 2. Të mësosh nga praktika 38

2. 3 Si aplikohet klinika e ligjit? 39

2. 3. 1 Planifikimi 42

2. 3. 2 Zbatimi 42

2. 3. 3 Reflektimi 43

2. 3. 4 Integrimi 43

2. 4 Hapat për të realizuar një detyrë në mënyrë të suksesshme 44

2. 5 Vendosja e objektivave 46

Kapitulli III 54

Aftësitë e përfituara nga klinika e ligjit 54

3. 1 Si të përfitojmë aftësi të reja? 54

3. 1. 1 Aftësitë e reja të para në dritën e globalizimit 57

3. 2 Zgjidhja e problemeve 60

3. 2. 1 Modeli i zgjidhjes së problemeve 62

3. 2. 2 Aftësitë për zgjidhjen e problemeve 64

3. 2. 3 Rëndësia e zgjidhjes së problemeve 68

3. 3 Çfarë përfitojnë më shumë se të tjerët studentët e klinikës? 69
3. 4 Aftësitë që përfitohen nga klinika e ligjit 74
Kapitulli IV 78
Çështje të etikës profesionale në klinikën e ligjit 78
4. 1 Çfarë është etika profesionale? 78
4. 2 Parimet në klinikën ligjore 79
4. 2. 1 Konfidencialiteti 82
4. 2. 2 Konflikti i interesit 88
4. 3 Kontradiktoriteti dhe konflitet në klinikën e ligjit 90
4. 4 A është e gabuar përfaqësimi i klientëve që mund të përballojnë një avokat? 92
4. 5 Procedimi disiplinor 94
Kapitulli V 97
Modelet më të mira të klinikës në botë 97
5. 1 Shoqata e edukimit të klinikës ligjore, CLEA 97
5. 2 Klinika e ligjit në Shtetet e Bashkuara 99
5. 2. 1 Klinika e ligjit në Unversitetin e Kolumbisë në Neë York 101
5. 2. 2 Klinika e ligjit në fakultetin Juridik, Baltimore. 101
5. 2. 3 Shkolla e ligjit C. Vanderbilt 103
5. 2. 4 Shkolla e së drejtës në Xhorxhtaun, Washington 104
5. 3 Klinika e ligjit në Itali 105
5. 3. 1 Objektivat e klinikës së ligjit në Itali 107
5. 3. 2 Klinika e ligjit në Universitetin e Breshia - s 109
5.4 Klinika e ligjit në Poloni 109
5. 5 Klinika e ligjit në Francë 114
5. 6 Vështrim krahësues të klinikave në botë 115
Kapitulli VI 125
Modelet e klinikës së ligjit 125
6. 1 Ku aplikohet klinika? 125
6. 2 Kush mund të jetë një klient klinike? 125
6. 3. 1 Këshillimi ligjor 128
6. 3. 2 Paditë 129
6. 3. 3 Përfaqësimi i klientit në gjykatë ose organet e administratës publike 129
6. 3. 4 Ndihma të tjera 130

6. 4 Klinika për të miturit 130
6. 5 Klinika e organizatave jo-fitimprurëse 132
6. 6 Klinika për të drejtën e mjedisit 133
6. 7 Klinika për të drejtat e njeriut 134
6. 8 Klinika e ligjit për çështjet penale 136
6. 9 Klinika e ligjit për të drejtën familjare 138
6. 10 Klinika e ligjit për të drejtën migratore 140
Kapitulli VII 142
Klinika dhe planifikimi i karrierës 142
7. 1 Roli i klinikës në krijimin e një plani karriere 143
7. 2 Procesi i reflektimit 146
7. 3 Mbikëqyrja 150
5. 4 Hapat për planifikimin e karrierës 151
Kapitulli VIII 154
Klinika e ligjit në Shqipëri 154
8. 1 Sa njihet klinika e ligjit në Shqipëri 154
8. 1. 1 Njohja e klinikës nga studentët e së drejtës 155
8. 1. 2 Njohja e klinikës nga komuniteti 159
8. 2 Klinika e ligjit në Fakultetin e Drejtësisë 161
Përfundime dhe Rekomandime 173
Bibliografia : 174
Abstrakt / Abstract 177

Hyrje

Sot në të gjithë botën ka një zhvillim dhe përmirësim të dukshëm të programeve akademike në fakultetet e drejtësisë. Ato po përshtaten dhe po programohen në përputhje me përvojat më të mira ndërkombëtare dhe gjithashtu në përputhje me ndryshimet sociale-kulturore apo ekonomike të një vendi. Në çdo rast ajo që synohet është përmirësimi i tyre dhe ofrimi i programeve akademike sa më të arrira për studentët në përpjekje për të krijuar juristë të aftë dhe të gatshëm për t'u përballuar me sfidat e profesionit por edhe të kohës. Vazhdimisht i është kushtuar një rëndësi e madhe lëndëve teorike, ato që i mësojnë të drejtën studentëve duke synuar t'i bëjnë juristë të suksesshëm. Natyrisht që kjo është shumë e rëndësishme, pasi duke u njohur e drejta mund të aplikohet në praktikë, të përdoret për t'u shërbyer interesave të njerëzve dhe gjithashtu të jetë një instrument në duart e juristëve në shërbim të komunitetit. Megjithatë vetëm studimi i lëndëve teorike nuk mjafton për përgatitjen e studentëve të aftë. Është e domosdoshme që këto dije teorike, e drejta materiale dhe ajo proceduriale të zbatohen dhe aplikohen në praktikë në mënyrë që të njihet nga afër e drejta dhe të kuptohet tërësisht ajo. Këtu hyn në lojë klinika e ligjit, si pjesë e programit akademik në edukimin juridik.

Klinika e ligjit është zbatim i ligjit në praktikë me qëllim jofitimprurës, që i shërben interesit publik. Klinika e ligjit lindi si një metodë mësimdhënie për të ndihmuar studentët në mësimin praktik të së drejtës, dhe u zhvillua më vonë edhe në formën e ndihmës juridike falas, pa lidhje me fushën akademike. Në kuptimin akademik, klinikat e ligjit ofrojnë përvojë praktike për studentët e të drejtës në fakultetet e drejtësisë si edhe shërbime të ndryshme ligjore në drejtim të shtesave, kryesisht vunerabël të popullsisë që nuk kanë mundësi të sigurojnë një ndihmë të tillë profesionale kundrejt pagesës. Klinikat akademike janë programe të drejtuara zakonisht nga profesorët e klinikës. Shumë klinika ligjore ofrojnë punë pro bono në një ose më shumë të fusha të së drejtës, duke ofruar shërbime ligjore falas për klientët.

Kjo është një fushë e të drejtës që është përhapur në shumë fakultete të drejtësisë, për shkak të avantazheve që sjell dhe horizonteve të reja që ofron për studentët por edhe profesorët e së drejtës. Ajo sjell disa risi në shumë aspekte të edukimit juridik, prandaj është parë si pjesë e pandarë e tij. Asnjëherë nuk mund të flasim për një formim të plotë juridik pa praninë e praktikës juridike dhe aftësive të pazëvendësueshme që studentët fitojnë duke praktikuar ligjin.

Klinikat e ligjit ekzistojnë në të gjithë botën dhe janë të dizejnuara për të siguruar aplikime relevante shoqërore të arsimimit ligjor. Megjithatë, klinikat mund të ndryshojnë nga vendi në vend dhe shpesh edhe brenda vendit. Këto dallime tek klinikat mund të jetë rezultat i faktorëve të ndryshëm socio-ekonomik dhe politik. Megjithatë, pavarësisht

dallimeve të tilla në strukturën dhe përmbajtjen e klinikave, ato janë të ngjashme në misionin e tyre. Shumica e klinikave kanë zhvilluar në fakultetet e drejtësisë klinikat e ndihmës që ndjekin një motiv fisnik, atë të ofrimit të ndihmës ligjore falas për të varfërit. Shumëllojshmëri të programeve klinike kanë filluar të aplikohen në fakultetet e drejtësisë si rezultat plotësimin e nevojave të paplotësuara të komunitetit lokal.

Në këtë punim jam munduar të bëj një trajtim të klinikës së ligjit, si një risi e programit akademik e aplikuar në fakultetet e drejtësisë. Këtu është trajtuar klinika, çfarë përfaqëson ajo, mënyra e aplikimit, format në të cilat shfaqet dhe modelet e saj. Gjithashtu jam munduar të trajtoj avantazhet që sjell klinika e ligjit si për studentët e së drejtës ashtu edhe për komunitetin që përfiton ndihmë juridike falas. Një vëmendje jo e vogël i është kushtuar avantazheve që sjell klinika në spektrin akademik, cilat janë aftësitë që përfitojnë studentët e së drejtës, vlerat, mundësitë dhe prioritetet që marrin nga klinika. Gjithashtu është trajtuar përfitimi që merr komuniteti, duke qënë se klinika ka në fokus jo vetëm praktikën e studentëve por nga ana tjetër ndihmën ligjore falas të ofruar për personat vunerabël të popullsisë, pra ata që nuk kanë mundësi të përballojnë ndihmë ligjore me mjetet e tyre financiare.

Meqë vendi ynë është ende në hapat e para të zbatimit të klinikës dhe implementimit të saj si pjesë të programit akademik kam marrë si bazë modelet dhe programet më të mira klinike të universiteteve ndërkombëtare që janë lider në këtë fushë. Është trajtuar përvoja më e mirë ndërkombëtare duke u ndaluar në programet e klinikës në Shtetet e Bashkuara, që është vendi edhe ku ka lindur klinika, por edhe në shtete të tjera si Italia apo Polonia me të cilën Fakulteti ynë i Drejtësisë ka një bashkëpunim dhe lidhje të veçantë. Gjithashtu janë trajtuar këto modele të huaja të para në dritën e mundësive për t'u përshtatur dhe implementuar në sistemin akademik shqiptar, duke u vënë theksi te ato klinika që i përshtaten më shumë ambientit tonë akademik por edhe nevojave më të mprehta të popullsisë. Pra, është vënë theksi te aplikimi i atyre klinikave që trajtojnë problemet më të mprehta të realitetit shqiptar, si çështjet e pronave, dhuna në familje, të drejtat e komunitetit rom etj. Në këtë mënyrë jo vetëm që trajnohen studentët për të trajtuar juridikisht problemet më të mëdha të praktikës juridike shqiptare por dhe i vihet në ndihmë asaj pjese të komunitetit që përballet me këto probleme më shpesh.

Në pjesën e dytë të punimit është trajtuar klinika në aspektin praktik, fushat e së drejtës ku ajo zbatohet, ndihma që jep në planifikimin e karrierës së studentëve të rinj por edhe në aftësitë e domosdoshme për profesionin që ata mësojnë prej saj.

Klinika e ligjit është një lëndë e re në programin akademik për studimin e së drejtës në fakultetin tonë megjithatë ajo po tërheq një vëmendje të madhe për studentët për shkak të përfitimeve dhe aftësive që ata marrin prej saj por edhe për shkak të përvojës interesante. Ajo aktualisht vepron si lëndë me zgjedhje në tre departamentet e së drejtës në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, dhe përkatësisht në të drejtën civile, penale dhe të drejtat e njeriut në departamentin e të drejtës publike. Duke marrë parasysh faktin që klinika e ligjit përbën një risi në programet akademike shqiptare e kam parë të vendit të

trajtoj klinikën në të gjitha aspektet e saj duke shërbyer kështu si një nxitës për promovimin dhe zhvillimin e saj në Shqipëri. Ky punim synon të bëjë të njohur avantazhet e klinikës, përfitimet që merren prej saj dhe të krijojë akses në informacion për të gjithë qytetarët dhe jo vetëm studentët. Kjo është e nevojshme sepse klinika nuk i shërben vetëm studentëve por ndihmën më të madhe ajo e ofron për komunitetin duke ofruar ndihmë ligjore falas për kategori të caktuara të popullsisë. Ky në fakt, është edhe një faktor tjetër që duhet të shërbejë për zhvillimin e klinikës në Shqipëri, pasi nuk janë në paktë individët që kategorizohen si kategori vunerabël e popullsisë dhe duke mos pasur akses në drejtësi kanë nevojë për ndihmë ligjore falas.

Klinika e ligjit është ofruar bazuar në programet më të mira akademike të huaja, duke marrë parasysh zhvillimin e paktë në vendin tonë dhe faktin që ende përbën një risi në sistemin arsimor universitar shqiptar. Në fakt, ne kemi një bashkëpunim shumë frytdhënës me Poloninë, një nga vendet me klinikën me të zhvilluar dhe që ka bërë progres të padiskutueshëm në fushën akademike klinike. Gjithashtu një ndihmë të vlefshme në këtë drejtim është bashkëpunimi me misionin e USAID në Shqipëri, i cili ka dhënë një kontribut në trajnimin e profesorëve të klinikës por edhe në bazën materiale për klinikën e ligjit në fakultetin e drejtësisë. Sot, falë bashkëpunimit me USAID kemi laboratorë të klinikës në ambientet e fakultetit, të cilët do të bëjnë të mundur krijimin e orëve të përshtatshme të klinikës. Gjithashtu janë vënë në dispozicion libra dhe artikuj të ndryshëm, manuale në mënyrë që kjo disiplinë që përbën ende një risi për në, të zbatohet dhe aplikohet ashtu siç duhet dhe të kuptohet rëndësia e saj për studentët por edhe për komunitetin. Nëse ajo vihet në zbatim si duhet dhe rezultatet e përfituara prej klinikës do të jenë ato të dëshiruarat.

Bazuar në programet e huaja akademike, klinika e ligjit është bërë pjesë e rëndësishme e programit akademik të Fakultetit të Drejtësisë. Kjo synohet duke marrë parasysh avantazhet që sjell ajo në formimin juridik të studentëve duke i bërë ata të prekin nga afër përvojën e një profesionisti të vërtetë, duke u përballur me sfidat, problemet dhe vështirësitë profesionale dhe duke u rritur profesionalisht. Prandaj, gjatë trajtimit teorik të klinikës në këtë punim i është kushtuar një vëmendje e konsiderueshme trajtimit të programeve më të mira dhe bashkëkohore të vendeve perëndimore, duke pasur si synim përqasjen me programin shqiptar të risive dhe avantazheve më të mira që sjellin këto modele të huaja.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar aplikimit të klinikës si program akademik në mënyrë që jo vetëm ajo të zbatohet siç duhet por edhe të ofrojë përvojat e duhura dhe të sjellë rezultatet e dëshiruara për studentët e së drejtës. Duke qënë se klinika e ligjit po aplikohet për herë të parë në fakultetet e drejtësisë dhe jemi ende në fazën e një përvoje pak-vjeçare, jam ndalur në trajtimin e mënyrës së aplikimit të saj bazuar edhe në modelet e huaja duke pasur synim njohjen dhe kuptimin e rëndësisë që ka klinika për formimin dhe edukimin juridik të juristëve të rinj.

Gjithashtu një kapitull i është kushtuar klinikës së ligjit në Shqipëri, si një risi në programin akademik të fakultetit të drejtësisë. Një vëmendje i veçantë i është kushtuar edhe informimit të publikut të gjerë në lidhje me klinikën e ligjit si edhe përhapja e informacionit te studentët e drejtësisë për vlerat, përfitimet dhe avantazhet që ajo sjell. Është trajtuar në formën e një studimi, klinika e ligjit në vendin tonë dhe mënyra e perceptimit dhe pritja që i bën publiku asaj. Duke qënë se kemi të bëjmë me një lëndë të re në programin akademik i është kushtuar vëmendje jo vetëm njohjes së saj nga studentët por edhe kuptimi si duhet i misionit që ajo ndjek, objektivave dhe qëllimeve që ka. Gjithashtu, duke qënë se në fokus të klinikës është ofrimi i ndihmës ligjore për anëtarë të komunitetit vunerabël të popullsisë, synohet njohja dhe promovimi i saj edhe në rradhët e popullsisë në mënyrë që ata t'i drejtohen klinikës për zgjidhjen e problemeve të ndryshme juridike që hasin në jetën e përditshme. Vetëm duke realizuar këtë objektiv të dyfishtë, klinika e ligjit do të interferohet si pjesë e pandarë e sistemit akdemik shqiptar në fushën e së drejtës dhe do të japë rezultatet e dëshiruara.

Bazuar në përvojat e huaja, dhe zhvillimin e klinikës në to, mund të them padyshim se klinika do të integrohet përsosmërisht edhe në fakultetet e drejtësisë në Shqipëri duke bërë që edhe ne të arrijmë në këtë drejtim standardet europiane por edhe më gjerë, ato ndërkombëtare. Ky punim synon të japë një panoramë të klinikës së ligjit duke e trajtuar atë në aspektin teorik në mënyrë që të njihet dhe implementohet siç duhet. Gjithashtu punimi ka si qëllim të shpjegojë mënyrën e aplikimit dhe zbatimit të klinikës në praktikë për të shërbyer kështu si një guidë në formësimin e tij në fakultetet shqiptare. Në fund të leximit të tij, do të jeni të aftë jo vetëm ta kuptoni klinikën e ligjit, misionin dhe objektin e saj por edhe ta vlerësoni për përfitimet që jep për sistemin akademik por edhe për komunitetin e gjerë.

Autori

Pjesa e parë

Klinika e ligjit, pjesë e edukimit juridik

Kapitulli 1

Çfarë është klinika ligjore?

Përmbledhje : 1. 1 Një kuptim i përgjithshëm mbi klinikën e ligjit; 1. 1. 1 Një trajtim i termave kryesorë të klinikës; 1. 2 Si lindi klinika ligjore?; 1. 3 Street Law – E drejta e aplikuar në rrugë; 1. 3. 1 Qëllimet e klinikës Street Law; 1. 3. 2 E drejta e ndihmës ligjore falas - Standardet ndërkombëtare; 1. 3. 3 Si të komunikohet me publikun?

1. 1 Një kuptim i përgjithshëm mbi klinikën e ligjit

Klinika e ligjit është zbatim i ligjit në praktikë me qëllim jofitimprurës, që i shërben interesit publik. Klinika e ligjit lindi si një metodë mësimdhënie për të ndihmuar studentët në mësimin praktik të së drejtës, dhe u zhvillua më vonë edhe në formën e ndihmës juridike falas, pa lidhje me fushën akademike. Në kuptimin akademik, klinikat e ligjit ofrojnë përvojë praktike për studentët e të drejtës në fakultetet e drejtësisë si edhe shërbime të ndryshme ligjore në drejtim të shtresave, kryesisht vunerabël të popullsisë që nuk kanë mundësi të sigurojnë një ndihmë të tillë profesionale kundrejt pagesës. Klinikat akademike janë programe të drejtuara zakonisht nga profesorët e klinikës. Shumë klinika ligjore ofrojnë punë pro bono në një ose më shumë të fusha të së drejtës, duke ofruar shërbime ligjore falas për klientët.

Studentët japin kontributin e tyre me anë të punës kërkimore, hartimit të dokumentave ligjorë, apo takimit me klientët. Në shumicën e rasteve janë profesorët e klinikës që përfaqësojnë klientët në gjyq duke realizuar edhe mbrojtjen e tyre. Megjithatë, në disa vende ekzistojnë rregulla që i lejojnë studentët të paraqiten në gjykatë dhe të mbrojnë klientët e tyre.

Klinika e ligjit i jep mundësi studentëve të mësojnë nga praktika. Nuk kemi më të bëjmë me leksione nëpër salla auditorësh, apo me seminare, provime, detyra kursesh. Në klinikën e ligjit çdo gjë është e fokusuar në përvojën praktike, eksperiencën që fitohet në sallat e gjyqit, prej vëzhgimit, diskutimit dhe trajtimit të problemeve të ndryshme ligjore,

por tashmë jo në salla leksionesh por në sallat e gjyqeve, zyrat e avokatisë apo terrenin ku kërkohet të praktikohet realisht e drejta.

Kjo është një fushë e të drejtës që është përhapur në shumë fakultete të drejtësisë, për shkak të avantazheve që sjell dhe horizonteve të reja që ofron për studentët por edhe profesorët e së drejtës. Ajo sjell disa risi në shumë aspekte të edukimit juridik, prandaj është parë si pjesë e pandarë e tij. Asnjëherë nuk mund të flasim për një formim të plotë juridik pa praninë e praktikës juridike dhe aftësive të pazëvendësueshme që studentët fitojnë duke praktikuar ligjin.

Klinika ligjore, e quajtur klinika e shkollës së drejtësisë ose klinika e ligjit, është një program i organizuar nga Universiteti i Drejtësisë , e cila ofron ndihmë juridike falas për personat të cilët ndodhen në vështirësi ekonomike dhe pamundësi për të siguruar një ndihmë ligjore nga avokati. Ajo e mbështet veprimtarinë e saj në punën vullnetare të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë. Ndihma juridike ofrohet nga studentët e Klinikës nën kujdesin e pedagogut përgjegjës të lëndës Klinika e Ligjit në të drejtën penale, publike dhe civile.

Klinika e Ligjit mund të ketë kuptime të ndryshme për persona të ndryshëm. Kështu ajo mund të përcaktohet edhe si: " një mjedis i të mësuarit ku studentët identifikojnë, kërkojnë dhe aplikojnë njohuritë e tyre në këtë mjedis".[1] Po kështu edukimi ligjor klinik është e vetmja mundësi në të cilën teoria dhe praktika sillen së bashku. [2]

Vazhdimisht i është kushtuar rëndësi e madhe lëndëve teorike, atyre që i mësojnë të drejtën studentëve duke synuar ti bëjnë juristë të sukseshëm. Natyrisht që kjo është shumë e rëndësishme, pasi duke u njohur e drejta mund të aplikohet në praktikë, të përdoret për tu shërbyer interesave të njerëzve dhe të jetë një instrument në duart e juristëve në shërbim të komunitetit. Megjithatë vetëm studimi i lëndëve teorike nuk mjafton për përgatitjen e studentëve të aftë. Është e domosdoshme që këto dije teorike, e drejta materiale dhe ajo procedurale të zbatohen dhe aplikohen në praktik në mënyrë që të njihet nga afër e drejta dhe të kuptohet tërësisht ajo. Këtu hyn në lojë klinika e ligjit, si pjesë e programit akademik në edukimin juridik.

Misioni i programit klinik të Universitetit të Drejtësisë është që t'ju mësojë studentëve aftësitë avokatore, etikën profesionale dhe efektin e institucioneve ligjore mbi të varfërit, të aplikojnë ligjin ndërkohë që shërbejnë si avokatë për persona që u mohohet aksesi në drejtësi, të reformojnë edukimin ligjor dhe sistemin ligjor për të qenë më përgjegjës ndaj interesave të të varfërve. Si rrjedhojë, klinika kërkon që të njohë studentët me problemet e përgjegjësisë profesionale dhe me çështje të veçanta ligjore të sjella në Klinikë prej klientëve real.

[1] R. Grimes, "The Theory and Practice of Clinical Legal Education", fq 138.
[2] Richard Lewis, " Clinical Legal Education Revisited", fq 1

Pra, klinika është një mekanizëm përmes të cilit synohet përsosja e mëtejshme e procesit të edukimit të studentëve të drejtësisë përmes harmonizimit të dijeve teorike me praktikën e zbatimit të ligjit.

Në klinikën ligjore studentëve ju jepet mundësia që të veprojnë dhe të kryejnë të njëjtat veprime që kryejnë avokatët në punën e tyre siç janë kërkimet ligjore, përpilimi i dokumentave ligjore, intervistimi i klientëve dhe përgatitja e opinioneve ligjore. Pjesëmarrja në Klinikën e Ligjit është një mundësi mjaft e madhe për studentët për të fituar eksperiencë përpara futjes në tregun e punës.

Shumë Klinika ligjore janë të hapura vetëm për studentët e vitit të tretë, megjithatë shumë universitete e kanë Klinikën e Ligjit edhe në programin shkollor për studentët e vitit të dytë, dhe kjo nuk ka sjellë asnjë ndryshim në organizimin e punës dhe cilësisë së Klinikës, pasi puna e kryer nga studentët e vitit të dytë ka rezultuar shumë efikase. Në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, Klinika e Ligjit është pjesë e programit për studentët e vitit të tretë sistemi Bachelor si dhe për studentët e programit Master Profesional dhe Master Shkencorë.

Klinika e Ligjit tashmë nuk është pjesë vetëm e Fakultetit të Drejtësisë Universiteti Tiranës por edhe e Shkollës së Magjistraturës, por Klinika e Ligjit në Shkollën e Magjistraturës ka një natyrë ndryshe nga ajo e Fakultetit të Drejtësisë. Qëllimi i Klinikës është ofrimi i konsulencës juridike në formën e një pune kërkimore e shkencore për Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë dhe Prokurorinë e Përgjithshme në lidhje me çështje konkrete të komplikuara, të cilat kërkojnë përgjigje me natyrë krahasuese e juridike. Produkti final i programit të Klinikës Ligjore dhe Kërkimore do të jenë memorandumet ligjore që do t'i jepen institucioneve të mësipërme.[3] Cilësia e memorandumeve dhe e punës kërkimore të bërë do të garantohet nga dy nivele mbikqyrësish akademikë. Niveli i parë përbëhet nga një grup me 9 lektorë nga Shkolla e Magjistraturës, ndërsa niveli i dytë përbëhet nga 3 lektorë të tjerë të Universitetit të Utrehtit.

Klinikat e ligjit ekzistojnë në të gjithë botën dhe janë të dizejnuara për të siguruar aplikime relevante shoqërore të arsmimit ligjor. Megjithatë, klinikat mund të ndryshojnë nga vendi në vend dhe shpesh edhe brenda vendit. Këto dallime tek klinikat mund të jetë rezultat i faktorëve të ndryshëm socio-ekonomik dhe politik. Megjithatë, pavarësisht dallimeve të tilla në strukturën dhe përmbajtjen e klinikave, ata janë të ngjashme në misionin e tyre. Shumica e klinikave kanë zhvilluar në fakultetet e drejtësisë klinikat e ndihmës që ndjekin një motiv fisnik, atë të ofrimit të ndihmës ligjore falas për të varfërit. Shumëllojshmëri të programeve klinike kanë filluar të aplikohen në fakultetet e drejtësisë si rezultat plotësimin e nevojave të paplotësuara të komunitetit lokal.

[3] http://www.magjistratura.edu.al/324-.html?lang=1

Kur një klinikë ligjore prezanton një klient në gjyq, nuk mund të përjashtojmë faktin që diçka e pazakontë po ndodh. Një klient i palicensuar ka përgjegjësi mbi një person tjetër; përgjegjësinë e përfaqësimit ligjor, gjë që në rrethana normale, vetëm avokatët e liçensuar mund ta bëjnë.[4] Shumë gjyqtarë jnë mësuar tashmë me rregullat e praktikës së studentëve dhe e autorizojnë praktikën e mbikqyrur te studentët e drejtësisë. Këto rregulla mund të lejojnë përfaqësimin e klientëve nga studentët e praktikave ligjore por vetëm nën konktrollin e një avokati të liçensuar. Janë të rralla pretendimet gjithsesi, që gjyqtarët të jenë të njohur me qëllimet konkrete të programit të klinikës së ligjit apo për përgjegjësitë akademike të klinikës.

Përpos kësaj, sa më e madhe të jetë përfshirja e studentëve ndaj klinikës së ligjit, aq më shumë rritet dhe interesi i gjyqtarëve për tu njohur me programet e klinikës së ligjit. Kur bashkëpunimi i gjyqtarëve me studentët është interaktiv, shpesh, studentët të japin vërtet përshtypjen e avokatëve të sapoliçensuar. Ata vishen si avokatë "të rinj" dhe mësojnë që të qëndrojnë në mënyrën e duhur, pavarësisht se është avokati i liçensuar ai që mban përgjegjësi ligjore. Megjithatë, ka raste që gjyqtarët kanë vështirësi në pranimin e studentëve të klinikës së ligjit. Ata shpesh hasin vështirësi në bashkëpunimin me studentët për shkak të mungesës së përvojës së të rinjve. Në disa rrethana apo shkallë gjykimi, veprimet e studentëve praktikantë mund të ngatërrojnë ose edhe të shqetësojnë gjyqtarët, të çilët nuk kanë kohë fizike për të zgjatur çështjet apo shqyrtimin e tyre.

Pse nuk mundet që studentët thjesht të vëzhgojnë avokatët në paraqitjet e tyre në gjyq? Mos ndoshta ky program e vë praktikën e studentit mbi çdo interes tjetër ligjor? Pse ka kaq pak çështje dhe kaq shumë student për çdo çështje? Këto janë pyetjet që mund të shqetësojnë disa pre gjyqtarëve në lidhje me punën e klinikës. [5] Pikërisht për këtë është e rëndësishme që të gjithë anëtarët e sistemit gjyqësor të kuptojnë objektivat dhe detyrimet e klinikës së ligjit, një synim dyfish i përfaqësimit sa më të mirë të klientit dhe i çilësisë sa më të lartë të edukimit praktik të studentëve.

Megjithatë, nëse u referohemi kohëve të fundit, sidomos në vendet perëndimore ,dhe kryesisht ato amerikane,ka pasur arritije ne forçimin e ideve eksperimentale,sa i përket anës praktike studimore,dhe metodave interaktive ligjore. Pjesëmarrja e studentëve në dhënien e opinioneve ligjore dhe në disa vende,edhe në pjesëmarrjen e tyre si përfaqësues në çështje konkrete,është një rezultat i kënaqshëm në çilësinë e edukimit ligjor. Publikimet dhe raportet e fundit,si për shembull a i i Edukimeve Praktike Eksperimentale të Neë York-ut, flasin jo vetëm për rritjen e metodave praktike akademike,por edhe rritjen e kompetencave që u jepen studentëve në trajtimin e çështjeve konkrete. Aftësitë profesionale, dhe vlerat morale, të rëndësishme për një përfaqësim sa më dinjitoz ligjor kanë zënë një rol të rëndësishëm në studimet akademike. Shpesh herë studentët dalin të përgatitur vetëm teorikisht nga fakulteti, duke synuar për arritjen e eksperiencës pas mbarimit të studimeve, kështu ata fillojnë të punojnë të papaërgatitur dhe rrjedhimisht e bllokojnë përparimin e sistemit.

[4] Clinical Law Review/spring 2011,546
[5] James E.Moliterno, *Legal Educatio,Experiental Education and Professional Responsability*

Duke marrë nxitje nga kultura akademike amerikane, por edhe ajo europiane, edhe Shqipëria ka mbështetur këtë sistem edukimi, duke bërë pjese të fakultetit te drejtësisë, Kliniken e Ligjit. Ofrimi i opinioneve ligjore, nga studentët, pa pagesë, ndaj individëve që nuk kanë mundësi të paguajnë konsulencën, ka rritur jo vetëm nivelin akademik të studentëve, por edhe ndërgjegjësimin e akademikëve dhe të sistemit ligjor për rëndësinë e këtij sistemi edukimi. Megjithatë ende në fillimet e kësaj pune, duhen shumë përpjekje nga të dy palët për të arritur një rezultat sa më të kënaqshëm.

Gjithësesi në të gjitha Klinikat Ligjore gjyqtarët, vazhdojnë të jenë më pak të informuar se akademikët lidhur me rëndësinë e kësaj pjese te edukimit eksperimental. Këndvështrimi i tyre disi më teknik, i bën t`i shohin metodat eksperimentale si pengesa në mbarëvajten e sistemit gjyqësor. Sigurisht, në një farë mënyre pranohet disi skeptiçizmi i tyre lidhur me menyrën se si veprojnë klinikat ligjore. Ofrimi i eksperiencës për studentët dhe pjesëmarrja e tyre faktike në proceset gjyqësore,mund të duket sikur u ngadalëson dhe vështirëson punën gjyqtarëve,të çilët pretendojnë shpesh rezultate të shpeshta. Por skeptiçizmi i tepërt dhe refuzimi i tyre për bashkëunim,do të sillte ngadalësim të punës dhe suksesit të klinikave ligjore,dekurajimin e studentëve dhe si rrjedhojë edhe ngadalësimin e procesit të edukimit ligjor,dhe të vetë sistemit.[6]

Por, cilët janë faktorët që ndikojnë në mungesën e besimit dhe aspiratave të sistemit gjyqësor ndaj edukimit klinik ligjor?

Shpesh herë qëndrimi dyshues i gjyqtarëve ndaj edukimit klinik, vjen si trashëgimi e mungesës së evolimit historik dhe rëndësisë dytësore që i është dhënë prej vitesh metodave eksperimentale të studimit. Shumë nga gjyqtarët aktualë, janë produkt i një kohe, kur edukimi ligjor fokusohej, shpesh ekskluzivisht, vetëm në një klasë studimi rigoroze, bazuar në pak metoda interaktive. Duhet te mbajmë parasysh që vetëm pas vitit 1993, shkollat ligjore u vunë përpara përgjegjësisë për të mësuar aftësitë praktike dhe për t`u ofruar studentëve mundësi angazhimi në klinika ligjore të mbikëqyrura.[7] Gjyqtarët, të cilët nuk kanë qënë pjesë e këtij sistemi e kanë më të vështirë të bashkëveprojnë me metodat e reja edukuese ligjore. Duke shqyrtuar dhe duke pranuar ndryshimet që hasen mes perceptimit te gjyqtarëve rreth klinikave ligjore, shpesh drejtues dhe mbështetës të klinikave, kanë vlerësuar si të rëndësishem informimin e gjyqtarëve mbi punën e klinikave dhe mbi metodat e fundit te edukimit ligjor, përmes prezantimit të objektivave, metodave mësimdhënëse, paraqitjes së synimeve dhe kërkesave sa më të hapura për bashkëpunim.

Sigurisht, nuk ka asgjë më të mirë se sa bashkëveprimi dhe informimi i detajuar mbi punën e gjithëseçilit. Sidomos në sistemin gjyqësor dhe në edukimin ligjor, bashkëpunimi mes gjyqtarëve dhe studentëve të drejtësisë duhet të marrë rëndësi të veçantë.

Por përse duhet t`i dëgjojnë gjyqtarët studentët e drejtësisë?

[6] Adopting and adapting:Clinical Education and access to justice.
[7] ABA *Standards for Approval of Law Schools,*Standard 301

Sipas "Practice of law by law students", volumi i VI, kjo pyetje përbën një nga problematikat kryesore të bashkëpunimit gjyqësor me studentët.

Para disa vitesh në Dakotën e Veriut, ndërkohë që një student,i cili zhvillonte praktikën nën mbikëqyrjen e një avokati të liçensuar,gjatë një replike në sallën e gjyqit, pyetet nga gjyqtari: "Përse duhet të të dëgjoj ty? Ti je thjesht një student!"[8]

Pavarësisht të gjithë punës që ishte bërë me studentët, që t`u përgjigjeshin të gjitha pyetjeve të mundshme në gjyq, kjo ishte e vetmja pyetje për të çilën ata nuk ishin trajnuar. Pas kësaj, përgjigjet që mund të jepen gjyqtarëve në të tilla raste,zunë një vend të rëndësishëm në edukimin klinik.

Duhet të kuptojmë se detyra primare e nje gjyqtari është të shohë efiçensën e argumentave dhe provave që paraqiten dhe jo të mësojë palët në një konflikt. Në kontrast me qëllimin kryesor të klinikës, që është "të mësuarit", gjyqtarët kanë si qëllim parësor vënien në vend të së drejtës së shkelur. Një gjyqtar i cili përpiqet të kuptojë teorinë e të mësuarit nga eksperienca, duhet të marrë hapat e nevojshëm që salla e gjyqit të jetë një ambient jo vetëm gjyqsor, por edhe edukues per brezat e ardhshëm që dëshirojnë të mësojnë. Në të kundërt ata nuk duhet të ankohen për faktin se avokatët e rinj, që dalin nga bangat e shkollës janë të papërgatitur dhe pa eksperiencë. Nëse ata refuzojnë t`i dëgjojnë studentët tani, nuk do të marrin kënaqësi më vonë nga të dëgjuarit avokatë të papërgatitur.[9]

Studentët nën mbikëqyrje dhe asistent avokatët mund të përfitojnë shumë nga zhvillimi dhe ushtrimi i aftësive të tyre nga marrja e eksperiencës, duke përmirësuar kështu cilësinë e shërbimit që u ofrojnë klientëve. Duke vlerësuar këtë element qëndror të pedagogjisë klinike, disa gjyqtarë mund të vlerësojnë edhe më tepër rolin e tyre ne edukimin dhe afirmimin e avokatëve të rinj. Duke i bërë të kuptojnë më mirë rolin ë tyre në edukimin e të rinjve, që janë pjesë e sistemit ligjor, mund t`i bëjmë ata gjyqatrë që mbajnë një qëndrim skeptik, se edukimi praktik ligjor i këtyre studentëve, nuk është thjesht një detyrë e klinikës së ligjit, por është një synim dhe një përgjegjësi e përbashkët edhe e vetë gjyqatrëve, mbi të çilët bie përgjegjësia për t`i dëgjuar me vëmendje studentët praktikantë.

Aktivitetet e klinikave të ligjit mund të përfshijnë një shumëllojshmëri të ndihmës juridike. [10]

- Këshillim ligjor pa pagesë: Klinika ofron këshillim ligjor për të varfërit / në nevojë, gratë dhe fëmijët. Qendra merr raste të cilat janë të referuara nga organizata të ndryshme sociale dhe gjithashtu ata që paraqiten vetë në qendër duke kërkuar ndihmë. Qendra përpiqet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me

[8] Practise of law by law students , VI, *studentet praktikante ne Dakoten e veriut mund te sterviten ne mbikeqyrje dhe te replikojne ne gjyq,pas vitit te dyte te studimeve.*
[9] See Wenke,*supra* note 4,at 288
[10] A study of law school based on legal service clinics – Studim i Salcaocar College of law, faqe 56.

anë të stafit të saj të specializuar. Studentët janë të përfshirë në të gjitha fazat e procesit për të kërkuar dhe regjistruar marrjen e informacionit nga klienti, kërkime në aspektin ligjor dhe ndihmuar avokatët në gjykatë. Kjo ofron një mundësi shumë të mirë për studentët të fitojnë shkathtësinë e praktikës. Ata mësojnë të marrin udhëzime nga klienti për të gjetur të drejtën, të zbatojnë ligjin për të vendosur në lidhje me trajtimin e fakteve dhe për të sugjeruar rrjedhën e aktiviteteve.

- Programi i mësimit ligjor: arsimimi ligjor është një komponent shumë i fortë i programit të ndihmës juridike, pjesë e klinikës ligjore. Studentët nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e mësuesve kryejne mësim ligjor në kampe dhe grupe pune, veçanërisht në zonat e lagjeve të varfëra, fshatra, organizatat e punës, programet e grave për të informuar njerëzit për të drejtat e tyre. Mësimi ligjor përfshin ato qe njihen si lëndët bazë dhe më të rëndësishme si mbrojtja e konsumatorit, ligjet e tokës, mjedisit, ndalimi i korrupsionit, martesa, divorci, trashëgimia, pretendimet në lidhje me shkaktimin e dëmit etj. Të gjitha këto çështje diskutohen në grupe dhe jepet informacion i dobishëm për njerëzit që nuk e kanë atë. Informacioni jepet nëpërmjet leksioneve, posterave, afishimeve në rrugë, diskutime, etj. Grupet e mësimit ligjor kryhen me ndihmën e punonjësve socialë dhe ndihmës së specializuar që ofrojnë organizatat jo-fitimprurëse. Studentët gjithashtu përfshihen në krijimin e vetëdijes ligjore në shkolla të ndryshme.
- Hulumtime dhe Sondazhe. Klinika e ligjit në mënyrë aktive ndërmerr kërkime dhe sondazhe. Studentët dhe mësuesit janë të inkurajuar për të kryer hulumtime dhe anketa. Anketat dhe sondazhet janë kryer për çështje të ndryshme si: problemet me të cilat ballafaqohen shtresat e varfra të popullsisë; problemet me të cilat ballafaqohen nëpunësit vendas; ndalimi i punës së fëmijëve, mbrojtja e të drejtave të konsumatorit; problemi i ngacmimit seksual të grave në vendin e punës apo çështje të tjera të prekshme në vende të ndryshme. Jo vetëm informacioni i dhënë, por edhe sondazhet dhe studimet do të kryhen në ato çështje që konsiderohen si më të vështirat dhe problematike në një vend të caktuar.
- Peticione me shkrim në lidhje me çështje të interesit publik. Studentët paraqisin konflikte që prekin interesin publik dhe gjithashtu ndihmojë qytetarët të paraqisin peticione me shkrim apo padi për çështje të tilla si të drejtat e personit me aftësi të kufizuara, të drejtat e punëmarrësve apo kategorive të tjera vunerabël. Ata mbledhin informacion, mbledhin prova dhe me anë të dokumentacionit të përgatitur, ndihmojnë avokatët për mbrojtjen e çështjes në gjyq. Ndihma juridike mund të ofrohen edhe me anë të botimit të disa broshurave të hartuara në gjuhë të përditshme me informacion bazë të cilat shpërndahen gjatë programeve të trajnimit ligjor. Në këto broshura janë të publikuara ligjet që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve, mbrojtjen e konsumatorit, ligjet e punës, Kushtetuta dhe të drejtat e njeriut, ligjet penale, etj

- Reforma e Ligjit. Në mënyrë që të inkurajojë dhe të përfshijë studentët e drejtësisë në procesin e të menduarit në lidhje me çështje sociale dhe të drejtësisë, çdo vit përmes një takimi në ambiente të fakultetit, identifikohet një çështje sociale ose ligjore e cila duhet të adresohet për diskutim në këtë takim të zhvilluar. Pas vendosjes në lidhje me këtë temë, i caktohet një detyrë dy ose tre anëtarëve të fakultetit për të ndarë temën në fusha të ndryshme dhe për të formuluar ekipe të studentëve që do të hetojnë, hulumtojnë dhe kryejnë një studim mbi temën e zgjedhur prej tyre. Me afrimin e fundit të vitit shkollor, studimi dhe rezultatet e studentëve paraqiten në formën e një pune kërkimore në një seminar ku diskutohen çështje të ligjit të nivelit shtetëror. Studentët janë të udhëzuar nga fakulteti në çdo fazë. Seminaret e zhvilluara përfshijnë çështje të rëndësishme si të drejtat e njeriut, mbrojtja e konsumatorit, ndalimi i punës së fëmijëve, etj. Në fakt diskutimi përfshin të gjitha ato çështje që janë të një rëndësie të konsiderueshme në vend, dhe kjo varion nga një vend në tjetrin, në varësi të kushteve ekonomike, sociale, kulturore por edhe politike. [11]

Pra, mund të themi se ky është një kuptim i përgjithshëm në lidhje me klinikën e ligjit, misionin që ajo ndjek dhe metodat kryesore. Por, sot klinika e ligjit është integruar në shumicën e fakulteteve të drejtësisë në vende të ndryshme të botës. Edhe pse modeli u mor nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ai është zhvilluar dhe përshtatur në mënyra të ndryshme në shtete të ndryshme. Modelet që ofrojnë sot universitetet perëndimore janë nga më të ndryshmet dhe impakti që ato sjellin në studimin e të drejtës në këto vende është shumë i madh. Madje po t'i referohemi programit të klinikës në këto vende ato kanë karakteristikat e tyre të veçanta dhe shfaqen në një shumëllojshmëri formash dhe aktivitetesh. Gjithashtu vihet re nje interesim gjithmonë e më i madh i studentëve për klinikën dhe përfitimet që ajo ofron.

1. 1. 1 Një trajtim i termave kryesorë të klinikës

Gjatë shqyrtimit të klinikës së ligjit, si pjesë e edukimit juridik të studentëvë të së drejtës do të hasen terma të shumtë, të cilët shpesh mund edhe të ngatërrohen për shkak të ngjashmërisë që paraqesin por edhe për mungesë të përvojës në këtë fushë. Që të kuptohet klinika, objektivat e saj, mënyra e aplikimit dhe rezultatet që sjell është e domosdoshem njohja e këtyre termave për t'u bërë dallimi midis tyre por edhe për të kuptuar më mirë. Më poshtë po trajtojmë disa prej termave më të ndeshur në praktikë si edhe kuptimi i tyre shkencor.

Klinika

Program i aplikuar në shkollat e së drejtës, që i mëson studentëve përvojën me anë të eksperiencës direkte, nën mbikqyrjen e avokatëve dhe profesorëve mbikyqrës, një punë që zakonisht ka në fokus drejtësinë sociale dhe punën në favor të interesit publik.

Klinika live e klientit

[11] http://www.law.harvard.edu/academics/clinical/clinics/

Një program klinike në të cilin studentët krijojnë marrëdhënie avokat-klient direkt me klientë, duke praktikuar gjykimin ligjor dhe performuar shërbime ligjore për këta klientë. E njohur gjithashtu si klinika e" shërbimit direkt".

Klinika praktike

Një program ku studentët punojnë nën mbikqyrjen e avokatëve jo pjesë e klinikës në përvoja praktike jashtë fakultetit me mbikqyrjen edhe të një profesori mbikqyrës të klinikës. Studentët mund të punojnë në këtë program klinike, por mund të kryejnë edhe detyra të tjera të ndryshme nga përfaqësimi i klientit, duke shpenzuar më shumë kohë në vëzhgimin se sa në aplikimin e detyrave ligjore.

Klinika hibride

Klinika që ofrojnë praktika, modele të shërbimit direkt, dhe përqasje të tjera. Për shembull një program ku studentët kryejnë praktikën në një zyrë avokatie jashtë shkollës, por nën mbikëqyrjen direkte të profesorëve të klinikës.

Klinika e shtëpisë

Ky është një term i përdorur për të treguar se klinika organizohet dhe mbikëqyret e gjitha nga fakulteti pa ndërhyrjen e aktorëve të tjerë. Ky program është në kontrast me format e paraqitura më lart.

Stimulimi

Stimulimi është një metodë e përdorur për të treguar modele të ndryshme sjelljesh të aplikuara në klasë, shpesh të izoluara nga praktika ligjore, ku përdoren kazuze apo raste për diskutim në klasë, duke praktikuar hartimin e dokumentave ligjorë, intervistën e klientit, këshillimin ligjor etj.

Praktika

Një ndërthurje e marrjes së dijeve teorike dhe praktimit të tyre në praktikë, kryesisht në atë fushë ligjore. Zakonisht nuk përfshin procesin gjyqësor por mund të përfshijë planifikimin, organizimin ose avokatinë informale.

I mësuari nga praktika

Një metodologji që i jep mundësi studentëve të mësojnë duke kryer detyra të caktuara praktike në lidhje me ligjin, si në rastet e stimulimit të gjyqeve në klasë, ashtu edhe në programet e klinikës. Zakonisht kemi të bëjmë me një metodë akademike që përfshin diskutimin në klasë dhe mbikëqyrjen.

I mësuari reflektiv

Kjo është një metodë mësimi por edhe mësimdhënie në të cilën studentët mendojnë, flasin dhe shkruajnë bazuar në eksperincën e tyre të klinikës. Zakonisht reflektimi ndodh

nën mbikëqyrjen e një profesori të klinikës por mund të jetë edhe i vetdrejtuar nga studentët. Mënyrat e realizimit të tij në praktikë përfshijnë gazetat, intervistat personale, mbikëqyrjen e rasteve dhe diskutimin në grup.

Mbikëqyrja e rasteve

Kjo metodë lidhet me diskutimin nga studentët dhe profesori i klinikës të aspekteve ligjore, strategjike dhe të sjelljes mbi përfaqësimin e një klienti.

Mësimdhënia direkte ose jo-direkte

Në mësimdhënien direkte, mësuesi i jep studentëve pyetje në një mënyrë pak a shumë direkte. Në atë jo-direkt pyetjet e drejtuara studentëve paraqiten në mënyrë më pak direkte me anë të sugjerimeve, apo pyetjeve të tërthorta. [12]

1. 2 Si lindi klinika ligjore?

Fryma e parë e klinikës ligjore lindi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fillim të shek. XX, shumë shpejt pasi metodat e librave me kazuze të së drejtës në fund të viteve 1980' shërbyen si një metodë për zhvillimin e karrierës në fushën e të drejtës. Metoda mbi librat me kazuistikë e vinte theksin te apelimi i vendimeve të padrejta dhe metoda sokratike, e cila shërbeu si një largim nga metodat ekzistuese në sistemin ligjor amerikan në fund të shek. XIX. Kjo metodë filloi të fitonte përkrahje të madhe në gjirin e studentëve dhe shumë prej tyre dolën vullnetarë të punon në zyra avokatie, pa pagesë, ndërkohë që fitonin aftësi të analizës ligjore dhe të të bërit avokati duke ofruar ndihmë juridike falas për disa shtresa të popullsisë që nuk kishin mundësi të përfitonin një të tillë kundrejt pagesës.

Me ndryshimet e sistemit mësimor në Amerikë, në fillim të shek. XX lindi nevojë për të parashikuar praktikën ligjore si pjesë të edukimit juridik, e cila do t'i vintë në ndihmë studentëve, krahas metodave të mësimdhënies me anë të librave. Pas kurseve 4 vjeçare në Fakultetet e së drejtës në SH. B. A, si ai Kalifornisë, Yale-it, nevoja për praktikë ligjore u bë urgjente dhe e domosdoshme.

Klinikat e ligjit u krijuan për të ofruar ndihmë juridike falas për komunitetin, ku natyrisht ata që do të përfitonin do të plotësonin disa kritere në mënyrë që të kategorizoheshin si shtresa vunerabël. Juristët e rinj që u punësuan aty do të merrnin një pagesë të njëjtë me atë të nëpunësve të thjeshtë dhe do të punonin nën mbikqyrjen e një profesori të klinikës. Në këto klinika ligji iu kushtua një rëndësi shumë e madhe ofrimit të vlrerave të rëndësishme për komunitetin dhe ato përbëheshin nga specialistë të disa fushave të së drejtës.

Në 1921 Fondacioni për Avancimin e Mësimdhënies në Sh. B. A realizoi një studim mbi klinikën e ligjit, të quajtur" The Reed report" i cili parashikoi tre cilësi kryesore të

[12] Manual për profesorët e rinj të klinikës – botim i Shoqatës për Edukimin e klinikës së ligjit- maj 2009, faqe 10.

nevojshme për të përgatitur studentët për praktikën juridike; edukim i përgjithshëm, njohuri teorike të së drejtës dhe aftësi praktike. Këto cilësi, sipas këtij raporti ishin elementët bazë ku duhet të mëshohej në mënyrë që të përfitoheshin student të aftë jo vetëm për të njohur por edhe për të praktikuar të drejtën.

Por, pavarësisht fillimeve të hershme, klinika ligjore në këtë formë që njihet dhe aplikohet sot në SH. B. A, nisi në vitin 1960. Ajo u përhap në masë të gjerë, në vitet 1970', rreth 125 shkolla të së drejtës deklaruan se kishin të implementuar në sistemin e tyre arsimor një formë të klinikës së ligjit. Shumë prej tyre përfituan nga Fondacioni Ford, me angazhimin që do të ofronin konsulencë juridike falas për një pjesë të popullsisë. [13] Duke qënë se ky Fondacion përfundoi në fund të viteve 1970' lindi nevoja për të rivlerësuar dhe reformuar klinikën e ligjit në sistemin arsimor amerikan.

Megjithëse Amerika është i pari vend ku lindi, u formua dhe u zhvillua klinika e ligjit, nuk mund të mohohet edhe ndikimi që kanë pasur zhvillimet në vende të tjera, të sistemit Common Laë dhe Civil Laë. Këtu përmendim zhvillimin e klinikës së ligjit në Britaninë e Madhe, Çeki, Poloni, Rusi, Francë, etj. Megjithatë në këto vende zhvillimet e klinikës janë shumë më të vona, ato datojnë pas viteve 1990 ', madje edhe pas viteve 2000' ku klinika e ligjit u konsolidua si pjesë e sistemit të tyre të brendshëm akademik me ndikim të konsiderueshëm në përgatitjen e studentëve.

1. 3 Street Law – E drejta e aplikuar në rrugë

E drejta e aplikuar në rrugë është një metodë mësimdhënëie që i drejtohet grupeve të caktuara duke përdorur metodologji interaktive të mësimdhënies. Elementët e praktikës së ligjit përfshijnë për të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut, të drejtat civile, parimet kushtetuese, zgjidhjen e konflikteve, procesin e avokatisë, të drejtën civile dhe penale, të drejtën e punës, të drejtën familjare dhe të drejtat e konsumatorit.

Një nga qëllimet më të rëndësishme të klinikës së ligjit është promovimi pozitiv për përfshirjen në çështjet publike. Synohet të përmirësohet procesi i avokatisë, ose si përfshirja qytetare mund të ndikojnë në procesin ligjvënës. Në demokracinë tonë, qytetarët janë përgjegjës për të bërë ligjin, zakonisht nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesuesit së tyre. Ndërsa votimi është, natyrisht, një detyrim i rëndësishëm i qytetarisë. Roli i një individi ligjbërës është shumë më i gjerë se sa votimi. Qytetarët janë gjithashtu përgjegjës për të punuar për të ndryshuar ligjet që nuk po ndihmojnë për të zgjidhur problemet dhe duke punuar për ligje dhe politika të reja që adresojnë probleme në komunitetet e tyre, qytetet, shtetet.

[13] Fondacioni Ford është një fondacion me seli dhe i orientuar globalisht New York me misionin e avancimit të mirëqenies njerëzore. Krijuar në 1936 nga Edsel Ford dhe Henry Ford, ishte e financuar fillimisht nga një dhuratë 25.000 USD nga Edsel Ford. Me 1947, mbas vdekjes së dy themeluesit, fondacioni mori në pronësi 90 për qind të aksioneve pa të drejtë vote të Ford Motor Company. (Familja Ford mbajti aksionet e votimit për veten e tyre.) Në mes të viteve 1955 dhe 1974, fondacioni i shiti pronat e tij Ford Motor Company dhe tani nuk luan asnjë rol në këtë kompani të automobilave. Për vite të tëra, fondacioni ishte më i madhi, dhe një nga fondacionet më me ndikim në botë, me shtrirje globale dhe interes të veçantë në fuqizimin ekonomik, arsim, të drejtat e njeriut, demokracinë, artet kreative, dhe zhvillimin e vendeve të Botës së tretë.

Kjo qasje filloi në 1972 në Universitetin Xhorxhtaun në Sh. B. A ku dërgoheshin studentët e ligjit në shkollat e mesme në Washington DC për t'i mësuar të drejtën nxënësve aty. Street LaW Inc. është një program i Xhorxhtaun i cili zhvillon dhe zbaton programe të mësimit praktik të ligjit në gjithë botën.

Street law bashkon studentët e së drejtës, nxënësit e shkollave të mesme dhe anëtarë të komunitetit për të eksploruar të fshehtat e ligjit, edukimin publik dhe përmirësimin e komunitetit duke përdorur metoda të mësimit praktik.

Programi i klinikës Street Law ofron zakonisht dy metoda; programi i klinikës për komunitetin si dhe programi për nxënësit e shkollave të mesme. Të dy klinikat ofrojnë një mundësi unike për studentët e drejtësisë për progres në zhvillimin e tyre profesional, ndërsa në të njëjtën kohë duke siguruar një shërbim ligjor për komunitetin. Studentët e drejtësisë janë komponent qendror në avancimin e këtij qëllimi: 1) Në Klinikën Street Law për shkollat e mesme, studentët e drejtësisë mësojnë një ose dy semestra praktikën e ligjit nxënësve në shkollat e mesme 2) Në Klinikën Street Law për komunitetin studentët e drejtësisë mësojnë një semestër drejtësinë praktike për nxënësit e rritur, prindërit kryesisht të pastrehë apo që ndodhen në streha të posaçme për shkak të gjendjes së tyre. Përveç kësaj, anëtarët e klinikave kanë marrë pjesë edhe në një shumëllojshmëri të programeve të tjera në shërbim të komunitetit.

Street Law ka në fokus kuptimin e ligjit dhe çështjeve ligjore nga komuniteti i gjerë në mënyrë që të lehtësojë punën e tyre të përditshme duke qënë se ata do të përballen në çdo aspekt të jetës së tyre me ligjin. Veçanërisht të rëndësishme janë fushat e konsumatorit, strehimi, familja, punësimi. Kalimi i të rinjve nga jetesa me prindërit e tyre për të jetuar vetëm apo edhe duke krijuar familjet e tyre e bëjnë të domosdoshëm ndërgjegjësimin mbi të drejtat themelore të njeriut nga këta subjekte dhe kjo njohje realizohet nga klinika e ligjit. Ajo synon t'i ndihmojë këta individë në çështjet e rëndësishme në jetën e tyre për të promovuar njohje të shëndetshme për politikat publike dhe ligjit.

Përveç kësaj, Street law prezanton studentët me ligjin penal, atë civil dhe ligjin kushtetues, parimet bazë të së drejtës dhe ofron një platformë për diskutimin e drejtuar nga çështjet e rëndësishme të politikave publike që kanë të bëjnë me krimin, diskriminimin, kujdesin shëndetësor, dhe emigracionin. Këto diskutime kanë kontribuar në ndërtimin e grupeve me pjesëmarrës të studentëve të së drejtës dhe anëtarëve të komunitetit bazuar në vlera të rëndësishme si mirëkuptimi, toleranca, udhëheqja dhe një angazhim për drejtësi shoqërore duke ekspozuar studentët drejt një game të gjerë të pikëpamjeve dhe përvojave.

Një kurs i klinikës së ligjit përdor raste studimore, ushtrime ligjore, ushtrime në grupe të vogla dhe analitike duke menduar probleme për të zhvilluar aftësitë e të menduarit të nivelit të lartë që përgatisin nxënësit për përvojat e tyre univeristare. Programi i klinikës së ligjit në shekullin XX parasheh një formë të re, më aktive dhe pjesëmarrjen e gjerë të qytetarëve.

Në kohët e fundit, shkencëtarët politikë dhe analistë socialë kanë paralajmëruar periodikisht se një pjesë e madhe e vendeve të botës, përfshirë SHBA janë shndërruar në ”kombe të spektatorëve, ” kombe të njerëzve të shkëputur nga qeveritë, komunitetet dhe njëri-tjetri. Si pasojë, klinika e ligjit siguron një kornizë gjithëpërfshirëse për studentët që të bëhen më shumë pjesëmarrës aktivë në zhvillimin dinamik të demokracisë në shoqërinë tonë. Të gjitha gjeneratat e studentëve të universitetit dhe familjet e tyre do të përfitojnë nga pasuria e ofruar nga programet e klinikës së ligjit.

Klinika e ligjit jo vetëm fton studentët për të studiuar drejtësi dhe çështjet ligjore që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme, por i nxit ata të identifikojnë edhe sfidat dhe të propozojnë zgjidhje për problemet që çdo ditë ata, familjet apo komuniteti e tyre mund të përballet.

Kursi i klinikës së ligjit promovon njohuri të ligjit nga nxënësit, pjesëmarrjes së komunitetit dhe individiwt me anë të procesit të avokatisë në komunitet duke përdorur tri strategji kryesore: [14]

1. Zhvillimi i njohurive të rëndësishme e thelbësore të parimeve të së drejtës që lidhen me çështjet reale që mund të ndikojnë në jetën e përditshme të nxënësit, familjeve dhe komunitetit. Kjo vetëdije rrit kapacitetin e nxënësit për të identifikuar fushat më problematike që lidhen me qeverisjen dhe ndihmon komunitetin të përfitojë nga njohuritë e nxënësve dhe kontributet personale.
2. Rritja e aftësive të nxënësve të mendojnë në mënyrë kritike, për të zgjidhur problemet ligjore, të komunikojnë në mënyrë efektive duke përdorur avokatinë me gojë dhe me shkrim, dhe të demonstrojnë aftësi duke përdorur strategji të ndrsyhme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
   Kjo qasje sjell fuqizimin dhe zhvillimin e besimit te studentëve në veten e tyre dhe përmirësimin e aftësive vendimmarrëse, të nevojshme për postet e ardhshme udhëheqëse në qeveri dhe komunitet.
3. Përfshirja dhe inkurajimi i nxënësve në mënyrë të drejtpërdrejtë në komunitetin lokal duke integruar komunitetin në aktivitetet dhe mësimni në klasë për të nxitur të mësuarit aktiv eksperimental.

Një theks i rëndësishëm vihet në procesin e avokatisë me anë të shkëmbimit individual të eksperiencave duke ftuar ekspertë të lëndës që ndajnë ekspertizën e tyre për një varg të çështjeve sociale. Kjo qasje ndërthur teorinë me aplikimin praktik të së drejtës për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë perspektiva pozitive ndaj publikut me anë të shërbimit dhe politikave publike si dhe të krijojnë një zë lokal për të adresuar shqetësimet e komunitetit.

Street Law, Inc është një organizatë jofitimprurëse që u rrit dhe u zhvillua nga një program i arsimit juridik publik në Universitetin Xhorxhtaun në Sh. B. A. Që nga viti

[14] STREET LAW: To understand law and legal issues - Copyright © 2011 botim i The McGraë-Hill Companies, Inc.

1975, Street Law ka siguruar materiale edukative në lidhje me ligjin e aplikuar në praktikë, demokracinë, të drejtat e njeriut dhe për studentët e të gjitha moshave në të gjithë Shtetet e Bashkuara dhe nëpër botë. Përveç tekstit të studentëve, ka manuale për një mësimdhënie të plotë dhe faqe interneti të përditësuar me burime suplementare, mbështetja me anë të një fjalori, karikatura politike, aktivitetet e analizës të të dhënave, dhe një bankë elektronike e pyetjeve të testit.

1. 3. 1 Qëllimet e klinikës Street Law

Dy qëllimet kryesore të klinikës janë :

- Edukimi në lidhje me ligjin dhe të drejtën për të rinjtë që janë pjesë e komunitetit;
- Sigurimi i një zhvillimi profesional i studentëve të së drejtës gjatë praktikës së tyre.

Pra, përfitimet e klinikës janë të dy anëshme. Jo vetëm që synohet të ndërgjegjësohen dhe t'i mësohen elementët bazë të së drejtës të rinjve në veçanti dhe komunitetit në përgjithësi, por nga ana tjetër kjo synon edhe përmirësimin profesional të studentëve të së drejtës.

Qëllimi i rëndësishëm i edukimit klinik është që t'ju mësojë studentëve konceptet e drejtësisë sociale e cila shtrihet në dy fusha: 1. T'u vësh në dukje studentëve shtrirjen e sistemit ligjor, vendin dhe rolin e tij në shoqëri dhe 2. Ti sfidosh ata për të menduar në mënyrë kritike ndaj sistemit.[15]

Mendimi kritik ka treguar mënyra për të identifikuar, diskutuar dhe debatuar punën e avokatëve në aspektet teknike dhe sociale.[16]

Sigurisht përveç pjesës kritike të të mënduarit qëllimi i drejtësisë penale përfshin edhe një angazhim nga ana e Klinikës për ofrimin e shërbimeve ligjore për ata persona aksesi i të cilve në drejtësi është i kufizuar. Dhe sigurisht, edukumi klinik shfaqet pjesërisht "nga dëshira pë të rilidhur studentët me drejtsinë sociale".[17] Në literaturën klinike dhe në praktikë klinicistët ngrenë pyetjen nëse qëllimi kryesor i edukimit klinik është mësimi dhe trajnimi i avokatëve të rinj apo promovimi I drejtësisë sociale apo një kombinim i të dyjave.[18] Disa dijetarë shkojnë aq larg sa thonë se pedagogët e klinikës dhe avokatët kanë për detyrë të ekspozojnë sudentët ndaj padrejtësisë dhe të kuptojnë rolin që ata do të marrin në të ardhmen në punën e tyre qoftë pro ose kundër padrejtësisë. Nëpërmjet projekteve klinika angazhon studentët në zgjidhjen e problemeve komplekse, të menduari strategjik, negocomin, menaxhimin e projekteve dhe aftësitë komunikuese, gjithashtu klinika i vendos studentët përballë padrejtësive dhe tregon fuqinë e tyre si reformues dhe avokatë të drejëtsisë sociale. Mësimet dhe aftësitë e mësuara nëpërmjet projekteve të

[15] Po aty
[16] Po aty, fq 495-496
[17] Po aty, fq 496
[18] Anna E. Carpenter, "The Project Model of Clinical Education: Eight Principes to Maximize Student Learning and Social Justice Impact", fq 53-54

ngritura nga klinika nuk mësohen në asnjë shkollë të drejtësisë dhe veçanërisht në rrugë eksperimentale.[19]

Drejtësia sociale është një term që nuk është i përcaktuar në mënyrë të qartë. Ajo është e lidhur zakonisht me politikat progressive dhe axhendën për reformat ligjore. Axhenda e edukimit klinik për drejtësinë sociale kërkon të promovojë barazine substanciale, mundësi të barabarta dhe kapërcimin e shtypjes ligjore, sociale dhe politike si dhe ndikimin e shtypjes. Gjithashtu, drejtësia sociale në edukimin klinik është ngushtësisht e lidhur me vlerat e pjesmarrjes demokratike.[20]

Ekziston një konsensus i plotë ndërmjet dijetarëve se misioni i drejtësisë sociale është thelbi i edukimit klinik.

Sipas dijetarëve të ndryshëm drejtësia sociale duhet të përparojë. Shumë dijetarë kanë dhënë mendime të ndryshme për mënyrën sesi duhet të përparojë drejtësia sociale. Disa flasin për avancimin e drejtësisë sociale nëpërmjet punës substanciale në klinik, pavarësisht shërbimeve ligjore civile apo penale. Të tjerë flasin për përparim të drejtësisë sociale nëpërmjet përgatitjes së avokatëve të varfërisë. Këta janë avokatë që do të punojnë fort dhe luftojnë për të siguruar aksesin e shtresave në nevojë në drejtësi. Një tjetër autor sygjeron tre aspekte kryesore mbi bazën e të cilave mund të arrihet përparimi i drejtësisë sociale. Këto tre aspekte janë:

1- Shërbimi. Aspekti i parë i misionit të drejtësisë sociale është shërbimi ose e mira që klinika ju ofron në mënyrë të drejtpërdrejt individit, shoqerisë ose kolektivit. Klinika është aty ku punohet ditë për ditë për të rritur aksesin në drejtësi, për të siguruar shërbime ligjore për të varfërit dhe për të nënpërfaqësuar klientët, organizatat jo-fitimprurëse ose grupet komunitare.[21]

2- Reforma. Reforma nënkupton përpjektjet e klinikës, që nëpërmjet projekteve ligjore apo strategjive të tjera ligjore, të ndikojë te sistemi ligjor për ndryshime ligjore.

3- Vlera. Vlera përfshin rolin e klinikës në angazhimin që kanë studentët e saj ndaj drejtësisë sociale me shpresën se ata do të vënë re padrejtësitë dhe nëpërmjet karrierës së tyre të bëhen sfidues të drejtësisë dhe të ndërmarrin akte që sjellin ndryshime.[22] Një eksperienc në klinikën ligjore mund të ndikoje te studentët në angazhimin e tyre për të kryer gjatë karrierës së tyre si avokat shërbime pro bono ose të shnderrohen në avokat të shtresave në nevojë.[23]

[19] Anna E. Carpenter, "The Project Model of Clinical Education: Eight Principes to Maximize Student Learning and Social Justice Impact", fq 54
[20] Po aty, fq 55
[21] Po aty, fq 56-57
[22] Jane H. Aiken, "The Clinical Mission of Justice Readiness", fq 231
[23] Anna E. Carpenter, "The Project Model of Clinical Education: Eight Principes to Maximize Student Learning and Social Justice Impact", fq 57

Në fillimet e veta edukimi klinik përfshinte ose fokusohej vetëm tek shërbimet dhe reforma.[24] Sot puna e klinikave përfshin dy ose më shumë aspekte të drejtësisë sociale.[25]

Street Law ka në fokus kuptimin mbi ligjin dhe çështjet ligjore, është një kurs I përqendruar në zhvillimin tek nxënësit e njohurive dhe aftësive të nevojshme për të jetuar në shoqërinë tonë. Ky kurs ka objektiv :

• të sigurojë një kuptim praktik të ligjit dhe sistemit ligjor që do të jenë të dobishme për nxënësit në jetën e përditshme;

• të përmirësojë kuptimin mbi parimet dhe vlerat themelore të Kushtetuës, ligjeve dhe sistemit ligjor në përgjithësi;

• të zhvillojë një vullnet dhe një aftësi për të zgjidhur mosmarrëveshjet përmes mjeteve informale dhe ku është e nevojshme duke përfshirë edhe mekanizmat formal;

• të angazhojë nxënësit në një kuptim praktik të ligjit dhe sistemit ligjor me metoda interaktive dhe të përqëndrohet në çështjet ligjore përkatëse të cilat studenti i përjeton gjatë jetës së tij;

• të përfshijë nxënësit me temat aktuale në lidhje me zbatimin e ligjit të tilla si; krimi kibernetik, vjedhja e identitetit, pronësia intelektuale, ndalimi i terrorizmit, emigracionit dhe shumë çështje të tjera.

• të zhvillojë aftësitë analitike të nxënësit duke pasur parasysh aspektet ligjore dhe sociale, çështjet ekonomike, morale dhe politike përmes aktiviteteve të tilla si gjyqe imituese dhe stimulim i problemeve ligjore;

• të ndihmojë për të shqyrtuar çështje bazuar në raste studimore, të përdorë hulumtimin hetues, dhe diskutimet mbi çështje aktuale ligjore.

Studentët e drejtësisë të përfitojnë në mënyra të ndryshme nga përvoja e tyre klinike.

Për shembull, klinika i mundëson atyre :

- Të fitojnë një njohuri më të madhe të drejtës materiale dhe procedurale gjyqësore duke i mësuar në lidhje me tema të caktuara ligjore;
- Zhvillimi i guximit dhe aftësinë në prezantim me gojë, si në prezantimet formale dhe duke i menduar dhe përgatitur vet ato,
- Mësojnë për të shpjeguar ligjin në terma ligjorë të komunitetit duke studiuar sistemin ligjor në kontekst të këtyre personave të prekur direkt, dhe duke shqyrtuar realisht koncepte të gjera të tilla si drejtësisë dhe paanësisë;
- Zhvillojnë aftësitë e planifikimit dhe të përgatitjes dhe të përmirësuar aftësitë hulumtuese ligjore;

[24] Barry, "Question of Mission"
[25] Anna E. Carpenter, "The Project Model of Clinical Education: Eight Principes to Maximize Student Learning and Social Justice Impact", fq 57-58

- Mësojnë të ofrojnë personalisht një shërbim të dobishëm publik me rezultate të menjëhershme për komunitetin.

Klinika Street Law i ndihmon nxënësit e shkollave të mesme : [26]

- Për të përjetuar pasojat e përditshme të ligjit në jetën e tyre;
- Për të kuptuar vlerat dhe forcat që formësojnë ligjin;
- Për të zbuluar mekanizma nëpërmjet të cilave është formuar një shoqëri e së drejtës
- Për të zhvilluar aftësi akademike, të menduarit kritik, aftësitë qytetare dhe të komunikimit.
- Klinika, me fokus të saj në edukimin e përqendruar tek nxënësi, krijon një mjedis në klasë që fton nxënësit të mësojnë nga njëri-tjetri permes :
- Ekspozimit ndaj koncepteve komplekse ligjore;
- Përfshirja në role, gjyqe imituese, dhe diskutime në grupe të vogla, dhe
- Reflektimi mbi zbatimin e parimeve ligjore në jetën e tyre.

Nxënësit e shkollave të mesme që kanë marrë kursin një vjeçar të Street Law kanë mundësi të studiojnë drejtësinë, dhe nxënësit të zhvillojnë aftësitë bazë akademike të tilla si lexim, shkrim, dëgjim, të shprehurit me gojë, zgjidhjen e problemeve, dhe të menduarit analitik. Për më tepër, objektivat e kurseve të klinikës së ligjit synojnë edukimin e gjerë të komunitetit me vlerat bazë të shoqërisë.

Në rrjedhën e këtij objektivi, me anë të programit të klinikës Street Law, nxënësit e shkollave të mesme mësojnë :

- Strukturën themelore të sistemit ligjor, duke përfshirë marrëdhëniet mes legjislaturave, gjykatat, dhe agjencitë, dhe se si qytetarët kanë të bëjnë me proceset ligjvënëse të çdo dege të qeverisë;
- Të drejtat themelore kushtetuese;
- Ligjet dhe proceset e përfshira në sistemin e drejtësisë penale dhe të miturit, si dhe ato që kanë të bëjnë me çështje të konsumit, çështjet familjare, strehim, dhe të drejtave individuale;
- Funksionni dhe funksionimin e sprovave dhe procedurave të tjera ligjore.

Përveç kësaj, nxënësit në kurset e klinikës së ligjit fitojnë aftësitë e nevojshme që qytetarët të veprojnë në mënyrë efektive brenda sistemit ligjor. Ata mësojnë të :

- Kuptojnë dhe të përdorin terminologjinë themelore ligjore;
- Lexojnë duke kuptuar në mënyrë të qartë dhe të plotë institute ligjore të tilla si kontratat, formularët për ankesa të vogla drejtuar gjykatës dhe aplikimet e kreditit;

[26] Programi i Street Law Clinic i marre nga programi akademik i Gorgetown University. http://www.law.georgetoën.edu/academics/academic-programs/clinical-programs/our-clinics/DC-Street-Law-Program/about-our-clinic.cfm

Si t'i përgjigjen në mënyrën e duhur pyetjeve të policisë dhe oficerëve të zbatimit të ligjit;

- Të zgjidhin drejtimet e veprimit për të shmangur problemet e mundshme ligjore, p. sh. , si konsumatorë, të mësuarit për të inspektuar para blerjes;
- Si të kërkojnë zgjidhje të përshtatshme për problemet juridike, p.sh. të mësojnë të shkruajnë kërkesa efektive ankimore.

Edukimi klinik ka si qëllim kryesor që t'ju mësoje dhe t'i nxisë studentët për të analizuar punën dhe rolin e avokatit dhe procesit ligjor. Ky qëllim përfshin dy komponentë kryesor, komponentin aftësive dhe komponentin e zhvillimit profesional, vlerave. Disa i shohin këto komponete në lidhje me njërit tjetrin disa të tjerë i shohin ata të ndryshëm. Gary Bellow e përshkruan edukimin klinik si zgjerim të perspektivave dhe zhvillim të gjykimit, disiplinës dhe intelektit.

Pedagogët e klinikës bëjnë një ndarje të procesit ligjor në disa pjesë përbërëse dhe pastaj propozojnë ide dhe teori në lidhje me atë që përbën ecurinë e cilësisë së lart të këtij komponenti. Kështu, pedagogët e klinikës zgjerohen në idenë se procesi ligjor është një proces i përbërë nga aftësi të dallueshme dhe të ngjashme duke i inkurajuar studentët të bëjnë kërkime të mëtejshme rreth procesit që përdorin avokatët për të gjetur mundësi dhe hapësirë, për të menduar ndryshe ose në mënyrë kritike rreth një çështje ligjore, për të bindur gjykatën që të përkrahi dhe adoptojë këtë pikëpamje.

Edukimi klinik i vendos studentët perballë aftësive për të identifikuar, pyetur dhe hetuar thellë në kompleksitet, për të përvetësuar praktikën përmes së cilës rregullat ligjore marrin kuptim nëpëermjet aktiviteteve interpretuese të avokatëve.

Nxënësit kanë mundësi të mësojnë të shqyrtojnë politikat themelore dhe vlerat për të vlerësuar se çfarë duhet të jetë ligji. Për shembull studentët janë të inkurajuar për të përdorur njohuritë dhe përvojën e tyre për të vlerësuar ligjet dhe politikat e ndërlidhura të tyre, arsyetimin dhe vlerat. Për shembull, kur nxënësit të shqyrtojnë një problem të veçantë, u kërkohet të mendojnë për këtë në kushtet e tyre dhe pastaj nga pika të tjera të mendimit.

Ata duhet të përcaktojnë dhe të zbatojnë ligjin e duhur, të përcaktojnë mjetet juridike në dispozicion, dhe të diskutojnë shqetësimet shpesh - konkurruese të politikës, interesat shoqërore dhe vlerat themelore mbi të cilat bazohen këto politika.

Si dhe duke studiuar të drejta specifike kushtetuese, studentët hetojnë nëse qëllimet e tilla si barazi, procesi i rregullt ligjor, dhe drejtësia janë arritur.

Studentët mund të studiojnë se si sistemi ligjor balancon vlerat konkurruese që janë në konflikt. Për shembull, nxënësit të shqyrtojë se si " liria e fjalës" mund të vendosen në balancë kundrejt interesave të shoqërisë duke e kufizuar këtë të drejtë kur bëhet fjalë për përhapjen e fjalëve të dëmshme, fyese, të rrezikshme apo që cënojnë interesat e komunitetit.

Kurset e Street Law për të përmbushur këto objektiva përdorin një shumëllojshmëri të metodave të përqendruara tek nxënësi, duke përfshirë krijimin e roleve, simulimeve, diskutimeve në grup, ligjëratave, rasteve studimore, aktiviteteve të ndryshme, pjesëmarrësit e ftuar, udhëtime në terren, dhe simulimet e proceseve ligjore.[27]

Elementi kryesor i programit është një konkurs vjetor në shkallë qyteti që konsiston në një imitim gjyqi. Nxënësit e shkollave të mesme luajnë rolet e avokatëve dhe dëshmitarëve në një rast hipotetik sjellë para gjykatësve aktuale në Gjykatën e Lartë. Përveç të mësuarit e komunikimit dhe aftësitë e përgatitjes, procedurat e gjykimit, dhe punën në grup, studentët praktikojnë spektrin e aftësive njohëse duke kuptuar një model të komplikuar në fakt, aplikojnë faktet duke analizuar dhe vlerësuar çështjet faktike dhe ligjore, dhe sintetizojnë komponentët e shumta në një prezantim të unifikuar.

Klinika e ligjit e modeluar për t'i ardhur në ndihmë shkollave të mesme, është një kurs në lidhje me ligjin që prek jetën e përditshme të çdokujt, ofruar për nxënësit e rritur. Studentët e drejtësisë mund të angazhohen dhe një pjesë të kohës së tyre t'ia kushtojnë mësimit të së drejtës dhe aplikimit të saj në praktikë për anëtarët e komunitetit.

Klinika e ligjit fokusohet në aspektet praktike të ligjit që prekin jetën e përditshme të pjesëmarrësve, duke përfshirë kërkesat para gjykatave, të drejtat dhe detyrimet midis pronarit – qiramarrësit në kontratën e qirasë, përfitimet publike, lufta kundër dhunës në familje, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, mbrojtjen e konsumatorit, arsimi, dhe tema të tjera. Kursi përdor metoda interaktive, të cilat promovojnë debatin dhe sigurojnë lexim autentik, kuptimplotë dhe mundësitë e të shkruarit. Me anë të këtyre metodave, synohet që pjesëmarrësit të zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësitë e komunikimit.

Pra, klinika e ligjit nuk fokusohet në çdo aspekt të ligjeve por vetëm ato që janë më të prekshme për qytëtarët e thjeshtë duke u munduar t'i orientojë ata se si të veprojnë në situata delikate dhe se ku të kërkojnë ndihmë. Pra, klinika e ligjit ka në fokus komunitetin duke mbajtur në vetvete një element të rëndësishëm social.

1. 3. 2 E drejta për ndihmë ligjore - standardet ndërkombëtare

Është e drejta për ndihmë juridike pjesë e të drejtave themelore të njeriut? A është e garantuar me Kushtetutë dhe dispozitat e së drejtës ndërkombëtare? Ekzistojnë normat ligjore detyruese që do t'u sigurojnë qytetarëve të paktën një standard minimal të ndihmës ligjore dhe cili do të ishte ky standard? [28]

Deklarata Universale e të drejtave të Njeriut parashikon se"të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji". [29] Ajo gjithashtu

[27] Carolyn Grose, "Beyond Skills Training, Revisited: The Clinical Education Spiral", fq 496

[28] Cf. H. Brayne, Është ndihma ligjore një e drejtë e njeriut?, "The Law Society Gazette" 25 janar, 1989.
[29] Neni 7 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

formulon të drejtën për gjykim të drejtë [30]. Dokumenti nuk parashikon asnjë detyrim të dhënies e ndihmës juridike, megjithatë ai ka theksuar se të gjithë individët gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Deklarata, pa asnjë lloj diskriminimi. [31] A mund të flasim për barazinë para ligjit, të mbrojtjes së barabartë ligjore, e drejta e barabartë për një gjykim të drejtë të njerëzve të cilët dy të mungesës së mjeteve, nuk mund të përfitojnë nga ndihma juridike? Është mungesa e aksesit në ndihmën juridike një akt që çon në diskriminimin e më të varfërve? Të gjitha këto janë pyetje që lindin po të shohim dispozitat e Deklaratës por edhe po të bëjmë një reflektim se sa mund të zbatohen njësoj për të gjithë këto të drejta dhe liri themelore, përfshirë këtu ndihmën juridike, që është edhe objekt trajtimi.

Një dokument tjetër akti i Kombeve të Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe politike. Ky akt në mënyrë të ngjashme me Deklaratën Universale, parashikon garancitë dhe të drejtat themelore, ndër të cilat përmendim të drejtën për një gjykim të drejtë :" Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij, ose të drejtat dhe detyrimet e tij në një proces ligjor"[32]. Ajo gjithashtu ndalon diskriminimin e çdo lloji, duke përfshirë edhe diskriminimin kundër statusit financiar, në ekzekutimin e të drejtave të njohura nga Konventa. Konventa gjithashtu parashikon të drejtën për mbrojtje në akuzat penale, personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore të zgjedhur ng vetë personi i pandehur. Në lidhje me këtë të drejtë lind pyetja nëse duhet të caktohet ndihma ligjore falas për të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmën profesionale të avokatit mbrojtës dhe që nuk mund të përballojnë financiarisht ta paguajnë atë.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një instrument tjetër i Këshillit të Europës, e cila është e detyrueshme për tu zbatuar nga shtetet ratifikuese, formulon të drejtën e të gjithë të akuzuarve për një vepër penale për asistencë ligjore, përmes avokatit mbrojtës që e zgjedhin vetë, ose avokatit kryesisht të caktuar nga organet kompetente në qoftë se ata nuk kanë mjete për të siguruar vetë ketë ndihmë ligjore ose ndihma e ofruar " *në qoftë se është në interes të drejtësisë*". Në këtë rast lind pyetja cilat janë situatat në të cilën" interesat e drejtësisë" kërkojnë dhe e bëjnë të nevojshme caktimin e ndihmës ligjore falas?

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg ka theksuar një numër të elementeve të cilat duhet të merren në konsideratë përveç mungesës së mjeteve financiare si shkak për caktimin e ndihmës ligjore falas; paaftësia e të akuzuarit për të mbrojtur vet veten e tij, kjo do të pengojë ose bëjë të pamundur mbrojtjen e tyre; kompleksitetin faktik apo ligjore të çështjes, ashpërsia e dënimit që përfshin mundësinë e burgimit ndaj tij etj. Prandaj, Gjykata mund të vendosë një shtet ka cënuar detyrimet e KEDNJ kur nuk i ka siguruar të pandehurit ndihmë ligjore falas, edhe pse ai mund të mos ketë qënë në kushtet e mungesës së mjeteve financiare. Konventa shkelet duke mos siguruar avokatin mbrojtës

[30] Neni 10 I Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.
[31] Neni 2 i po kësaj Deklarate.
[32] Neni 14 i Konventës.

një të akuzuari të privuar nga mjetet financiare ose edhe kur janë plotësuar një ose më shumë kritere të konsideruar si" *në interes të drejtësisë*".

Konventa nuk i referohet vetëm ndihmës juridike në akuza penale, ajo gjithashtu garanton të drejtën për gjykim dhe një dëgjim të drejtë të çështjes nga një gjykatë gjatë një procesi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile dhe siguron gëzimin e të drejtave të parashtruara në Konventë pa diskriminim në asnjë bazë, duke përfshirë këtu edhe mjetet financiare. [33]

Me anë të interpretimit, Gjykata e lidh"të drejtën për gjykim" në rastet civile ku shteti është i detyruar të sigurojë ndihmë juridike jo vetëm në çështjet penale por edhe ato civile nëse është e nevojshme për të garantuar akses efektiv në gjyq në funksion të një përfaqësimi të detyrueshëm nga një avokat mbrojtës. [34]

Edhe pse kriteret e mësipërme të Gjykatës japin bazën për të nxjerrë konkluzione të përgjithshme megjithatë ajo është shprehur se nëse ndihma ligjore falas është e nevojshme në një rast të caktuar varet nga kompleksiteti dhe rrethanat e saj dhe kjo vlerësohet rast pas rasti. Konventa dhe Gjykata e ka lënë këtë në vlerësimin diskrecional të shteteve nënshkruese për të përcaktuar sistemin e tyre të brendshëm të ofrimit të ndihmës juridike për personat pa mjete financiare apo që ndodhen në kushte të tjera që e bëjnë të nevojshme atë.

Gjithashtu një instrument tjetër është karta për të drejtat dhe liritë themelore në Bashkimin Europian e cila parashikon se" të gjithë duhet të kenë mundësinë për të qenë të këshilluar, përfaqësuar dhe mbrojtur" si të drejta themelore. Megjithatë nuk sqarohet se a duhet ndihma ligjore falas të vihet në dispozicion për ata që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Direktiva e Këshillit të Bashkimit Evropian përcakton se të gjithë personat e përfshirë në një mosmarrëveshje civile kanë të drejtë për ndihmë ligjore adekuate sipas detyrës zyrtare nëse ata nuk mund të përballojnë vet shpenzimet për ta siguruar vet atë në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tyre përpara një gjykate. Kjo ndihmë përfshin dy elementë; këshillimi ligjor i dhënë para gjyqit dhe e drejta për përfaqësim gjatë gjykimit. [35] Megjithatë, kjo dispozitë ekskluzivisht i referohet mosmarrëveshjeve ndërkufitare, prandaj është e mundur dhe e realizueshme që qytetarët e Bashkimit Evropian do të kenë qasje më të mirë për ndihmë juridike në vendet anëtare.

Si pjesë e sistemit ligjor të brendshëm, ndihma ligjore është e organizuar duke u konsideruar si një çështje e brendshme e vendit në fjalë, dhe modele të ndryshme të saj ekzistojnë në botë dhe në praktikën evropiane. Ndër këto modele mund të përfshijmë mbrojtjen ligjore falas që caktohet me vendim të organit të akuzës në rastin e çështjeve penale. Gjithashtu ajo mund të ofrohet nga gjykata, apo edhe nga zyra avokatie që ofrojnë

[33] Neni 14 I KEDNJ.
[34] Shih Airey k. Irlandës, 9 tetor, 1979.
[35] Neni 3 i Direktivës.

dica çështje *pro bono* në vit. Një grup organizatash jo-qeveritare kanë këtë mision dhe ofrojnë ndihmë ligjore falas.

Gjithashtu ekzistojnë sisteme që njihen si skema e sigurimit juridik, ku lidhet një policë sigurimi e cila mbulon shpenzimet gjyqësore deri në një vlerë të caktuar.

Megjithatë kjo e drejtë lidhet ngushtësisht me faktorë të brendshëm të vendit, si faktorë ekonomikë, socialë, politikë etj. Prandaj, duke marrë parasysh këtë element, Konventa dhe GJEDNJ i ka lënë një fushë të gjerë diskrecioni shteteve anëtare.

1. 4 Si të komunikohet me publikun?

Duke qënë se bëhet fjalë për komunikim me njerëz që nuk e njohin ligjin dhe e kanë të vështirë të kuptojnë terma specifikë kërkohet një mënyrë e veçantë e të komunikuarit me ta. Kjo do ta bëjë klinikën më të frytshme, efektive dhe qëllimet do të realizohen më shpejt. Ka manuale të posaçme që i vijnë në ndihmë studentëve të klinikës për t'i orientuar ata mbi metodat e komunikimit dhe mënyrën e sjelljes me komunitetin. Në fakt, rregullat e diskuitmit nuk janë dhe aq standarde, ato do të variojnë natyrisht prej temës apo fushës së ligjit për të cilën ofrohet këshillimi ligjor.

Rekrutimi i avokatëve dhe studentëve të drejtësisë për të dhënë mësim në mjediset e komunitetit është çelësi për të ndihmuar edukimin e publikut duke përhapur koncepte ligjore për komunitetet e margjinalizuara dhe për të mbështetur personat e mbitaksuar dhe organizatat e nënfinancuara. Përfitimet vijnë jo vetëm në sjelljen e informacioneve praktike ligjore dhe aftësitë për njerëzit shpesh të mbyllur-jashtë procesit ligjor, por edhe në ofrimin e mundësisë për avokatët dhe studentët e drejtësisë që në një mënyrë efikase dhe të dobishme të përdorin aftësitë e tyre ligjore në dobi të komunitetit.

Duke qënë se kjo është një çështje që do të trajtohet në mënyrë të detajuar më poshtë është e domosdoshme të theksohet se aftësitë e komunikimit janë çelës kyç në klinikën e ligjit. Studentët që praktikojnë klinikën duhet të kenë aftësi të shpjegojnë çështje të ndërlikuara ligjore me anë të fjalëve të thjeshta. Këtu mund të vijnë në ndihmë shembujt praktikë të cilët do ta lehtësonin shumë procesin e të shpjeguarit dhe kuptuarit njëkohësisht.

Në shpjegimin e çështjeve është e rëndësishme t'i lihet mundësi palës dëgjuese të bëjë pyetje, të japë sygjerime apo argumente në mënyrë që të ndihmohet në procësin e të përthithurit dhe asimilimit të informacionit. Pyetje të tilla mund të vijnë në ndihmë :

- Çfarë mendimi keni për situatën konkrete?
- Cila është zgjidhja që ju do të sugjeronit për problemin?
- A keni hasur raste të tilla në jetë dhe si i keni zgjidhur ato?
- Cilat mënyra janë më efikase dhe kujt do t'i drejtoheshit për ndihmë?

Komunikimi është çelësi për të hyrë në marrëdhënie me të tjerët. Në rastin e klinikës ai është faktor bazë që realizon ndërveprimin e palëve dhe përshpejton rezultatet, prandaj i duhet kushtuar një rëndësi thelbësore.

Gjithashtu, studentët që marrin përsipër një detyrë të tillë duhet të jenë të aftë jo vetëm për çështjet ligjore, por edhe për mënyrën e komunikimit. Në të kundërt klinika nuk do të jetë frytdhënëse dhe nuk do të japë feed-backu-n e pritur. Komunikimi jo vetëm që duhet të jetë i shtruar, nxitës, përkrahës dhe mbështetës por duhet të jetë edhe i kulturuar. Jo vetëm përdorimi i gjesteve dhe fjalëve fyese është i ndaluar, por edhe dhënia e përshtypjes palës tjetër që ai po gabon apo nuk ka aftësi për fushën.

Street law fuqizon njerëzit përmes programeve të saj të cilat janë një përzierje unike e anës materiale dhe proceduriale të problemeve juridike. Studentët marrin informacion thelbësor rreth ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut përmes strategjive që nxisin zgjidhjen e problemeve, të menduarit kritik, të mësuarit bashkëpunues, komunikimin rreth konflikteve duke përmirësuar aftësitë e zgjidhjes, dhe aftësinë për të marrë pjesë në mënyrë efektive në shoqëri.

Street law. Inc ka sjellë mesazhin mbi edukimin e ligjit, demokracisë, dhe të drejtat e njeriut në më shumë se 40 vende e gjithë bota. [36] Krahas metodave dhe manualeve të sjella prej saj, një vend të rëndësishëm zënë manualet mbi komunikimin dhe procesin bashkëpunues midis palëve pjesëmarrëse. Qëllimi kryesor është implementimi i klinikës së ligjit si pjesë e programit akademik edhe në ato vende që nuk e njohin atë. Ky implementim do të arrihet me anë të programeve të njohjes dhe përshtatjes nëpër fakultetet e drejtësisë por duke i mëshuar njëkohësisht vlerave dhe efekteve pozitive që klinika sjell. Gjithashtu synohet prezantimi i saj në komunitet. Deri tani rezultatet janë mjaft të arrira dhe premtuese njëkohësisht.

Pedagogjia klinike është padiskutim e lidhur ngushtë me idealet e shërbimit publik të profesionit ligjor. Prandaj vazhdimisht pedagogët e klinikave ligjore janë përpjekur të ngulisin te studentët rëndësin e një drejtësie në interest ë shërbimit publik.

Profesor John Dubin identifikon tri mënyra kryesore përmes së çilave klinikat e ligjit mund të rrisin objektivat socialë.[37] Së pari, klinikat përfaqësojnë zakonishtë persona dhe grupe të cilët nuk do të mund të përfaqësoheshin në ndonjë mënyrë tjetër për shkak të varfërisë dhe mundesive ekonomike të kufizuara. Së dyti, në ekspozimin e studentëve si "avokatë", në angazhimin e tyre në punë publike dhe mirënjohjes që ata marrin, klinikat inkurajojnë studentët që ta konsiderojnë shërbimin pro bono si një karrierë përtej fakultetit. Së fundmi, përtej të ardhmes si avokat, klinikat i transformojnë mundësitë eksperimentale në një botë eksplorimi të kuptimit të drejtësisë dhe zgjerimit të kuptimin personal për të, duke grumbulluar dhe ekspozuar impaktet që sistemi ligjor lë tek personat dhe grupet e ndryshme pa privilegje ligjore.

[36] Sreet law. Inc është një organizatë jofitimprurëse që krijon në komuniteti programe që u mësojnë njerëzve rreth ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut në mbarë botën. Pjesëmarrësit e programit përfitojnë nga mësimet e "jetës reale", të cilat ata mund të përdorin për të sjellë ndryshime pozitive për pjesën tjetër të jetës së tyre. Programet e arritshme, synojnë fuqizimin e studentëve dhe komunitetet që të bëhen aktivë, kontribues për shoqërinë. Street law e ka fillimin në vitet 1972 ku Universiteti Xhorxhtaun krijoi një program për pjesmarrjen dhe mësimin e nxënësve dhe komunitetit rreth ligjit dhe çështjeve ligjore.

[37] Dubin note 66,at 1476

Mbi të gjitha pavarsisht rëndësisë që ka interesi publik, interesi parësor i klinikës është gjithnjë interesi i klientëve dhe i studentëve. Pikërisht për këtë ka patur shpesh debate se cilat prioritete duhet të jenë më të rëndësishme, dhe sa u takon klientëve që do të perfitojnë shërbimet e klinikës. Qëllimi i klinikës nuk është të zëvendësojë një studio ligjore, dhe as të maksimizojë numrin e klientëve, përkundrazi ajo ushtron veprimtarinë e saj ndaj një kategorie të caktuar të klientëve.

Interesi publik ka qënë dhe vazhdon të jetë një ndër momentet më të rëndësishme të edukimit ligjor. Në një debat në gjykatën e Dakotës së Veriut u diskutua nëse ofrimi i shërbimit falas ndaj personave me pamundësi paguese, bënte kompromis me cilësine e ofrimit të shërbimit. Absolutisht që jo. Klinikat mbajnë përgjegjësi të plotë për opinionet dhe përfaqësimin ligjor të kryer nga studentët. Si u tha shpesh edhe më lart, studentët mbikqyren vazhdimisht nga akademike të përgatitur dhe të kualifikuar në rolin e avokatëve. I vetmi interes i shërbimit falas është për të rritur interesin publik dhe ndihmuar vullnetarisht personat në nevojë ligjore dhe ekonomike, si dhe për të stimuluar edhe më shumë punën e studentëve, metodat eksperimentale praktike.[38]

U përmend së tepërmi roli i mbikqyrjes, por çfarë tjetër bëjnë pedagogët mbikqyrës të klinikave ligjore? Shumë nga krijuesit e parë të klinikave kanë punuar fillimisht në zyrat e mbrojtjes publike ose në organizatat e interesit publik. Në ndihmë të shërbimeve ligjore dhe interesave sociale, ajo çka përfytyrohet shpesh gabim për drejtuesit e klinikave ligjore është se ata janë thjesht avokatë vullnetarë të asistuar prej studentësh të rinj, që janë të gatshem të punojnë pa pagesë. Në këtë përfytyrim të gabuar harrohet fakti se këta drejtues kanë përgjegjësine kryesore si pedagog dhe anëtarë të fakultetit të drejtësisë, si dhe harrohet se kurset e zhvillimit të klinikës përfshijnë një program të rregullt akademik dhe përkushtim të plotë kohor dhe profesional.

Gjyqtarët dhe të tjerët që qëndrojnë jashtë klinikës priren të jenë të pa informuar për pëpjekjet mësimdhënëse të klinikës dhe synimet edukuese të saj. Akademike të tjerë madje kanë refuzuar futjen e metodave eksperimentale duke i parë si të dëmshme për pedagogjinë doktrinale. Si rezultat i përpjekjeve të mëdha të dokumentuara akademike, drejtuesit e klinikave kanë fituar një status të lartë në shumë shkolla ligjore. Në disa prej rasteve atyre u është dashur të heqin dorë nga procesi i mësimdhënies duke u përqëndruar vetëm në cështjet dhe problemet e klinikës. Ndryshe nga perceptimi i disave roli i drejtuesve të klinikës përfshin shumë më tepër sesa të merren me studentët në zgjidhjen e cështjeve konkrete. Profesor Steven Wizner e përshkruan evolucionin e tij nga një avokat në një studio ligjore në një profesor klinikë si më poshtë :

“ kur reflektoj në atë që më ka ndodhur profesionalisht që kur fillova të punoj si pedagog përgjegjës i një klinike kuptoj që kaloj shumë kohë në ditën time të punës i asistuar nga studentët e mi duke bëra gjëra që nuk mund ti bëja në punën time si një avokat i një studioje ligjore. Unë u mësoj studentëve të mi anet substantive të ligjit dhe të praktikës. Unë u mësoj atyre për sistemin dhe institucionet. Unë kaloj orë të tëra me studentët

[38] Clinical Law Review ,534

individualisht edhe ne grupe, në klasa në mbikqyrje por edhe në biseda më pak formale, duke i ndihmuar ata të kuptojnë se cfarë do të shohin në botën reale, duke i ndihmuar ata të njohin dhe të përballen me ndjenjat dhe emocionet rreth cështjeve të klientëve të tyre, dhe me problemet ligjore të klientëve. Unë flas me ta për zgjedhjen e cështjeve analizën e problemeve të klientëve, për cështjet e etikës, dhe se si të përballen me klientë të vështirë. Unë kaloj kohë duke i mesuar ata se sit ë përgatiten për paraqitjen në gjyq, për seancat dëgjimore, për negocimet dhe të tjera aktivitete përfaëuese. Unë i ndihmoj ata në shkruajtjen dhe rregullimin e punëve te tyre me shkrim, sigurisht në të mirë dhe ne interes të klientit. Të gjitha këto aktivitete janë ato që më përcaktojnë mua si një pedagog përgjegjës të klinikës."[39]

Detyrime të tilla si ato që përshkruan profesor Wizner kanë ndryshuar "pamjen" e klinikës dhe kanë zgjeruar rolin e klinikave ligjore ne përmasa të mëdha. Ato e bëjnë punën ligjore jo vetëm profesionale, por edhe njerëzore, interesante dhe me adrenaline

[39] Wizner,note 74,at 261

Kapitulli 2

Aplikimi i klinikës në praktikë

Përmbajtja : 2. 1 Përfitimet e klinikës ligjore; 2. 2 Të mësosh nga praktika; 2. 3 Si aplikohet klinika e ligjit?; 2. 3. 1 Planifikimi; 2. 3. 2 Zbatimi; 2. 3. 3 Reflektimi; 2. 3. 4 Integrimi 2. 4 Hapat për të realizuar një detyrë në mënyrë të suksesshme; 2. 5. Vendosja e objektivave

2. 1 Përfitimet e klinikës ligjore

Studentët mësojnë në auditorë nrreth të drejtës, parimet dhe normat ligjore. Megjithatë e drejta duhet aplikuar në praktikë, duhet ushtruar dhe duhet prekur nga secili për t'u përvetësuar siç duhet. Prandaj juristët nuk krijohen vetëm në sallat e leksioneve, ata rriten, zhvillohen dhe aftësohen në praktikë. Kjo e bën të domosdoshme praktikën, si një element kyç në procesin e edukimit juridik për secilin student.

Arsyet pse stidentët zgjedhin klinikën si lëndë të formimit të tyre janë disa :

- Për të përcaktuar qëllimet që do të realizojnë në studimet e tyre. Në universitet studentët mësojnë çdo gjë që mund të mësohet nga librat. Por, ata kanë nevojë të mësojnë edhe aftësohen më shumë, prandaj i vënë vetes qëllime që mund t'i përmbushin vetëm me anë të klinikës së ligjit.
- Për të aplikuar mësimin teorik në botën e vërtetë. Parimet, ligjet, normat ata mund t'i zbatojnë në të vërtetë, duke i aplikuar për zgjidhjen e çështjeve konkrete, për të parë rezultatet dhe pasojat që do të vijnë prej zbatimit ose jo të tyre.
- Për të realizuar rritje dhe zhvillim personal. Klinika i ndihmon studentët jo vetëm të realizohen profesionalisht duke i mësuar aftësi të mira dhe të pazëvendësueshme nga çdo proces tjetër, por i ndihmon edhe të zhvillohen

personalisht. Ata bëhen të zftë të përballojnë problemet, për të zgjidhur situatat, bëhen të pavaruar, fitojnë vetbesim, dhe krijojnë kontakte të reja.

- Për të eksploruar interesat e tyre në karrierë. Duke praktikuar të drejtën ata vendosin se ku përshtaten më shumë, cila fushë e të drejtës i tërheq më mirë, dhe ku do të ishin më të aftë. Prandaj klinika bëhet një udhërrëfyes për kërrierën e tyre profesionale.
- Për t'u bërë të dobishëm në shoqëri. Ofrimi i ndihmës falas për komunitetin i bën ata të ndihen të dobishëm, të shfaqin karakterin e tyre altruist, të japin një ndihmë në komunitet. Thjesht, klinika i ndihmon ata të bëhen njerëz më të mirë.
- Për të rritur dijeninë rreth nevojave të komunitetit. Ata bëhen të ndërgjegjshëm rreth problemeve më shqetësuese në komunitet, cilat janë shtresat në nevojë, si mund t'u vihet në ndihmë etj.
- Të punojnë me persona të ndryshëm. Diversiteti dhe përshtatja ndaj tij është një mësim i mirë që ta ofron klinika. Studentët kuptojnë diferencat midis tyre, mundohen t'i pranojnë dhe kapërcejnë ato dhe të bashkëpunojnë pavarësisht atyre.
- Të përmirësojnë mundësitë për punësim. Klinika sjell një përvojë të dobishme e cila do të vlerësohet si e tillë nga punëdhësi i ardhshëm. Një student i klinikës është më i aftësuar në disa aspekte se të tjerët që nuk e kanë zgjedhur atë dhe kjo natyrisht do t'i shërbejë edhe në tregun e punës.
- Të krijojë kontakte me njerëz të rinj. Kjo natyrisht do t' shërbejë në jetën e tij profesionale, pasi këto kontakte do t'i vijnë në ndihmë edhe në të ardhmen.

Studentët të cilët punojnë në klinikën e ligjit janë shumë entuziast rreth eksperiencës së tyre. Ata janë të vetë motivuar dhe shpesh shumë të përkushtuar në punë. Ata janë shumë përgjegjës për veprimet që ata bëjnë dhe mënyrën se si veprojnë. Të jesh pjesë e punës në Klinikën e Ligjit ndikon në reduktimin e disa ndienjave dhe të frymëzon për studime të mëtejshme. Puna në Klinikën e Ligjit i bën studentët të mendojnë edhe njëherë se çfarë është Universiteti i Drejtësisë dhe çfarë drejtimi do të mari në të ardhmen karriera e tyre. duke patur mundësi që studentët të aplikojnë në praktikë njohuritë e tyre teorike ata tashmë fillojnë që të selsksionojnë dhe të pozicionohen në rolin që ata duan të kenë në të ardhmen në funksionimin e sistemit të drejtësisë.[40]

Pra, përfitimet e klinikës janë disa, madje ne mund të përmendim edhe të tjera. Megjithatë këto përfitime nuk janë të garantuara, ato kërkojnë një proces të mirëmenduar të klinikës, zgjedhja me kujdes e praktikës, vendosja e qëllimeve dhe objektivave, dhe sidomos refketimi mbi eksperiencën personale. Pavarësisht se studenti mund të jetë i përgatitur të punojë fort në vendin e punës ai duhet edhe të reflektojë mbi ato që mëson. Pra, reflektimi është një proces thelbësor për të maksimizuar përfitimet e klinikës në mënyrë që studentët të marrin atë feed-back të dëshiruar nga klinika e ligjit.

[40] Richard Lewis, " Clinical Legal Education Revisited", fq.9.

2. 2. Të mësosh nga praktika

Edukimi klinik synon t'ju tregoj studentëve një mënyrë të caktuar të mësuari, e ndryshme dhe nga qëllimi i tyre kryesor sesi ata të mendojnë si një avokat. Aftësia për të transferuar, aftësia për të përgjithësuar mësimet dhe aftësitë e marra nga një vend dhe situatë e caktuar dhe aplikimi i tyre në një mësim apo situatë të ngjashme është edhe zemra e edukimit klinik.[41] Ky qëllim ka për detyrë që ti ndihmojë studentët që të bëjnë lidhje ndërmjet eksperiencës së tyre në klinik në situata të tjera ligjore që ata përballen në karrierën e tyre duke pasqyruar aftësitë e fituara në klinikë. Një nga aplikimet kryesorë të këtij qëllimi është mësimi i studentëve në njohjen e zgjedhjeve të momentit dhe të jenë të aftë të bëjnë zgjedhje të qëllimshme në përballje me pasigurinë.[42]

Përpara se studentët të zgjedhin klinikën e ligjit duhet të marrin në konsideratë përfitimet që do të vijnë prej saj. Të aplikosh klinikën do të thotë të aplikosh të drejtën, prandaj kjo natyrisht që përkthehet në përfitime për studentët. Megjithatë që të merret feed-backu i përmendur më sipër është e domosdoshme që të reflektohet mbi atë që mësohet dhe të ndiqen disa hapa të domosdoshëm.

Në këtë drejtim është e domosmdoshme të aplikohet të mësohet prej përvojës. Në fakt, çdo i mësuar, në çdo lloj fushe lidhet me përvojën që fitohet nga aplikimi në praktikë i asaj që mëson. Megjithatë te klinika e ligjit kjo është thelbësore dhe përbën thelbin e kësaj praktike të ligjit. [43]

Dija e përfituar nga eksperienca është e ndryshme prej dijes të përfituar nga teoria, që lidhet me elementët abstraktë të materies, që dallon nga dija empirike që përfitohet me anë të konfirmimit ose jot të të dhënave të përfituara nga ekzaminimi i të dhënave. [44]

Dija e përfituar prej praktikës rrallë herë është e mjaftueshme për t'u përgatitur për një vend pune, kryesisht një të vështirë. Kjo dije duhet të shoqërohet më me aplikimin e dijeve teorike dhe empirike të fituara në përvoja të tjera. Shumë punë, qoftë edhe të thjeshta bazohen në leksione të shkruara ose instruksione të marra në auditorë për t'i mësuar punëmarrësve atë që kanë nevojë të dinë për atë vend pune. Në një klasë klinike ligjore ose gjatë praktikës së studentit, do të testohen dijet empirike që janë përfituar gjatë leximit të librave shkollë. Kjo mundëson ofrimin ndaj studentëve të një dimensioni të shtuar të të eksperiencës së avokatëve apo procesit të avokatisë.

Megjithatë dija e fituar nga praktika duhet të dallohet nga eksperiencat e zakonshme të përfituara kudo. Është ajo se çfarë do të bësh me përvojën e përfituar që bën dalimin nëse do të marrësh fryte prej saj apo jo. Studentët do të përfitojnë dije rreth të drejtës gjatë viteve të tyre të studimit. Mësimdhënia është një proces aktiv, kurse i mësuari një proces

[41] Carolyn Grose, "Beyond Skills Training, Revisited: The Clinical Education Spiral", fq 494
[42] Po aty, fq 495
[43] Legal Clinics and the better trained Lawyer : A history of clinical education at Northwestern- Copyright 2006 by Northwestern University School of Law Printed in U.S.A., Northwestern University Law Review Vol. 100, No. 1, fq 53
[44] Learning from practice – J.P.Ovigly, Leah Wortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II, faqe 7

pasiv. Fatmirësisht, shumë profesorë të së drejtës sot përdorin metoda alternative të mësimdhënies që i ndihmojë studentët të dalin nga procesi pasiv, të jenë aktivë dhe të përfitojnë maksimalisht nga dija e ofruar atyre. Megjithatë, ka padyshim një limit se si dija mund të përfitohet aktivisht një sallë leksioni. Sado efikase të jenë metodat e përdorura kjo dije nuk mund të jetë maksimlaisht frytdhënëse nëse nuk shoqërohet me praktikë. Klinika e ligjit ashtu si praktika mund të rrisi në mënyrë të konsiderueshme mundësitë e studentëve për të mësuar aktivisht.

Shumë student janë mjaft entuziastë për programin e klinikës së ligjit. Ata mendojnë se do të jenë tashmë të aftë të dalin në terren për të parë dhe bërë atë që juristët e vërtetë bëjnë në praktikë. Shumica e njerëzve preferojnë të jenë aktivë në procesin e të mësuarit, megjithëse jo të gjithëve iu jepet një mundësi e tillë. Studentët do të përfitojnë më shumë nëse realizojnë një lidhje midis procesit të mësimit pasiv në auditorë dhe vendosejs së qëllimeve për t'i praktikuar ato realisht në çështje të caktuara ligjore. Secili student është individual në stilin e vet të të mësuarit por edhe praktimin e të drejtës. Kjo do të thotë se edhe rezultati i marrë nga secili prej tyre do të variojë në varësi të këtyre karakteristikave thelbësore që ata kanë. Ne të gjithë jemi të vetdijshëm që mësojmë në mënyrë të ndryshme. Ajo që është efektive dhe frytdhënëse për dikë nuk është për një tjetër, prandaj duhet edhe rezultate të vlerësohen në këtë këndvështrim. Për shembull studentit mund t'i duhet të mësojë për të paraqitur një dëshmi, si një nga provat në procesin penal. Ai këtë mund të mësojë duke lexuar libra, duke lexuar ligjin në fuqi. Gjithashtu ai mund të zgjedhë të ndjekë procese penale duke vëzhguar performancën e prokurorëve ose mënyrën se si avokatet mbrojnë klientët e tyre. Gjithashtu ata mund të ngrenë një model të tyrin dhe të kërkojnë në lidhje me të mendimin e një eksperti të fushës. Ndoshta ai do t'i aplikojë që të treja këto mënyra. Çështjet ligjore apo fushat e ligjit që secili zgjedh tregojnë diçka për stilin e preferuar të të mësuarit të gjithsecilit. Zgjidhja e bërë nuk është domosdoshmërisht rruga më e mirë ose më e arsyeshme midis metodave të tjera të të mësuarit, megjithatë është zgjedhja personale e inidividit.

Secili student dëshiron të apikojë të drejtën në praktikë sesa të qëndroje për orë të tëra në mënyrë passive në auditor. Megjithatë dija e përfituar nga praktika nuk mund të merret kurrsesi pa pasur dijen empirike, pra pa përvetësuar teorinë e së drejtës, e cila të jep zgjidhjen për situate të ndryshme ligjore. Prandaj kemi të bëjmë me një proces zinxhir i cili nuk mund të funksionojë pa të gjitha hallkat dhe as të japë rezultatet e kërkuara. Fillimisht mësohet e drejta në aspektin teorik dhe më pas ajo plotësohet me anë të praktikës. Kjo është një rradhë e detyrueshme për t'u ndjekur në të kundërt klinika nuk do të funksionojë dhe as të japë rezultat.

2. 3 Si aplikohet klinika e ligjit?

Të mësosh nga praktika do të thotë të përfitosh nga eksperiencat e tua profesionale. Ky në fakt është një proces i cili kalon në disa faza dhe kërkon një farë kohe për të sjellë rezultatet e dëshiruara. Kjo mund të shpjegohet me anë të një skeme ku përfshihen tre elementët bazë; Të planifikosh, të bësh, të reflektosh dhe të integrosh. Nëse ndiqen këto

hallka atëherë mësimi do të jetë më efikas dhe i realizuar dhe do të përfitohet më shumë prej klinikës si në nivelin makro dhe atë mikro.

Metodat klinike konsistojnë gjerësisht në tre tema kryesore:

- Argumentimi i studentit rreth çështjes së klientit;
- Mësimi i procesit ligjor si process i përbërë nga tema të ndryshme;
- Dhënia mundësi e studentëve të reflektojnë mbi përvojat e tyre.

Këto tre tema janë të ndërthurura në spiralen praktikë-teori ku në të parën (1) përfshihet praktika dhe e treat (3) është teoria. Tema e dytë (2) është zemra e metodave klinike, në të janë të përfshira të dyja si teoria dhe praktika. Praktika është metoda që klinika përdor për të mësuar këto tema. Më posht përshkruhet se si këto tema përkthehen në metoda të mësimit nëpërmjet tre teknikave konkrete: 1- situata dhe roli i supozuar i studentit, 2- studentët, avokatë të klientëve; 3- reflektimi.

1- Situatat dhe roli i supozuar i studentit

Eksperiencë e cila në shumicën e klinikave shprehet në mardhëniet avokatë-klientë dhe përfaqësimin e klientëve nga studentët duke marë rolin e avokatëve. Studentët kanë përgjegjësi për çështjet e klientëve të tyre. Edhe pse studentët janë nën mbikëqyrjen dhe veprojnë mbi bazën e udhëzimeve të pedagogëve përkatës, ata e kanë shumë të qartë faktin se çështjet dhe klientët e klinikës janë çështje dhe klient të studentëve dhe jo të udhëheqësve të tyre. Gjatë eksperiencës së tij në klinik studenti merë një rol, mëson detyrimet e rolit, njeh disa sygjerime të caktuara të përfshira në mësimin e rolit dhe në fund të fundit fiton aftësitë e nevojshme për të praktikuar rolin. Metoda klinike i mëson studentëve të reflektojnë dhe të mësojnë nga ky rol i supozuar.[45]

Studentët duke lujatur rolin e avokatëve ndaj klientëve të Klinikës marin edhe përgjegjësitë e avokatëve në lidhje me çështjen ndaj së cilës ata janë duke dhënë kontributin e tyre dhe në fund do të japin dhe opinionin juridik. Gjatë punës së tyre me çështjen studentët mbajnë atë qëndrim që edhe avokatët kanë në punën e tyre në lidhje me marrëdhënien me klientin apo me çështjen që kanë në dorë. Vendosja në rolin e avokatëve e ndihmon studentin në zhvillimin e aftësive të tij rreth kuptimit të përgjegjësisë në punë por edhe mësimit rreth punës së avokatit, mënyrës së tyre të vepruarit dhe mënyrës se si ligji aplikohet në praktikë.

2- Studentët, avokatë të klientëve

Studenti i Klinikës së Ligjit ka tashmë një status të ri, ai ka statusin e avokatit sepse ai mer çështje reale, ka klient real, jep një ndihme ligjore reale dhe bën një përfaqësim real të klientit të tij. Në kryerjen e detyrave të caktuara studentët përjetojnë ndienjën e përgjegjësisë, ata marin përgjegjësinë e supervizorit mbi vete në zgjidhjen e problemeve

[45] Carolyn Grose," Beyond Skills Training, Revisited: The Clinical Education Spiral"

reale. Pra, studentët vendosen në rolin e përfaqësuesimit të klientve real duke i sfiduar ata kështu për të nxjer teori nga praktika e tyre dhe duke u bazuar në teori të udhëhiqen për të marë vendime dhe veprime konkrete për mënyrën e përfaqësimit të klientit të tyre.[46]

3- Reflektimi

Reflektimi është metoda që i udhëheq studentët për të nxjer teori nga praktika dhe të bëjnë të mundur aplikim e këtyre teorive në praktik. Kjo i ndihmon dhe i shtyn studentët që nga e veçanta të përgjithësojnë dhe të zhvillojnë mësimin e tyre përtej kësaj. Roli i pedagogëve të klinikës është që të kuptojë motivimet, përshtypjet dhe marrëdhëniet e rolit përformues në përpjekjet për të zgjeruar vetë-reflektimin, vetëdijen dhe një kuptim më përfshirës të këtyre fenomeneve të rendit juridik të cilat janë në qëndër të kërkesave pedagogjike.[47] Reflektimi i studenteve rreth eksperiencës së tyre në klinik dhe komponentët e tij e udhëheqin studentin në vetëdije, përgjegjësi dhe perceptimin e statusit.[48]

Modelin e aplikimit të klinikës mund ta ilustojmë me fugurën e mëposhtme :

PLANIFIKO => **BËJ** => **REFLEKTO** => **INTEGRO**

Fig. 1

Pavarësisht se të gjithë elementët e mësipërm janë të domosdoshëm për mësimin prej praktikës, elementët kyç janë planifikimi dhe reflektimi. Përvoja juaj do të jetë më efikase nëse vendosni qëllime për praktikën. Ju duhet të krijoni një plan dhe të merrni masa që ai të realizohet në praktikë dhe të arrini qëllimet tuaja. Gjithashtu duhet t'i kushtoni kohë të menduarit rreth përvojës tuaj dhe se në cilat eksperinca doni të investoni dhe cilat doni të evitoni. Është qëllimi juaj të përfitoni dije të reja apo të përmirësoni ato ekzistueset? Në fillim duhet të vendosen objektivat dhe vetëm më pas mund të kryhen disa detyra pët të realizuar qëllimet tuaja. Vendosja e qëllimeve dhe planifikimi janë elementë bazë për të përfituar nga klinika.

Por edhe refkeltimi është një proces shumë i rëndësishëm. Reflektimi është procesi që kthen eksperiencën në mësim. Ndërkohe që po përgatiteni për vendin e punës ju reflektoni për të kuptuar se cila aftësi ju nevojiten më shumë, çfarë kërkesash do të ketë ndaj jush, dhe cilat burime do të lehtësojnë të mësuarin tuaj. Refketimi është i

[46] Po aty
[47] Po aty
[48] Wallance J. Mlyniec, "*Where to Begin? Traning New Teachers in the Art of Clinical Pedagogy"*

rëndësishëm për të oarë përmes përvojës tuaj ndërkohë që ajo zhvillohet. Vëzhgimet dhe veprimet mund të ndodhin shumë shpejt në praktikë duke mos ju lënë kohë të analizoni dhe të përfitoni ërtet prej tyre. Në mënyrë periodike duhet parë prapa në kohë tq ajo çfarë është bërë për ta anlizuar, për të nxjerrë përfitime dhe mësime prej saj.

Reflektimi mund të zhvillohet veçmas ose në grup. Reflektimi do të përfshijë të menduarin shpejt, të kalohen ngjarjet në mendje, dhe të përpiqeni t'i jepni një kuptim përvojës tuaj. Mund të mbahen edhe shënime për të shkruar disa prej përfundimeve të këtij procesi, të cilat do t'ji ndihmojnë për të ardhmen. Reflektimi përfshin gjithashtu përfshirjen në diskutime të ndryshme në klasë. Seminaret mund t'i kushtohen në një pjesë të kohës së tyre diskutimit në grup mbi këto përvoja. Të gjitha këto do të përmirësojnë dhe përshpejtojnë shumë procesin e të mësuarit nga praktika. [49]

2. 3. 1 Planifikimi

Klinika e ligjit duhet filluar duke e planifikuar atë paraprakisht. Secili student vendos qëllimet dhe objektivat që dëshiron të arrijë.

Çfarë synohet të arrihet me anë të klinikës së ligjit? Çfarë do të doje të ishe i aftë pas kësaj përvoje të cilën nuk je i aftë ta bësh tani? Cilat aftësi do të doje të fitoje ose përmirësoje? Gjatë klinikës do të vendosen objektiva dhe qëllime të caktuara, të cilat do të shikohen hap pas hapi nëse janë përmbushur apo jo. Në fund të klinikës do të reflektohet mbi atë që është realizuar, mbi përvojat e reja, se sa efikase kanë rezultuar dhe çfarë është përfituar gjatë kësaj eksperience.

Planifikimi lidhet drejpërdrejt me eksperiencën që dëshirohet të realizohet. [50] Nëse gjatë programit të klinikës është caktuar një detyrë e caktuar, duhet zgjedhur mënyra për ta realizuar atë. Mënyra e zgjedhur lidhet drejtpërdrejt edhe me feed-backun e dëshiruar, cilat janë rezultatet që synohen të përfitohen. Këto mund të diskutohen me profesorin mbikqyrës të klinikës, i cili mund të ndihmojë në marrjen e inisiative të duhura dhe zgjedhjeve të vlefshme. Pasi vendoset se çfarë do të bëhet, është e nevojshme të hartohet një plan pune i cili do të shërbejë për të realizuar objektivat e dëshiruara. Gjithashtu duhet të mbahet një axhendë ku të shënohen të gjitha detyrat e realizuara në praktikë, si edhe rezultatet e përfituara hap pas hapi.

2. 3. 2 Zbatimi

Hapi i dytë është ekzekutimi i planit të ndërmarrë. Për të kryer detyrat e caktuara është e nevojshme të konsultohemi me ligjit material dhe atë procedurial në mënyrë që hapat e hedhura të jenë të sigurta. Gjithashtu të nevojshme janë edhe konsultat e vazhdueshme me pedagogun mbikqyrës për të marrë udhëzime se cilat janë mjetet e duhura dhe efikase për çdo detyrë.

[49] Learning from practice – J.P.Ovigly, Leah Wortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II.
[50] Clinical Anthrology. Readings for live-client clinics – A.J.Hurder, F.S.Bloch, S.L.Brooks, S.L.Kay. Anderson Publishing Co, Ohio, fq 53.

Pjesë e klinikës mund të jenë detyra nga më të ndryshmet që duhet të kryejë secili student. Prandaj është e nevojshme kryerja e secilës prej tyre me përkushtim dhe devotshmëri që duhet të kryejë secili student. Zbatimi me sukses kërkon jo vetëm përkushtim por edhe ndershmëri, bashkëpunim dhe respektim i mendimit të të tjerëve. Pra, kërkohet prania e disa vlerave të cilat janë të domosdoshme që projekti të realizohet me sukses. Jo të gjithë janë të afte ta përbllojnë siç duhet punën në grup apo detyra të veçanta që i jepen, megjithatë gjatë programit të klinikës ata do t'i përfitojnë disa nga këto cilësi, gjithmonë duke u shoqëruar me përkushtimin e nevojshëm. Prandaj, klinika themi se është e vlefshme edhe në këtë drejtim.

2. 3. 3 Reflektimi

Reflektimi është një proces kyç në përfitimin prej klinikës. Kjo konsiston në vlerësimin dhe të menduarin e praktikës së realizuar. Çfarë është realizuar gjatë asaj kohe? Cilat janë detyrat e kryera? Çfarë aftësish janë përfituar apo përvetësuar?

Për këtë mund të diskutohet edhe me kolegët, profesorët, por edhe me familjarët. kështu mund të analizohet edhe më mirë përvoja e fituar. Gjithashtu shumë e vlefshme do të ishte të shkruhej një artikull në një gazetë në lidhje me eksperiencën e realizuar. Kjo do të shërbente për të trajtuar në aspektin kritik personal të përvojës së përfituar. Gjithashtu mund të mendohet rreth asaj që është thënë në sallën e gjyqit, apo mendimet e gjyqtarit, diskutimet e palëve. Prej klinikës mund të përfitohet shumë më tepër si përvojë nëse shoqërohet me refletim. Të reflektosh rreth asaj që ke bërë ti dhe të tjerët !

Reflektimi të ndihmon edhe për ta kryer më mirë detyrën herën tjetër. Nëse ke kryer disa gabime apo pasaktësi këto mund të rregullohen nëse refletohet në lidhje me to, nëse mendohet se cila do të ishte rruga më efikase e zgjedhur e cila do të shoqërohet edhe me rezultate më positive.

Duke aplikuar përvojën e mëparshme në një detyrë te rë, ti fillon një proces të ri të mësuari. Ti mësosh të vlerësosh çdo eksperincë, qoftë edhe negative, nxjerr mësime prej saj dhe e bën atë të vlefshme në një farë mënyre për ty. Gjithashtu reflktimi është i domosdoshëm edhe për të kuptuar se cila fushë e së drejtës të përshtatet më shumë. Ti mund të vlerësosh se ku je më efikas, cilat janë situatat që të favorizojnë dhe ato që nuk i përballon dot me efektshmëri. Mëson cilat aftësi të tuat janë pika e fortë dhe cilat pika e dobët. Mëson të përmirësohesh, të rritesh, të bëhesh më i zoti.

Reflektimi është një element i procesit të të mësuarit që mund të realizohet në çdo pikë të ciklit. Mund të refletohet mbi planifikimin dhe performancën për çdo detyrë të dhënë gjatë programit të klinikës. Mësimi është shumë më efikas nëse çdo detyrë, çdo hap i hedhur shoqërohet me procesin e reflektimit.

2. 3. 4 Integrimi

Integrimi është hallka e fundit e procesit të realizimit të klinikës në praktikë. Integrimi konsiston në atë proces ku dija e mëparshme integrohet dhe përputhet me atë të marrë rishtas për të rritur aftësitë personale. Dijet e reja integrohen në tërësinë e dijeve

ekzistuese dhe e ndohmon studentin të bëhet më i aftë, pasi i ofrohet një dije e re, një praktikë e re, një pamje e re për situata të ndryshme. Integrimi është një proces i domosdoshëm për t'u bërë një jurist i zoti, për të përfituar prej përvojës dhe asaj çka të ofron klinika.

Dijet e fituata nuk duhet të ngelen të veçuara, por duhet të integrohen me ato ekzistueset sepse kështu mund të fitohet vërtet. të integrosh do të thotë të mendosh me mençuri. Mendohet rreth asaj që mësohet dhe asaj që tashmë dihet duke i bashkuar këto dhe i trajtuar në një dritë frytdhënëse. Varet nga secili student, sa është ai i aftë të përfitojë nga praktika, sa mund të zhvillojë njohuritë e tij dhe kjo natyrisht është individuale. Në varësi të aftësisë për të menaxhuar një situatë të tillë do të variojnë edhe përfitimet e marra dhe feed-backu.

2. 4 Hapat për të realizuar një detyrë në mënyrë të suksesshme

1. Identifikimi i çështjes[51]

Mendoni për in tuaj apo komunitetin. A ka një problem që duhet të adresohet dhe cili është ai? E njihnit më përpara apo jo këtë problem? A është duke shkaktuar dëm dhe do të shërbentë eleminimi i tij ose do të ishte parandalimi më i mirë? A mundet një politikë apo ligj i caktuat ta shkaktojë?

2. Vendosni një objektiv.

Realizo një të nesërme më të mirë duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve :

Cila është zgjidhja apo politika publike që propozojmë? Si do të përmirësohet komuniteti juaj

në qoftë se politika juaj është zbatuar?

3. Bëhuni një ekspert në këtë çështje.

Merr dijeni për faktet. Është e nevojshme mbledhja e informacionit për të mbështetur pozicionin tuaj. Informacioni mund të mbidhet nga onitorimi i medias, kërkimi në internet, shkoni në bibliotekë, dhe realizoni intervista me anëtarët e komunitetit apo specialistë të fushës. Mëso të dy anët e çështes duke u informuar mbi këndvështrime të ndryshme.

4. Rekrutoni aleatët.

Identifikoni postblloqe. Identifikoni koalicione apo miqtë që do t'ju ndihmojnë në këtë çështje. Rekrutoni njerëz që dëmtohen nga problemi dhe të tjerët të cilët mund të përfitojnë nga ndryshimi i politikës për të vepruar si aleatë. Identifikoni kundërshtarët tuaj. Pse ata do të jetë kundër tuaj mendimit tuaj për propozuar njëpolitikë të re? Cilat strategji mund të përdorin për të rëzuar përpjekjet tuaja? Kush do të jenë aleatët e tyre?

[51] Learning from practice – J.P.Ovigly, Leah Wortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II.

5. Identifikimi i strategjive tuaja.

Për të qënë relativisht efektiv, ju do të mund të përdorni një shumëllojshmëri metodash dhe strategjish veprimi. Konsideroni mënyrat e mëposhtme :

• të fillojë një fushatë për atë politikë;

• dërgojë e-mail aletatëve apo mbështetësve tuaj;

• të kryhet një studim mbi çështjen konkrete;

• të qarkullojë një peticion;

• postoni mesazhin tuaj në një buletini apo gazetë të përditshme të komunitetit;

• mendoni për të koordinuar një tubim publik, marshim, ose manifestim të heshtur;

• të organizohet një protestë apo marshim ;

• dëshmoni në një seancë publike për çështjen tuaj;

• loboni personalisht, apo

• merrni pjesë në një takim të komunitetit.

6. Planifikoni për të pasur sukses.

Çfarë duhet bërë në vend të parë, të dytë, etj? Kush do të jetë përgjegjëspër çfarë? Si do të dini që ju keni qenë i suksesshëm?

7. Puna me median.

Media është mjet i mirë për të marrë zgjidhje duke e paraqitur shqetësimin tuaj para një

audience të madhe. Kërkoni mënyra për të shpjeguar çështjen tuaj në mënyrë bindëse para një publiku të gjerëdhe informojini ata në lidhje me shqetësimet tuaja. Përdorni disa nga strategjitë :

• shkruani një letër redaktorit;

• i kërkoni të mbajë një konferencë për shtyp;

• të krijojë një komunikatë të shërbimit publik;

• të shfaqet në një televizion kabllor komunitetit në program apo radio, emisione të ndryshme dhe

• bëni të mundur të qarkullojnë postera, fletushka dhe broshura.

8. Krijo burime financiare.

Paraja është vetëm një burim që mund të jenë të dobishme në përpjekjet tuaja. Identifikoni burimet që ekzistojnë brenda grupit juaj. Çfarë talentesh dhe aftësish personale keni ju dhe ekipi juaj për të ofruar? A e dini se një biznes apo organizatë jofitimprurëse mund të jenë të gatshëm për të dhuruar hapësirë , ushqim, apo sende të tjera për të të çuar përpara kauzën tuaj? Nëse ju vet nuk dispononi burimet e nevojshme bëni të mundur t'i gjeni ato të ata që mund të kontribuojnë.

Është e rëndësishme që studentët e klinikës të orientohen në lidhje më të qënit i suksesshëm në punën e tyre. Prandaj është e nevojshme që pedagogu udhëzues të qëndrojë gjithmonë pranë tyre duke i udhëzuar dhe ndihmuar në punën e tyre të përditshme. Normalisht që hapat e mësipërm vlejnë për një avokat profesionist kështu që nuk mund të themi se do ishin të realizueshme menjëherë nga juristët e rinj. Prandaj disa prej tyre mund të realizohen me ndihmën e një stafi të specializuar, siç mund të jenë profesorët e klinikës. Gjithashtu mund të kemi bashkëpunim të frytshëm edhe me specialistë të fushave të caktuara, siç mund të jenë avokatë të ndryshëm, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, gjyqtarë, madje edhe juristë që punojnë në fusha të ckatuara në administratën shtetërore. Të gjithë këta do të jepnin kontributin e tyre që programi i klinikës të ishte i suksesshëm dhe studentët të përfitonin vërtet prej tij.

Megjithatë kontributi që mund të jepet për klinikës, mund të mos jetë vetëm në planin profesional por edhe atë financiar. Për të realizuar siç duhet klinikën është e domosdoshme të zotërohen burimet e nevojshme financiare. Këto jo gjithmonë mund të disponohen nga fakulteti, prandaj mund të kërkohet bashkëpunimi me aktorë të jashtëm. Përmendim këtu organizata të ndryshme jo-fitimprurëse të cilat mun dtë japin një kontribut të caktuar për këtë. Gjithashtu mund të ofrohet një donacion i caktuar nga organizma ndërkombëtarë që ushtrojnë veprimgtarinë në vendin tonë. Përmendim këtu bashkëpunimin e suksesshëm që ka pasur Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës me USAID, i cili ka dhënë një kontribut të vlefshëm jo vetëm në literaturë por edhe në ndihmë profesionale që klinika të realizohet siç duhet, bazuar në modelet më të mira amerikane dhe që feed-backu i marrë të jetë ai i dëshiruar.

2. 5 Vendosja e objektivave

Në qoftë se ti nuk e di ku po shkon, atëherë ka mundësi të përfundosh diku tjetër.

Yogi Berra

Ashtu siç thuhet në shprehjen e mësipërme që të arrish atje ku dëshiron duhet të vendosësh objektiva dhe të përpiqesh për të realizuar dëshirat e tua. Në çdo ndërmarrje në jetë, njeriu duhet të jetë i vetdijshëm për hapat që po hedh, për qëllimet që ka dhe mënyrën si do t'i realizojë ato. Të gjithë punëmarrësit në çdo lloj pune kanë kontroll mbi punën e tyre, kanë obëjtiva të caktuara dhe plane si t'i përmbushin ato. E njëjta gjë ndodh

edhe me juristët, dhe paralelisht duhet të ndodhi edhe me studentët e klinikës që janë juristë të ardhshëm. Dijenia mbi qëllimet e vendosura në punë dhe ekzistenca e një plani se si do të përmbushen ato, e bën më të lehtë punën dhe më arritshëm suksesin në atë që bën.

Programet e klinikës ndryshojnë nga një shkollë në tjetrën në varësi të faktit se si pritet që studenti të veprojë me detyrat e dhëna. Në disa programe klinikash studentit i jepen detyra të caktuara të cilat ai duhet t'i përmbushë dhe të marrë masat për të realizuar objektivat që ka marrë përsipër. Në disa programe të tjera studenti mbikqyret gjatë punës së tij nga një pedagog mbikqyrës pa iu ngarkuar detyra të caktuara. Në disa të tjera, pedagogu mbikqyr studentët në punën e tyre por ai merr parasysh edhe detyrat e realizuara prej tyre.

Në varësi të modelit të zgjedhur do të ndryshojë edhe përfitimi që studentët marrin, por edhe rezultati i punës. Megjithatë pavarësisht modelit të zgjedhur, vendosja e objektivave është një nga detyrat që studenti do t'i realizojë patjetër në mënyrë që ta dijë ku po shkon dhe çfarë do të arrijë. Kjo do ta bëjë shumë më tepër efektive eksperincën e tij si student i klinikës së ligjit. [52]

Edhe në ato raste ku vendi i punës janë përcaktuar paraprakisht për studentin, ka shumë mënyra që ai ta bëjë punën e vet inovative dhe të mësojë çdo ditë një gjë të re. Në klasë secilit student mund t'i jepet e njëjta detyrë dhe t'i bëhet e njëjta pyetje. Por, në jetën e përditshme gjërat janë më pak të kontrollueshme dhe të parashikueshme.[53] Çdo ditë nëvendin e punës studenti do të ketë detyra për të bërë dhe do të duhet të marrë vendime nga më të ndryshmet. Kjo do ta bëjë atë të aftë të përballojë situata të ndryshme, nga më të thjeshtat te më të komplikuarat. Duke i treguar mbikqyrësit mbi dëshirat dhe aspiratat që keni në vendin e punës, kjo do ta ndihmojë atë t'ju japë detyrat e duhura dhe natyrisht do ta shndërrojë klinikën e ligjit në një eksperincë të bukur dhe të vlefshme. Kur studentët, para se të fillojë programi i klinikës, pyeten për objektivat që duan të arrijnë me klinikën, përgjigjet e tyre ndahen në katër kategori :[54] - Zhvillimi i aftësive;

- Eksplorimi se çfarë lloj pune do të zgjidhet pas shkollës;
- Dëshira për të mësuar rreth një fushe të caktuar të ligjit apo institucion të caktuara, shpesh e shoqëruar edhe me dëshirën për të fituar reputacion si edhe kontakte të reja;
- Marrja në konsideratë se si të merret kënaqësi nga puna dhe balancimi i kësaj me jetën private.

[52] Anna E. Carpenter, "The Project Model of Clinical Education: Eight Principes to Maximize Student Learning and Social Justice Impact", fq 75
[53] Colleen F. Shanahan & Emily A. Benfer, "Adaptive Clinical Teaching", 2013
[54] Legal Clinics and Law Students: Rocks and Cement for Better Legal Education- John S. Bradway, fq 54.

Në mënyrë që studentët e klinikës, jo vetëm të japin kontributin e tyre duke ofruar ndihmë ligore falas ndaj komunitetit, por edhe të arrijnë që gjatë eksperiencës së tyre në Klinikë të fitojnë aftësi profesionale dhe këto aftësi të jenë shumë të domosdoshme në karrierën e tyre të ardhshme, pedagogët e klinikës ndjekin disa hapa të rëndësishme nëpërmjet të cilave ata i bëjnë studentët profesionistë para se ata të diplomohen.

Pedagogët e klinikës realizojnë një projekt për mënyrën se si do ti aplikojnë këto hapa ndaj studentëve të vet. Pedagogët në fillim bëjnë një zgjedhje dhe më pas të përcaktojnë qëllimin që duan të arrijnë me këtë zgjedhje , sepse një pedagogë më parë duhet të përcaktojë ku do të arrijë dhe më pas mënyrën se si mund të arrij. Pra, në mënyrë që studentët të mund të përfitojnë shumë nga klinika dhe të japin më të mirën e tyre të mundshme në klinikë pedagagogët duhet të kenë për studentët një projekt dhe nëpërmjet tij të mund të aplikojnë tetë hapat nga të ciltat studentët arrijnë të pëfitojnë. Këto hapa janë:[55]

1) Ekzistenca e një plani për të arritur qëllimin

Në mënyrë që studentët të mund të mësojnë nga eksperienca e tyre në klinik, pedagogët duhet që të kenë realizuar më parë një projekt dhe më pas ta vënë këtë projekt në zbatim. Kjo metodë është një metodë e familjarizuar në çdo klinikë ligjore. Në mënyrë që të kuptojmë se si ky projekt funkisonon po japim një shembull me disa qëllime që duhet të arrijë studenti nga projekti i realizuar nga klinika:

- vendoset në rolin e avoktit dhe përvetëson të gjitha punët e klinikës;

- zhvillohet në gjykimin profesional;

- zhvillohet në aftësitë profesionle të komunikimit;

- zhvillohet në aftësinë për të menaxhuar kaosin dhe përfshihet në zgjidhjen e problemeve komplekese;

- zhvillohet në aftësitë e bashkëpunimit;

- zvillohet në mënyrën e të menduarit;

- kupton dhe provon rolin e avokatit si një planifikues startegjik dhe si vëzhgues të profesionistëve të tjerë.

Pra, kjo nënkupton që në mënyrë që studentët të arrijnë të përfitojnë nga eksperienca e tyre në klinik duhet që pedagogët të kenë përgatitur më parë një projekt, të kenë planifikuar qëllimet që duan të arrijnë me këtë projekt dhe më pas ta vënë këtë projekt në zbatim nëpërmjet studentëve të klinikës duke realizuar kështu një përfitim të dyfishtë, nga njëra anë kontributin e studentëve në klinik për të arritur qëllimin e klinikës në vetevete,

[55] Katherine Kruse, " Biting off What They Can Chew: Strategies For Involving Students in Problem-solving Beyond Individual Client Representation" , fq 441-442

dhënien e ndihmës ligjore falas për të varfërit dhe nga ana tjetër edhe përfitmin e studentëv nga kjo eksperienc në klinik për zhvillimin e aftësive të tyre profesionale.

2) Koha e limituar

Një nga aspektet më të rëndësishme të projektit të planifikuar është realizimi i tij brenda një kohe të caktuar. Në qoftë se klinika jepet në një semester atëherë edhe projekti duhet të realizohet brenda këtij semestri. Ky principë ndihmon studentin që të përvetësojë maksimalisht punën në klinik, por gjithashtu edhe për klinikën në mënyrë që të ketë aftësi dhe mundësi që të realizojë gjatë një viti shkollor më shumë se një projekt. Duke qënë se Klinika e ligjit është një lëndë semestrale edhe projektet që planifikohen për t'u realizuar nga studentët duhet të jenë të limituara në një semsetër në mënyrë që studentët të mund të punojnë fort për të maksimizuar përvetësimet e tyre nga klinika, por të këtë mundësi që edhe studentët e semestrit tjetër të mund të përfshihen në projekte të reja të klinikës.

3) Shërbimi ndaj klientit

Sigursht që në qëndër të projektit të Klinikës duhet të jetë klienti. Ky klient sipas projektit mund të jetë një organizatë jofitimprurëse, një grup komunitarë ose një agjensi qeveritare të cilat e lejojnë klinikën që t'ju mësojë studentëve vështirësitë e përfaqësimit institucional ose komunitarë. për të pasur një projekt përgjegjës ndaj nevojave të klientëve, projekti mund të përfshijë në vetëvete një klient të vetëm. Ashtu si një klient individual e pajisë studentin me drejtime, qëllime dhe kontekse, gjithashtu edhe në përvetësimin e çështjes së klientit të tij, ashtu edhe një klient ka të njëjtat përfitime nga projekti. Qëllimet dhe nevojat e klientit do ta udhëheqin studentin në marrjen e vendimeve të veta në lidhje më çështjen e klientit dhe në përputhje më kontekstin e projektit.

Kur studentët përfaqësojnë një grup ose një organiztaë ata përballen me komunikime dhe vendime shumë komplekse. Problemet janë më të vështira për tu lokalizuar dhe identifikuar sepse nuk kemi një klient të vetëm me një perspektivë të vetme për të kuptuar dhe vlerësuar. Procesi i identifikimit të qëllimeve të klientëve është shpesh burimi më efikas i të mësuarit për studentët pjesëmarrës në projekt. Studentët mësojnë jo vetëm se ata duhet të kuptojnë qëlimet e klientit dhe se procesi i identifikimit të qëllimeve nuk është një proçëes i ndershëm, por studentët mësojnë gjithashtu se ata, si avokatë, lujanë një rol kritikal duke ndihmuar dhe këshilluar klientin e tyre nëpërmjet procesit të identifikimit dhe prioritetit të qëllimeve.[56]

4) Studentët si avokatë primarë

Idealisht studentët janë avokatët e parë në projektin e klinikës dhe që nga fillimi i punës së tyre në klinikë deri në fund të projektit janë ata që vendosin kontaktin e parë me

[56] Anna E. Carpenter, "The Project Model of Clinical Education: Eight Principes to Maximize Student Learning and Social Justice Impact", fq 81

klientët e tyre. Kur pedagogët shërbejnë si avokatë primarë dhe janë këta që vendosin kontaktin e parë me klientin, studentët nuk do të ndjehen shumë të përfshirë në projekt sepse ata nuk do të veprojnë si një avokat i vërtet.

Profesorë Deborah Epstein përdor konceptin e "përmbysjes së egos". Koncepti i përmbysjes së egos nënkupton faktin se një marrdhënie e suksesshme mbikëqyrje varet nga sigurimi klinikës se intersat, njohuritë dhe aftësitë e saj nuk ndikohen nga marrdhënieja me supervizorin. Sa më sshumë që supervzori të shkatërrojë egon e klinikës aq më shumë interesat, njohuritë dhe aftësitë e studentëve do të fokusohen në marrdhënien me mbikëqyrësin. Sipas qëllimit të projektit, koncepti i përmbysjes së egos sugjeron që mbikëqyrësi të qëndrojë sa më larg marrdhënies së studentit me klientin dhe t'i lejojë studentit që të menaxhojë këtë marrdhënie plotësisht si dhe punën e pavarur të projektit. Kur studentët kanë pronësi në punën e tyre në klinik, një qëllim që mund të arrihet, pjesërisht, duke i bërë studentët avokatë të parë në punën e projktit të tyre, cdo moment gjatë eksperiencës në klinikë është një burim potencial i reflektimit dhe gjithashtu një burim i vëzhgimit dhe kuptimit.

5) Përtej kërkimeve dhe shkrimeve

Projekti në të vërtet ju kërkon studentëve që puna e tyre të shtrihet më tepër se kërkimet dhe shkrimet. Për sa i përket kërkimit një projekt mund të përfshijë kërkime dhe shkrime tradicionale por ai mund të përfshijë edhe kërkime dhe eksperienca të tjera jashtë librarisë apo kërkimeve në internet. Projektet mund ti zhvillojnë studentëtë me këto aftësi shumëdimensionale duke i nxjerrë jashtë klasave të leksioneve, larg nga kompjuterat dhe përfshirja e tyre në komunitet. Eksperienca në klinikë i aftëson studentët në realizimin e kërkimeve jashtë librarisë dhe internetit por në këkime nëpërmjet përfshirjes së tyre në komunitet.[57]

6) Zhvillimi i aftësive bashkëpunuese

Studentët të cilët bëhen pjesë e projektit të Klinikës punojnë si një skuadër avokatësh duke ndarë përgjegjësitë për çdo aspekt të projektit. Duke realizuar një punë në grup, klinika mund të zhvillojë aftësitë bashkëpunuese të studentëve të cilat do t'ju shërbejnë studentëve për jetën e tyre profesionale në të ardhmen. Shumë klinicistë e identifikojnë bashkëpunimin si një nga qëllimet më të vështira për tu mësuar dhe e trajtojnë atë si një nga aftësitë më thelbësore të profesionit, e cila është një ndër aftësitë më të vlëfshmë nga gjithë të tjerat të mësuara në edukimin klinik. Në mënyrë që të bëhet më i lehtë zhvillimi i aftësive bashkëpunuese, projekti mund të përfshi mundësinë që studentët të përfshihen në bisedime dhe punë të përbashkëta më njëri tjterin ose të përfshihen në marrdhënie më palë të treta siç mund të jenë ekspertë të ndryshëm.

Studentët duke u përfshirë në projekte të përbashkëta dhe duke punuar për të realizuar qëllimin e projektit ata mësohen që të punojnë në grup, mësohen që të ndajnë idete e tyre

[57] Po aty.

me njërit tjetrin, të përpunojnë idetë e njërit tjetrit dhe të arrijnë që të gjithë së bashku të realizojnë qëllimin kryesor. Kështu, duke punuar për të realizuar një qëllim të përbashkët ata aftësohen të punojnë edhe në grup. Studentët pajisen më një tjeterë aftësi shumë të rëndësishme e cila do ti ndihmojë ata në profesionin e vet në të ardhmen për të realizuar bashkëpunime më kolegët e vet në projekete të ndryshme. Fryma e bashkëpunimit është arritja më e madhe për të realizuar qëllimin kryesor.

7) Praktika dhe performanca gjyqësore

Përdorimi i performancës e shoqëruar me reagime dhe kritika është një ndër metodat kryesore të edukimit klinik e cila mund të aplikohet më së miri për qëllimin e projektit. Procesi i të realizuarit një performancë dhe më pas të marësh reagime rreth performancës, i ndihmon studentët të përmirësojnë aftësitë, të përmirësojnë pakënaqësitë e veta, dhe të ndërtojnë siguri për performancën e tyre. Studentët nga performancat e tyre mund të marin reagime pozitive po aq edhe kritika.

Studentët mund të performojnë në situata të ndryshmë ata mund të performojnë përpara klasës, ose mund të performojnë përpara supervizorit të tyre dhe duke marë reagime pozitive apo edhe kritika arrijnë që të përmirësojnë aftësitë e tyre. Studentët performojnë edhe para një trupi gjykues nëpërmjet pyetjes së dëshmitarëve, paraqitjes së provave, realizimit të mbrojtjes para trupit gjykues. Performancat e studentëve në bazë të projekteve të Klinikës, reagimet pozitive dhe kritikat që studentët marrin në këto performanca nga supervizorët e tyre apo nga bashkëpunëtorë të tjerë të projekteve, i ndihmojnë studentët për të zhvilluar aftësitë e veta profesionale dhe duke hedhur gurët e themelit të praktikës bëjnë që këta studentë të jenë mjaft të përgatitur për profesionin e vet dhe i bëjnë edhe më përgjegjës dhe më të angazhuar rreth punës së tyre në të ardhmen.

8) Komponenti seminar

Një nga aspektet më kritikuese të çdo eksperience klinike është mësimi gjatë realizimit të seminareve. Seminaret janë krijuar për të mësuar dhe zhvilluar aftësitë specifike dhe për të dhënë informacionin e nevojshëm që studentët të mund të realizojnë në mënyrë efektive punën e tyre në klinik. Seminaret e klinikës gjithashtu janë një mundësi e mirë për ide, për të diskutuar problemet që dalin gjatë realizimit të projektit si dhe për të ndarë mendimet mes studentësh.

Seminaret e klinikës më tepër përfshijnë mësimin e ligjit material, procedurial dhe rregullat e përgjegjësisë profesionale lidhur me punët e klinikës. Po ashtu gjatë seminareve mësohen aftësi ligjore të tilla si pyetja e dëshmitarëve, këshillimi i klientit si dhe arritja e një marrveshje negocimi. Nëpërmjet realizimit të ushtrimeve simuluese studentët përformojnë këto aftësi gjyqësore përpara klasës dhe mbikëqyrësit dhe më pas marin reagimet për punën e tyre.

Seminaret gjthashtu mund të mësojnë edhe aftësi të veçanta të përdorura në projektin aktual siç mund të jenë realizimi i një prezantimi, lehtësia në lënien e takimeve apo

komunikimi me klientët. Në përputhje me këtë, klinika përfshin një sërë metodash gjatë seminareve. Në seminare studentët mësojnë ligjin material dhe më pas bëjnë aplikimin e tij në projektin e tyre, të ndeshura me pyetjet etike të ngritura gjatë përfaqësimit, aftësive gjyqësore praktike, kritikat dhe mësimet nga performancat e të tjerëve dhe nëpërmjet bisedimeve reflektojnë në mënyrë kritike rreth performancës së tyre.

Para se të fillojnë programin e klinikës, studentët duhet të inkurajohen të marrin një letër dhe të shkruajnë atë që duan të realizojnë me anë të klinikës. Ata duhet të mos vet-përmbahen, të shkruajnë çdo gjë që do të dëshironin. Mund të përdorin çdo format që i duket i përshtatshëm, dhe të shkruajnë çdo gjë që i duket e vlefshme dhe se atyre do t'i shërbente në jetën e tyre profesionale. Ky format fillestar gjatë klinikës do të përmirësohet, do t'i shtohen objektivatë reja të cilat mund të jenë edhe më afër realitetit ose më të mirëmenduara. Pasi caktohen objektivat e para, ato mund të shtohen dhe përmirësohen me kalimin e kohës. Për shembull puna në prokurori mund të zhvillojë një sërë aftësish si; investigimi i fakteve, intervistimi, këshillimi, negocimi, analiza e ligjit, ushtrimi i diskrecionit mbi detyra të ndryshme që i jane caktuar, avokatia me gojë që zhvillon shumë aftësinë në të folur, ekzaminimi etj. Studentët mund të vlerësojnë se cilën prej tyre do të donin të përvetësonin apo do t'iu interesonte në karrierën e tyre profesionale.

Të përcaktosh objektivat, do ta ndihmojë edhe pedagogun mbikqyrës që të caktojë dtyrat e duhura te studentët. Kjo, pasi në varësi të detyrave të caktuara do të përmirësohen aftësi të caktuara. Gjithashtu studentët mund të flasin hapur duke treguar atë çka dëshirojnë të arrijnë dhe mënyrën se si mund të përmirësohen.

Përveç mendimit se si mund të realizohen detyra të caktuara, studentët duhet të vlerësojnë se edhe në çfarë rastesh duan të jenë të pranishëm; gjyqe, konferenca, apo në takime të zhvilluara në zyra. Kjo lidhet drejpërdrejt edhe me atë që do të donin të realizonin të nesërmen në praktikë kur të ushtronin profesionin e tyre. Nëse ata nuk shprehin interesim për to, mund edhe të mos ftohen në këto evente prandaj është e nevojshme që studenti të shprehë atë që dëshiron në mënyrë që edhe të tjerët t'i vijnë në ndihmë për ta realizuar atq që do.

Një mënyrë tjetër për të vendosur objektiva, është të mendohet mbi eksperiencat që tashmë janë kaluar. Kjo mund ta ndihmojë studentin për të përcaktuar se çfarë tjetër do të realizojë, çfarë dijesh dhe aftësish të tjera do të fitojë bazuar në ato që tashmë ka fituar. Nëse objektivat lidhen me procedimin penal disa pyetje mund t'i vijnë në ndihmë studentit në këto raste. Çfarë eksperience ka pasur ai me drejtësinë penale para se të hynte në fakultetin e drejtësisë? A ka marrë pjesë ai më përpara në një gjyq imitues dhe nëse po, cilat janë qënë përshtypjet e tij mbi këtë eksperiencë?

Një mënyrë e tretë është ajo e marrjes në konsideratë të kuptimeve të tjera që mund të kenë qëllimet e shprehura në draftin e objektivave që studenti do të arrijë. Kjo do të ndihmojë që të shmangen edhe keqkuptimet me pedagogun mbikqyrës pasi studentët mund të kenë një percetim jo shumë të qartë mbi terma të caktuar. Për shembull studentët

mund të kenë një përfytyrim të gabuar për atë që do të thotë dhe përmban në vetvete shkrimi dhe kërkimi ligjor.

Pavarësisht se shumica e studentëve kanë objektiva të shumtë për të realizuar kur hyjnë në kursin e klinikës, jo gjithmonë ato mund të realizohne në praktikë. Kjo, pasi jo çdo vend praktike ofron mundësi të shumta përmirësimi apo jo të gjithë ofrojnë mundësinë për të përmirësuar aftësitë apo për të realizuar qëllime të caktuara. Prandaj studentët duhet të marrin parasysh jo vetëm objektivat që i kanë vënë vetes por edhe hierarkinë midis tyre. Jo të gjitha qëllimet që ata i kanë vetes janë njësoj të rëndësishme, prandaj ata duhet të dinë kush prej tyre është prioritare për t'u realizuar.

Kapitulli III

Aftësitë e përfituara nga klinika e ligjit

Përmbajtja : 3.1 Si të përfitojmë aftësi të reja?; 3.1.1.Aftësitë e reja të para në dritën e globalizimit. ; 3.2 Zgjidhja e problemeve; 3. 2. 1 Modeli i zgjidhjes së problemeve; 3.2.2 Aftësitë për zgjidhjen e problemeve; 3.2.3 Rëndësia e zgjidhjes së problemeve; 3.3 Çfarë përfitojnë më shumë se të tjerët studentët e klinikës?; 3.4 Aftësitë që përfitohen nga klinika e ligjit.

3. 1 Si të përfitojmë aftësi të reja?

Një shumicë e madhe e avokatëve perceptojnë në mënyrë kritike boshllëqet midis asaj që ata mësojnë në shkollat e ligjit dhe aftësive të nevojshme në vendin e punës. Ky ishte përfundimi i një studimi të ri nga Qendra Berkman për Internetin & Shoqërinë në Fakultetin Juridik të Harvardit, në partneritet me LexisNexis, e cila arritu në përfundimin se [58] :

- Më shumë se 75 për qind e avokatëve të anketuar thanë se kishin mangësi në aftësitë praktike pas përfundimit të arsimit të tyre në shkollën e së drejtës.
- vendi i punës së sotme kërkon aftësi që kurrikulat tradicionale të shkollës së ligjit nuk i mbulojnë.

Shumë avokatë të punojnë në ekipe komplekse të shpërndara në të gjithë zyrat e avokatisë : pothuajse 80 për qind e avokatëve të anketuar i përkasin një ose më shumë ekipesh të punës, ku 19 për qind e tyre punojnë në më shumë se pesë ekipe.

[58] New Skills, New Learning:
legal education and the promise of technology- studim I Berkman center for internet & society, Universiteti I Harvardit, shkolla e së drejtës, faqe 5.

Megjithatë, vetëm 12 për qind e studentëve të drejtësisë raportojnë punojnë në grupe në projekte të klasës.

Firmat më të vogla mund të qëndrojnë konkurruese me firmat më të mëdha me anë të vendosjes më të mirëmenduar të mjeteve të teknologjisë dhe duke shfrytëzuar sasinë shpërthyese e të dhënave që janë në dispozicion në web. Avokatët që punojnë në këto firma nuk kanë aftësitë teknologjike që duhen për të realizuar këto mundësi.

- Ekspertët ligjorë seriozisht nën - shfrytëzojnë teknologjitë e reja, madje edhe në ato mjedise të tilla si edukimi ligjor klinik, që janë fusha të orientuara drejt praktikës dhe ku teknologjia është e domosdoshme të përdoret.

Hulumtimi gjithashtu tregon një shkëputje në trajnimet pas-unversitare, nga firmat ligjore veçanërisht to që janë në gjendje të përballojnë zhvillimin profesional të avokatëve të tyre.

- As fakultetet juridike dhe as shumica e vendeve të punës nuk i sigurojnë avokatëve trajnime që t'i japin atyre mundësi të zhvillojnë aftësi që të përshtasin dijet teorike me ato të praktikës. Vetëm 36 përqind e avokatëve të anketuar raportojnë një trajnim të dedikuar mb zhvillimin e tyre profesional gjatë vitit të tyre të parë të punësimit.
- Klientët janë gjithnjë të gatshëm të paguajnë për trajnimin e bashkëpunëtorëve, në mënyrë që ata të jenë më të aftë të zgjidhin çështje të komplikuara ligjore. Së fundi, është i domosdoshëm përparimi në informatikë dhe krijimi i rrjeteve që ofrojnë zgjidhje potenciale për të shmangur mangësitë në aftësi dhe ky trajnim i ka fillimet që në në fakultet.
- Duke përdorur teknologjitë për të mbështetur programet klinike shkollore të cila të parashikohen në ligj ndihmohen nxënësit në mjetet praktike në mënyrë që të fitojn aftësitë që duhet të kenë për të pasur sukses në praktikë në të ardhmen.
- Të mësuarit përmes simulimit kompjuterik pasqyron zhvillimin e teknologjisë dhe mundëson pjesëmarrësve të bëhen të aftë në marrjen e vendimeve më të përshtatshme dhe më afër me raste studimi të vërteta.

Shpesh puna e klinikave ligjore përçaktohet si e njëjtë me punën e internshipeve apo shërbimeve të përkohshme praktike. Edhe pse të dyja këto raste të praktikës, japin mësime të çmuara për studentët, përfitimet që merren nga puna e pedagogjisë klinike, janë unike sa i përket mësimdhënies nga klinikat ligjore.

Klinikat ligjore përpiqen të përmbushin vazhdimisht standardet e vendosura për funksionimin e klinikave ligjore, duke promovuar mundësi reale të pjesëmarrjes në procese gjyqësore nëpërmjet çështjeve konkrete, me klientë realë. Në mënyrë të përshtatshme ato mbikëqyrjen, për t`u dhënë studentëve mundësi reflektimi mbi gabimet e tyre, dhe mbi problemet dhe hendeqet ligjore, të pakuptueshme për ta. Këto standarde nxisin vlerat dhe përgjegjësitë e profesionit ligjor, dhe zgjerojnë aftësitë për të rritur performancën dhe nivelin e kompetencave. Angazhimi i edukuesve klinikë për

angazhimin e studentëve, për reflektimin mbi bazën e eksperiencës dhe zgjerimin e aftësive profesionale thelbësore, janë në fakt synimet dhe standardet kryesore të edukimit klinik.

Të mësuarit e këtyre aftësive dhe vlerave, siç u diskutua edhe më lart, kërkon një kohë të veçantë, për të arritur nga studentët rezultate si: reflektimi, analiza, dhe një përfaqësim i denjë për klientët. Pedagogjia klinike i angazhon mbikëqyrësit si "kritikë" të çështjeve ku studentët e angazhuar zhvillojnë praktikën në rolin e "avokatit".[59]

Një qëllim kryesor është të lejohet studenti i klinikës që të "kërkojë dhe të mendojë mbi vendimarrjen si të ishte një avokat." Kështu do të jetë i gatshëm të kritikojë vetë punën e tij si avokat, dhe të lidhë eksperiencat e tij politike, sociale dhe psikologjike me dimensionsionet e avokatisë.

Për këto arsye, "mbikëqyrja e çeshtjeve", në një klinikë ligjore, nuk do të thotë domosdoshmërisht që pedagogu mbikëqyrës u tregon studentëve se si të menaxhojnë çështjet, apo si të përshtaten me rolin e tyre drejtues. Në vend të kësaj, anëtari i fakultetit që mbikëqyr punën e klinikës, qëndron shpesh me studentët për të diskutuar problemet që ata hasin me çeshtjet e tyre, dhe për t`i ndihmuar që vetë studentët të gjejnë një zjidhje sa më të përshtatshme, ose në rastet kur nuk është pranuar përfaqësimi në gjyq, të japin një opinion ligjor sa më të saktë dhe profesional.

Mbikëqyrja e rasteve që vijnë në klinikë është shpesh një punë rraskapitëse, nëse bëhet në mënyrën më të mirë të mundshme. Ajo kërkon afrimitet të veçantë me studentët, kujdes për nevojat e tyre profesionale,por edhe për ato emocionale. Është një punë intensive në kohë, dhe një aspekt që shpesh nuk kuptohet dhe vlerësohet si duhet nga kolegët, të cilët nuk janë pjesë e klinikës.

Gjithashtu, duhet shtuar se ky rol nuk kuptohet edhe prej shumë gjyqtarëve të cilët i shikojnë studentët thjesht si të rinj që duan të marrin informacion. Klinika zbaton atë që profesor John Bradway e quan "mbikqyrje të qetë", përmes së cilës studentët fitojnë më shumë eksperiencë, në bazë të nivelit dhe cilësisë së mbikqyrjes.[60]

Ndryshe nga përvojat e tjera të praktikës, klinikat e ligjit operojnë me premisën se studenti është avokati kryesor për klientin. Njëkohësisht "kujdestarët" e klinikës duhet të kujdesen që të sinkronizojnë fokusimin te edukimi ligjor i studentit me detyrimin për të mbrojtur interesat e klientit. Synimi i klinikave ligjore është t`u mësojnë studentëve të performojnë sa më mirë që të munden. Si rezultat i kësaj studentët e ligjit përpiqen të prodhojnë përfaqësim sa më të denjë për klientët.

[59] Gundlach,note 4 at 287
[60]Clinical Law Review 547

Profesor Roy Stuckey identifikon inkulacionin e vlerave të ekselencës në praktikë - " të arrijmë përtej standardit tipik të tregut… tu shtrojmë studentëve rrugën e ekselencës" – si mënyra më e mirë e praktikës për klinikat ligjore.[61]

Gjithësesi, që në ditët e para të edukimit klinik, shqetësimi se mos studentët e ligjit do të humbisnin kohë me aspekte të parëndësishme dhe të vogla të çështjeve, se do të përfshiheshin më shumë se çduhej emocionalisht, kanë qënë gjithnjë në rritje. Argument i kundërt ishte, " nëse studentët e ligjit ndjekin dhe trajtojnë m kujdesin më të madh çështjet e klientëve të tyre, atëherë ata janë për tu lavdëruar e jo për tu shqetësuar ." Shpesh herë përfshirja e tepërt emocionale vjen nga studentët e pa survejuar, dhe jo nga ata që punojnë nën mbikqyrje.

Për këto arsye kuptimi ligjor i programeve të klinikave moderne duhet të kalojë njohuritë sipërfaqësore, si ato të reflektuara nga mbështetësit e parë të klinikës së ligjit, si nderuari Harold Greene,i cili fillimisht i përshkroi interesat praktike të studentëve si një eksperiencë suplementare për rutinën e shkollës dhe një dritë në funksionimin e sistemit të drejtësisë. ndërkohë gjyqtarja Shirley Levittan arriti të artikulojë më mirë strukturën e programeve të klinikave të ligjit duke vënë në dukje, përshembull numrin e studentëve që do të mbikqyreshin, ekzistencën e punës në grup, përdorimin e simulimeve dhe intesitetin e mbikqyrjes.

Sigurisht këta të nderuar, dhe shumë të tjerë zhvilluan gjithnjë e më shumë konçeptin e edukimit klinik duke rritur gjithnjë e më shumë çilësin e ketij edukimi dhe synimet e tij.

Ashtu si në fillim të këtij kreu evidentuam synimet kryesore, që shtrihen për të dyja palët, si për studentët ashtu edhe për klientët. Një synim dyfish, që përbën, edukimin ligjor dhe mësimin praktik dhe të mbikëqyrur të studentëve si dhe përfaqësimin dhe mbrojtjen e plotë dhe dinjitoze të interesave të klientëve.

3. 1. 1 Aftësitë e reja të para në dritën e globalizimit

Avokatët e sotëm po praktikojnë në fusha shumë më të larmishme se paraardhësit e tyre, për shkak edhe të evolimit të së drejtës e cila vjen në përputhje me ndryshimin e shoqërisë dhe zhvillimet e reja sociale. Ndërsa shumica e avokatëve vazhdojnë të punojnë vetëm, dekadat e fundit kanë treguar një rritje të konsiderushme të firmave të mëdha të avokatisë që përbëhen prej qindra avokatëve të vendosur dhe që ushtrojnë veprimatrinë e tyre profesionale kudo nëpër botë. Firmat më të vogla tani kanë mundësinë për të konkurruar në skenën globale me anë të shërbimeve që ofrojnë. Teknologjia ka lehtësuar shumë nga këto ndryshime, por aftësitë njerëzore duhet gjithashtu të mbajnë ritmin me këtë evolucion. Një ndryshim i mjedisit të punës, për shkak të ndryshimeve teknologjike por edhe të kushteve të biznesit në zhvillim, kërkon që avokatët të zotërojnë dhe perfeksionojnë aftësi të reja. Aftësitë që mund të shfaqen si të nevojshme për avokatët,

[61] Robert A.Wenke My view from the branch

mund të grupohen në tri kategori: njohuritë gjeneruese, njohuritë teknike - sociale, dhe ato praktike.

Avokatët sot kanë mundësi të përdorin të dhëna të ndryshme nga mjete teknologjike, kompjuteri, lundrimi në internet dhe më pas t'i përpunojnë këto të dhëna dhe t'i përdorin si të dhëna të dobishme në punën e tyre të përditshme. Zhvillimet teknologjike, aksesi më i madh në internet dhe përhapja e informacionit padyshim janë lehtësi që i ofrohen edhe avokatëve, si çdo profesionistë, por ata duhet të përfitojnë dhe të shfyrtëzojnë këto risi të ofruara nga bota e sotme.

Aftësitë teknike-sociale i mundësojnë profesionistëve për të punuar me kolegët nëpërmjet të mjeteve të teknologjisë, për shembull, email. Kjo lehtëson shume bashkëpunimin dhe ndërveprimin midis tyre, i jep mundësi të kufizojnë kostot monetare dhe ato në kohë dhe natyrisht është një lehtësi në punën e tyre. Aftësitë praktike përfshijnë përkthimin e praktikës apo njihurive që ofrohen prej saj në situata dhe probleme të reja të përditshme, për shembull, duke krijuar forma të automatizuara që mund të ripërdoren në situata të ngjashme. Përveç këtyre aftësive, avokatët përgjegjës për menaxhimin dhe drejtimin e firmave të avokatisë (qoftë si praktikues të vetëm apo si udhëheqës të ardhshëm të firmave të mëdha) mund të duhen aftësitë bazë të menaxhimit të teknologjisë në të njëjtën mënyrë si ata mund të kërkojnë aftësi të tjera të menaxhimit.

Shmangia e" obezitetit të të dhënave" [62] në një botë të mbingarkuar me të dhëna mund të jetë një nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen sot avokatët. Gjykimi i shëndoshë ligjor buron nga aftësia për të filtruar, vlerësuar, dhe të vepruar mbi atë që quhet informacion të mirë. Profesionistëve të rinj të cilët nuk dijnë të dallojnë të dhënat e vlefshme nga të dhënat e padobishme, ose të kthyer informacion në njohuri vepruese, do të jetë në një disavantazhi i veçantë në vendin e punës, sidomos kur ata ushtrojnë profesionin e juristit apo avokatit. Jurisprudenca kërkon patjetër një klasifikim të mirë të të dhënave, sepse përdorimi i të dhënave të panevojshme, apo jo të lidhura me çështjen, do të dëmtonte shumë punën si edhe interesat e klientit.

Janë identifikuar disa mënyra për grumbullimin e informacionit të cilësisë së lartë dhe që nëse përdoren me mprehtësi mund të gjenerojnë vlera për praktikat ligjore. Për shkak rritjes së vëllimit të përgjithshëm të të dhënave në dispozicion online, rritet edhe sasia e informacionit të dobishëm për avokatët. Sipas ekspertëve të intervistuar, avokatët që kanë aftësi të mira klasifikimi të informacionit si edhe ata që mund të vlerësojnë të dhënat e dobishme nga ato jo të dobishme, do të kenë më shumë mundësi të jenë të suksesshëm gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Është gjithashtu e mundur që të realizohet një zhvillim në strategjitë e juristëve të rinj për menaxhimin e mbingarkesës së informacionit duke i përgatitur ata me një aftësi të tillë të domosdoshme.

[62] Obezitet i të dhënave – term i përdorur për herë të parë nga David Shenk në veprën e tij Data Smog: Surviving the Information Glut (1997).

Aftësitë teknike-sociale janë aftësitë për të përdorur teknologji si një mjet shkëmbimi social dhe janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme për avokatët. Për shembull, shumica e juristëve sot punojnë në ekipe, duke përdorur sistemet e tjera të informacionit si shkëmbimi i email-eve për të komunikuar dhe për të koordinuar punën mes tyre. Në fakt, email-i është mjet praktik nëpërmjet të cilit realizohet një punë e rëndësishme ligjore. Madje ajo mund të konsiderohet se është për një avokat një mjet i rëndësishëm pune, ekuivalent i bisturisë së një kirurgu. Përsëritja që ndodh në të menduarit dhe të shkruarit juridik, ndodh me anë të shkëmbimeve të email që është një shembull të aftësive tekniko –sociale, duke ndihmuar për të gjeneruar dhe të përsosur njohuritë.

Aftësitë teknike -sociale duket se ndryshojnë nga aftësitë tradicionale shoqërore. Në fushën e negociatave, për shembull, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në internet (ODR) [63] po shfaqet si një nën- disiplinë e veçantë për që njeh negociatat online me anë të një rruge si email që ndryshon dukshëm nga i njëjti aktivitet i kryer ballë për ballë. Është e mundshme që të tjera aktivitete të kryera me mjete teknologjike, për shembull ndërmjetësimi në fushën e punës, ndryshojnë në thelb nga metodat tradicionale të kryerjes së tyre duke punuar krah për krah.

Njohuri të pakta ekzistojnë në lidhje me aftësitë teknike-sociale, asnjë prej të intervistuarve për këtë studim nuk mund të dentifikojë burimet e praktikave më të mira për avokatët për të ndjekur zhvillimet e teknologjisë për të organizuar ekipet e tyre. Shumica e firmave ligjore kanë kapacitet për të vënë në dispozicion mjete të shumta teknologjike për ekipet etyre të punës, por në shumicën e firmave që teknologjia është shumë e nënvlerësuar dhe gjen përdorim të paktë. Për shembull, ndërsa firmat më të mëdha (85%) kanë qasje në mjete të tilla si video-konferencat, dhe 65% e këtyre firmave raportojnë se e përdorin atë shpesh, teknologjia duket si e pafavorizuar duke u vlerësuar si e dobishme nga vetëm 16% e përdoruesve të saj.

Udhëheqësit e ardhshëm duhet të praktikojnë të menduarin sistematik. Zyrat e sofistikuara ligjore kanë nevojë për menaxherë që të mbikëqyrin proceset e ndryshme praktike të firmës. Këta janë personat përgjegjës për krijimin ose identifikimin e dokumenteve të automatizuar dhe që menaxhojnë një sërë çështjet teknike të firmës.

Avokatët shpesh përdorin kompjuterat për të kryer humultime mbi çështje " ligjore" dhe" faktike". Historikisht, hulumtimi i kompjuterizuar ka qenë atribut i avokatëve në kërkim të case-laë, pra çështjeve të ngjashme, por sot gati të gjithë juristët përdorin intrenetin për të kryer hulumtime për shumë qëllime. [64]

Prandaj është e domosdoshme që juristët e rinj të azhornohen me zhvillimet e teknologjisë, pasi ai mund t'i sjellë atyre shumë avantazhe dhe prioritete në punën e tyre. Sot në fakt, të rinjtë janë më afër risive teknologjike se të rriturit, megjithatë studentët e klinikës duhet të orientohen t'i përdorin këto mjete për qëllimin e duhur. Kryerja e

[63] ODR- Online Despute resolution- një rrugë jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmmarëveshjeve on-line, e cila ka gjetur përhapje në shumë vende të botës, sidomos mosmarrëveshjet tregtare.
[64] Legal Clinics and Law Students: Rocks and Cement for Better Legal Education- John S. Bradway, fq 49.

kërkimeve, humultimeve për të gjetur një bazë ligjore për probleme të ndryshme juridike është një mundësi e përdorimit të tyre. Gjithashtu komunikimi me juristë nga e gjithë bota mund t'i vijë në ndihmë atyre, por edhe marrja e një infromacioni të larmishëm apo konsultimi i bibliotekave on-line. Sot, ka një numër të madh faqesh interneti që i vijnë në ndihmë studentëve të drejtësisë. Duke qënë se është synuar informatizimi edhe i administratës publike, studentët jo vetëm që marrin informacion të larmishëm por edhe hyjnë në kontakte me një sërë profesionistësh të fushave të ndryshme të cilët do t'i vijnë në ndihmë me punën dhe eksperincën e tyre. Gjatë punës së tyre si studentë të klinikës, teknologjia dhe interneti do të bëjë të mundur lehtësimin e detyrave të studentëve duke përmirësuar edhe aftësitë e tyre kërkimore dhe ato të shfyrtëzimit të burimeve të ndryshme që kanë në dispozicion. Kjo është një aftësi e nevojshme që do t'u duhet gjatë gjithë jetës së tyre profesionale.

3. 2 Zgjidhja e problemeve

Një prej aftësive më të rëndësishme që i duhet një avokati gjatë jetës së tij profesionale, dhe që fitohet nga klinika ligjore është aftësia për të zgjidhur probleme. Gjatë jetës së tij profesionale avokati do të përballet me shumë çështje të ndërlikuara, të cilat edhe nuk do të mund t'i japë një zgjidhje, por e rëndësishme është që ai të zhvillojë aftësinë për të menaxhuar situata të ndryshme. Menaxhimi i situatës do ta nxjerrë atë nga shumë situata që mund të konsiderohen labirinte pa dalje. Me anë të këtij menaxhimi ai do të jetë i aftë të zgjidhë probleme të ndryshme juridike ose jo, të cilat do t'i paraqiten në jetë.

Qëllimi i trurit, ashtu si çdo organ tjetër i trupit është të sigurojë mbijetesën e organizmit njerëzor. Ky funksion është automatik, truri reagon ndaj çdo faktori të jashtëm ose të brendshëm që synon të kërcënojë mirëqënien e tij. [65] Zgjidhja e probleme është një mekanizëm bazik për mbijetësën, njëriut i duhet të zgjidhë problemet me të cilat përballet në mnëyrë që të jetojë. Megjithësë njerëzit në botën moderne nuk përballen me rreziqe të tilla si sulmi nga kafshët e egra, osë të jetë pa strehë apo ushqim, por rreziqet mund të shfaqen në forma të tjera që cilat kërcënojnë mirëqënien e tyre. Në kuadër të të qënit një avokat apo student praktikant, këto rreziqe mund të marrin forma të ndryshme si; frika e të mos diturit ose të bërit një gabim, frika e mos ofrimit të një pune, ose frika e humbjes së punës ose klientit.

Kjo frikë mund të mos jetë shumë racionale, në rastin e studentëve që bëjnë një praktikë dhe i jepen detyra të caktuara, dhe kërkohet marrja e një feed-backu nga pedagogu mbikqyrës. Megjithatë ambienti i punës mund të jetë stresues dhe të ketë presion ndaj studentëve praktikantë, gjë që e vështirëson së tepërmi aftësinë e tyre për të zgjidhur probleme ose për të mësuar lirisht. Sipas imazheve të skanimit të trurit shihet se ai nuk është efikas gjatë mosmenteve të trysnisë apo frikës, dhe se ai mëson më shpejt gjatë momenteve të qetësisë dhe kur njëriu është i lumtur. Kjo tregon se është e nevojshme që ambienti i punës të jetë paqësor dhe studentët të përkrahen gjatë punës, t'i vihen në dukje gabimet jo në mënyrë kritike dhe të nxiten të përfshihen në inisiativa të reja. Ata duhet të

[65] Learning from practice – J.P.Ovigly, Leah Wortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II, faqe 173.

përgëzohen kur realizojnë një detyrë në mënyrë të suksesshme apo edhe kur nuk e realizojnë dot atë por përpiqen dhe përkushtohen duke dhënë energji dhe dëshirë.

Fakultetet e drejtësisë nuk mund t'i trasnformojnë studentët në zgjidhës të mirë problemesh. Zgjidhja e problemit vjen natyrshëm, sepse është një mekanizëm për mbijetesë. Çdo student i të drejtës ka zgjidhur probleme shumë më herët se të frekuentonte fakultetin. Gjithashtu secili prej tyre solli me vete disa cilësi personale të cilat e ndihmojnë ose e pengojnë të zgjidhi problemet lehtësisht.

Aftësia për të zgjidhur problemet mund të ndryshojë nga sistemi tradicional arsimor prej sistemit më të moderuar të mësimdhënies që aplikohet sot në fakultetet e drjtësisë. Aftësitë mbi zgjidhjen e problemeve në fakultetet e drejtësisë kërkojnë; leximi i çështjeve ligjore dhe nxjerrja e bazës ligjore të përdoruru në to, identifikimi i fakteve të çështjes që ka çuar gjykatën të marrë një vendim të tillë, mësimi përmendësh i rregullave dhe ligjeve kryesore, fakteve dhe politikave, analizimi i këtyre fakteve te një çështje konkrete, paraprimi i argumentave që mund të sillen nga të dyja palët, dhe shkrimi dhe i foluri në mënyrë ligjore. Këto aftësi që fitohen gjatë fakultetit të drejtësisë dhe që janë vendimtare për" mbijetesën" në mjedisin e punës, mund të përdoren shumë mirë për zgjidhjen e problemeve.

Problemet e jetës reale nuk përshtaten domosdoshëmrisht me çështjet dhe kazuset e njohura në provimet në fakultet. Problemet në jetën reale synojnë të jenë të keq-strukturuara, jo të mirë-përcaktuara dhe shpesh paraqiten me pjesë që mungojnë.

Një avokat mund të përballet me një familje që paraqitet në zyrën e tij duke qarë, pasi zjarri që ka rënë në shtëpinë e tyre ka shkatërruar çdo gjë. Pas pyetjeve të mëtejshme ai verifikon që djali ka pasur dëmtime të rënda pasi është hedhur nga dritarja për t'i shpëtuar zjarrit. Dhe pas hetimeve verifikohet se kompania përgjegjëse nuk ka vendosur shkallë zjarri siç do të duhet të bënte.

Për shkak se truri i avokatëve dhe i studentëve është trajnuar shumë mirë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme me anë të provimeve në fakultet, ata synojnë të bëjnë një përqasje ligjore për çdo problem që i kërkohet të zgjidhin. Prandaj trajtimi dhe zgjidhja e një problemi mund të sjelle pasoja komplekse, të padëshiruara për klientët të cilët mund të pretendojnë se avokati nuk po i mbron siç duhet interesat e tyre.

Për të qënë efektiv në zgjidhjen e problemeve, duhet të mësohet si të përballen ato në mënyrë më të hapur, pa shkuar direkt te zgjidhja që ofron ligji ose pa lejuar instiktet primare personale të japin zgjidhje të pamenduara të problemit. Një nga sfidat më të mëdha është të përmirësohen aftësitë dhe dijet personale dhe të praktikohen këto derisa të bëhen mjete të vlefshme për zgjidhjen e problemeve.

3. 2. 1 Modeli i zgjidhjes së problemeve

Modelet shpesh mund të shërbejnë si udhërrëfyes të mirë për të ndihmuar juristin ns zgjidhjen e problemeve me të cilat përballet. [66] Disa modele parashikojnë një pamje të të gjithë procesit, duke i ardhur në ndihmë edhe funskioneve të trurit për të trajtuar atë siç duhet dhe për të implementuar mënyra të reja të të menduarit dhe vepruarit. Modelet mund të jenë një drejtues i mirë në raste të veshtira, por modelet mund të jenë edhe të rrezikshëm nëse aplikohen njësoj për të gjitha situatat, pa u thelluar në lidhje me to dhe pa hyrë në themel të problemit. Prandaj avokatët duhet të marrin parasysh interesat, vlerat dhe nevojat e çdo problemi të veçantë në mënyrë individuale. Një prej modeleve më të mira të zgjidhjes së problemeve paraqitet më poshtë, i cili është konsideruar si mjaft efikas dhe përfshin disa hallka zinxhir në vetvete. Në seclilën hallkë merret një informacion i caktuar i cili do të jetë i nevojshëm por jo i mjaftueshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve qe do dalin në çdo fazë. Për shembull gjatë diskutimit të problemit me të tjerët, avokati mëson rreth personalitetit të të tjerëve, sjelljeve, karakteistikave të të tjerëve, ndikimet e jashtme etj, të cilat do të ndikojnë sjelljen e dikujt në trajtimin e një problemi të caktuar.

Po paraqesim më poshtë një model për zgjidhjen e problemeve, i cili përbëhet nga disa hallka dhe mund t'u vijë në ndihmë si avokatëve ashtu edhe studentëve të klinikës.

1. **Analiza e situatës** ==> 2. **Diagnostikimi i problemit** ==> 3. **Investigimi** ==>
4. **Vlerësimi i zgjidhjeve** ==> 5. **Plani i veprimit** ==> 6. **Implementimi** ==>
7. **Vlerësimi**

Fig. 2

Faza e parë konsiston në Analizimin e situatës, dhe i referohet vlerësimit se çfarë po ndodh realisht dhe e ndihmon personin të ecë përpara në fazat e tjera. Në këtë fazë mund të bëhen disa pyetje ndihmëse :

- Çfarë nuk shkon me situatën konkrete? Si ndikon ajo te unë?
- Cila do të ishte situata ideale?
- Çfarë duhet të bëj tani?
- Kam përjetuar diçka të ngjashme më përpara? Nëse po, si mësova të jem më i dobisëhm atëherë?

[66] Po aty.

Faza e dytë është Diagnostimi i problemit, dhe ofron një përcaktim paraprak të problemit duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve :

- Si mund ta përcaktoj problemin në këtë pikë?
- Kush tjetër mund të më ndihmojë për të identifikuar problemin?
- Cilat janë rolet, interesat, objektivat?
- Kë dhe çfarë prek ky problem?
- Cilat janë interesat apo objektivat e tyre?
- Kush apo çfarë është përgjegjës për këtë problem?
- Është problemi pjesë e një problem edhe më të madh?
- Nëse po, kujt duhet t'i adresohemi fillimisht?
- A mund të ishte parandaluar një problem i tillë?

Faza e trët, përbëhet nga Investigimi ose hetimi i situatës. Ajo shërben për të parë jashtë kontekstit të problemit për të kuptuar çfarë informaciobi shtesë duhet dhe kush mund të ndihmojë për ta siguruar atë. Kjo fazë e nxit avokatin ta rivlerësojë problemin si pasojë e procesit të hetimit. Disa pyetje që mund të jenë ndihmëse në këtë proces janë :

- Çfarë informacioni shtesë duhet? (fakte, ndjenja, çështje ligjore)
- Kush/çfarë mund të ndohmojë?
- Kush është personi/enti i përshtatëshmë për ta zgjidhur këtë problem?
- A ka çështje kulturore që duhen marrë në konsideratë?

Faza katër përbëhet nga Vlerësimi i zgjidhjeve dhe ndihmon personin të zhvillojë disa zgjidhje ligjore ose jo, për të adresaur problemin. Kjo fazë jep mundësi për teknika kreative të të mënduarit. Pyetjet potenciale që mund të përdoren këtu janë :

- Çfarë zgjidhjesh ofron ligji?
- Çfarë zgjidhjesh të tjera mund të ketë? Mund të ndihmojë i menduari kreativ?
- Interesat, vlerat apo objektivat do të prekte kjo zgjidhje?
- Çfarë do të donte klienti të bënte?
- Çfarë problemesh të reja mund të sillte secila prej këtyre zgjidhjeve?
- A mund të parandalohen këto problem të reja potenciale?
- Cila zgjidhje do të ishte më efikase?

Pasi mendohet për disa variante zgjidhjesh, vjen faza e pesët që është Plani i veprimit. Ky plan mund të përfshijë një ose disa zgjidhje. Procesi i aplikimit në praktikë të këtij plani është gjithashtu një proces që duhet marrë në konsideratë në këtë fazë. Pyetjet që mund të ndihmojnë në këtë fazë janë :

- Cila është mënyra më e mirë e veprimit?
- Çfarë duhet të përfshihet?
- Kush do të vërë në zbatim planin?
- Kush është përgjegjës për të?
- Si duhet të merren vendimet?

- Çfarë problemesh të reja mund të krijohen, dhe çfarë hapash duhen marrë për t'i parandaluar ato?
- Marrë parasysh infromacionin e paraqitur më lart, cila është rruga më e mirë?
- Çfarë është mësuar?

Pasi vlerësimit në mënyrë të kujdesshme kalohet në fazën gjashtë që është Implementimi, pra zbatimi i planit në praktikë. Pyetjet më të rëndësishme në këtë fazë janë :

- Po e ndjek unë planin e veprimit? Nëse jo, përse?
- Është plani i veprimit duke prodhuar rezultatet e prituara?
- A duhet ta ndryshojë unë planin e veprimit dhe nëse po, në ç'mënyrë?

Faza e fundit është Vlerësimi, është një përpjekje për të vlerësuar gjithë procesin dhe të reflektohet në atë që është mësuar dhe në gjithë procesin e zgjidhjes së problemit. Është një hap i thjeshtë por i domosdoshëm, që realizohet vazhdimisht, para, gjatë dhe pas fazës zbatuese. Këtu mund të bëhen pyetje si :

- A është zgjidhur problemi?
- Çfarë ndodh nëse janë krijuar probleme të reja?
- Ishte plani i veprimit i përshtatshëm? A mund të ndrsyhohej ndonje gjë paraprakisht?
- Çfarë u mësua nga i gjithë procesi?

Kur aplikohet ky model për zgjidhjen e problemeve është e rëndësishme të dihet se procesi nuk ecën gjithmonë aq lehtë sa shfaqet në skemën vizuale. Shpesh herë do të duhet të kthehesh mbrapa për të rivlerësaur situatën, për të mbledhur informacion shtesë, për t'u konsultuar me disipilina të tjera. Të gjitha këto do të jenë hapa ta nevojshëm gjatë zgjidhjes së problemit. Është e rëndësishme që të adoptohet një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe fleksibël. Ndekja e këtyre hapave me kujdes do të lehtësojë zgjidhjen e një problemi, por që natyrisht ajo nuk realziohet njësoj për çdo student. Zotërimi i disa aftësive të veçanta e ben punën më të lehtë dhe rezultatin më të arritshëm për disa. [67]

3. 2. 2 Aftësitë për zgjidhjen e problemeve

Ashtu siç u shfaq edhe nga modeli më lart, zgjidhja e problemeve kërkon disa aftësi të veçanta për të ofruar një zgjidhje të mirë dhë fleksibël. Ato që duhen janë disa vlera, sjellje dhe aftësi. Aftësitë që nevojiten në procesin e zgjidhjes së problemeve përfshijnë; të dëgjuarit, bashkëpunimin, puna në grup, gjetja e fakteve, kominikimi i mirë, arritja e konsensusit, marrja e vendimeve të drejta, velrësimi i përshtatshëm i situatës, i menduari kreativ, vlerësimi i nevojave, puna në disiplina të tjera, dhe berja e pyetjeve të duhura.

Dëgjimi dhe pyetja. Shpesh juristët mendojnë se ata dinë të dëgjojnë duke prezumuar se e bëjnë atë çdo ditë. Dëgjimi gjatë punës me të tjerët dhe kryesisht në zgjidhjen e problemeve është një proces i ndryshëm që diferencon nga dëgjimi i përditshëm. Ai kërkon vëmendje të plotë te folësi dhe interes të plotë për të kuptuar vërtet atë që folësi po

[67] Learning from practice – J.P.Ovigly, Leah Wortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II, faqe 179.

mundohet të thotë. Ndonjë herë kjo përfshin të dëgjosh gjëra që folësi nuk po i thotë, ose të lexosh midis rreshtave. Në kuadër të punës me klientët ky dëgjim mundëson përmirësimin e raporteve dhe mtë ndërtohet një marrëdhënie besimi midis palëve e cila do të ndihmojë gjatë gjithë procesit. Dëgjimi është një aftësi bazë për të identifikuar problemin, të kuptosh impaktin që ai ka te klienti, dhe sqarimi i nevojave të klientit.

Shumë e rëndësishme është që avokati të mos bëjë shumicën e të folurit, por ai më shumë të dëgjojë dhe të mundohet të kuptojë dhe reflektojë. Puna e tyre është të inkurajojnë të tjerët për të komunikuar lirisht dhe të bëjnë pyetjet e duhura aty ku nevojiten.

Bashkëpunimi dhe puna me të tjerët, është një aftësi shumë e rëndësishme, qoftë edhe me profesionistë ë i përkasin disiplinave të ndryshme. Bashkëpunimi nuk është një aftësi që zhvillohet gjatë studimeve në drejtësi. Studentët kanë shumë pak mundësi bashkëpunimi gjatë studimeve, ndoshta gjatë një gjyqi imitues, por në fakt atyre nuk u jepen udhëzime se se të realizojnë një bashkëpunim efektiv dhe të frytshëm. Gjithashtu, ata mund të preferojnë të punojnë vetëm, duke menduar se kanë më shumë kontroll mbi punën e tyre. Zgjidhja e problemeve, në fakt përfshin edhe punën dhe bashkëpunimin me njerëz të tjerë. Shpesh herë kjo realizohet nëpër grupe dhe aftësitë për ta bërë këtë nuk vijnë domosdoshmërisht në mënyrë natyrale. Bashkëpunimi dhe puna në grup kërkojnë komunikimi të qartë dhe një ndjenjë të lartë përgjegjësie për punën e kryer dhe gjithashtu një angazhim për të realizuar qëllime. Avokatët shpesh punojnë me profesionistë nga disiplina të tjera, e cila ngre një sërë çështjesh të tjera. Për shembull hierarkitë e heshtura midis dispilinave ose çështjeve të personalitetit mund të sjellë probleme në punën në grup. Mund të lindin probleme komunikimi, sepse secila disiplinë ka gjuhën e vet dhe mënyrën apo metodat specifike për zgjidhjen e problemeve. Shumë e rëndësishme të theksohet është se puna me profesionostë që i përkasin disiplinave të ndryshme, kërkon respekt reciprok që lidhet me të kuptuarit se çdo disiplinë kontribuon në mënyrën e vet në zgjidhjne e një problemi të caktuar. Ndërtimi i konsensusit është një aftësi e domosdoshme në punën në grup dhe lidhet me mënyrën e pavarur të çdo anëtari të grupit për të dëgjuar, vlerësuar dhe komunikuar me të tjerët në grup.

Gjykimi i mirë është një aftësi kyçe në proceszin e zgjidhjes së problemeve. Një nga pasojat e shkollimit ligjor është se juristët tentojnë të përqëndrohen shumë në çështje të caktuara, duke i kategorizuar problemet ligjore kryesisht si çështje të të drejtave. Kjo ka qënë një metodë efikase për zgjidhjen e problemeve gjatë fakultetit, dhe truri i tyre është stervitur me këtë mënyrë, pasi refktohet mënyra e librave për të mësuar studentët në zgjidhjen e një çështje të caktuar. Në botën reale, problemet ligjore nuk shfaqen në mnëyrë kaq precize. Ata shpesh herë janë shumë më të komplikuar dhe metoda e mësuar nga studentët në shumë raste nuk mjafton për t'i dhënë një zgjidhje të saktë atyre. Përveç të drejtave të njeritu ata hasin çështje të shëndetit, të mjedisit, si edhe ndërthurjen e interesave ekonomike. Emocione si inati, turpi, hakmarrja dhe frika mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces. Gjithashtu ndodh shpesh që përveç palëve në proces të përfshihen edhe interesat e personave të tretë. Mund të këmi përfshirjen e miqve, anëtarëve të familjes, si edhe anëtarë të komunitetit, të cilët mund të preken nga çështja

në fjalë. Të kuptosh përmasat e problemit mund të ketë një impakt të rëndësishëm në zgjidhjen e problemit. Gjithashtu ta shohësh problemin në një kënd më të gjerë të ndihmon të mendosh edhe një larmi zgjidhjesh të cilat mund të jenë efikase dhe t'i vijnë në ndihmë palëve të përfshira në konflikt por edhe personave të tretë që preken. Gjithashtu ata duhet të praktikojnë aftësitë e tyre gjykuese në mënyrë që gjykimi dhe vlerësimi i bërë për çdo çështje të jetë ai i duhuri. [68]

I menduari kreativ. Fakultetet e drejtësisë japin disa mësime në lidhje me mendimit kreativ, pasi inkurajohen studentët të japing zgjidhje të ndrsyhme për një problem të caktuar, duke ndërthurrur trajtimin ligjor me atë praktik. Në fakt, duhet dalluar i menduari kritik me atë kreativ. Ndërsa i menduari kritik i jep mundësi juristit të shikojë problemin me sy kritik, duke dashur ta analizojë dhe t'i japë një zgjidhje sa më të drejtë, koncepti ndryshon te mendimi kreativ. Në mëndimin kreativ synohet të ofrohen alternativa të ndryshme zgjidhje, të jemi kreativ, të kemi një imagjinate të zhvilluar duke ofruar sa më shumë mundësi apo opsione që synojnë të kënaqin rezultatet e kërkuara. Megjithatë ka disa teknika të mendimit kreativ të cilat synojnë të rritjen e aftësisë për të zhvilluar argumenta të rinj. Nëse juristët janë të interesuar në zgjidhjn e problemeve, dhe e shohin problemin në një këndvështrim më të gjerë, atëherë i menduari kreativ mund ta ndihmojë trurin e tyre të realizojë lidhje të reja dhe të dobishme.

Çdokush mund të mendojë në mënyrë kreative, ky është një proces që nuk kërkon një talent të veçantë. Shumë mendojnë në këtë mënyrë kur ndalojnë së menduari në mënyrë mekanike për problemin e shtruar për zgjidhje. Të bësh një shtëtitje ose një dush, për shembull, janë mënyra të mira për të stimuluar ide të reja. Këto metoda duke menduar vazhdimisht mbi një problem të caktuar. Kështu ai do të ndihmohej shumë nëse do të lejohej për një çast të shlodhej, madje ideja brilante e zgjidhjes mund të vijë tamam në këtë moment.

Një metodë tjetër e mendimit kreativ është *ndërrimi i lenteve*, çka nënkupton se duhet parë problem me një sy tjetër, nga një këndvështrim i ndrsyhëm, nga një kënd apo aspekt i ri. Për shembull, avokatët mund ta shohin problemin në dritën e një dispiline tjetër, të shohin se si do të zgjidhej ky problem nga një profesionist i një disipline tjetër. Marrim rastin e një problem në lidhje me shëndetësinë, i cili do të shihej nga këndvështrime krejt të ndryshme nga një mjek, pacient, avokati i pacientit apo një biznesmen, të krahësim me mënyrën se si do të shihej nga një jurist.

Fjalët, figurat dhe objektet, gjithashtu mund të stimulojnë të menduarin kreativ. Ka një shumëllojshmëri lojrash fjalësh. Një metodë është të ndërrohet fjala me një tjetër që ka ngjashmëri me të. Kjo mund të çojë në një këndvështrim tjetër të problemit dhe në zgjidhje alternative. Për shembull, nëse avokati po shqetësohet për aftësitë jo të mira të komunikimit të klientit, ndoshat ai duhet të merret me aftësitë e tij të komunikimit. Komunikimi i tij ndoshta është shumë i ashpër dhe e ndrydh klientin. Për të pasur një

[68] Understanding the big picture – Të shohësh problemin në një kënd më të gjerë, nga një pikëpamje më e gjerë, e cila do të shërbejë për të gjetur një zgjidhje me efikase. (shënim i autorit)

zgjidhje efikase ai mund ta përmirësojë këtë dhe kjo do të çojë edhe në lehtësimin e problemit.

Një mënyrë efkase është përdorimi i fjalëve, figurave dhe objekete të zakonshme si një mnëyrë për të diversifikuar mënyrat e zakonshme që përdor truri për të trajtuar problemin. Këtu mund të vijnë në ndihmë fjalë ose figura nga më të thjeshtat.

Mënyrë tjetër është *imagjinata*. Si do të ishte bota nëse ky problem nuk do të ekzistonte? Si mund të realziohet kjo ëndërr? Mund të imagjinohet bota ose shoqëria pa atë problem të caktuar dhe lehtësitë që kjo do të sillte. Kjo mund të ndihmonte të gjendeshin mënyra të ndryshme dhe efektive të mendimit dhe të gjetjes së një zgjidhje. Megjithatë shumë prej problemeve kërkojne një plan konkret veprimi në mënyrë që t'u jepet zgjidhje.

Shumë libra dhe artikuj shkencorë mund t'u vijnë në ndihmë juristëve të rinj për të përmirësuar metodën e mendimit kreativ, si një aftësi e domosdoshme për të zgjidhur probleme. Ato mund t'i vijnë në ndihmë edhe profesionistëve të fushave të tjera sepse çdokush merret me zgjidhjen e problemeve dhe mund të përdoren nga të gjithë. Përdorimi i metodave të tilla mund ta zgjojë trurin nga ai i menduari standard i përditshëm, i cili shpesh nuk rezulton i suksesshëm për zgjidhjen e çdo problemi. Zgjidhja e problemeve jo vetëm që është e domosdoshme për vazhdimësinë e punës por gjithashtu i ofron avokatëve një kënaqësi të madhe profesionale duke i ndihmuar të realizohen në karrierën e tyre.

Sjelljet janë të domosdoshme gjithashtu. Sjellje të rëndësishme për të zgjidhur probleme janë të jesh mendje. hapur, këmbëngulës, i durueshëm, jo paragjykues, i repsektuesëhm, kureshtar, i besueshëm, i vetdijshëm për konfliktin e interest, i hapur ndaj kritikave, i prirur drejt ndryshimeve pzitive dhe për të parë deri ku shkojnë aftësitë personale.

Këto sjellje mund të ndahen në dy grupe. Në grupin e parë përfshihen ato aftësi që i dnihmojnë juristët të punojnë në mënyrë efikase më të tjerët. Këtu përfshihet; të mos qënët paragjykues, të qënët i respektueshëm, i besueshëm, dhe i hapur ndaj kritikave. Natyrisht, mungesa e ndonjë prej këtyre aftësive do të sillte mangësi në bashkëpunimin në punën në grup.

Grupi i dytë i aftësive përfshin të jesh mendje-hapur, këmbëngulës, i duruar, kureshtar, i japin mundësi juristit të punojë shumë dhe të jetë efektiv në zgjidhjen e problemit. Për shkak se truri do të përdorë metoda të përdorura për zgjidhjen e problemeve, ai shpesh e ka të vështirë të përqafojë metoda të reja. Kjo bën që truri ta ketë të vështirë të të zgjidhë problemet shpejt, duke e pasur të vështirë edhe të zgjidhë jetë mendje. hapur dhe këmbëngulës. Megjithatë kureshtja mund të shërbejë për ta zgjidhur këtë ngërç, duke ofruar pak durim në mënyrë që procesi i zgjidhjes së problemit të vazhdojë dhe të japë rezultatin e dhëshiruar.

Vlerat janë gjithashtu të rëndësishme për procesin e zgjidhjes së problemeve. Ato ndërthurren me aftësitë dhe sjelljet dhe përfshijnë repsektin mbi marrëdhëniet e

ndrsyhme, respektimi i diferencave, i kulturës, i dijeve të të tjerëve, vlerësimi për marrjen e vendimeve, pranimi i kufizimeve të dikujt, përfshirja, kreativiteti, vetdija, vet-reflektimi. Këto vlera inkurajojnë bashkëpunimin dhe vendosmërinë për zgjidhjen e problemeve. Ato ndajnë subjektet nga tendenca për t'u përfshirë në zgjidhjen e problemit apo për t'u përfshirë nga panikukur përballen me një problem të caktuar.

3. 2. 3 Rëndësia e zgjidhjes së problemeve

Sot po përballemi me ndryshime të shumta, ka një rritje të konkurencës për punë dhe klientë, zhvillime të vrullshme teknologjike, procesi i pandalshëm i globalizimit, prandaj juristët nuk mund të bazohen vetëm në analizën e ligjit për të qënë të suksesshëm. [69]

Mënyra të reja për të ndihmuar klientët mund të përdoren nga avokatët. Avokatia bashkëpunuese është një term që përdoret sot për të identifkuar pikërisht këtë vlerë të rëndësishme në procesin e avokatisë. Kjo do të thotë bashkëpunim me klientin, marrja parasysh jo vetëm e nevojave por edhe e mendimit të tij, Gjithashtu menaxhimi i konflikteve, parandalimi dhe jo kurimi i problemeve, dhe puna e përbashkët janë shembuj të mënyrave më të fundit për të zgjidhur dilemat e klientëve. Shumë institucione kanë ndërtuar mekanizma të shumtë për të parandaluar përkeqësimin e problemeve. Duke përfshirë këtu dialogun, marrëveshjet si edhe ndërmjetësimin, pajtimin apo arbitrazhin.

Duke marrë parasysh këto përqasje të reja procesi i zgjidhjes së problemeve bëhet më efiksa, ofron metodologji të reja dhe për zgjidhje më praktike dhe modern. Gjithashtu rritet roli i avokatëve në shoqëri, ata bëhen persona të rëndësishëm në aspektin e trajtimit të problemeve shoqërore dhe behën më të dobishëm. Gjithashtu sot promovohen vlera të reja me anë të avokatisë si; promovimi i drejtësisë sociale, vlerësimi i vyrtyteve, përpjekjet për parandalimin e problemeve, si edhe vet-reflektimi kritik. Sot procesi i zgjidhjes së problemeve kërkon një përqasje më modern të problemit duke refuzuar përdormin e metodave të vjetra tradicionale, duke qënë se edhe shoqëria ka ndryshuar, së bashku me problemet që e shqetësojnë atë.

Një model shumë i mirë bashkëpunimi është modeli i paraqitur në SH. B. A në gjykatat për trajtimin e të droguarve, ku ka një bashkëpunim të ndërsjelltë midis avokatëve, prokurorit, gjyqtarit si edhe specialistëve të fushës për ta trajtuar nga ana mjekësore personin në mnyrë që të rehabilitohet.

Gjithashtu përdorimi i metodave jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ADR është një trajtim më i diferencuar i problemeve duke marrë parasysh në rradhë të parë nevojat e palëve në proces dhe ofrimin e një zgjidhje të përshtatshme për ta. Këto metoda synojnë në rradhë të parë parandalimin e problemit dhe mos përkeqësimin e tij. Nëse ai është krijuar synohet të gjendet një zgjidhje sa më e mirë për ta eleminuar me sa më pak pasoja negative. Gjithashtu synohet minimizimi i pasojave të mëtejshme negative, duke menduar në mënyrë kritike për të. Kjo mënyrë e mendimit e ndan avokatin e mirë nga ai

[69] Clinical Anthrology. Readings for live-client clinics – A.J.Hurder, F.S.Bloch, S.L.Brooks, S.L.Kay. Anderson Publishing Co, Ohio, fq 89.

jo i mirë. Zhvillimi i aftësisë për zgjidhjen e problemeve ndihmon avokatët të jenë më të suksesshëm, të përfaqësojnë më mirë interesat e klientit dhe gjithashtu të marrin një kënaqësi më të madhe shpirtërore për punën e tyre.

Pra, mund të themi se zgjidhja e problmeve është një proces jetik, i cili mundëson mbijetesën profesionale të juristit. Nëse ai dështon herë pas here në këtë nismë, atëherë nuk mund të jetë i suksesshëm në punën e vet dhe klientët nuk do të jenë të prirur të zgjedhin atë si përfaqësues të interesave të tyre. Prandaj mësimi i kësaj aftësie më anë të klinikës i vjen në ndihmë studentëve të jenë të suksesshëm në punën e tyre. Ata do të jenë të aftë të jo vetëm të përballojnë problemet që do të hasin në të ardhmen, por do të jenë të aftë edhe t'i zgjidhin ato me profesionalizëm. Nëse mësohen vazhdimisht të gjejnë një zgjidhje për problemin ata do të jenë në hapat e parë drejt shndërrimit në profesioniste të suksesshëm në të ardhmen. Edhe nëse zgjidhja në fillim nuk është ajo e duhura, apo nuk arrihet rezultati më i mirë i mundshëm, përfitimi sërsih ekziston. Edhe mundimi që ata marrin përsipër për të zgjidhur një çështje të caktuar, është domethenës në këtë proces. Ata aftësohen duke u përballuar me situata të vështira, sepse në fund të fundit kjo është ajo që ata do të bëjnë në praktikë.

Çfarë janë avokatët? Me fjalë të thjeshta mund të themi se ata janë zgjidhës problemesh. Ata zgjidhin problemet që njerëzi hasin gjatë jetës së tyre dhe që nuk kanë mundësi për t'i zgjidhur vet. Kështu që ata i drejtohen profesionistëve, të cilët do të ofrojnë shërbimin e tyre porfesional për të zgjidhur një çështje apo problem të caktuar. Avokatia është një punë si gjithë të tjerat. Ofrohen një shërbim kundrejt pagesës, por e veçnata është se avokatët nuk punojnë me lëndë të parë në kuptimin fizik të fjalës. Avokatët punojnë më problem, kjo është puna e tyre e përditshme. Ky është një koncept që duhet ngulitur në mendjen e studentëve sepse thjesht i menduari në mënyrë të tillë i bën ata të jenë të përgatitur për të ushtruar siç duhet profesionin e tyre.

3. 3 Çfarë përfitojnë më shumë se të tjerët studentët e klinikës?

Profesorët më të mëdhenj të klinikës nëpër universitete botërore janë pyetur pse klinika është e domosdoshme për studentët. Sot po i kushtohet një rëndësi gjithmonë e më e madhe klinikës, si pjesë e pandarë e edukimit juridik, dhe madje ajo po zhvillohet dhe perfeksionohet në forma të reja dhe të vlefshme për studentët por edhe për stafin akademik.

Në opiniohet e tyre ata janë shprehur se klinika është pjesë e pandarë e edukimit juridik që ofrohet për studentët, pasi u ofron atyre disa cilësi thelbësore që nuk mund t'i përfitojnë vetëm nga përvetësimi i lëndëve teorike. Aspekti material dhe procedurial i të drejtës mësihet nëpër auditorë, megjithatë mësimi i vërtetë dhe përthithja e informacionit nuk mund të realizohet ndryshe përveçse duke praktikuar atë që mësohet. Të jesh pjesë e klinikës do të thotë të prekësh të drejtën, ta bësh atë nga abstrakte në konkrete, të përfitosh dhe marrësh maksimumin prej saj. me pak fjalë, ajo u jep atyre me aftësitë themelore, gjykimin dhe vlerat e nevojshme që të angazhohen në praktikën e ligjit.

Pyetjes se cilat janë sfidat më të mëdha për studentët në klinikën e ligjit, Michael Pinard, profesor i klinikës në Universitetin e Maryland-it në Sh. B. A përgjigjet : Puna në klinikë është intensive. Ajo i përball studentët me çështje të vështira ligjore dhe me klientë të cilët kanë kaluar vështirësi të ndryshme në jetën e tyre. Ajo i përball ata me sfidën e zbulimit se kush janë ata si njerëz, cilët janë ata si studentë dhe cilët duan të jenë si avokatë të ardhshëm. [70]

Pyetja lind se çfarë iu duhet studentëve të heqin nga një përvojë klinikë? Ata detyrohen të largohen nga kaq shumë gjëra. Ata mësojnë fuqinë e ligjit. Ata gjithashtu mësojnë që klientët shpesh kanë probleme të shumta ligjore dhe jo-ligjore që duhet të zgjidhen. Studentët për herë të parë përballen me mungesën e aksesit në drejtësi dhe zbrazëtirat ligjore që ekzistojnë. Në anën tjetër, ata gjithashtu kanë mundësi të shohin bukurinë e ofrimin e shërbimeve ligjore në një nivel të lartë për shtresa të ndryshme të popullsisë. Ata njihen me njerëz të rinj, njohin problemet e tyre dhe këto probleme bëhen edhe pjesë e jetës së tyre. Puna në klinikë i mëson atyre një etikë të punës pro bono, të cilët do të mund ta kryejnë në karrierën e tyre juridike. Edhe pse ata në të ardhmen do të behën avokatë është e rëndësishme që kjo etikë të vazhdojë dhe t'i japë atyre mundësinë të bëhen të dobishëm. Një çështje pro bono në vit do të ishte një veprim shumë fisnik prej tyre, dhe në fakt hapat e një praktike fillojnë që në klinikën e ligjit.

Klinikat e ligjit në fakultet ndihmojnë individë të veçantë të përmbushin nevojat ligjore që përndryshe do të ishin të paadresuara, për shkak të mundësive të tyre të kufizuara ekonomike. Klinika jep përfitime jo vetëm për studentët por mbi të gjitha për komunitetin. Individë të kategorisë vunerabël do të marrin shërbime ligjore të cilat nuk do të mund t'i përfitonin në mënyrë tjetrër. Kemi një përfitim të dyanshëm pra, përfitim me dy kahe, për studentët por edhe për shoqërinë. Pra, klinika promovon një element të fuqishëm social, ndihmën ndaj shtresave në nevojë. Dhe kjo i brumoset këtyre juristëve të rinj që në fillimet e karrierës së tyre profesionale. Pa dyshim që përfitimet do të jenë të mëdha në këtë drejtim.

Sot ka një numër të madh studentësh që i bashkohen klinikës, dhe ky numër shtohet dita ditës. Klinika është pjesë e detyrueshme e programit mësimor në shumë universitete të huaja. Në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë ajo është një lëndë me zgjedhje, pasi jemi ende në fillimet e saj, por interesimi i studentëve është i madh. Vet studentët të pyetur deklarojnë se kanë marrë klinikën në fakultetin juridik dhe ajo i ka njohur me ligjin në një mënyrë shumë konkrete. Një edukim i tillë ligjor i ka mësuar vlerat dhe etikën që avokatët duhet të zotërojnë, por përvoja e tyre klinike i ka përzierë këto vlera dhe etikën dhe përvojat. Është parë nga afër edhe nga studentët që klinika synon të ndihmojë të marrin formë dijet duke i bërë avokatët të aftë nesër dhe i ndihmon ata të krijojnë një grup të profesionistëve të përkushtuar për çështje që lidhen me interesin publik.

[70] Përfitimet e klinikës së ligjit - Botim i Michael Pinard, profesor i klinikës së ligjit në Universitetin e Maryland në SH.B.A, janar 2012.

Përfitimet e klinikës janë vërtet të shumta. Së pari, ajo ndihmon të sigurojë një arsim të mirë dhe të harmonishëm ligjor për studentët, si ajo u jep atyre përvojat themelore të nevojshme për t'u angazhuar në profesionin. Së dyti, klinika shpesh shërben që persona të veçantë të adresojnë çështjet ligjore kritike që ndryshe do të shkojnë të paplotësuara. Së treti, studentët janë tepër kërkues si praktikues. Ata gjejnë mënyra për të avancuar ligjin dhe praktikën e ligjit në mënyra që krijojnë një ndryshim kuptimplotë. Përfshirja e studentëve në praktikë do të ketë një impakt të rëndesiëhm social për gjithë komunitetin. Ata janë të prirur të kërkojnë ndryshim, të evidentojnë ato fusha që janë problematike, t'i shohin gjerat me sy kritik. Qënia aktiv e juristëve të rinj është një përfitim për shoqërinë. Kjo do të sjellë nisma ligjoore të reja apo trajtim të atyre problemeve të pazgjidhura. Ata do të evidentojnë problemet e vjetra, ta pazgjidhura dhe do të mundohen të gjejnë një zgjidhje për çdo çështje. Kjo vjen jo sepse ata janë më të aftë se profesionistët me përvojë, por sepse ata kanë një cilësi të vyer, pasionin. Pasioni për profesionisin dhe kauza të rëndësishme do ta bëjë punën e tyre më efektive dhe zgjidhjet më të afërta.

Gjatë gjithë programit të klinikës, të mësuarit nga përvoja vazhdimisht sfidon studentët për të aplikuar teori dhe analitike dhe pëdorur aftësitë e tyre për të zgjidhur probleme ligjore nga më të ndryshmet. Të mësuarit nga përvoja është studimi i ligjit, njëkohësisht i shoqëruar me aplikimin e tij në praktikë. Edukimi ligjor klinik dhe praktikat e vazhdueshme janë në qendër të këtij objektivi. Studentët gjithashtu kanë mundësi të fitojnë përvojë praktike përmes praktikave, punëve pro bono dhe inovative si edhe kurseve që përfshijnë punën në terren apo stimulime të proceseve gjyqësore. Puna e studentëve varion në varësi të çështjes konkrete. Për shembull, në mosmarrëveshjet në lidhje me kushtet e punës, studentët analizojnë rrezikun, marrëveshjet dhe kontratën e punës, dhe negociojnë për të përmirësuar kushtet e punës. Në të drejtën tregtare, studentët ndihmojë një biznes imagjinar në proceduart e krijimit dhe rregjistrimit të tij pranë organeve kompetente. Gjithashtu e ndihmojnë në lidhjen e kontratave, në menaxhimin e investimeve e deri tek përballja me procedurat e falimentit.

Krahas trajtimit të problemeve ligjore, studentët mësojnë të aplikojnë metodat jashtëgjyqësore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Pajtimi, negocimi apo arbitrazhi janë mejete të cilat ata do të duhet t'i përdorin në të ardhmen në karrierën e tyre profesionale. Ata mund të mësojnë aftësi të mira të negocimit. Mësojnë të trajtojnë problemin, të diskutojnë me palët në proces, të mendojne alternativa të ndryshme zgjidhjeje si dhe ajo që është shumë e rëndësishme të jenë asnjëanës gjatë negocimit.

Nga ndryshimi i klimës në çështjet e të drejtave të njeriut, çështjet e biznesit të vogël për familjet në krizë, martesa dhe mosmarrëveshjet që lidhen me të, çështjet e barazisë gjinore, pretendimet në lidhje me diskriminimin në punësim, si edhe çdo çështje tjetër që prek interesat e komunitetit do të jenë objekt trajtimi në programet e klinikës ligjore.

Nxënësit e klinikës kanë mundësi për të punuar me klientët e vërtetë në disa prejproblemet më të mëdha të kohës sonë. Ata kanë mundësi të bëhen dhe të ndihen të dobishëm. Studentët bëhen këshilltarët, ndërmjetësit, ligjvënësit, avokatët, si edhe fakorët

e ndryshimit të sistemit. Ata bëhen edukatorë për njerëzit e thjeshtë si dhe kanë mundësi për të aplikuar njohuritë ligjore dhe ndërtojnë përvojën ata kanë fi mbi bazën e asaj që kanë mësaur. Ata presin në shkollë shumë prej shqetësimeve të klientëve të ndryshëm dhe i japin këshillat e para juridike në lidhje me çështjen. Qëllimi i programeve të klinikës është që të sigurojë disa shërbime bazë për klientët, ndërsa nga ana tjetër lejohen studentët të fitojnë disa aftësi bazë dhe të domosdoshme që do t'u nevojiten gjatë gjithe jetës së tyre profesionale.

Programet e klinikës bëjnë që studentët të zhyten në mendime, të marrin përsipër përgjegjësi, dhe të reflektojnë mbi punën e tyre. Duke punuar nën mbikëqyrjen e ngushtë dhe me kohë të plotë nga profesorët e klinikës, studentët inkurajohen për të ndjekur qëllimet e veta të mësimit, ndërsa duke marrë përsipër detyra ata mësojnë të marrin përgjegjësi dhe përballojnë probleme të vështira juridike.

Gama e gjerë e klientëve dhe përballja me çështje të rëndësishme shpesh herë edhe të ndjeshme është një sfidë por edhe përfitim për studentët. Studentët e klinikës fitojnë aftësi të rëndësishme në komunikim, mbledhjen e informacionit, krijimi i bindjes te të tjerët dhe fitimi i eksperiencave ligjore dhe praktike. Ata shpesh përgatisin analiza të problemeve duke adresuar kështu shumë prej nevojave të klientëve të tyre. Studentët gjithashtu inkurajohen që të njohin dhe zgjidhin çështjet e sfidave etike që ngrihen për diskutim nga rastet e tyre si edhe ata përpiqen për të zgjidhur dilemat më të ngutshme të klientëve të tyre. Këto të gjitha dhe përgjegjësitë e marra përsipër kanë mundësi ta bëjnë një përvojë klinike një nga përvojat më më të dobishme dhe emocionuese të viteve të fakultetit të drejtësisë nga studentët.

Ja se si është shprehur një student i klinkës në Universitetin e Kolumbisë në lidhje me përvojën e tij: "Puna në klinikë ishte përvoja më e mirë dhe e vlefshme që kam marrë gjatë viteve të fakultetit të drejtësisë. Kjo ishte një mundësi e pakrahasueshme për të mësuar nga shokët e klasës e mi, stafi i klinikës, dhe klientët tanë. Sfidat janë ndryshe nga ato të paraqitura në klasë, ato kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e të tjerëve, dhe kjo i bën edhe më interesante. Unë jam i bindur se ata kanë bërë një punë të mirë duke na përgatitur në për të kontribuar menjëherë në vendin e punës. " [71]

Pjesëmarrja në një klinikë të ligjit i mundëson studentëve të përgatiten për karrierën e tyre dhe të zgjedhin profile të ndryshme, në përputhje me dëshirat dhe aftësitë personale. Shërbimi në çështe të interesit publik, praktika private, këshillimi ligjor jo vetëm përmirësojnë aftësitë por nxisin edhe një perspektivë kritike në lidhje me rrugën se si duhet të praktikohet ligji, para se të fillohet karrierën ligjore. Si rezultat, studentët e klinikës janë të përgatitur në mënyrë unike për të marrë pas diplomimit të tyre rolet profesionale.

[71] Opinion i një studenti të klinikës në Fakultetin e Drejtësisë në Columbia University, botuar në faqen zyrtare të fakultetit. Universiteti I Kolumbisë në SH.B.A është një nga Universitetet lider ne botë në lidhje me programet e klinikës dhe që ofron ndihmë ligjore falas në favor të komunitetit.

Negocimi – Klinika e ligjit i ofron studentëve mundësi që të përfshihen në teorinë dhe praktikën e negociatave. Ata do të mësojnë rreth negocimit nëpërmjet simulimeve të konfliteve dhe ushtrimeve të ndryshme. Studentët do të fitojnë aftësi për të bërë marrëveshje dhe zgjidhur konfliktet duke negociuar për kontratat, transaksionet e biznesit, dhe mosmarrëveshjet shumë-palëshe. Duke përdorur këtë përvojë praktike si një trampolinë, klinika shqyrton të tilla tema si natyra e konfliktit integrues dhe bashkëpunimi midis palëve, mënyra për të kapërcyer pengesat në një rmarrëveshje, marrëdhëniet avokat-klient, artin e bindjes, si edhe roli i kulturës, gjinisë dhe racës në negociata. Nxënësit reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe mund të botojnë artikuj të shkurtër në revista javore për të treguar mbi eksperiencën e tyre dhe dobinë e saj si edhe mund të filmojnë negociatat me profesorin e tyre.

Etika dhe përgjegjësia profesionale - Arsimi klinik i vendos studentët në situata profesionale kuata janë të detyruar të vënë teorinë e përftuar në mënyrë abstrakte në klasë në praktikë. Studentët mësojnë se çfarë do të thotë të sigurojnë një realzim të zellshëm të procesit të avokatisë ndërsa mbajnë në nivelin më të lartë parimet dhe standardet etike të profesionit. Pyetje tipike etike me të cilat ballafaqohen studentët përfshijnë:

Kur përfaqësojnë organizatat, se si duhet të veprojë një avokat? Dallimet midis nevojave të individëve që përfshihen në një organizatë nevojat e organizatës si një e tërë? Kur është e përshtatshme për avokatët për t'u zëvendësuar nga një koleg i tyre gjatë gjykimit të çështjes së një klienti? Kur ndodh që dhe a është e drejtë për një ndërmjetës për të siguruar një vlerësim ligjor gjatë rrjedhës së një ndërmjetësimi? Për të ndihmuar një prind për të rifituar përgjegjësinë prindërore të fëmijës, duhet të merret parasysh se klienti ka qenë i burgosur për një krim të rëndë?

Këto janë vetëm disa nga pyetjet që i dalin për zgjidhje studentëve gjatë praktikës së tyre. Pyetjet dhe çështjet etike mund të jenë të panumërta, ato variojnë nga lloji i çështjes, natyra e konfliktit, palët, si edhe interesat e përfshira në konflikt. Gjatë zgjidhjes së problemit, ata mund të konsultohen jo vetëm me literaturë juridike, e cila jo gjithmonë të ofron një zgjidhje, por edhe me profesorin e tyre mbikqyrës. Edhe pse ata shpesh herë mund të ndodhen në një udhëkryq dhe të jenë pa një zgjidhje, përvoja klinike i shërben për t'u përballuar me sfida të reja dhe për t'i përballur me vështirësitë e profesionit.

Prandaj, klinika është e vlefshme dhe mund të themi se studentët që e përfitojnë atë si përvojë përfitojnë jo vetëm një eksperiencë të re, por shumë më tepër. Ata fitojnë aftësi të reja, mundësi gjykimi, mësojnë të krijojnë kontakte të reja dhë të përfitojnë prej tyre. Ata do të jenë më të aftë të përballojnë sfidat e avokatisë, sidomos në vitet e para të karrierës së tyre, sepse do të kenë kaluar një eksperiencë të ngjashme në vitet e shkollimit të tyre. Në fakt, klinika është procesi i avokatisë nga studentë, ata edhe pse nuk janë diplomuar do të kalojnë një eksperincë të tillë duke veshur gjithë kompetencat dhe detyrat që një avokat ka në kuadër të përfaqësimit të interesave të klientit të tyre.

3. 4 Aftësitë që përfitohen nga klinika e ligjit

Një prej aftësive kryesore, të cilës iu kushtua një vëmendje edhe lart është zgjidhja e problemeve. Studentët bëhen të aftë të zgjidhin raste të ndryshme ligjore dhe të trajtojnë ligjërisht probleme të ndryshme. Duke qënë se kjo aftësi u trajtua më lart gjerësisht, po trajtohen ne mënyrë të përmbledhur edhe disa cilësi të reja.

Arsyetimi dhe analiza ligjore

Klinika, me anë të vënies përballë të rasteve konkrete dhe problemeve ligjore, i zhvillon studentëve aftësinë për të arsyetuar. Çdo mendim personal që ata kanë, qoftë edhe i gabuar është e rëndësishme të arsyetohet. Arsyetimi është një elemnt kyç në bindjen e personave të tjerë që ai ka të drejtë. Një mendim i arsyetuar vlen më shumë se një mendim jo i arsyetuar. Arsyetimi natyrisht do të bëhet bazuar në argumenta juridikë. Mendimi mund të arsyetohet bazuar në dispozitat ligjore apo edhe vendime të mëparshme të gjykatave që mund të krijojnë një preçedent për atë rast. Aftësia arsyetuese do të përmirësohet me kalimin e kohës, sa më shumë të diskutojnë dhe të trajtojnë probleme juridike aq më shumë do të kenë mundësi të përmirësojnë këtë aftësi.

Aftësi e rëndësishme përveç arysetimit është analiza ligjore. Të analizosh një problem do të thotë ta kuptosh atë, ta perceptosh dhe të mendosh disa alternativa zgjidhje. Analiza ligjore është një cilësi që studentët e klinikës e fitojnë me anë të përfshirjes në çështje të ndryshme ligjore, me anë të përballjes me sfida dhe probleme që ata mund të mos i kenë hasur kurrë më parë. Në këto aftësi përfshihen :

- Identifikimi dhe formulimi i teorive ligjore;
- Formulimi i teorisë më të përshtatshme;
- Zhvillimi i teorisë;
- Vlerësimi i teorisë ligjore;
- Kritikat ndaj argumentimit ligjor.

Kërkimi ligjor

Kërkimi ligjor është procesi i identifikimit dhe marrjes së informacionit të nevojshëm për të mbështetur vendimmarrjen ligjore. Në kuptimin më të gjerë, kërkimi ligjor përfshin çdo hap në një kurs të veprimit që fillon me një analizë të fakteve të një problemi dhe përfundon me aplikimin dhe komunikimi i rezultateve të hetimit.

Proceset e kërkimit ligjor ndryshojnë sipas vendit dhe sistemin ligjor të përfshirë. Megjithatë, hulumtimet juridike në përgjithësi përfshijnë detyra të tilla si: gjetjen e burimeve parësore të ligjit, ose autoritetit primar, në një juridiksion të caktuar (raste, statutet, rregulloret, etj), të kërkoni autoritetin e mesëm (për shembull, komente të ligjit, ligjore fjalorë, traktatet ligjore, dhe enciklopedi ligjore për informata në lidhje me një temë ligjor, dhe të kërkoni burimet jo-ligjore për informacion hetues ose mbështetës.

Këkimi ligjor është një aftësi esenciale për profesionin e avokatit. Me anë të klinikës studentët mësojnë të idnetifikojnë një problem të caktuar ligjor dhe të kryejnë humutime

apo studime të thelluara për të gjetur një zgjidhje. Pavarësisht vështirësisë së çështjes ata duhet të jenë të përgatitur për të gjetur informacion apo duhet të dinë se ku të kërkojnë që të lehtësojn ëpunën e tyre dhe të jenë sa më shpejt pranë një zgjidhje. Kjo aftësi përfshin :[72]

- Njohuri mbi natyrën e ligjit dhe instituteve të së drejtës;
- Njohuri dhe aftësi për të përdorur mjetet më efektive të kërkimit ligjor;
- Kuptimi i procesit të implementimit dhe realizimit të kërkimit ligjor në praktikë.

Investigimi i fakteve

Me anë të programit të klinikës studentët do të përfshihen në çështje të mirëfillta ligjore, do të duhet të analizojnë dhe të vëzjgojnë më kujdes faktet. Investigimi i fakteve lidhet me aftësinë për të trajtuar situatën në aspektin ligjor. Është e rëndësishme që një jurist të dijë të dallojë faktet juridike nga ato që nuk kanë rëndësi për të drejtën. Klientët, duke mos pasur dijeni për fsuhën por njëkohësisht duke qënë shumë të përfshirë emocionalisht në atë që ka ndodhur nuk do të jenë të aftë ta bëjnë këtë dallim. Ata, gjatë intervistët do të tregojnë çdo gjë që mundin, por është detyra e juristit t'i kërkojnë të specifikojnë vetëm ato fakte që sjellin pasoja juridike, pra që kanë rëndësi për të drejtën. Kjo aftësi përfitohet me anë të prekjes së çështjeve të vërteta ligjore, dhe ajo përfshin :

- Kuptimin e rëndësisë së investigimit të fakteve;
- Panifikimi i një investigimi apo hetimi;
- Implementimi i kësaj strategjie në praktikë;
- Memorizimi dhe organizimi i informacionit në një formë të aksesueshme;
- Vendimi për të mbyllur procesin e mbledhjes së fakteve;
- Vlerësimi i informacionit që është përftuar.

Komunikimi

Komunikimi është një aftësi bazë e profesionit ligjor. Duke qënë se kemi të bëjmë me marrëdhënie të vazhdueshme me njerëz, aftësitë komunikuese janë ndër të tjera aftësi që diferencojnë një jurist të mirë nga një jo i mirë. Kjo është një aftësi që fitohet dhe perfeksionohet me kohën. Sa më shumë të komunikojmë aq më shumë do të jemi të aftë që komunikimi ynë të jetë i përshtatshëm dhe të japë rezultate. Kjo, sepse me anë të komunikimit realizohet një pjesë e rëndësishme e detyrave të avokatit, duke filluar që nga komunikimi me palën e deri te arsyetimi dhe mbrojtja e çështjes në gjyq.

Aftësi të mira komunikimi përfshijnë :

- Të kuptosh prespektivën dhe të ardhmen e komunikimit, të vlerësojmë se çfarë synimi duam të realizojmë;
- Përdorimi i metodave efektive në komunikim.

[72] Legal Clinics and the better trained Lawyer : A history of clinical education at Northwestern- Copyright 2006 by Northwestern University School of Law Printed in U.S.A., Northwestern University Law Review Vol. 100, No. 1, fq 157.

Këshillimi

Një prej detyrave të avokatit është këshillimi ligjor i klientit për probleme të ndryshme juridike. Normalisht që të gjithë hasim vështirësi apo problem në jetën tonë, dhe kur nuk jemi specialist të fushës, do të kërkojmë ndihmën e një eksperti, si për çështjet juridike ashtu edhe për çështje të natyrave të tjera. Në klinikë, studentët janë shumë të përshtatshëm për të realizuar këshillimin ligjor të klientit pikërisht se ata kanë formimin eduhur juridik. Këshillimi si një aftësi e përfituar nga klinika përfshin :

- Krijimi i një marrëdhënie këshillimi që respekton kufijtë e detyrave të avokatit;
- Marrja e informacionit të nevojshëm për të marrë vendimin e duhur;
- Analizimi i vendimit;
- Këshillimi me klientin para se të merret vendimi;
- Implementimi në praktikë i vendimit të klientit.

Negocimi

Negocimi është një nga hapat për zgjidhjen e konfliktit. Fillimisht, avokatët e palëve do të punojnë për të negociuar midis tyre dhe që mosmarrëveshja të zgjidhet në rrugë paqësore, pa qënë e nevojshme t'i drejtohen gjykatës. Nëse kjo nuk jep sukses ata do të përdprin rrugët proceduriale të nevojshme, si padia për t'iu drejtuar gjykatës e cila do të ndihmojë në zgjidhjen e konfliktit.

Në mnëyrë që negocimi të rezultojë i suksesshëm ai duhet të përfshijë disa elementë :

- Përgatitja për negocim;
- Drejtimi i një seance negocimi;
- Këshillimi me klientin për të bërë oferta në ndyshme gjatë negocimit dhe marrja parasysh e vendimit të tij.

Mjetet alernative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ADR

Gjatë ndihmës juridike që ofron klinika, mund të vihen në zbatim edhe mjetet jashtëgjyqësore për zgjidhjen alernative të mosmarrëveshjeve, si mjete të shpejta, fleksibël dhe me pak kosto. Këtu përfshihet pajtimi, negocimi, ndërmjetësimi si edhe arbitrazhi. Klientët mund të këshillohen në lidhje me këto metoda, duke iu shpjeguar si funksionojnë, procedura që ndiqet, avantazhet që sjellin, mjetet e ankimit ndaj tyre, etj.

Megjithatë në mënyrë që klienti të këshillohet në lidhje me to dhe ato të aplikohen në praktikë, studentët duhet t'i njohin ato. Ata gjithashtu duhet të kenë disa njohuri bazë mbi :

- Procesin gjyqësor në shkallë të parë;
- Procesin gjyqësor në apel;
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve administrative;
- Procedurat që ndiqen në mjetet alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Organizimi dhe menaxhimi i punës ligjore

Për të qënë efikas një avokat duhet të jetë i njihur me mënyrat për një menaxhim dhe oragnizim të mirë të punës. Këtu përfshihet :

- Vendosja e qëllimeve dhe parimeve në lidhje me menaxhimin;
- Zhvillimi i sistemeve dhe procedurave për të siguruar që koha dhe përpjekjet të përdoren në mënyrë efikase;
- Zhvillimi i sistemeve dhe procedurave për të siguruar që puna do të kryhet në kohën e duhur;
- Zhvillimi i sistemeve dhe procedurave për bashkepunim efektiv me njerëz të tjerë;
- Zhvillimi i sistemeve dhe procedurave për administrim efikas të një zyre ligjore.

Kuptimi dhe zgjidhja e problemeve etike

Thamë se çështjet etike janë një element i rëndësishëm në punë e juristëve. Megjithatë ata duhet të jenë të përgatitur për të kuptuar se kemi të bëjmë me një çështje etike para se të ndërhyjnë për ta zgjidhur atë. Një jurist për të pasur jë aftësi të tillë duhet të jetë I njohur me :

- Natyrën dhe burimet e standardeve etike;
- Mjetet me anë të të cilave mund të vihen në zbatim këto standarde;
- Procesin e njohjes dhe zgjidhjes së dilemave etike.

Kapitulli IV

Çështje të etikës profesionale në klinikën e ligjit

Përmbajtja : 4.1 Çfarë është etika profesionale?; 4. 2 Parimet në klinikën ligjore; 4. 2. 1 Konfidencialiteti; 4.2.2 Konflikti i interesave; 4. 3 Kontradiktoriteti dhe konfliktet në klinikën e ligjit ; 4. 4 A është e gabuar përfaqësimi i klientëve që mund të përballojnë një avokat?; 4. 5 Procedimi disiplinor

4. 1 Çfarë është etika profesionale?

Etika (greq. Ηθική, nga fjala ήθος, ithos - ves, dok, zakon) në filozofi është studimi dhe vlerësimi i sjelljes njerëzore në dritën e parimeve morale. Parimet morale mund të shikohen si standardi i sjelljes që njerëzit kanë ndërtuar për veten e tyre ose si lënda e shtrëngimeve dhe detyrimeve që një shoqëri e caktuar kërkon nga pjestarët e saj. Ajo merret me çështjet se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe, si mundemi ne të bëjmë dallimet mes tyre, a është e mira dhe e keqja e njejtë për të gjithë; si mundemi të bëjmë vendime të forta që mund të ndihmojnë apo pezmatojnë të tjerët? Emërtimi përdoret edhe për çdo sistem ose teori të vlerave morale ose parimore. Tradicionalisht etika ndahet në etike normative, metaetikë, dhe etikë e zbatuar. [73]

Etika profesionale shërben dhe ekziston si një disiplinë rregulluese për të gjitha profesionet. Kemi etikë në fushën ligjore, që është edhe objekt i punimit, etikë për ekonomistët, për mësimdhënien, etika në fushën e gazetarisë etj. Pra, etika është një disiplinë e domosdoshme që rregullon të gjitha profesionet që kanë lidhje me njerëzit dhe

[73] Përkufizimi zyrtar I etikës, si disiplinë shkencore, i parashikuar në faqen zyrtare të Wikipedia. http://sq.ëikipedia.org/ëiki/Etika.

që përmbajnë disa detyrime të caktuara ndaj profesionistëve në veçanti dhe ndaj shoqërisë si një e tërë. [74]

Etika profesionale është një grup normash që rregullon profesionin e juristit. Për të ushtruar një profesion të tillë në mnëyrë sa më të rregullt, është e domosdoshme të ketë rregulla që e qeverisin atë si profesion por edhe që zbatohen me përpikmëri nga profesionistët e fushës. Duke parë domosdoshëmrinë e rregullave të etikës në profesionin ligjor, janë hartuar Kode të Etikës në shumicën e këtyre profesioneve. Kemi Kodin e Etikës së Avokatit, Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Kodin e Etikës së Gjyqtarëve të cilët rregullojnë këto profesione dhe parashikojnë norma të detyrueshme sjelljeje për këta profesionistë. [75] Gjithashtu norma të rëndësishme përmbajnë ligjet proceduriale në Shqipëri, si Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Procedurave Administartive. Përveç këtyre ligjeve bazë, ka edhe ligje të tjera që udhëzojnë profesionistët në fushën e ligjit të ushtrojnë detyrën me korrektësi, me profesionalizëm, duke shmangur konfliktin e interesave dhe duke mbrojtur sa më mirë interesat që përfaqësojnë.

Në mënyrë që të respektohen me rigorozitet këto norma është parë e nevojshme të krijohen edhe organizma të rëndësishëm si Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterëve, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Konferenca Kombëtare e Gjyqtarëve, të cilat janë organe mbikqyrëse përveç të tjerave edhe per menyrën e ushtrimit të profesionit dhe zbatimit të garancive që parashikon ligji.

Parimet e parashikuara në ligjin" Për Avokatinë" është e domosdoshme jo vetëm te njihen por edhe të zbatohen nga studentët e klinikës. Kjo, pasi ata vërtet janë ende studentë, por klinika i jep mundësinë të ushtrojnë perkohësisht të njëjta detyra me ato të një avokati profesionist. Ata kanë një klient, interesat e të cilit duhet të mbrohen, dhe kanë gjithashtu detyrime jo vetëm ndaj klientit por edhe ndaj kolegevë të tjerë, institucioneve shtetërore me të cilat do të hyjnë në kontakt, etj.

4. 2 Parimet në klinikën ligjore

Në fakt parimet që studentët duhet të kenë parasysh gjatë përvojës së tyre në klinikën e ligjit, janë të njëjta me ato që zbatojnë avokatët. Kjo lidhet pikërisht me faktin se në klinikë studentët shndërrohen për një eksperiencë në avokatë. Ata kanë një klient, interesat e të cilit duhet të përfaqësojnë, kanë detyrime ndaj gjykatës, kolegëve, institucioneve shtetërore, por gjithashtu ndaj fakultetit të drejtësisë, i cili po i ofron një mundësi të tillë me pritshmërinë që ata të sillen me dinjitet dhe profesionalizëm.

[74] Legal Clinics and the better trained Lawyer : A history of clinical education at Northwestern- Copyright 2006 by Northwestern University School of Law Printed in U.S.A., Northwestern University Law Review Vol. 100, No. 1, fq 83.

[75] Kodi Etik i Avokatit dhe Ligji nr.9109 datë 17.7.2003"Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" i ndyshuar përmbajnë disa norma bazë dhe parime të detyrueshme për t'u repsektuar nga avokatët që ushtrojne profesionin në Republikën e Shqipërisë.

Pavarësia është një parim shumë i rëndësishëm. Avokati është i pavarur në ushtrimin e profesionit të tij. Për të siguruar pavarësinë avokati duhet të jetë i lirë nga çdo ndikim që mund të lindë nga interesat e tij personale ose nga presioni i jashtem. [76]

Dihet tashmë se sa e rëndësishme është të kemi avokatë të pavarur, të gatshëm dhe me vullnetin për të vepruar si në emër të atyre klientëve të preferuar por edhe në emër të atyre që nuk janë edhe aq të pëlyer, në çështje gjyqësore civile dhe penale. [77] Është pikërisht rëndësia e ruajtjes së pavarësisë dhe zotësisë së avokatit si ushtrues i profesionit, ajo që të drejtën e përfaqësimit në gjyq të të tjerëve, e kufizon me ata që mund të demostrojnë që jo vetëm e njohin mirë ligjin dhe të drejtën por edhe kuptojnë përgjegjësitë etike të avokatit.

Megjithatë, duke qënë njerëz jo të gjithë avokatët ruajnë standardet që priten prej tyre dhe disa klientë, gjyqtarë dhe avokatë të tjerë mund të ankohen ndaj tyre. Klientët mund të mos jenë të kënaqur për një sërë arsyesh. Ata mund të mos jenë trajtuar siç duhet nga avokati, mund të mos jenë këshilluar siç duhet apo për një sërë arsyesh të tjera. Avokatët fajtorë mund të vihen përpara përgjegjësisë disiplinore ose t'i nënshtrohen trajnimeve të mëtejshme për të rritur standardet e tyre profesionale.

Pavarësia është një parim bazë që avokati ta ushtrojë detyrën siç duhet duke përfaqësuar maksimalisht interesat e klientit. E njëjta gjë vlen të thuhet për studentët e klinikës. Ata duhet të kryejnë detyrat e ngarkuara me pavarësi. Ky është një hap i rëndësishëm për të kuptuar dhe zbatuar siç duhet këtë parim, i cili do të jetë parësor edhe kur ata të jenë profesinistë të vërtetë. Edhe pse ata janë edne në bankat e shkollës, për të kryer detyrën e klinikës duhet të jenë të pavarur. Nuk duhet të ketë ndërhyrje nga stafi pedagogjik, apo nga persona të jashtëm. Pavarësisht se ata janë ende studentë duhet të shihen si të aftë për ta kryer siç duhet detyrën dhe jo si persona pa përvojë tek të cilët mund të ndërhyhet lehtësisht. Pavarësisht udhëzimeve me profesorin mbikqyrës, do të jenë ata që do të marrin vendimet sipas vlerësimit më të mirë personal.

Avokati në ushtrimin e profesionit vepron në përputhje me ligjin, Statutin, Kodin e Etikës dhe interesat e ligjshme të klientit duke i ofruar atij shërbimet profesionale të mbështetura në gjykimin e tij më të mirë.

Pavarësia e avokatit është aq e nevojshme për të besuar në procesin e drejtësisë sa edhe paanshmëria e gjygjtarit. Avokati duhet të shmangë çdo cënim të pavarësisë së tij dhe të mos kompromentojë standardet profesionale për të kënaqur klientin, gjykatën apo të tretët.

Parimi i pavarësisë shfaqet si një parim bazë edhe në ligjin që rregullon profesionin e avokatit në Shqipëri. Avokati ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e vet me ndershmëri dhe dinjitet, të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e

[76] Neni 1 i Kodit të Etikës së Avokatit
[77] James Dingemans, QC- Strukturat disiplinore për profesionin e avokatit : Vendosja e shtetit të së drejtës, botim në revistën Avokatia, vëllimi 1, janar 2012, faqe 23.

ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe të interesave të personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij. [78]

Në mënyrën se si repsektohet parimi pavarësisë ndikon jo vetëm vendosmëria dhe integriteti i studentëve, por edhe mbështetja nga profesori mbikqyrës. Është ai që duhet të dalë garant që persona të jashtëm, brenda fakultetit ose jo, të mos ndërhyjnë apo ndikojnë në çfarëdo lloj mënyre në punën e studentëve të tij. Pavarësia është një parim por edhe vlerë njëkohësisht me të cilën studentët duhet të mësohen që në hapat e parë të ushtrimit të profesionit dhe për këtë një rol të konsiderueshëm do të luajë klinika e ligjit.

Dinjiteti është një parim bazë që lidhet ngushtësisht me reputacionin dhe integritetin moral e profesional të avokatit. Ky parim është i rëndësishëm jo vetëm për avokatët profesionistë, por edhe për studentët që marrin pjesë në klinikën e ligjit.

Avokati gjithnjë duhet të ruajë dinjitetin e profesionit. Avokati nuk duhet të bëjë deklarata fyese ose përbuzëse për aktivitetin apo vendimet e gjykatave apo autoriteteve të tjera. Avokati duhet të nxisë edhe klientin që të sillet me respekt ndaj gjykates apo autoriteteve te tjera. Për të ruajtur reputacionin e mirë të vetes dhe Dhomës së Avokatëve, avokati nuk duhet të tolerojë sjellje jo korrekte dhe me mungesë respekti nga ana e gjykates dhe kujtdo tjetër kundrejt vetë avokatit, asistentit, nxënësit apo klientit. Kultura e përgjithshme dhe ajo juridike e avokatit duhet të manifestohet në çdo moment gjatë ushtrimit të profesionit, në paraqitjen e tij, në fjalët që mban dhe në mardhëniet që krijon me këdo. Avokati paraqitet ne procesin e gjykimit me kartën e identitetit për çdo vit dhe uniformën e avokatit. Avokati nuk mund të përfshihet në veprime që kanë të bëjnë me pandershmërine apo keq përfaqesimin. Avokati, në praktikë dhe në jetën e tij private, duhet të qëndrojë larg çdo sjelljeje, e cila mund të zhvlerësojë emrin e mirë të profesionit. [79]

Edhe pse studentët e klinikës nuk janë diplomuar ende, dhe ata nuk kanë një liçencë për ushtrimin e profesionit dhe nuk janë pjesë e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, ata duhet të kryejnë detyrat e tyre me dinjitet. Kjo lidhet me detyrimin për të ofruar një besim dhe emër të mirë të çdo personi që ushtron këtë profesion, por gjithashtu për të rritur edhe besimin e klientit. Studentët duhet të sillen me korrektësi, të mos përdorin fjalë fyese qoftë edhe dekurajuese për sistemin e drejtësisë. Ata duhet të sillen me korrektësi jo vetëm në lidhje me sjelljen por edhe veshjen dhe qëndrimin që mbajnë. Nëse ata marrin pjesë në gjyq për të përfaqësuar interesat e klientit të tyre, ata duhet të vishen me uniformën përkatëse. Gjithashtu duhet të trajtojnë klientin me dinjitet, edhe pse ai mund t'i përkasë nje shtrese vunerabël të popullsisë dhe duhet të mbrojnë interesat e tij para gjykatës, institucioneve shtetërore apo kujdo që mund t'i cënojë ato.

Përkushtimi dhe aftësitë profesionale. Avokati në çdo kohë duhet të veprojë me përkushtim dhe gatishmëri kur përfaqëson një klient. Avokati ka për detyrë t'u shërbejë

[78] Neni 9/1 i ligjit nr.9109 datë 17.7.2003"Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
[79] Neni 4 i i Kodit të Etikës së Avokatit.

interesave të klientit në mënyrën më efikase të mundur. Avokati duhet të ofrojë përfaqësim cilësor të klientit. Aftësia përfshin njohuritë ligjore dhe aftësitë profesionale të cilat janë të nevojshme në çdo rast konkret. Avokati nuk duhet të trajtojë një çështje për të cilën ai nuk ka aftësitë e nevojshme perveç se kur bashkëpunon me një avokat i cili është kompetent për ta trajtuar atë. Avokati ka për detyrë të zhvillojë aftësitë e tij nëpërmjet përgatitjes së vazhduar profesionale. [80]

Edhe pse aftësitë profesionale të studentëve të klinikës nuk janë ato që priten nga një profesionist, ata janë studentë që kanë studiuar të drejtën dhe kanë njohuri mbi të. Ata janë në hapat e para drejt të bërit avokatë profesionistë, prandaj pritet që edhe detyrat t'i kryejnë në mënyrë cilësore. Kjo kërkoet jo vetëm për t'i përgatitur për të ardhmen por është një domosdoshmëri jetike për interesat e klientit. Kërkohet patjetër që ai të përfaqësohet sa më mirë dhe të mbrohen interesat e tij, sepse kjo ka një rëndësi thelbësore për të. Bëhet fjalë për një klient që përfiton ndihmë ligjore falas sepse nuk ka mundësi të paguajë një avokat, por ai ka nevojë që çështja të fitohet gjithsesi. Bëhet fjalë për interesa jetikë për këtë klient dhe është detyra e studentëve të klinikës t'i përfaqësojnë ato si duhet.

Duke qënë se ata shpesh nuk kanë përgatitjen e mjaftueshme për të zgjidhur çdo çështje, lejohet udhëzimi nga profesori mbikqyrës. Madje kjo mbikqyrje është e domosdoshme që ata t'i kryejnë detyrat siç duhet. Ata gjithashtu do të shoqërohen ne gjyq, në kërkesat drejtuara organeve shtetërore etj nga profesori i tyre, pasi lënia vetëm nuk do t'i shërbente as atyre por mbi të gjitha klientit, i cili mund të dilte i humbur nga procesi gjyqësor.

4. 2. 1 Konfidencialiteti

Konfidencialiteti është një nga detyrimet bazë në profesionin e avokatit. Ai lidhet me ruajtjen e fshehtësisë së informacionit që merret gjatë klinikës. Edhe pse ata nuk janë profesionistë, ky është një detyrim bazë që fillon të ushtrohet që në përvojën e klinikës dhe do t'I shoqërojë ata gjatë gjithë jetës së tyre profesionale.

Konfidencialiteti që buron nga ligji dhe normat e etikës profesionale është e drejtë, detyrim dhe garanci për avokatin. Avokatit për shkak të informacionit të veçante që merr nga klienti në kushtet e mirëbesimit nuk i lejohet të shkelë kërkesat e Nenit 9 të Ligjit"Për Ushtrimin e Profesionit të Avokatit në Republikën e Shqipërisë"

Avokati duhet të ruaje konfidencialitetin e të gjithë informacionit të dhënë nga klienti i tij ose të marrë prej tij, rreth këtij klienti ose të tjerëve, gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk është i kufizuar në kohë. Avokati duhet t'iu kërkojë ortakëve dhe stafit të tij dhe gjithkujt tjetër të angazhuar prej tij gjatë ofrimit të shërbimeve profesionale të ruajnë konfidencialitetin.

Detyrimi i konfidencialitetit nuk shkelet kur:

[80] Nenet 5, 6, 7, 8, 9 të Kodit të Etikës së Avokatit.

a) Avokati informon një person të cilit ai është duke i deleguar detyrat individuale për shërbime ligjore mbi ecurinë e çështjes në fjalë, me kusht që edhe një person i tillë t'i nënshtrohet detyrimit të konfidencialitetit.

b) Tregon konfidenca ose sekrete me pëlqimin e klientit ose të klientëve në fjalë, por vetëm pasi t'ua tregojë plotësisht atyre këtë gjë.

d) Tregon konfidenca ose sekrete të nevojshme për të caktuar ose marrë pagesen e `avokatit ose për të mbrojtur avokatin ose nëpunësit e tij ose ortakët kundër një akuze për sjellje të gabuar. [81]

Në mënyrë që të mbrohen siç duhet interesat e klientit studentët duhet të ruajnë këtë informacion të marrë si konfidencial dhe nuk mund ta bëjnë atë publik. Ky informacion nuk mund të diskutohet me të tretë dhe gjithashtu nuk të shpërndahet pa autorizim. Konfidencialiteti është një detyrim bazë i profesionit ligjor, dhe lidhet me një nga të drejtat themelore që është ruajtja e privatësisë së klientit të përfaqësuar. Ai nuk është i kufizuar në kohë, çka do të thotë se edhe pse programi i klinikës ka mbaruar, ky informacion gjithsesi duhet të ruhet dhe nuk mund të bëher publik.

Një detyrim i tillë i rëndësishëm përcaktohet edhe në ligjin" Për avokatinë", i cili për qa sa është e mundur vlen dhe zbatohen edhe për juristët e rinj që marrin pjesë në klinikën e ligjit.

Avokatit i ndalohet të bëjë publike të dhënat, që i ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojturose të përfaqësuar prej tij ose nga dokumentet që ky i fundit i ka vënë në dispozicion, nëfunksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur ai ka dhënë miratimin e tij me shkrim.

Avokatit i ndalohet të bëjë kallëzim në organin e ndjekjes penale dhe nuk mund të pyetet si dëshmitar për personin, të cilit i ka kryer shërbime dhe ndihmë juridike, si dhe për rrethana që ai i ka mësuar gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit. [82]

Konfidencialiteti është një nga hallkat më të rëndësishme të marrëdhënies avokat-klient. Avokatët e premtojnë atë, klientët bazohen në të dhe organet mbikqyrëse e kërkojnë atë. [83]

Nëse behesh pjesë e një praktike pranë një zyre avokatie, por edhe pranë organeve shtetërore si Prokuroria, ti bëhesh pjesë e skuadrës që do të realizojnë një punë të caktuar, dhe detyrimet që rëndojnë mbi ta, rëndojnë edhe mbi ty. Praktika ka avantazhet dhe një sërë përfitimesh për studentët, por ajo ka edhe detyrime shumë të rëndësishme për t'u zbatuar. Moszbatimi i tyre mund të prishë gjithë zinxhirin e kryerjes së një funksioni të caktuar. Studenti që fillon praktikën është një nga hallakt e këtij zinxhiri, prandaj

[81] Neni 14 i i Kodit të Etikës së Avokatit.
[82] Neni 9/3 dhe 9/4 i ligjit nr.9109 datë 17.7.2003"Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" i ndyshuar.
[83] Learning from practice – J.P.Ovigly, Leah Ëortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II, faqe 67

përmbushja e detyrimeve të tij është esenciale. Pavarësisht se gjatë praktikës, student mund të mos angazhohet direkt me përfaqësimin ligjor të klientit, ai do të vihet në dispozicion të një informacioni që klasifikohet si konfidencial, sepse lidhet drejpërdrejt me interesat e klientit të tij dhe kjo bën që për të, të lindë detyrimi i konfidencialitetit, pra ruajtjes së këtij infromacioni dhe mos bërjes së tij të aksesueshëm për të tretë.

Konfidencialiteti lidhet drejtpërdrejt me besimin e klientit dhe është çelësi i një marrëdhënie të shëndetshme avokat-klient. Prandaj, studentët e klinikës do të udhëzohen nga profesoiri mbikqyrës por edhe nga kolegët me të cilët do të hyjnë në marrëdhënie që të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë, pasi ky përbën një nga detyrimet bazë të një avokati. [84]

Konfidencialiteti është një nga çështjet etike më të rëndësishme në këshillim. Kur ai është i pranishëm mund të çojë në një ndryshim të shpejtë dhe të sigurtë të klientit; kur ai është i dyshimtë klienti mund të hermetizohet dhe të fosilizojë përjetë problemin e tij për shkak të ndrydhjes që i shkaktohet. Problemet juridike që një klinet mund të ketë mund të jenë shume delicate, ai mund të ketë vështirësi të flaës për to, prandaj ofrimi I besimit dhe sigurimi që biseda është konfidenciale janë thelbësore për të fituar besimin e tij. Në dukje, konfidencialiteti mund të perifrazohet shumë thjesht, gjithshka që thuhet në mjediset e këshillimit është tërësisht konfidenciale dhe këshilluesi nuk ka të drejtën për ta thyer konfidencialitetin, për të nxjerrë tek të tretët të vërtetën e mësuar në këshillim. Kur flasim për këshillim, i referohemi këshillimit ligjor, momenti i parë kur avokati hyn në kontakt me klientitn dhe merr dijeni për problemin e tij. Që në këtë moment e në vazhdim avokati ka detyrimin e konfidencialitetit. Që në fillim të këshillimit klientit duhet t'i bëhet e qartë se cilat janë kushtet e konfidencialitetit.

Përgjithësisht këshilluesi garanton klientin se do të ruajë konfidencialitetin pavarësisht nga rrethanat imponuese, jo shtrënguese të thyerjes së tij. Kjo do të thotë se kur klienti rrëfen informacionin privat, këshilluesi e ruan atë për qëllimin që u rrëfye. Megjithatë ekzistojnë disa situata në të cilat këshilluesi duhet ta thyejë konfidencialitetin, sidomos kur duhet të paralajmërojë dhe të mbrojë persona të tretë. Gjithsesi, sa herë që këshilluesi mendon se duhet thyer konfidencialiteti, ai ia bën të qartë këtë qëllim klientit dhe e inkurajon atë të marrë pjesë në rrëfimin e së vërtetës.

Rregulli i përgjithshëm është se çështjet e klientit nuk diskutohet me të afërmit e tij si: grua, burrë, fëmijët etj. Përjashtohen rastet e trajtimit të fëmijëve, të cilat mund të diskutohen me prindërit apo përfaqësuesin ligjor të fëmijës, për shkak se ai nuk ka zotësi të plotë për të vepruar dhe një këshillim i tillë është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të tij. Madje në këto çështje është e detyrueshme edhe prania e psikologut. Gjithashtu nuk mund të diskutohen me klientë të rinj rastet e klientëve të mëparshëm.

[84] Clinical Anthrology. Readings for live-client clinics – A.J.Hurder, F.S.Bloch, S.L.Brooks, S.L.Kay. Anderson Publishing Co, Ohio, fq 94.

Megjithatë edhe pse kemi të bëjmë me një detyrim shumë të rëndësishëm, ai nuk është absolut. Kjo do të thotë se ka disa raste kur konfidencialiteti mund të thyet, por rastet janë taksative dhe të parashikuara shprehimisht në ligj, për të mos lënë vend për abuzime.

Detyrimi i konfidencialitetit nuk shkelet kur: [85]

- Avokati informon një person të cilit ai është duke i deleguar detyrat individuale për shërbime ligjore mbi ecurinë e çështjes në fjalë, me kusht që edhe një person i tillë t'i nënshtrohet detyrimit të konfidencialitetit.

- Tregon konfidenca ose sekrete me pëlqimin e klientit ose të klientëve në fjalë, por vetëm pasi t'ua tregojë plotësisht atyre këtë gjë.

- Tregon konfidenca ose sekrete të nevojshme për të caktuar ose marrë pagesen e `avokatit ose për të mbrojtur avokatin ose nëpunësit e tij ose ortakët kundër një akuze për sjellje të gabuar.

Megjithatë shpeshherë tek avokatët vihet re nevoja e diskutimit të rasteve të veçanta me pjestarë të familjeve të tyre apo kolegë të punës. Këshilluesi ka nevojë të reflektojë e të rrëfehet, kjo vjen si pasojë e ngarkesave emocionale dhe psikologjike që ai mund të mbart nga diskutimi me klientin e tij. Këshilluesi e ndjen shumë nevojën të nxjerrë nga vetja atë çka ka akumuluar gjatë këshilimit, ndaj supervizorët e qendrave të këshillimit mendojnë për skema të asistencës profesionale për këshilluesit. Ajo që këshillohet është që supervizorët të ngrenë skema të realizimit të"debrifing" që janë seanca të shkurtra gjatë të cilave këshilluesi nuk rrëfen raste, por atë çka ndodhi me të, me veten e tij, gjatë punës me rastet. Seanca të tilla ndihmojnë në spastrimin e rëndesave të ditës dhe në minimizimin e stresit, mënjanimin e konsumimit profesional dhe ngritjen e protokolleve etike të këshillimit ligjor.

Me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurimin e cilësisë në shërbim, këshilluesi nuk duhet të harrojë:

- Përgjegjësitë profesionale,
- Detyrimin për të parandaluar dhe mbrojtur jetën e të gjithë aktorëve të përfshirë në skemën e këshillimit,
- Rrezikun e keqtrajtimit të fëmijëve, të abuzimit fizik, emocional, psikik,
- Rrezikun e inkurajimit të varfërisë,
- Rrezikun e dyzimit të marëdhënieve me fëmijët, të plotësimit të nevojave personale me sjelljet e tyre.

Çështje të shërbimit konfidencial bëhen edhe më të vështira nëse do të kemi parasysh se shpeshherë këshilluesit promovojnë punën dhe këshillimin në grup. Risku etik buron nga situatat kur ai nënvlerëson aspekte të tilla si:

- Dinamikën e formimit të grupit;

[85] Neni 14 i i Kodit të Etikës së Avokatit

- Konfidencialitetin në grup;
- Marëdhëniet personale brenda grupit;
- Mundësinë e abuzimit me teknikat e këshillimit në grup;
- Mundësinë e abuzimit me pavarsinë e anëtarëve të grupit;

Kjo çështje bëhet edhe më e rëndësishme kur flitet për klinikën e ligjit. Në programin e klinikës marrin pjesë një numër i caktuar studentësh, të cilët ngarkohen me detyra të caktuara. Detyrimi i konfidencialitetit duhet ruajtur në mënyrë individuale nga secili prej tyre dhe secili duhet të jetë i vetdijshëm për përgjegjësitë e tij. Ata mund të marrin dijeni për një çështje të caktuar të gjithë bashkë, gjatë diskutimit në grup apo kryerjes së detyrave të caktuara. Nëse vetëm njëri e shkel këtë detyrim kjo përbën një shkelje për gjitha stafin e punës dhe do të cënojë jo vetëm interesat e klientit por edhe besimin e tij, që është një proces i pakthyeshëm.

Studentët gjatë përvojës së tyre në klinikën e ligjit, mund të jenë të ngarkuar e këshillimin ligjor të klientit. Kjo, pasi përfaqësimi në gjyq mund të jetë tejet i komplikuar ‘ër ta që janë juristë të rinj pa përvojë. Para fillimit të këtij procesi është e këshillueshme që ata të marrin sygjerime nga profesori mbikqyrës apo persona të tjerë të specializuar në këshillimin juridik. Disa prej këtyre këshillave mund të përfshijnë :

Reagimi i natyrshëm: Mos u ndje qe duhet të shprehesh ndjenjat qe nuk dëshiron te shprehesh Ndaj mendimet dhe perjetimet e tua me klientin (brenda kufijeve te profesionit). Kujdesu që ajo që thua të jetë në përputhje me sjlljen tënde joverbale.

Këshillimi duhet të përmbushe nevojat e klientit dhe ajo ato të këshilluesit- analizo veten. Ki kurajon të pranosh ato raste kur nuk arrin të kuptosh si dhe sa duhet, apo kur keqkupton atë që thuhet dhe kur ke reaguar në mënyrë të papërshtatshme.

Këshilluesi nuk duhet të heqë dorë nga personaliteti i tij duke u hequr si një person tjetër. Këshilluesit i lejohet të ndajë me klientin një pjesë të përjetimeve te tij, ngjarja dhe situata delikate. Këshilluesi merret dhe orientohet prej nevojave te klientit dhe jo prej nevojave te vetes Këshilluesi konkurent me veten ka kurajë të nevojshme për të pranuar çdo lloj mangësie, keqkuptimi apo reagimi jo efikas qe ka kryer. Duhet kohë për te punuar që reagimet profesionale të jenë identike me ato profesionale.

Gjithashtu duke qënë se klinika ka në fokus ndihmën ligjore falas për shtresa të caktuara të popullsisë. Këta ka shumë mundësi të jenë klientë me probleme të veçanta duke qënë se do të përfitojnë prej ndihmës ligjore falas të ofruar nga programi i klinikës. Kjo e bën të nevojshme këshilimin e studentëve se si të punojnë me këta persona, por që natyrisht do të asistohen edhe nga psikologë, apo specialistë të fushës. Këtu mund të përfshihet puna me klientë që kanë probleme që nuk pranohen nga shoqëria, persona që kanë pasur probleme me ligjin, alkoolin, abuzimet, varësite, orientimin seksual etj.

Një element i rëndësishëm është besimi te vetevetja, te këshilluesi dhe si formohet ai. Besimi i individit në vetvete fillon të formohet herët në perputhje me cilësinë dhe sasinë e

dashurisë që foshnja merr nga prindërit apo te afërmit, përshtatja e tij për të marre në kontroll veten dhe për të vendosur për një përshtatje me arritjet dhe sukseset personale, në pershtatje me qëndrimin qe mban njeriu për vlerat e tij personale. Besimi në vetevete është një hap i rëndësishëm për të plotësuar nevojat e klientit.

Çdo përparim i këshilluesit drejt pranimit te pasigurive, hezitimeve dhe dilemave personale përbën një përparim. Përhapja e informacionit mund të ndodhë vetëm me lejen e klientit. Gjithashtu është e rëndësishme që në diskutimet me kolegë të tjere, rasti i klientit të mbetet gjithmonë anonim dhe i paidentifikueshëm. Mund të kërkohet diskutim në lidhje me fenomenin, problemin e veçantë me të cilin ai përballet, por duhet të bëhet çfarë është e mundur që identiteti i klientit të ngelet anonim dhe integriteti i tij personal të mos preket në asnjë mënyrë.

Një detyrim i tillë parashikohet edhe nga Ligji" Për mbrojten e të dhënave personale" i cili parashikon detyrimin e çdo subjekti që ka akses në të dhënat e inidvidëve të tjerë, qofshin këto sensitive ose jo, ka detyrimin për t'i ruajtuar ato dhe të mos i bëjë publike në mënyrë të paautorizuar. [86]

Një detyrim i tillë prek edhe juristët apo avokatët si subjekte që bien vazhdimisht në kontakt me të dhënat personale të klientëve të tyre. Vitet e fundit po i kushtohet një rëndësi e madhe mbrojtjes së këtyre të dhënave, për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e tyre, por edhe se është rritur numri i rasteve ku indentifikohen shkelje. Madje kemi edhe krijimin e institucionit të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili funksionon në bazë të ligjit dhe aketeve nënligjore në fuqi.

Për mbrojtjen e të dhënave personale ekziston një legjislacion i gjerë vendas dhe ndërkombëtar, i cili duhet të jetë në bazën e punës të kontrolluesve dhe përpunuesve dhe punonjësve të zyrës së Komisionerit. [87]

Akte ndërkombëtare që parashikojnë një mbrojtje të tillë janë :

- Deklarata Universale e të drejtave dhe lirive të njeriut;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, amenduar nga Protokolli nr. 11, hyrë në fuqi më 1 Nëntor 1998;
- Konventa e Këshillit të Evropës"Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale", ratifikuar me Ligjin nr. 9288, datë 7. 10. 2004;
- Direktivat 95/46/EC dhe 2002/58/EC të Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian;
- Protokolli shtesë i Konventës së KE"Për Mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe lëvizjen

[86] Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008"Për mbrojtjen e të dhënave personale"
[87] Udhërrëfyes për mbrojtjen e të dhënave personale- Për Subjektet e të dhënave- Publikim i Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale

ndërkufitare të të dhënave personale", ratifikuar me ligjin nr. 9287, datë 7. 10. 2004.

Mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë kushtetuese. Në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garantohet e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Ky nen parashikon:

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.

2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin. [88]

4. 2. 2 Konflikti i interesit

Një avokat është në konflikt interesi kur ka një rrezik të rëndësishëm që përfaqësimi i një ose disa klientëve të jetë materialisht i kufizuar nga përgjegjësitë që ky avokat ka ndaj një klienti tjetër, një klienti të ardhshëm, personi të tretë ose një interesi personal të vet avokatit. [89]

Një prej detyrimeve që ka avokati gjatë ushtrimit tyë profesionit të tij është të parandalojë dhe të shmangë konfliktin e interesit. Jemi para konfliktit të interesit kur avokati dhe klienti i tij kanë interesa që jo vetëm mund të jenë kontradiktore, por mund të jenë edhe konkurruese. Në këto raste avokati duhet të heqë dorë nga përfaqësimi ligjor i çështjes nëse nuk mundet të shmangë konfliktin e interesave. Konflikti i interesave mund të jetë real, kur ai realisht ekziston dhe interesat janë në knflikt me njëri tjetrit duke vënë në dyshim përfaqësimin sa më të mirë të klientit. Gjithashtu konflikti i interesit mund të jetë edhe potencial, çka do të thotë se ai nuk ekziston por krijohen dyshime ose përshtypja te publiku që kemi të bëjmë me një çështje konflikti dhe kjo do të cënonte jo vetëm besimin e klientit por edhe reputacionin dhe integritetin moral dhe profesional të avokatit. Pra, edhe kur kemi të bëjmë me një konflikt potencial, pra të mundshëm interesi avokatit i lind detyrimi të heqë dorë nga çështja.

Shmangja e konfliktit të interesit është një detyrim që parashikohet edhe në legjislacionin në fuqi. Përveç Kodit të Procedurës Penale, ky detyrim parashikohetr edhe në ligjin"Për Avokatinë" por edhe Kodin e Etikës së Avokatit.

Avokatit i ndalohet të marrë pjesë në një çështje, kur ai ka qenë i ngarkuar më parë në të si gjykatës, prokuror, oficer i Policisë Gjyqësore ose si dëshmitar. Avokati nuk lejohet të

[88] Neni 35 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
[89] MODEL RULES OF PROF'S CONDUCT R. 1.7 (a((2) 2009

japë ndihmë ligjore ose të përfaqësojë një person, kur ka këshilluar ose ka përfaqësuar më parë palën kundërshtare në të njëjtën çështje, ose kur avokati ka lidhje gjaku apo ka interes të njëjtë me palën kundërshtare. Avokatët, që shërbejnë në të njëjtën zyrë avokatie, nuk lejohen të përfaqësojnë palët kundërshtare në të njëjtën çështje. Avokatët, që ushtrojnë profesionin e tyre pranë së njëjtës zyrë avokatie, prezumohet se janë në dijeni dhe zotërojnë dokumentet për këdo që është mbrojtur apo përfaqësuar nga zyra e tyre. Përveç rasteve të parashikuara më sipër në këtë nen, avokati është i detyruar të sigurohet se nuk vepron në konflikt me interesat e personit që mbrohet ose përfaqësohet prej tij. Kur avokati dyshon se është duke vepruar në konflikt interesash, ai duhet të marrë miratimin me shkrim nga palët, të cilat mendohet se preken nga ky konflikt interesash. [90]

Ligji parashikon rastet që ndalohet ushtrimi i profesionit të avokatit sepse konfliti i interesave e ndalon këtë. Megjithatë përveç rasteve që parashikon ligji asnjë nuk e ndalon avokatin që të marrë masa për të parandaluar situatat në konflikt interesi, të cilat mund të shfaqen edhe neë raste të tjera përveç këtyre që përmenden shprehimisht në ligj.

Megjithatë konflikti i interesit shfaqet jo vetëm në marrëdhëniet e punës së avokatit me klientët e tij, por edhe në marrëdhëniet me institucionet në vend. Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit të tij, nuk mund të jetë, njëkohësisht, gjyqtar, prokuror, noter, nëpunës civil ose punonjës i administratës publike. [91] E vetmja veprimtari që mund të kryejë avokati është mësimdhënia, e cila lejohet pikërisht për shkak të përfitimit të interesit publik.

Një detyrim i avokatit për të shmangur punësim në pozicione të papajtueshme parashikohet edhe në Kodin e Etikës, i cili referon te ligji që rregullon këtë profesion. Gjithashtu i kushtohet një rëndësi e madhe shmangies së konfliktit të interesave si një detyrim bazë dhe që lidhet drejpërdrejt me punën cilësore dhe profesionale të avokatit.

Avokati nuk mund të japë ndihmë juridike, të këshillojë, të përfaqësojë apo mbrojë në emër te dy ose më shumë klientëve në të njëjtën çështje, në rast se ka konflikt interesash të atyre klientëve midis tyre. Avokati nuk përfaqëson dhe heq dorë nga perfaqesimi apo mbrojtja e dy ose më shumë personave, kur lind nje konflikt interesash midis klientëve, kur avokati bindet se përfaqësimi do të cënojë marrëdhëniet me klientin tjetër. Avokati që më parë ka përfaqesuar një klient në një çeshjte, nuk përfaqëson një klient tjetër në të njëjtën çështje, kur interesat e këtij personi u sjellin dëm interesave të klientit të mëparshëm. Përfaqësimi lejohet përjashtimisht, vetëm në rast se klienti i mëparshëm jep pëlqimin e tij.

Avokati duhet gjithashtu të tërhiqet nga përfaqësimi ose mbrojtja në rast se ekziston rreziku i shkeljes të besimit të klientit të mëparshëm, ose në rast se njohja që zotëron avokati për çështjen e klientit të mëparshem, do të përbënte epërsi të padrejtë për klientin e ri. Rregulli i mësipërm është i barazvlershëm edhe për rastin kur profesioni i avokatit ushtrohet në ortakëri, apo nga e njëjta zyrë.

[90] Neni 9/5- 9/9 i ligjit nr.9109 datë 17.7.2003"Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
[91] Neni 4 9 i po këtij ligji

Avokati nuk duhet të përfshihet në transaksione biznesi me një klient nëse ai dhe klienti kanë interesa të ndryshme si dhe kur klienti pret nga avokati që ai ta ushtrojë gjykimin profesional për mbrojtjen e klientit, perveçse kur:

- transaksioni dhe kushtet në te cilat avokati ka fituar interesa janë të drejta, të arsyeshme për klientin dhe i janë deklaruar në mënyrë të plotë dhe transmetuar me shkrim në një mënyrë që të kuptohet si e arsyeshme nga ana e klientit;

- Avokati këshillon klientin të kërkojë këshillat e një avokati të pavarur lidhur me transaksionin; dhe

- Klienti jep miratimin e tij me shkrim, mbas deklarimit të plotë të kushteve të transaksionit dhe të konfliktit të qenësishëm të interesit në këtë transaksion. [92]

Edhe pse Kodi tregohet i kujdesshëm për të përfshirë të gjitha ato situata që përbëjnë konflikt interesi, avokati ka detyrimin që të indentifikojë çdo situatë tjetër që do ta çonte atë në kushtet e konfliktit të interesit dhe do të cënonte integritetin e tij si edhe interesat e klientit të përfaqësuar.

Kodi i Etikës edhe pse është hartuar dhe përbën një dokument të detyrueshëm për avokatët profesionistë, është gjithashtu i detyrueshëm për studentët e klinikës. Ata duhet të marrin masa për të shmangur konfliktin e interesave, i cili do të kërcënonte rezultatet e mira të punës së tyre. Raste të konfliktit të interesave në klinikë mund të jenë të shumta. Përmnedim këtu përfaqësimin e familjarëve të një prej studentëve të klinikës, apo përfaqësimin njëkohësisht të dy klientëve të cilët kanë interesa konkurruese me njëri tjetrin. Këto janë rastet më alarmante që duhet të identifikohen menjëherë nga studentët e klinikës si raste të papranueshme dhe të merren masa për të shmangur një mbrojtje të tillë ligjore.

4. 3 Kontradiktoriteti dhe konflitet në klinikën e ligjit

Idealet e akademikëve në lidhje integritetin dhe standardet profesionale takohen me botën e vërtetë në programet e klinikës, veçanërisht ku klinika përfaqëson klientë që kanë interesa shumë të fuqishme. Duke e bërë të dëgjueshëm zërin e klientëve të tyre në çështje të rëndësishme, klinika mund të prekë njerëz që janë në pozicione të caktuara duke testuar kërkesat e fakulteteve për të qëndruar me standarde të vërteta në botën reale. Liria akademike, pavarësia profesionale dhe detyra e avokatit për të siguruar aksesin në drejtësi, janë të gjitha shumë të mira në teori. Por çfarë ndodh kur aktivitetet e klinikës kërcënojnë t'u shkaktojnë insitucioneve të tyre shuma të mëdha parash? A duhet akotorët e klinikës të heqin dorë nga parimet e tyre profesionale para të mirës së universitetit si një i tërë [93]?

[92] Nenet 20, 21, 22, 23, 24, 25 të Kodit të Etikës së Avokatit

[93] Adam Babich – Controversal, conflicts and law clinics, artikull i botuar në Clinical law Review, vol 17. Nr 2, Pranverë 2011, Fakulteti i Drejtësisë New York, faqe 469

Nga njëra anë klinika i mëson studentët të kryejnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe në respektim të standardeve më të larta profesionale. Nga ana tjetër nuk pretendohet që klinika të marrë në mbrojtje çështje pa marrë parasysh asnjë pasojë. Sot po ngulmohet që klinika të ofrohet në mnyrë të barabartë për të gjithë subjektet përfitues, pa u lidhur me ndikime politike. Studentëve u kërkohet që të mësojnë të drejtën dhe ta praktikojnë atë, duke qendruar jashtë çdo ngjyrimi emocional dhe politik. Profesionalizmi është ai që kërkohet mbi gjithçka tjetër !

Rastet kur janë përpjekur që klinikat të manipulohen me mjete të ndryshme janë jo të pakta, sidomos në Shtetet e Bashkuara, ku klinikat janë të zhvilluara dhe kanë një rrugë të gjatë progresi dhe niveli akademik. Eksperienca e TELC është një shembull i një përvoje të tillë. [94] Klinika e ligjit që trajtonte çështjet e të drejtës së mjedisit do të padiste industritë amerikane për dëmet e shkaktuara në ambient. Më pas do të shohim se kjo padi do të tërhiqej dhe ajo u pasua edhe nga një çmim i rëndësishëm që do t'i akordohej TELC, çka vuri në dyshim gjithë veprimtarinë e saj ligjore si edhe integritetin e lartë të akotëreve pjesmarrës në atë program.

Një rast tjetër është rasti kur një prej senatorëve të Luizianës kërcënoi se do të tërhiqte fondet nga Universiteti i Maryland në SH. B. A në kundërveprim të një padie të paraqitur në gjykatë nga klinika e këtij universiteti kundër Purdue, një kompani men ndikim shumë të fuqishëm politik. Megjithatë klinika e këtij universiteti nuk u tërhoq, madje mund të themi se ajo korri një fitore shumë të suksesshme për klientët e saj kundër Purdue.

Shpesh herë çështje kontradiktore krijojnë konflikt intersash. Një çështje e ndjekur nga një klinikë e një universiteti mund të cënojë hapur ose jo intersat e një donator të fuqishëm të universitetit ose të dikujt që jep një kontribut të caktuar për të. Gjithashtu mund të përfshhet edhe një projekt ku politikanë apo njerëz me ndikim të fuqishëm kanë interesa të përfshira. Sipas disa studiuesve situate të tilla kontradiktore krijojnë një konflikt interesi bazuar në pamundësinë e aktorëve të klinikës për të dalë kundër interesave të punëdhësve të tyre ose atyre që lidhen me ta. Dhe pikërisht ky kërcënim ndaj punës së tyre mund të krijojë një konflikt interesi, sipas kësaj teorie. [95]

Kontradiktoriteti është një teori që lidhet me konfliktin sepse ajo shkurajon juristët të kryejnë detyrat e tyre duke i shmangur shqetësimet personave me influencë në shoqëri.

Ata që aplikojnë klinikën kanë gjithashtu detyrime ndaj punëdhësve të tyre. Përgjegjësia e tyre ndaj universitetit nënkupton detyrimin që ata të veprojnë me profesionalizëm, të bëhen mentor të aftë për studentët e tyre dhe t'i ofrojnë atyre përvojën më të mirë të klinikës në kuadër të përmirësimit dhe fitimit të aftësive të reja. Profesorët e klinikës, si

[94] Shiko botimin në shtyp Tulane Environmental Law Clinic Honoured with Camille F. Gravel Jr Pro Bono Award By Federal Bar Association, 27 Korrik 2010, http://www.law.tulane.edu.tlsNews/Newsitem.aspx?id=14150.

[95] Helen A. Andersen – I foluri ligjor dhe shqetësimi mbi konflitet potenciale : Një siguri qesharake? Profesor Helen A. Andersen shpjegon :
Konfliktet e biznesit nuk konsiderohen domosdoshmërisht sis i shkelje të kodeve etike, por presionet ekonomike mbi juristët në këto raste synojnë të favorizojnë jë çështje ose një tjetër.

pjesë e stafit akademik natyrisht që duan më të mirën për universitetin, për kolegët dhe për studentët. Megjithatë universitetet shpesh kanë disa qëllime ose objektiva për të përmbushur, dhe nuk përjashtohet mundësia që këto në disa raste të jenë në konflikt interesi. Profesorët e klinikës, janë pjesë e dtafit akademik, dhe detyra e tyre kryesore është të mësojnë studentët të realizojnë detyrat e tyre me profesionalizëm, përkushtim dhe në përputhje me parimet më të larta profesionale për t'i shndërruar ata në profesionistë të zotë por edhe me integritet të lartë moral dhe professional në të ardhmen e tyre. [96]

Për disa juristë, përgjigjia e pyetjes nëse kontradiktoriteti shkakton konflikt interesi mund të jetë pa interes. Nëse avokati do të marrë në përfaqësim një çështje në konflit interesi, atëherë klienti do të kërkojë përjashtimin e tij nga çështja, në mbrojtje të interesit vetjak. Nëse avokati nuk e do çështjen ai nuk është i detyruar ta marrë atë, përveç rasteve kur caktohet si avokat kryesisht nga gjykata ose prokuroria. Megjithatë, përfaqësimi i një çështje në kushtet e konfliktit të interest mund të përcaktojë edhe fatin e çështjes, dhe rrjedhimisht mbrojtjen ose jo të interesave të klientit. [97] Rregullat mbi ushtrimin e profesionit zakonisht i nxisin avokatët të shmangin konfliktin e interesave. [98] Megjithatë konflikti i interesave nuk është një term neutral, i pavarur nga vlerësimi i interesave konkrete të palëve në çështje. Duke e trajtuar kontradiktoritetin si një konflikt interesi do të inkurajojë firmat ligjore të ngrenë komitete për të vërtetuar ndihmën ligjore *pro bono* duke minimizuar detyrimin e avokatëve për të kënaqur interesat e individëve të pasur dhe të fuqishëm gjatë punës së tyre.

Një prej detyrimeve të parashikuara më lart, është detyrimi i konfidencialitetit. Ky është një detyrim që mund te anashkalohet, nëse klienti jep pëlqimin. Lind pyetja, pse do të duhej klienti të jepte pëlqimin në një rast të tillë, duke qënë se kjo nuk është në interesin e tij? Në fakt, klientët që përfitojnë ndihmë ligjre falas nga programet e klinikës janë më të disavantazhuar në krahësim me klientët e tjerë. Kjo pasi ata duhet të pranojnë disa kushte që nuk do t'i pranonin në kushte normale, pra nëse do të kishin mjete financiare për të përballuar pagesën e ndihmës ligjore. [99] Prandaj është përgjegjësia profesionale por edhe morale e avokatit për të mos përfituar nga një disavantazh i tillë. Asnjëherë nuk duhet të detyrohet klienti të japë pëlqimin për një vendim i cili nuk do të ishte në interesin e tij më të mirë. [100]

4. 4 A është e gabuar përfaqësimi i klientëve që mund të përballojnë një avokat?

Klinika ofron shërbim *pro bono* për një kategori të caktuar personash. Këtu përfshihen ata subjekte që nuk mund të përballojnë një avokat, pasi u mungojnë mjetet financiare.

[96] Adam Babich – Controversal, conflicts and law clinics, artikull i botuar në Clinical law Review, vol 17. Nr 2, Pranverë 2011, Fakulteti i Drejtësisë New York, faqe 481
[97] Po aty.
[98] Ligji" Mbi avokatinë", Kodi i Etikës së Avokatit, Kodi i Procedurës Penale apo ligje të tjera në fuqi.
[99] Gary Belloë & Jeanne Kettleson-From Ethics to Politics: Comfronting Scarcity and Fairness in Public Interest Practice
[100] David luban and Michael Milleman, Good judgment : Ethics teaching in Dark Times, 9 GEO.J.Legal Ethics 31 (1995)

Megjithatë në praktikë mund të hasen raste kur përfaqësohen klientë që nuk bëjnë pjesë në këtë kategori. Lind pyetja nëse kjo është korrekte. A duhet lejuar një gjë e tillë apo është në kundështim me vet objektin dhe qëllimin e klinikës?

Shumica e universiteteve i ndalojnë klinikat e tyre të përfaqësojnë klientë që nuk konsiderohen" vunerabël", pra atë kategori që nuk ndodhet në kushtet e mospasjes së mjeteve financiare për të përballuar vet një avokat. Kjo lidhet me faktin se klinika synon të ndihmojë një kategori të veçantë njerëzish dhe këtyre individëve i pakësohen mundësitë nëse merren në përfaqësim klientë jashtë kësaj kategorie. Në fakt ndihma ligjore falas ndaj kujtdo nuk është në qëllimin e klinikës, sepse në fakt nuk do të kishte kuptim e kundërta. Megjithatë rregulli i përgjithshëm është që avokatët mund të përfaqësojnë këdo që dëshirojnë. Ky rregull aplikohet jo vetëm kur ata e ushtrojnë profesionin kundrejt pagesës, por edhe kur përfaqësojnë çështje falas, për qëllime që lidhen me interesin publik. Në një vendim të Gjykatës Së Lartë në Sh. B. A, gjyqtari David Souter arsyeton se :"…*Avokatët e organizatave jo-fitimprurëse kanë të drejtë të përfaqësojnë edhe personat me aftësi të kufizuara, edhe pse këta nuk kategorizohen si individë me të ardhura të pakta, sepse shteti nuk ka një justifikim të ligjshëm për të ndaluar ndihmën ligjore falas në një rast të tillë.* "

Në mungesë të një rregullimi nga legjislacioni shqiptar, do t'i referohemi legjislacionit amerikan në lidhje me subjektet që përfitojnë ndihmën ligjore falas.

Shërbimi publik *pro bono* përfshin përfaqësimin e :

- Personave me mjete të kufizuara monetare;
- Organizatave të bamirësisë, fetare, civile, edukuese që kanë si objekt kryesor të drejtat e personave me mjete të kufizuara;
- Individë ose organizata që synojnë të mbrojnë të drejtat civile ose ato publike;
- Organizatave të bamirësisë, fetare, civile, edukuese ku pegaesave e tarifave normale do të dëmtonte financat e organizatave ose do të ishte e papërshtatshme. [101]

Pra, këto janë kategoritë e subjekteve përfitues nga ndihma ligjore falas. Çdo subjekt që dëshiron të përfitojë nga shërbimet e klinikës duhet të katëgorizohet në një prej këtyre rasteve. Megjithatë studentët e klinikës mund të dëshirojnë të përfaqësojnë edhe një individ apo subjekt tjetër, pavarësisht se ai mund të mos kategorizohet në rastet e parashikuara nga rregullat, nëse ata vërtet mendojnë se kemi të bëjmë me një subjekt pa mundësi për të realizuar të drejtën e tij në një tjetër mënyrë. Kjo lidhet me vët natyrën sociale që ndjek klinika, me qëllimin për të ndihmuar ata që nuk mund ta sigurojnë vet këtë ndihmë, prandaj në këtë fushë studentët duhet të mësohen por edhe të inkurajohen të jenë fleksibël. Ata mund të dalin ndonjëherë edhe jashtë rregullave, duke ofruar ndihmën e tyre dhe duke vënë në dispozicion aftësitë ndaj atyre që vërtet kanë nevojë për to, për t'i shërbyer një kauze të mirë.

[101] MODEL RULES OF PROF'L CONDUCT R. 6.1, 2009

Në rastet kur ata mendojnë se vërtet duhet ofruar ndihma ligjore falas ndaj një klienti mund t'i drejtohen profesorëve të klinikës, ose bordit drejtues të fakultetit duke argumentuar rastin konkret dhe duke shpjeguar se pse duhet ofruar një ndihmë e tillë. Studentët kanë vërtet mundësi të bëjnë një ndrsyhim në këtë aspekt, madje kjo mund të shndërrohet në një praktikë të aplikuar nga fakulteti. [102]

4. 5 Procedimi disiplinor

Profesioni i avokatit thamë se rregullohet nga një sërë rregullash që e bëjnë të domosdoshëm zbatimin pikërisht sepse ky profesion ka nevojë për rregullim dhe standarde të larta profesionale. Në rastin kur avokatët dështojnë në zbatimin dhe respektimin e këtyre rregullave, atëherë ndaj tyre mund të merren masa disiplinore.

Procedimi disiplinor ndaj avokatëve realizohet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të një procedure të caktuar të përcaktuar në ligj. Ndaj veprimtarisë rpfesionale të avokatit mund të vijnë ankesa nga kliëntë, gjyqtarë apo prokurorë, organe shtetërore, avokatë të tjerë apo çdo person që pretendon se i është cënuar një interes i ligjshëm nga puna e këtij avokati. [103]

Avokati i nënshtrohet procedimit disiplinor kur:

- ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e avokatit dhe me legjislacionin tatimor;
- ka vepruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në Kodin e Etikës së Avokatit dhe me rregullat e tjera të përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe dhomat e avokatisë. [104]

Procedurat disiplinore realizohen në bazë të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit duke i dhënë mundësinë avokatit të paraqesë pretendimet e tij para komisionit disiplinor. Masat disiplinore jepen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

Për shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit të avokatit, komisioni disiplinor I Dhomës Kombëtare të Avokatisë mund të japë një nga masat disiplionore të mëposhtme: [105]

- vërejtje me shkrim;

- gjobë nga 5 000 (pesë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

[102] Eleanor W.Myers, " Simple Truths" About moral education, 45 AM. U. L REV 823 (1996)
[103] Neni 37 i ligjit nr.9109 datë 17.7.2003"Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
[104] Neni 38 i ligjit nr.9109 datë 17.7.2003"Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
[105] Neni 43 i po këtij ligji.

- pezullimin e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet;

- heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit.

Lind pyetja nëse mund të ndërmerren masa të tilla disiplinore ndaj studentëve të klinikës. Në fakt, studentët e klinikës edhe pse po ushtrojnë disa nga detyrat e avokatit ata nuk janë avokatë profesionistë. Ata nuk kanë një liçencë për ushtrimin e profesionit. Megjithatë thamë se Kodi i Etikës së Avokatit dhe parimet bazë janë të detyrueshme edhe për ta, për aq sa mund të zbatohen dhe t'u kërkohen edhe atyre. Kjo bën që për ta të lindë një përgjegjësi morale por edhe akademike që t'i përmbushin siç duhet detyrat e tyre dhe mos shkelin parimet bazë të profesionit. Nëse ata nuk i zbatojnë ato, kjo nuk do të thotë se ndaj tyre do të aplikohen procedurat disiplinore të përmendura më sipër, sepse këto procedura janë të aplikueshme vetëm për avokatët profesionistë, të liçensuar dhe të atashuar pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Megjithatë këtyre studentëve mund t'u tërhiqet vëmendja, apo edhe të merren masa më të rënda në varësi të shkallës së fajit por edhe dëmit të ardhur nga veprimi apo mosveprimi i tyre. Në mnëyrë që ndaj tyre të aplikohen masa të tilla është e rëndësishme që ata të jenë udhëzuar fillimisht nga profesorët e tyre sepse mungesa e dijenisë nuk mund t'i penalizojë ata. Ata gjithashtu mund të vlerësohen negativisht nga detyra e klinikës apo edhe t'u kërkohet të marrin pjesë në një program tjetër në mënyrë që të eleminojnë mangësitë si edhe të fiksojnë detyrat e avokatit sidomos në kuadër të përgjegjësive etike, apo përgjegjësisë që kanë ndaj klientit të tyre.

Pjesa e dytë

Aspekte praktike të klinikës së ligjit

Kapitulli V

Modelet më të mira të klinikës në botë

Përmbajtja : 5. 1. Shoqata e edukimit të klinikës ligjore, CLEA; 5. 2 Klinika e ligjit në Shtetet e Bashkuara; 5. 3 Klinika e ligjit në Itali; 5. 3. 1 Objektivat e klinkës së ligjit në Itali; 5. 4 Klinika e ligjit në Poloni; 5. 5. Klinika e ligjit në Francë; 5. 6 Vështrim krahësues të klinikave në botë

5. 1 Shoqata e edukimit të klinikës ligjore, CLEA

Në pjesën e parë të këtij punimi, u trajtua klinika e ligjit, mënyra e aplikimit të saj, avantazhet që sjell, aftësitë e përfituara prej saj etj. Megjithatë bëhet fjalë vetëm për një trajtim teorik të saj. Në mnëyrë që ajo të kuptohet më mirë dhe të implementohet siç duhet në praktikë nevojitet të pasyqrohet por edhe të kuptihet një tablo e përvojave më të mira të klinikës në Shtetet e Bashkuara, aty ku ajo lindi por edhe të vendeve europiane ku duhet pranuar se ajo është zbatuar dhe zhvilluar me ritme mjaft të larta profesionale.

Duke qënë se klinikës i është kushtuar një rëndësi e madhe, si pjesë e edukimit juridik, për shkak të avantazheve që ajo sjell, kjo është pasqyruar edhe në aspektin organizativ. Kemi krijimin e një sërë organizatave ndërkombëtare që synojnë të vënë në dukje aspektet akademike dhe praktike të klinikës dhe ta afirmojnë atë në të gjitha fakultetet e drejtësisë. Shoqata për Shkollat Amerikane të Ligjit, seksioni mbi edukimin e klinikës ligjore dhe Shoqata e edukimit të klinikës ligjore, CLEA [106] janë dy organizatat kryesore në këtë fushë.

[106] Clinical Legal Education Education CLEA, shoqatë e krijuar në SH.B.A në 1992

Çfarë është Shoqata e edukimit të klinikës ligjore?

Shoqata e edukimit të klinikës ligjore është krijuar në 1992 me pjesmarrjen e profesorëve të klinikës në Shtetet e Bashkuara. Ajo është bashkë-publikues i Përmbledhjes mbi klinikën e ligjit, botim i përvitshëm që paraqet përvojat më të mira të klinikës në universitetet amerikane. Përmbledhja mbi Klinikën e ligjit (ISSN 1079-1159) është një gazetë gjysëm-vjetore e përkushtuar për çështje të teorisë mbi procesin e avokatisë dhe edukimin ligjor klinik. Rishikimi është sponsorizuar bashkarisht nga Shoqata Amerikane e Shkollave të Ligjit (AALS), Shoqata e Klinikës Ligjore (CLEA), dhe shkolla e së drejtës në Universitetin e Neë York. Pikëpamjet e shprehura në Përmbledhje janë të autorëve publikues dhe nuk duhet t'i atribuohen organizatave sponsoizuese r, institucioneve me të cilat autorët janë të lidhura, ose subjekteve të tjerë.

Kjo pëmbledhje mirëpret artikuj të ndrsyhëm (si dhe ese, komente, dhe lloje të tjera të pjesëve më të shkurtra) në avokati, mësimin klinik, praktikën ligjore, ose çështjet e lidhura me to. Tekste dhe citate duhet të jenë në përputhje me një sistem uniform të citimit që kërkohet për botimet e publikuara në të. Përmbledhja aplikon një sistem të shqyrtimit anonym të kolegëve që duan të publikojnë dorëshkrimet e tyre, si pjesë e procesit të përzgjedhjes së artikujve për botim, prandaj dorëshkrimet nuk duhet të mbajnë emrin e autorit ose identifikimin e informacionit. Kjo i shërben një procesi transparent dhe të hapur të përzgjedhjes së botimeve më të vlefshme dhe cilësore.

Ajo sponsorizon dhe mbështet konferenca, publikime dhe gazeta, ka një faqe zyrtare në internet me informacion të përditësuar dhe mbështet publikisht kauza të rëndësishme në mbrojje të aktorëve të klinikës së ligjit.

Krahas kësaj, në Shtetet e Bashkuara është krijuar edhe seksioni i klinikës së ligjit, pranë Shoqatës mbi shkollat amerikane të së drejtës, e cila gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e klinikës, vlerave dhe metodave të saj.

Shoqata e edukimit klinik ka sponsorizuar ëorkshop-e dhe konferenca me tema të ndryshme por të fokusuara padyshim te klinika e ligjit.

Ajo ekziston për të promovuar edukimin klinik ligjor si vlerë themelore për edukimin e avokatëve të rinj. Kjo shoqatë dhe anëtarët e saj kërkojnë të:

- të nxitin mësimin e shkëlqyer dhe ofrimin bursave për programet e klinikës;
- të integrojnë mësimin klinik duke zgjeruar metodat e saj në programin e edukimit ligjor të çdo shkolle të ligjit;
- reformimin e arsimit ligjor në mënyrë që të përgatisin studentët e drejtësisë për praktikë të shkëlqyer dhe reflektuese të ligjit;
- të çojnë përpara rregullimin e edukimit ligjor që siguron vitalitetin e vazhdueshëm të arsimit klinik në shkollat e ligjit; dhe

- të ndjekin dhe nxitin drejtësinë dhe diversitetin si vlerat thelbësore të profesionit ligjor. [107]

5. 2 Klinika e ligjit në Shtetet e Bashkuara

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qënë të parat që kanë aplikuar klinikën e ligjit, si metodë të studimit juridik, duke u bërë shembull për t'u ndjekur nga gjithë shtetet e tjera në shkollat e tyre të së drejtës. Prandaj për të kuptuar jo vetëm mënyrën se si lindi por edhe tendencat e saj bashkëshohore, rrugën e zhvillimit që ka përshkruar si edhe shumë elementë të tjerë është e nevojshme të bëhet një trajtim i klinikës së ligjit bazuar në përvojën amerikane.

Shkollat e ligjit në Shtetet e Bashkuara kanë krijuar klinikat e ligjit në fillim të viteve 1920. Fondacioni për Përparimin e Mësimit duke përmbledhur situatën në shkollat e së drejtës në SH. B. A, vuri në dukje se edukimit ligjor i mungojnë objektet klinike në krahasim me fushat mjekësore dhe inxhinierike të arsimit. Mendime të ngjashme u shprehën gjatë viteve 1930 dhe 1940 nga studiues ligjorë, se mësimet teorike në fakultete nuk arrijnë të trajnojë studentët e drejtësisë me cilësitë e përshtatshme për profesionin, duke shfaquar mendimin për të aplikuar klinikën e ligjit si pjesë të programit akademik.

Edukimi ligjor do të ndikonte në përmirësimin e aftësive dhe gjithashtu duke i shërbyer të varfërve do të realizohej një punë në interes të publikut. Në këtë mënyrë klinika do të jepte një përfitim të dyanshëm, për studentët e të drejtës por edhe për komunitetin në përgjithësi.

Megjithatë, lëvizja klinike filloi të fitojë vrullin e saj në Shtetet e Bashkuara vetëm pas lëvizjes civile dhe asaj për të drejtat e njeriut si edhe luftës së Presidentit Lyndon Johnson mbi varfërinë (dhe më vonë, lufta e vazhdueshme në Vietnam) e cili e ngriti ndërgjegjen sociale kombëtare në mes të viteve1960s. Me anë të klinikës së ligjit si pjesë së edukimit juridik vjen në skenë jo vetëm Lëvizja për të Drejtat Civile dhe luftës kundër varfërisë por gjithashtu në këtë kohë gjithmonë e më shumë po shihet një rritje e fondeve kombëtare për shërbimet ligjore për të varfërit ku një numër i madh klinikave ofronin shërbime ligjore falas për të varfrit. Megjithatë prioriteti i klinikës së ligjit si pjesë e studimit ligjor, drejtësia sociale dhe përgjegjësa profesionale filloi të humbiste terren në Shtetet e Bashkuara në vitet 1980, me një venitje të interesit të studentëve në puën në favor të interesit publik.

Programet klinike ofrojnë gamë të gjerë të aftësive të avokatisë të cilat fitohen me anë të përvojës klinike dhe do të shohim se në këtë periudhë programet e klinikës fillojnë duke u fokusuar më shumë në zhvillimin e aftësive. Megjithatë, drejtësia sociale dhe profesionale si edhe përgjegjësia morale dhe ajo profesionale mbetet në zemër të arsimit klinik në Shtetet e Bashkuara.

[107] Misioni i shoqatës i publikuar në faqen zyrtare të ëeb http://www.cleaëeb.org/mission

Shumica e shkollave të ligjit në SHBA ofrojnë kurse klinike duke ofruar asistencë ligjore falas për kategori të ndryshme të shoqërisë. Këto klinika operojnë në fusha të larmishëm e ligjit. Disa nga fushat më të rëndësishme ku klinikat janë dhënë më poshtë, bazuar në Raportin e Qendrës për Studimin e Aplikuar në Arsimin Ligjor. Klinikat më përhapura të ofruara nga fakultetet e së drejtës në Sh. B. A janë fushat :

- Mbrojtja penale;
- Çështje gjyqësore civile;
- Ndërmjetësimi;
- Drejtësia për të mitur;
- E drejta migratore;
- E drejta e komunitetit;
- E drejta familjare;
- Dhuna në familje;
- Legjislacioni tatimor;
- Apelimi i vendimeve administrative apo gjyqësore;
- Trasaksionet tregtare;
- E drejta e mjedisit;
- Strehimi;
- Të drejtat e njeriut;
- Azili potitik, refugjatët;
- Procedimet penale;
- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- Mbrojtja e shëndetit;
- Çështje gjyqësore civile dhe penale;
- E drejta e punës;
- Dënimi me vdekje;
- Pronësia intelektuale;
- E drejta administrative;
- Të drejtat civile dhe politike;
- Të drejtat e të burgosurve;
- Letrat me vlerë dhe titujt;
- E drejta e falimentimit;
- Testamentet, trustet, pasuritë e paluajtshme;
- E drejta e konsumatorit;
- Klinikat live për klientët;
- E drejta kushtetuese;
- E drejta e koorporatave.

Tipar i dukshëm i programeve klinike në SHBA, është mbështetja që mori nga Dhoma e Avokatisë. [108] ABA ndërsa merret me akreditimin e fakulteteve juridike i jep rëndësi të konsiderueshme përfshirjes së programeve të klinikës si pjesë e programit akademik.

[108] ABA- American Bar Association- institucion anlog me Dhomën e Avokatisë në Shqipëri

Preferenca ABA -së për të ofruar praktika të shumta klinike për studentët, edhe jashtë ambienteve të fakultetit ka ndihmuar edhe në rritjen e klinikave në SHBA.

Klinikat e ligjit më të vjetra dhe të njohura në SH. B. A paraqiten më poshtë :

5. 2. 1 Klinika e ligjit në Unversitetin e Kolumbisë në Neë York

Kjo klinikë ka filluar në vitin 1985 me fondet federale për të ndihmuar komunitetin me të ardhura të ulëta. Megjithatë e veçanta e kësaj klinike është se ajo ndihmon organizatat jofitimprurëse dhe të biznesit të vogël që të ofrojnë shërbime për komunitetet me të ardhura të ulëta. KQZ-ja nuk e ndihmon drejtpërdrejt komunitetin. Ajo përfaqëson institucionet të cilat ofrojnë shërbime të përballueshme për anëtarë të komuniteteve me të ardhura të ulëta. Klinika percepton se duke ndihmuar këto institucione do të jetë një mënyrë efektive për të maksimizuar përfitimet kur krahasohet me të vërtetë se çka përfitohet nga ofrimi i këtyre shërbimeve për individët.

Kjo klinikë zgjeron shërbimin e saj në të gjithë Neë York dhe organizatat që punojnë jashtë vendit. Ajo ndihmon organizatat që synojnë të ofrojnë shërbime për komunitetin për të përmbushur nevojat e paplotësuara. Këto shërbime që ofrojnë organizatat variojnë nga programet e shkrim-leximit, ofrimi i ushqimit, gjithashtu ofrohen programe shkollore dhe të programe që janë të përballueshme për strehim.

Klinika siguron ndihmë në aspekte ligjore të tilla si; hartimi i kontratave, marrëdhënia juridke e qirasë, politikat e punësimit dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Klinika zgjedh organizatat të cilat janë në gjendje të përballojë shërbime ligjore dhe kanë një potencial për kontributin e rëndësishëm të komunitetit. Studentët kalojnë dy semestra në këtë program klinike. Ata punojnë në një ekip dhe klinika trajton gjashtë deri në nëntë çështje në një vit akademik. Studentët gjithashtu të përfshirë në zhvillimin e arsimit ligjor, marrin si detyrë për të punuar një temë ligjore për organizatat e komunitetit dhe të biznesit të vogël. Kjo klinikë fokusohet në ndërtimin e kapacitetit të klientit dhe përfshirjes së tij në zgjidhjen e problemit ligjor. Studentët, të cilët marrin pjesë në programin e klinikës, duhet t'i nënshtrohen një seminari javor dhe janë nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë për punën e tyre. Sigurisht seminari do të forcojë mirëkuptimin e studentit mbi të drejtën materiale, dhe zhvillimin e aftësive të avokatisë si edhe dhe përgjegjësi profesionale që ata duhet të kenë parasysh.

Kursi gjithashtu ndihmon studentët në të kuptuarit e çështjeve jo- ligjore dhe t'i bëjë ata të zhvillojnë marrëdhënie me klientët në frymën e një bashkëpunimi të qëndrueshëm. Kjo klinikë promovon vlerat e drejtësisë sociale dhe inkurajon studentët për të kuptuar nevojat e klientit perspektivat, qëllimet dhe vlerat.

5. 2. 2 Klinika e ligjit në fakultetin Juridik, Baltimore.

Klinika e ligjit si pjesë e programit akademik në fakultetin e Drejtësisë në Baltimore ofron nëntë klinikat e mëposhtme;

- Praktika klinike për apelimin;
- Klinika për avokatinë në çështjet cvile;

- Klinika për zhvillimin e komunitetit;
- Klinika mbi praktiën penale;
- Klinika e ligjit për personat me aftësi të kufizuara;
- Klinika mbi të drejtën familjare;
- Klinika për ndërmjetësim në çështjet familjare;
- Klinika për të drejtat e emigrantëve;

Vetëm studentët të cilët janë të kualifikuar sipas Rregullës 16 të Rregullores Maryland mund të bëhen pjesë e klinikës, dhe vetëm pasi plotësojnë atë kusht mund të aplikojnë. Sipas Rregullës 16, studentët me rezultate më të mira akademike dhe pasi ka përfunduar me sukses 30 orë të punës në klasë, janë të pranueshëm. Disa klinika të cilat mund të aplikohen edhe në vendin tonë janë të trajtuara në mënyrë më të detajuar.

- **Klinika mbi zhvillimin e komunitetit**

Klinika mbi zhvillimin e komunitetit, ofron shërbime falas jo-gjyqësore në zonën e Baltimorës. Për këtë qëllim janë krijuatr dhe ushtrojnë aktivitetin organizatat e zhvillimit të komunitetit. Klinika ndihmon komunitetet të përmirësojnë veten e tyre duke mbështetur vendosjen e biznesevë të vogla në lagjet e pazhvilluara. Klinika gjithashtu ndihmon grupet që promovojnë strehimin, ofrimin e shërbimeve të ndryshme jetike në komunitet, veprimtarinë e shoqatave të komunitetit, dhe aktivitete të tjera me bazë në nivel lokal.

Klinika ofron shërbime këshilluese për klientët dhe formon organizatat jo-fitimprurëse, shoqëritë, ortakëritë dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, realizon bashkëpunimin me Bordet e avokatisë të cilët mund të ofrojnë shërbime ndihmëse dhe profesionale në çështje të ndryshme.

ShpeshKlinika ndihmon organizatat për të aplikuar për përjashtimin e taksave si edhe në hartimin dhe rishikimin e kontratave. Ajo gjithashtu i këshillon ato në lidhje me atë që ata mund dhe nuk mund të bëjë sipas ligjit, ose sipas një kontrate. Klinika gjithashtu ofron trajnim të grupeve në fusha të veçanta të ligjit dhe avokatëve për ndryshime në ligj, dhe bën thirrje për studentët e drejtësisë për të punuar direkt me klientët, në çifte ose individualisht. Ata marrin përsipër përgjegjësinë për të gjitha çështjet e klientit nën drejtimin e me kohë të plotë nga fakulteti i drejtësisë. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në seminare javore dhe takime që ofrojnë udhëzime dhe mbështetje për çështje të klientit dhe analizojnë kontekstet ligjore dhe të politikave që kanë të bëjnë me punën e zhvillimit të komunitetit. Studentët fitojnë përvojë duke punuar me klientët brenda një kuadri të strukturuar arsimor, duke ndihmuar për të forcuar komunitetet si edhe duke iu shërbyer atyre në mënyra të ndryshme.

Klinika për zhvillimin e komunitetit është një klinika një- semestrale. Studentët pritet të shpenzojnë rreth 20 orë në javë për një çështje të klinikës. Vetëm studentët të cilët ndjekin kursin e plotë të vitit të parë kanë të drejtë të jenë pjesë e klinikës.

- **Klinika e ndërmjetësimit në familje**

Klinika për ndërmjetësim në familje është një kurs një-semestral dhe me tre kredite. Klinika bashkëpunon me sistemin gjyqësor dhe një shumëllojshmëri të organizatave ligjore dhe ka synim të pajisë studentët me një gamë të gjerë të mundësitë në këtë fushë me mundësi aplikimi në praktikë në zgjerim. Në këtë program klinike, studentët përfaqësojnë klientët si ata të shkojnë përmes procesit të ndërmjetësimit, duke bashkë - ndërhyrë në konfliktet e të drejtës familjare dhe të angazhohen në projekte të hartuara për të të përmirësuar praktikën e ndërmjetësimit të familjes. Anëtarët student të klinikës janë pajisur me licenca për praktikë dhe për këtë arsye, ata duhet të kenë ose të jenë të regjistruar aktualisht në lidhje me përgjegjësinë profesionale. Përveç kësaj, studentët duhet të kenë mrrë pjesë në të paktën 40 orë të përgjithshme trajnimi për ndërmjetësim, qoftë përmes kursit të ndërmjetësimit ose nëpërmjet një trajnimi të miratuar jashtë shkollës së ligjit. Klinika ka trajtuar raste të tilla si kujdestaria e fëmijëve, përkrahja e fëmijëve dhe të drejtat e takimit me ta.

- **Klinika në të drejtën familjare**

Nën mbikëqyrjen e fakultetit, studentët në klinikën e të drejtës familjare përfaqësojnë klientët të ardhura të ulëta të cilët ngrenë pretendime duke kërkuar kujdestarinë e fëmijës, detyrimin për ushqim, zgjidhjen e martesës, miratimin dhe mjetet juridike civile për të ndaluar dhunën në familje. Studentët në këtë klinikë gjithashtu angazhohen në projekte sistematike në lidhje me çështjet e reformës së ligjit që kanë për qëllim rritjen e aksesit në drejtësi në drejtën familjare.

Klinika kërkon tre orë në javë seminar që mbulon çështje të tilla si intervistimi, këshillim, ndërmjetësimi, planifikimi i rastit, përfaqësimi në gjyq, refektimi i rastit dhe mbikëqyrja personale javore.

5. 2. 3 Shkolla e ligjit C. Vanderbilt

Aktualisht Shkolla Ligji Vanderbilt ofron 7 klinika të ligjit. Përshkrim i shkurtër i klinikave është dhënë më poshtë :

- Klinika për mosmarrveshjet e apelimit. Studentët përfaqësojnë individët me rastet e ankesave, duke filluar nga çështjet e emigracionit deri tek dënimet penale dhe raste të përgjithshme civile.
- Klinika mbi çështjet civile. Studentët përfaqësojnë individët në paditë në lidhje me kufizimin e zotësisë për të vepruar si edhe mosmarrëveshjet në lidhje fëmijët dhe prindërit që kanë nevojë për shërbime të edukimit special në shkollat publike.
- Klinika për zhvillimin ekonomik të komunitetit. Studentët përfaqësojnë organizatat jo -fitimprurëse që kanë si objekt kryesisht ndihmës ndaj personave të varfër.
- Klinika mbi praktikën penale. Studentët përfaqësojnë të rriturit të akuzuar për vepra penale dhe fëmijët akuzuar për vepra penale, krime apo kundravajte penale.

- Klinika mbi dhunën në familje. Studentët përfaqësojnë viktimat e dhunës në familje të varfër në marrjen e urdhrave të mbrojtjes, si dhe çështjet e kujdestarisë të çifteve të pamartuara.
- Klinika mbi pronësinë intelektuale. Studentët përfaqësojnë individët, bizneset, organizatat, grupet dhe shoqatat në çështjet në fusha të ndryshme të pronësisë intelektuale, duke përfshirë të drejtën e autorit, markat tregtare, të drejtat publicitare dhe sekretet tregtare. Klinika gjithashtu i ofron komunitetit programet e arsimit mbi pronën intelektuale.
- Klinika mbi të drejtën ndërkombëtare. Studentët mësojnë aftësi të veçanta të tilla si procesi i avokatisë gjatë negociatave të traktatit, hulumtim në lidhje me të drejtën ndërkombëtare dhe kryqëzimet e të drejtës ndërkombëtare dhe vendore.

5. 2. 4 Shkolla e së drejtës në Xhorxhtaun, Washington

Qendra juridike e Universitetit Xhorxhtaun i ka konsideruar më shumë rëndësi programit të klinikës si pjesë e programit akademik. Ky universitet ofron 23 kurse klinike nëpërmjet 14 klinikave të saj çdo vit. Këto klinika janë të mbikëqyrur nga 17 profesorë të klinikës që punojnë me orar të plotë në fakultet, 26 avokatë partner të fakultetit, dhe disa pedagogë zëvendësues të fakultetit. Ka rreth 300 studentë të regjistruar në këto programe klinike çdo vit. Misioni i programit të klinikës është që të edukojë studentët duke i mësuar me aftësitë e avokatisë dhe në të njëjtën kohë të ofrojë përfaqësim cilësor ligjor për të nën-përfaqësuar individët dhe organizata të ndryshme.

Në vijim po përmendim disa prej programeve më të mira të klinikës që ofrohen në Xhorxhtaun :

- Programi i procedimeve në apel. Ky program trajton çështje të emigracionit, parimin *habeas corpus* dhe një shumëllojshmëri të çështjeve të të drejtave civile në disa qarqe federale dhe gjykata.
- Qendra për Studime ligjore të aplikuara. Ofron përfaqësim *pro bono* të kualitetit të lartë për refugjatët që kërkojnë azil politik për shkak të përndjekjes, torturës dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut.
- Projekti i drejtësisë për komunitetin. Projekti i drejtësisë për komunitetin filluar në vjeshtë të vitit 2010. Ky projekt i ofron studentëve mundësi për të përfaqësuar direkt klientët, duke përdorur një shumëllojshmëri të taktikave dhe metodave të përfaqësimit.

Duke qënë se i gjithë projekti është i bazuar në komunitet, studentët trajnohen për të përfaqësuar lloje të ndryshme të rasteve në bazë të nevojave të komunitetit. Studentët të cilët janë të angazhuar në këto raste përgatisin dokumentet e nevojshme, intervistojnë klientët, trajtojnë problemet ligjore në aspektin e të drejtës dhe ofrojnë alternative të ndryshme zgjidhje për klientët e përfaqësuar prej tyre. Ata janë të ekspozuar ndaj ndërlikimeve të marrëdhënies avokat-klient dhe etikës profesionale. Studentët në këtë program përgatiten të kenë përgjegjësi të plotë për rastet e tyre dhe të marrin trajnim në

avokatinë me gojë, me shkrim, marrëdhëniet me median, dhe intervistimin dhe këshillimin e klientëve. Ata gjithashtu nxiten të marrin pjesë në politikë zhvillimin, hartimin e ligjeve dhe hulumtimin.

- Avokatia në çështjet penale është një program ku studentët përfaqësojnë të pandehurit në raste të kundravajtjeve penale ose krimet.
- Klinika mbi dhunën në familje. Studentët në klinikën për dhunën në familje përfaqësojnë viktimat e dhunës në kërkesat e tyre për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes etj.

Trajtuam disa nga klinikat më të famshme në universitetet e ligjit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtu është vendi ku klinika e ligjit lindi si pjesë e programit akademik, u zhvillua dhe transfomua deri në formën që e njohim sot. Progrmaet e klinikës në Sh. B. A në fakt janë mjaft të zhvilluara dhe ato edhe pse mund të huazohen nga Fakultete të drejtësisë të vendeve të tjera, kjo nuk do të thotë se rezultatet janë të njëjta. Kjo, pasi klinika është e lidhur drejpërdrejt me kushtet sociale dhe ekonomike të një vendi, duke qënë se fokusi i saj kryesor është ofrimi i ndihmës ligjore falas për kategori në nevojë. Edhe pse këto programe mund të huazohen, është e këshiillueshme që ato të aplikohen në përputhje me kushtet e veçanta të një vendi.

Programet e aplikuara në Shtetet e Bashkuara do të ishin të vështira për t'u aplikuar në vendin tonë për shembull, pasi klinika tek ne është ende në hapat e para të zhvillimit dhe gjithashtu mësimdhënia, sistemi arsimor dhe programet akademike në Shqipëri janë mjaft të ndryshme si nga niveli ashtu edhe nga kurrikulat me ato të universiteteve amerikane. [109]

5. 3 Klinika e ligjit në Itali

Fakulteti i Drejtësisë së Brescia organizoi në 3 shkurt 2012 një konferencë ndërkombëtare e cila ka për qëllim promovimin e projektit të nisur nga universitetet italiane të quajtur " Projekti mbi klinikat ligjore në Itali. " Konferenca u përkushtua për zhvillimin e klinikave ligjore në Evropë dhe analizimin e metodologjisë dhe format e ndryshme organizative në të cilat mund të ofrohen programet e klinikës së ligjit. Në konferencë, ku morën pjesë studiues italianë të cilët synojnë të ofrojnë risi në metodat e mësimdhënies dhe janë të interesuar në përvojën e klinikave dhe të personelit të huaj nga vende të ndryshme (SHBA, Britania e Madhe, Gjermani, Spanjë, Francë, Poloni), dhe që shumë prej tyre vijnë prej këtyre përvojave të huaja.

Një ndihmë të konsiderueshme për promovimin e klinikës së ligjit në Itali ka dhënë Nisma e drejtësisë për një shoqëri të hapur, një organizatë ndërkombëtare e cila ka qenë aktive në promovimin e klinikave ligjore si një mjet për nxitjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

[109] Studim i shkollës së ligjit bazuar në klinikën e ligjit – Botim i Forumit për klinikën e ligjit në rajonin e Azisë, 2011, faqe 65.

Konferenca është hapi i parë në një projekt i cili kërkon krijimin e klinikave juridike në brendësi të Fakulteteve të Drejtësisë italiane dhe ka për qëllim ndërtimin e rrjetit"Klinikat ligjore në Itali", e hapur për aderim nga të gjitha fakultetet e drejtësisë që ndjekin një qëllim të njëjtë.

Me klinikë ligjore do të kuptojmë një programi studimi, i cili ofron kurset e ligjit, me qëllim përmirësim të mësimdhënies së ligjit ku studentët krahas njohurive teorike mbi të drejtën, fitohen aftësi të reja nëpërmjet përvojës me anë të trajtimit të rasteve të drejtpërdrejta, sipas një qasjeje metodologjike, metoda" të mësosh duke praktikuar"

Nëse kjo është kornizë e përgjithshme, duke shqyrtuar programet klinike ligjore aktive në vende të ndryshme dhe në varësi të profilit në shqyrtim, është e mundur të vëzhgohet një pjesë e madhe e modeleve, të cilat mund të jenë kombinuar në mënyra të ndryshme. Duke iu referuar strukturës, ka klinika të organizuara ekskluzivisht në kuadër të fakultetit, të ashtuquajtura" *klinika në shtëpi*" me profesorë të fakultetit, të përhershme ose jo dhe avokatët, ose ka klinika ligjore ku shërbimi nuk është ofrohet direkt nga fakulteti, por nga palët e jashtme me të cilat fakulteti ka një marrëveshje të veçantë, të cilat njihen si" *externship"*.

Në lidhje me llojin e aktivitetit, ka klinika të cilat fokusohen në diskutimin e rasteve reale, të ashtu-quajtura klinika me klientë, dhe klinika e cila e bazon punën në raste të simuluara, ndonëse e zhvilluar në një mënyrë shumë të sofistikuar. Sa për përmbajtjen e rasteve, disa klinika synojnë të kryejnë më shumë aktivitete kontestuese, ose aktivitete të tjera të këshillimit, ndërmjetësimit apo edhe të "planifikimit social", dmth projektet për zhvillimin e shërbimeve sociale për institucionet publike ose organizatat jofitimprurëse.

Për sa i përket metodologjisë arsimore, ka klinika të bazuara në modelet e"mësimdhënies së drejtpërdrejtë", në të cilën qëllimi kryesor i mësuesi është të sigurojë një mësim të drejtpërdrejtë të studentëve me anë të pyetjeve ligjore të ngritura. Nga ana tjetër kemi dhe klinikat që bazohen në modelet e"mësimit të tërthortë", në të cilën mësuesi bën pyejte të tërthorta të nxjerri një mësim apo konkluzion me anë të përgjigjeve që jep duke përfituar aftësi dhe përvoja të reja.

Një tipar që bashkon përvojat e ndryshme të klinikave ligjore është vëmendja që i kushtohet dimensionit social të ligjit në bazë të rasteve konkrete që trajtohen nga klinikat e ligjit. Këto raste në pjesën më të madhë të tyre klasifikohen si rastet e"interesit publik". Shërbimet e ofruara nga klinika janë, në fakt, në adresë të kategorive vunerabël të popullsisë që kanë nevojë për një mbrojte të veçantë. Këtu përfshihen punëtorët, emigrantët, konsumatorët, fëmijët e keqtrajtuar, etj. Klinika ka për qëllim të ofrojë një mbrojtje të lartë dhe cilësore në mënyrë që këta individë të realizojnë të drejtat e tyre, të cilat nuk do të mund t'i realizonin në mungesë të klinikës së ligjit. Gjithashtu kanë të bëjnë me rastet në të cilat vihet në dyshim mbrojtja e të drejtave të njeriut apo cënimi i çështjeve që konsoderohen të lidhura direkt me interesin publik, të tilla si mjedisin ose shëndetin ose dhunën në familje.

Veprimtaria e mbrojtjes në gjykatë është një veprimtari që ofrohet pa pagesë. Nëse fitohet çështja nga studentët e klinikës me shpenzimet e pagave ligjore të palës tjetër me të ardhurat e fituara ushqehet buxheti i universitetit. Për rastin e kundërt, kur çështja nuk do të fitohet do të përdoren të ardhura nga një fond i krijuar për këtë qëllim.

5. 3. 1 Objektivat e klinikës së ligjit në Itali

Programet që ofrojnë klinikat ligjore në universitetet italiane ndjekin dy objektiva kryesore:

- Të ndërthurren leksionet teorike dhe tradicionale me përvojën praktike duke ofruar një mënyrë të ndryshme të studimit të ligjit, në bazë të të mësuarit eksperimental. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, se klinika synon të zvogëlojë rëndësinë e studimit teorik, i cili mbetet rruga më e rëndësishme dhe thelbësore për trajnimin e juristëve të rinj. Gjithashtu ofrohet një studim mjaft i plotë duke ndërthurru atë teorik me të mësuarit e lindur nga përvoja.
- Tregimi i studentëve se ligji mund të studiohet dhe aplikohet jo vetëm në madhësi e saj"teknike", por edhe në madhësinë e saj"Sociale". Kjo kuptohet në kontekstin që ligji nuk duhet të zbatohet në mnëyrë të verbër pa u marrë parasysh elementi social, sepse e drejta duke qënë se ka në fokus njeriun ka si qëllim që të ndihmohet njeriu dhe të zgjidhen problemet me të cilat ai përballet.

Klinika ligjore është, pra, një sfidë për të gjitha palët duke përfshirë:

- Për mësuesit, të cilët punojnë në klinikë dhe kjo përfshin pyetje mbi profesionalizmin e tyre dhe metodën mësimdhënsëse e cila duhet të pasurohet me njohuri të reja dhe mjete të reja të mësimit. Në të vërtetë, është e nevojshme për të reflektuar mbi çfarë është mësuar (ose duhet të mësojnë) në një fakultet modern të jurisprudencë, si dhe për të kuptuar si duhet t'i jepet ky mësim.

- Për studentët, klinika ofron një mundësi të përjetojnë forma të reja të të mësuarit dhe në të njëjtën kohë për të provuar veten e tyre duke bërë një detyrë që kërkon aktivizimin e një përzierjeje komplekse të aftësive, duke filluar nga analiza konceptuale, identifikimi i fakteve ligjërisht të domosdoshme, përgatitjen e dokumenteve dhe opinioneve, zhvillimi i aftësitë ndërpersonale dhe aftësinë për zgjidhjen e problemeve.

- Për institucionet dhe shoqatat profesionale (të Universitetit, Ministria, Dhoma e Avokatëve), sfida nga klinikat ligjore është ajo e rrugëve të inovacionit që duhet të forohen për studimin e së drejtës nga brezat e rinj. Studimi i shkencave juridike kërkon guximin për të ndërmarrë projekte të reja dhe të dinë se si të ofrohen mbështetja gjatë gjithë rrugës së studimit.

Karakteri inovativ i përvojës së klinikave ligjore, megjithatë, është gdhendur në mënyrë të përkryer në disa nga objektivat strategjike të procesit mësimdhënës në shumë prej universiteteve italiane. Synohet tejkalimi i vetë sistemeve të trajnimit, hapjen e njëjtëdrejt shoqërisë, përfshirjen dhe fuqizimin e studentëve dhe bërjen e tyre aktiv në të gjitha

hallkat e mësimit në fakultet. Nëse studentët janë aktivë, të përfshirë në procesin e studimit dhe atyre i merret mendimi mbi metodat dhe objektivat atëherë mësimi do të jetë shumë më efektiv. Së fundi, duhet të kontrollohet me kujdes mundësi për të hyrë në klinikat brenda reformës për trajnimin për qasje sa më të mirë drejt profesionit të juristit, ku normalisht mundësia për të qënë jurist i mirë lidhet drejtpërdrejt me studimit dhe kurset e ndjekura si edhe rezultatet e arritura në fakultet.

Përvoja e klinikave ligjore të Amerikës së Veriut është një përvojë e lakmuar edhe nga universitetet italiane. Këto programe janë huazuar nga shumë vende të botës përfshirë këtu edhe Italinë.

Shumica e universiteteve britanike, të gjithë ata me peshë më të madhe akademike, kanë ngritur kurse të klinikës së ligjit. Klinikat e reja ligjore kohët e fundit janë themeluar në vendet e familjes Civil Laë të tilla si Spanja, Franca, Gjermania, dhe shumë vende në Evropën Lindore, sidomos në rastin e Polonisë, ku klinikat janë bërë pjesë e programeve ministrore për zhvillimin Itali dhënat, nga kjo pikëpamje, një vonesë të konsiderueshme.

Italia në këtë drejtim mund të themi se ka një vonesë të konsiderueshme. Deri më tani, përvoja e vetme e klinikës ligjore e themeluar në programin e kursit ka qenë në Breshia, e cila u pasua këtë vit, nga një projekt i ngjashëm, më shumë zhvendosur në formën e një praktike, të zhvilluar nga Kolegji Ndërkombëtar i Universitetit të Torinos, një kolegj një vokacion të fortë në të drejtën ndërkombëtare private. Përvoja jo-kurrikulare kanë kohë që aplikohen në Universitetin e Firences, dhe më shumë kohët e fundit, në Universitetin e Trentos, Torino dhe Universitetin Roma Tre. Por, në përgjithësi, mund të thuhet se shumica e mësuesve dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë në Itali dinë pak ose asgjë prej përvojës klinike. prandaj është thelbësore që përvoja e realizuar në Breshia nuk do të mbetet një eksperiencë e izoluar, por do të bëhet pika e fillimit për njohjen dhe shpërndarjen e klinikës në shkallë ligjore.

Testimi i kësaj metode të mësimdhënies mund të rezultojë në një projekt me shumë ide të reja, e cila do të sjellë pranë universiteteve italiane përvojat më të përparuara në botë. Lëvizja për integrimin e studimeve klinike ligjore sot është, në fakt, një rrjet i madhësisë botëror, i cili është përhapur në të gjithë kontinentet, të cilat, me shpejtësi në rritje, kanë theksuar edhe brenda sistemeve të së drejtës civile të Evropës kontinentale, nevojën për përfshirjen e programeve klinike duke u bërë tradicionalisht më indiferente ndaj formave eksperimentale të studimit të ligjit.

Në konferencën Ndërkombëtare mbi studimet klinike ligjore që u mbajt në Valencia në korrik të vitit 2013 morën pjesë gati 300 delegatë nga universitetet në mbarë botën. E vetmja klinikë italiane e aplikuar nga një universitet juridik në Itali ishte ajo në Breshia.

Zhvillimi i përpjekjeve për forcimin e një projekti të institucionalizimit të klinikave ligjore, tregon për përfshirjen e tyre në regjimin në kurrikulat universitare, por që duhet gjithashtu të fokusohet në mbështetjen e disa palëve të interesuara. Një nga objektivat e projektit duhet të është edhe identifikimi i palëve të interesuara në klinikën e ligjit.

5. 3. 2 Klinika e ligjit në Universitetin e Breshia - s

Klinika ligjore në Breshia u vu në jetë me nxitjen e një grupi mësuesish, avokatësh dhe studentësh të cilët ishin të bindur se kishte ardhur koha për të bërë disa ndryshime në mënyrën e mësimdhënies dhe si të mësohet e drejta në fakultetet italiane.

Klinika është themeluar në vitin 2009 dhe, në kurrikula, figuron si lëndë me zgjedhje prej 40 orësh dhe që vlerësohet me 6 kredite, e hapur për studentët të regjistruar në vitin e tretë, të katërt dhe të pestë në fakultetin e drejtësisë. Pas dy viteve të eksperimentimit, këtë vit u udhëhoq në një maksimum prej 15 anëtarësh. Në krahasim me dy modelet tipike të klinikës; *klinika në shtëpi* dhe *externship*, klinika ligjore në breshia është vendosur në mes, duke i dhënë jetë një modeli hibrid, në të cilin një pjesë e aktivitetit është kryer në ambientet e fakultetit dhe, nën drejtimin e fakultetit dhe avokatëve, dhe një tjetër është realizuar jashtë, në zyrat e avokatisë, pranë OJF- ve apo në gjykata. Zgjedhja e këtij modeli hibrid i ka lejuar, deri tani, për të kompensuar mungesa, në sistemin universitar, të profilit të profesorit klinik që ofrojnë mësimin akademik në klinikën e ligjit. Parashikimi i këtij profili të ri, për këtë arsye është një hap shumë i rëndësishëm në procesin e ndërmarrë për të lehtësuar përhapjen e klinikave në fakultetin e së drejtës.

Gjatë rrjedhës së klinikës ligjore, studentët punojnë në grupe të vogla, nën udhëheqjen e përbashkët të një mësuesi dhe një avokati dhe studentët merren me trajtimin e rasteve të vërteta. Fakti që studentët duhet të angazhohen në studim dhe zgjidhje të verasteve reale dhe jo raste të simuluara, do të thotë se mbikëqyrësit duhet shqetësohen jo vetëm për të zgjidhur problemin nga pika teknike dhe ligjore, por edhe për të zhvilluar disa aftësi themelore të marrëdhënieve ndërpersonale, me klientin, si dhe natyrisht me mbikëqyrësin dhe anëtarët e tjerë të grupit të punës. Të mësuarit e kësaj aftësie veçanërisht të sofistikuar, duke ofruar dijet që potencialisht kërkohen për të arritur në nivelin që kërkohet për një profesionist, është një nga vlerat e shtuara të kursit krahasuar me kurset e tjera kurrikulare.

Klinika e ligjit në Breshia është vendosur në bazë të një parimi multidisiplinar. Kështu, rastet e trajtuara deri tani janë përqendruar në çështje të së drejtës civile, të drejtën familjare, e drejta penale, e drejta e punës, ligjit kundër diskriminimit dhe të drejtës ndërkombëtare, duke aplikuar kërkesat potenciale të metodës së përdorur në klinikat ligjore, të zbatueshme për të gjitha fushat e dijes juridike. Siç kemi thënë, edhe pse raste janë trajtuar raste të llojeve të ndryshme, megjithatë është e mundur të gjendet një emërues i përbashkët, i përbërë nga një karaktyersitikë që është trajtimi i çështjeve në dimensionin social. Vëmendje për çështjet e barazisë sociale dhe aplikimit të ligjit si instrument për mbrojtjen e nevojave themelore të personit është një tjetër nga aspektet dalluese të kursit. [110]

5. 4 Klinika e ligjit në Poloni

Klinika e parë ligjore në Poloni filloi të funksionoj në vititn 1997 në Fakultetin e Drejtësisë në Jagiellonian. Klinika u ngrit dhe funksionoi falë mbështeteje së fondacionit

[110] Clinica legale, imprarare il diritto attraverso casi reali – botim i Universitetit të Breshia-s, Itali fq 6

Ford dhe mbështetjës që Amabasada Amerikane dhe mbështetës të tjerë dhanë në realizimin e konferencave për edukimin ligjor klinik. Një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e klinikës ligjore në Poloni ka luajtur edhe Shoqata e Studentëve Europian të Drejtësisë (ELSA), e cila ka mundësuar realizimin e konferencave për edukimin klinik në Poloni si dhe pjesmarrjen e klinikës polake në kongrese kombetare dhe ndërkombëtare.[111]

Sot në Poloni funksionojne 25 klinika ligjore të vendosura në çdo Fakultet Drejtësie të cilat japin ndihmën e tyre ligjore në ndihmë të personave që nuk kanë mundësi ekonomike ku mund të përmëndim të papunët, të pastrëhet, pensionistët, personat e paaftë, të huajt dhe refugjatët. Statistikat tregojne se përafërsisht dhjetë mijë njerëz në vit i drejtohen klinikave ligjore dhe përfitjone ndihmë falas nga studentët e Fakultetit të Drejtësisë.[112]

Puna në klinik është e ndarë në seksione. Secili seksion ka si mbikëqyrës pedagogun përkatës të fakultetit. Studentët e japin opinionin e tyre ligjor në bazë të seksionit të cilit ata i përkasin. Këto seksione janë:

- E drejta civile;
- E drejta administrative;
- E drejta e punës;
- E drejta penale;
- E drejta e refugjatëve;
- E drejta e grave.

Puna e studentëve në Klinikën e ligjit përqëndrohet më tepër në dhënien e opinioneve ligjore, në intervistën e klientit, në bërjen e kërkesave dhe ngritjen e kërkesë padisë në gjykatë.

Sekretaria e Klinkës pret klientin mer çështjen dhe me pas këtë çështje ja jep një studenti të vetëm apo një grupi studentësh. Studenti komunikon me klientin e vet rreth çështjes duke u njohur me çështjen dhe marë edhe informacionet që i duhen për përgaytitjen e opinionit juridik. Përpara se studenti të japë opinionin juridik përfundimtarë ndaj klientit, ky opinion kontrollohet më parë nga supervizori i seksionit. Pasi përpilohet opinioni përfundimtarë student takon klientin për ti paraqitur këtë opinion. Në shumicën e rasteve ky është edhe fundi i punës së studentit ndaj klientit të vet, por ndonjëher çështja duhet të ndiqet deri në fund, ndaj klinika bashkëpunon me persona apo organizata të cilat në mbështetjë të klinikës e përfaqësojnë çështjen deri në fund edhe në gjykatë.[113]

[111] www.fupp.org.pl./en/legal-clinics/history
[112] Filip Czernicki, "The Polish Legal Clinics Program and the Role of the Polish Legal Clinics Foundation", fq 2
[113] www.fupp.org.pl./en/legal-clinics/history

Klinikat ligjore në Poloni me qëllim hapjen e debateve rreth metodave dhe sfidave të edukimit klinik kanë hapur edhe revistën e vet e quajtur "Klinika". Në këtë revist janë bërë shkrime nga më të ndryshmet rreth edukimit klinik por më të spikaturat dhe që kanë hapur një debat të madh kanë qënë ato rreth metodavë aktive të mësim dhënies; intershipet e realizuara nga klinika ligjore; disiplina e studentëve ndaj punës dhe ndaj klinikës; rekrutimi i anëtarëve të klinikës ligjore, kushtet që pjestarët e saj duhet të përmbushin për të qënë pjesë e stafit të Klinikës si dhe ndikimi që ka puna dhe përvoja në klinik te studentët, çfarë përfitojnë studentët dhe sa ju shërben kjo përvojë në të ardhmen në profesionin e tyre.[114]

- Fondacioni i Edukimit Klinik në Poloni

Ideja e krijimit të Fondacionit Klinik në Poloni u hodh gjatë një prezantimi të të gjitha klinkave ligjore që funksionojnë në Poloni në qershor të viti 2001. Me financimin dhe mbështetjen profesionale të fondacionit të Stefan Batory, ky plan u realizua për më pak se një vit. Fondacini i Klinikës Ligjore filloi funksionimin e vet në shkurt të 2002.

Fondacioni i edukimit klinik ka si objekt kryesor përveç financimit të klinikave ligjore edhe forcimin e potencialit të programit të klinikave për të ardhmen. Fondacioni i arrin objektivat e veta nëpërmjet: mbështetjes së bashkëpunimit ndërmjet klinikave, duke mbështetur bashkëpunimin ndërkombetarë në fushen e edukimit të praktikave ligjore, nëpërmjet organizimit të trajnimeve, konferencave, prezantimeve, veprimtarisë botuese, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për aktivitetet e klinikave, mbledhjen dhe shpërndarejne njohurive në fushën e organizimit klinik, duke bërë propagandë për idenë e dhënies së ndihmës ligjore falas.

Duke u bazuar në programin e tij fondacioni i klinikës ligjore ka mundësine të mbështesë dhe të organizojë perspektiva të reja për klinikën ligjore në Poloni, duke trajnuar avokatët e gjeneratës së re nëpërmjet përdorimit të metodave më të fundit të edukimit dhe në të njëjtën kohë, ata luajnë një rol plotësues në sistemin e administratës shtetërore, duke edukuar qytetarët rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre.[115]

Në Poloni, është e mundur të përfitohet ndihmë ligjore falas apo këshillim ligjor më shumë se ndihma ligjore falas që përfitohet nga avokati kryesisht i caktuar nga gjykata, për subjektet që nuk kanë mjete të mjaftueshme monetare. Më poshtë po përmendim disa nga mënyrat se si një qytetar polak mund të përfitojë ndihmë ligjore falas :

- Në çështjet civile, gjykata *ex officio*, mund të udhëzojë palët se si të përfitojnë ndihmë ligjore falas në lidhje me çështjen e tyre.
- Gjithashtu ndihma ligjore falas mund të ofrohet edhe nga zyra e prokurorit, brenda kushteve të përcaktuara në ligj.

[114] Po aty
[115] Filip Czernicki, "The Polish Legal Clinics Program and the Role of the Polish Legal Clinics Foundation"

- Ndihma ligjore falas mund të forohet edhe nga Avokati i shtetit, organ i ngritur për të mbrojtur të drejtat e qytetarit nga veprimet e padrejta të administratës publike.
- Një sërë organizatash jo-fitimprurëse që kanë në fokus të drejtat e jeriut mund të ofrojnë ndihmë ligjore falas.
- Zyra për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, gjithashtu ofron ndihmë ligjore falas për çështjet gjyqësore brenda fushës së aktivitetit të saj.

Kjo tregon se mundësi e individit për ndihmë ligjore falas, mund të përmbushet në shumë mënyra që janë të aksesueshme në sistemin ligjor polak. Megjithatë ndihma ofrohet për kategori të caktuara, asnjë organizatë nuk mund të mbrojë këdo pa përjashtim. Natyrisjt që bëhet fjalë për përmbushjen e disa kritereve.

Një nga qëllimet kryesore të programit klinik në Poloni është përmirësimi i procesit arsimor të studentëve të ligjit nëpërmjet kontaktit jo vetëm në teori me të drejtën, por në ushtrimin e ligjit, si zhvilimin e marrëdhënieve me klientët dhe problemet e tyre.

Vitin e kaluar studentët e drejtësisë kanë ofruar këhsillim ligjor pa pagesë për njerëzit e varfër nën mbikëqyrjen e mësuesve të fakultetit dhe praktikuesit. Ky është një kombinim i përsosur i arsimit dhe aftësive udhëzuese për marrjen e përfitimit nga praktika. Një tjetër qëllim i rëndësishëm i programit është që të sigurojë ndihmë ligjore për anëtarët e varfër të komunitetit. Kjo është një mënyrë për të ndriçuar studentët në aspektin e shërbimeve publike të profesionit ligjor. Hyrja në problemet sociale rrit ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë për problemet e komunitetit, varfërinë si dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në shoqëri.

Programi i klinikës është një hap shumë i rëndësishëm drejt një ndryshimi në arsimin juridik në Poloni. Si pjesë e klinikës ligjore të Universitetit të Varshavës është ofrimi i një mundësie për të kombinuar njohuritë teorike të fituara gjatë studimeve me elementet e praktikës. Përfundimisht kjo do të çojë në një trajnim më të mirë dhe përgatitjen e studentëve për profesionin e tyre të ardhshëm.

Ideja e klinikave ligjore të aplikuara në Poloni vjen nga Shtetet e Bashkuara. Ka vetëm disa klinika aktive në Evropën Perëndimore, p. sh. në Mbretërinë e Bashkuar, Francë, Gjermani, Austri etj. Programi është sidoqoftë, zhvillimi i shpejtë dhe të mirë në vendet e reja demokratike në Evropën Qendrore dhe Lindore, të tilla si Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria, Bullgaria, Rumania, Moldavia, Lituania, Ukraina dhe Polonia. Megjithatë mund të themi se Polonia ka ecur me hapa të shpejtë në këtë drejtim duke u bërë edhe nje nga vendet me programin më të zhvilluar të klinikës në rajon.

Klinika e parë ligjore në Poloni filloi të funksionojë në tetor të 1997 në Fakultetin Juridik të Universitetit Jagiellonian. Menjëherë pas kësaj, në vitin 1998 klinikat ligjore u përshinë me kurse në programin e studimit në Universitetin e Varshavës. Shoqata Evropiane e Studentëve të Drejtësisë (ELSA) ka luajtur një rol të madh në krijimin dhe zhvillimin e programit. Në maj 1998 ELSA Szczecin organizoi një konferencë mbi reformën në

edukimin ligjor e cila dha ide të mira mbi zhvillimin e klinikave ligjore. Kjo konferencë shte një forum i mirë për diskutim rreth arsimit klinik në Poloni, sidomos për shkak se ajo është e kombinuar me zhvilimin e një Kongresi Kombëtar të Bashkimit të Avokatëve polakë (Zrzeszenie Praënikóë Polskich) dhe Kongresi Kombëtar i dekanëve të fakulteteve të drejtësisë. Konferenca në Szczecin rezultoi në një zhvillim të shpejtë të idesë për përhapjen e programeve klinike në të gjithë vendin. Ka 9 klinika ligjore që funksionojnë në fakultetet e drejtësisë në Poloni në këtë moment : Krakóë, Ëarsaë, Białystok, Torun, Poznań, Lublin, Rzeszóë, Szczecin dhe Lodz.

Ka pasur një rritje thelbësore e nevojës për këshilla ligjore të ofruara nga klinikat dhe ideja është bërë shumë popullor në mesin e studentëve dhe anëtarëve të fakultetit. Kurse klinike janë përfshirë në programin e arsimit në fakultetet e drejtësisë dhe trajtohen si të ashtuquajturat kurse specialistesh. Studentët kanë arritur të vlerësojnë këtë mënyrë të re të të mësuarit dhe janë të kënaqur me fatësitë e reja të përfituara nga kurset e klinikës së ligjit.

Deri më tani disa qindra studentë kanë marrë pjesë në zgjidhjen e çështjeve ligjore që kanë të bëjnë me disa mijëra raste nag praktika. Puna në klinikë është e ndarë në seksione të mbikëqyrura nga mësuesit e fakultetit, dmth seksione në të drejtën civile, të drejtën administrative, ligjin e punës, e drejta penale, e drejta migratore si edhe të drejtat e grave. Në kohën shtesë studentët nxiten të punojnë me të burgosurit duke i foruar atyre këshillim mbi çështje të ndryshme. Puna e studentëve përfshin : mendime të shkruara, deklarata me shkrim, aplikacione të ndryshme, ankesat, kërkesat dhe ndërhyrjet. [116]

Roli i klinikës ligjore në Poloni është i shumëfishtë. Dy nga objektivat e klinikave ligjore duhet të dallohen: edukimi dhe aspekti social. Objektivi i ditëve të sotme konsiston në dhënien e ndihmës juridike për personat që kërkojnë shërbim juridik për një sërë çështjesh ligjore, por nuk mund të përballojnë për të paguar për të. Klinika pra, luna një rol të dyfishtë. Nga njëra anë komuniteti padyshim ka nevojë për shërbimet e studentëve. Synohet të ofrohet ndihmë ligjore falas për një kategori të caktuar të popullsisë dhe kjo naryrisht i shërben interesit publik. Nga ana tjetër klinika ligjore është e vlefshme për dijet dhe aftësitë që i ofron studentëve.

Që nga viti 2004 një sistem i ri i ndihmës juridike pa pagesë ka qenë në fuqi në çështjet administrative. Mocioni për të përjashtuar nga taksat gjyqësore dhe të caktohet sipas detyrës zyrtare një këshilltar tatimor ose agjent pranë një avokati është një formë që përmban pyetje të detajuara që kanë të bëjnë me gjendjen e familjes, pronës dhe të ardhurave.

Aplikimi mund të merret në konsideratë nga një prej nëpunësve të gjykatës dhe vendimi i tyre mund të ankimohet në gjykatë, por nga ana tjetër mund të parashtrohet ankesë edhe kundër një vendimi të gjykatës. Në përfitimin e ndihmës ligjore falas në çështjet

[116] Klinika e ligjit –Idea, organizimi, metodologjia, botim i Universitetit të Varshavës, Varshavë 2005, fq 25

administrative do të duhet të merren në konsideratë disa kritere të cilat vlerësohen rast pas rasti.

5. 5 Klinika e ligjit në Francë

Franca, si një nga vendet e familjes romano-gjermanike është gjithashtu e interesuar në implementimin e klinikës së ligjit si pjesë të programit akademik për shkak të avantazheve që ajo ofron.

Klinika ligjore Saint - Denis është një projekt inovativ arsimor i cili ka për qëllim të rrisë aksesin në drejtësi për njerëzit pa u përjashtuar për shkaqe diskriminuese. Përfshirë si një program arsimor që prej 1901 mes mësuesve dhe studentëve të Fakultetit Juridik të Paris 8 Vincennes -Saint- Denis, ajo ofron ndihmë ligjore për kategori popullsisë të pafavorizuara në departamentin e Seine -Saint- Denis.

Ky departament është i karakterizuar, ndër të tjera, nga prania e klientëve me veçori të caktuara. Ata mund të vuajnë në të njëjtën kohë nga vështirësi sociale, administrative dhe shëndetësore si edhe ekonomike. Përveç kësaj, përmes injorancës, frikës ose thjesht dorëheqjes, ata mund të ndihen të detyruar të heqin dorë nga të drejtat e tyre. Prandaj, klinika synon respektimin e të drejtave dhe dinjitetit të tyre me anë të shërbimeve falas që ofron për ta.

Duke vënë në dukje vështirësi ekstreme, në të njëjtën kohë me dobinë e njohurive ligjore që ata kanë, anëtarët e klinikës ofrojnë ndihmë efektive për të përfituar këto popullsi. Linjat telefonike janë zbatuar në këto ambiente të Universitetit, gjatë të cilit studentët mbledhin informacionin e nevojshëm për të mbështetur popullin. Anëtarët gjithashtu dëshirojnë të marrin pjesë në klinikën e ligjit duke synuar vënien në jetë të së drejtave të ndryshme të tyre dhe, më gjerësisht, të propozojë reforma për të ndërhyrë që edhe organet shtetërore të kontribuojnë në zbatimin e tyre në mënyrë të efektshme.

Klinika realizon një bashkëpunim të ngushtë me avokatët vullnetare. Përveç kësaj, shumë profesionistë kanë rënë dakord për t'u integruar në klinikë si anëtarë të Komitetit të Nderit. Ata janë garantuesit e rëndësisë shoqërore të punës në klinikë dhe artikulimin efektiv të punës me profesionet që ata përfaqësojnë. Përfshirja e të gjithë aktorëve pjesëmarrës si; studentë, mësues, avokat dhe të gjitha profesionale juridike - padyshim mbetet vullnetar dhe kërkon një frymë të ngushtë bashkëpunimi midis tyre.

Universiteti Paris 8 Vincennes-Saint-Denis është vendosur në një zonë të caktuar gjeografike, e cila shkakton një rritje në vështirësi sociale ekonomike dhe ligjore. Megjithatë, një situatë e tillë është një mundësi për të integruar në strukturën shoqërore aftësi të veçanta që promovojnë integrimin më të mirë të të gjitha palëve të interesuara. Krijimi i Klinikës Ligjore pikërisht plotëson këtë objektiv, për të integruar sektorin e saj gjeografik dhe social përmes nxjerrjes së një shërbimi inovativ. Hapja e Universitetit është realizuar me anë të promovimit të vlerave të përbashkëta, duke synuar jo vetëm ndihmën ndaj komunitetit por edhe përmirësimin e aftësive të studentëve të klinikës.

Klinika ligjore është një institucion i lindur në universitetet amerikane. Të vetëdijshëm për nevojën për të plotësuar dije teorike në një qasje praktike dhe të etur për të treguar dobinë e tyre për komunitetin, këto universitete kanë krijuar shërbime ligjore vullnetare për të mbështetur njerëzit në kuadër të punës së institucionit të tyre.

Studentët shoqërojnë individët në nevojë për ndihmë juridike, duke ofruar shërbimet që iu nevojiten. Janë sigurisht personat në fjalë kryesisht në situata delikate ku përmendim vështirësitë e mëdha ekonomike, sociale dhe shëndetësore. Studentët janë të trajnuar dhe të udhëhequr nga mësuesit të cilët kanë një kompetencë të dyfishtë akademike dhe praktikante, për të siguruar shërbimin më të mirë të mundshëm dhe jo një përfitim" *të lirë*". Në përputhje me klinikën, thelbësor është objektivi edukativ, ku kalohen orë mësimdhënie dhe linjat telefonike që janë të integruara në programin mësimor për studentët synojnë të sigurojnë ndihmë ligjore dhe këshillim falas për një ose më shumë subjekte në bazë të hulumtimit paraprak dhe aftësive të tyre praktike.

Për studentët, programet klinike ofrojnë një mundësi e madhe, ajo promovon futjen e tyre të mëvonshme në fushën e" profesionalizmit" të menjëhershëm dhe të kufizuar për shkak të mësimit vetëm teorik të së drejtës. Klinika në të vërtetë nuk është një kurs teorik, ajo më shumë është një stazh. Studentët që kanë marrë pjesë në këto programe menjëherë arrijnë të kuptojnë një problem ligjor dhe e dinë përgjigjen.

Për profesorët, këto programe lejojnë të krijojnë një kërkim të ri dinamik. Programet klinike mund të ofrojnë shërbime të praktikuesve, për të rritur çështjet shumë teknike për të cilat ekspertiza e Universitetit është thelbësore. Si e tillë, profesori zhvillon tema të reja kërkimore që ai përndryshe nuk do të kishte mundësi t'i zhvillonte.

Megjithatë, përfitimi më i dukshëm është shërbimi klinik në favor të komunitetit. Klinikat bëjnë të mundur që të përmbushet një domosdoshmëri për popullsinë në nevojë dhe që nuk ka të njëjtën mundësi për akses në drejtësi si përsonat e tjerë. Puna universitare dhe akademik është punë sociale pasi ka në fokus ndihmën e komunitetit.

5. 6 Vështrim krahësues të klinikave në botë

Së fundmi, pasi trajtuam klinikat e ligjit në vende të ndrsyhme të botës është e rëndësishme të bëhet një trajtim në aspektin krahësimor në lidhje me klinikat që ofrohen në këto vende. Më lart, është trajtuar përvoja më e mirë e disa vendeve të shquara për programet e klinikës që ofrojnë, megjithatë jam ndalur edhe në ato shtete me të cilat Shqipëria ka një lidhje të veçantë jo vetëm gjeografike por edhe akademike dhe kulturore, në lidhje me fushën e të drejtës.

Klinika ligjore në lindjen e mesme filloi funksionimin e saj në vitin 2009 në gjashtë universitete të Palestinës, me mbështetjen e Programit për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara. Një nga universitetet në të cilën u hap klinika ligjore në Palestinë është edhe Universiteti Hebron. Puna e klinikës ligjore në Universitetin e Hebronit filloi në shtator të 2011. Klinika, ashtu si klinikat në vendet e tjera të botës, kërkon të ndërtoj kapacitetet e

nevojshmë që studentët e saj të praktikojnë dijet e tyre ligjore nëpërmjet dhënies së ndihmës ligjore falas ndaj komunitetit.[117]

Klinika e ligjit është e përhapur edhe në vendet e Lindjes së Mesme. Puna e klinikës ligjore në Universitetin e Hebronit fokusohet në dhënien e ndihmës ligjore falas në fushën e të drejtës penale, familjare, të drejtave të njeriut si dhe në të drejtën e detyrimeve nga studentët e vitit të fundit. Studentët janë të organizuar në grupe dhe çdo grup mbulon një fushë të caktuar. Çdo student i regjistruar në klinik duhet që së paku gjatë kohës së tij në klinik të japë dy opinione juridike.[118]

- Pjesë e Univesitetit të Hebronit janë edhe kurset e trajnimeve ligjore. Qëllimi kryesor i këtij kursi trajnimi është përgatitja e studentëve për karrierën e tyre pas diplomimit. Kursi i trajnimit ligjor u jep mundësi studentëve të aftësohen në:

- përpilimin e dokumentave ligjore. Programi I trajnimit të studentëve në aftësimin e përpilimit të dokumentave ligjore bëhët në mënyrë intensive për 5 ditë, tetë orë në ditë. Ky kurs ka si qëllim ti aftësojë studentët në përpilimin e dokumentave kryesore ligjore duke përfshirë hartimet legjislative, shkrimin e kontratave, hartimin e ankesave dhe opinioneve ligjore. Trajnuesit me tepër se akademikë janë gjyqtarë, avokatë, prokurorë dhe ekspert të ndryshëm nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare;[119]

- në aftësitë gjyqësore. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve të studentëve të drejëtsisë për të dhënë opinion ligjore gjatë punë në klnik dhe për të përfituar aftësi praktike në universitetin e hebornit realizohet trajnimi I quajtur : aftësi ligjore". Ky kurs përshin teknika të intervistimit të klientit dhe alternativa të zgjidhjes së mundshme;[120]

- të drejtën procedurale. Në të drejtën procedural klinika e ligjit ka zbatuar një sërë projektesh për aftësimin e studentëve të tilla si "Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave", "Teknikat e Hetimit Penal", "Aftësi në të Drejtën Procedurale Familjare". Trajnuesit e këtyre kurseve janë vetë gjyqtarët dhe vetë stafi i gjykatave;[121]

- vizitat në institucionet ligjore dhe gjykatat. Për tu siguruar se studentët kanë dijeni ndaj rasteve aktuale , Klinika organizon vizita për studentët në gjykatat e magjistraturës, në gjykatat familjare dhe në gjykatat e shkallës së parë. Po ashtu Klinika organizon vizita edhe në Institutin e Mjekësisë Ligjore me qëllim që

[117] Mutaz M. Qafisheh, "The Role of Legal Clinics in Leading Legal Education: A Model From The Middle East", fq 179
[118] Po aty
[119] Al-Hayat 5833, 30 January 2012, 13
[120] Ross Hyams, "On Teaching Students to Act Like a Lawyer: What Sot of Lawyer"? *International Journal of Clinical Legal Education 21*
[121] Mutaz M. Qafisheh, "The Role of Legal Clinics in Leading Legal Education: A Model From The Middle East", Fq 193

studentët të vëzhgojnë anatonominë e trupit të viktimës si dhe vizita në Akademinë e Policisë për të vëzhguar mënyrën e një investigimi të imituar.[122]

- Një tjetër projekt në ndihmë të studentëve nga Klinika e ligjit në Univërsitëtin e Herbon është edhe ai i gjyqeve imituese, ku studentët vendosen në rolin e gjyqtarit avokatit, prokurorit, paditësit dhe të pandehurit. Pesë studentët të cilët dalin më mirë në gjyqin imitues marin pjesë dhe në kompeticionin kombëtarë të organizuar ndërmjet katër universiteteve të Palestinës.[123] Studentët më të mirë të këtij kompëticioni nominohen për të marë pjesë në kompeticione ndëkombëtare.[124]

- Me objektivin për të përmirësuar aftësitë ndërkombëtare ligjore të studentëve të drejtësisë, Klinika organizon kurse trajnimi për çështje të selektuara të së drejtës ndërkombëtare. Një ndër kurset e trajnimit që ka organizuar Klinika është edhe ajo e "Ligjit Humanitarë dhe Mekanizmat e Kombeve të Bashkuara në të Drejtat e Njeriut". Kursi i trajnimit u realizua në dy faza. Faza e parë ishte një fazë e hapur për të gjithë publikun, kurse faza e dytë ishte e hapur vetëm për studentët e drejtësisë e fokusuar në teknikat e raportimit dhe dokumentimit të shkeljeve të të drejatve të njeriut.[125]

- Klinikat Ligjore kanë bërë të qartë lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet akademisë dhe profesionit të praktikuar, dhe ato mund të konsolidojnë vendin e tyre brenda Fakultetit të Drejtësisë nëpërmjet zhvillimit të aleancave me profesionistë efektivë.[126]

Klinika angazhohet me profesioniste ligjore dhe ofron seminare me interes për avokatët, gjyqtarët, prokurorët, këshilltarët ligjorë dhe aktivistët e të drejtave. Klinika përpiqet që të trajtojë në seminare tema të vështira ligjore në të cilat shumë pak juristë kanë dije dhe aftësitë e nevojshme.[127]

- Klinika e ligjit në Universitetin e Heborn ka të përfshirë në projektin e saj edhe organizimin e konferencave akademike. Projekt të cilin ajo e ka realizuar nëpërmjet organizimit të dy konferencave gjatë vitit akademik 2011-2012. Konferenca e parë kishte të bëntë me reformën e ligjit modern të familjes dhe konferenca e dytë ishte konferenca ndërkombëtare për anëtarësimin e Palestinës në Kombet e Bashkuara.[128]

[122] Po aty
[123] Moot Court Competition in Hebron University, *Monthly Newsletter*, Public Relations Department, Hebron University, 11 April 2012
[124] Abdyl Haseeb Ansari, "Clinical Legal Education: Benefitting From the Banaras Experience" (2011)
[125] Mutaz M. Qafisheh, "The Role of Legal Clinics in Leading Legal Education: A Model From The Middle East", fq 194
[126] Jeff Giddings, "Contemplating the Future of Clinical Legal Education", fq 14
[127] Mutaz M. Qafisheh, "The Role of Legal Clinics in Leading Legal Education: A Model From The Middle East", fq 194
[128] Po aty, fq 195

Ideja e edukimit klinik ligjore nuk është e re. Fakulteti i Drejtësisë në Chicago ka klinikën ligjore më të vjetër, e cila është krijuar që në vitin 1910.[129] Por klinikat ligjore ashtu siç njihen dhe ekzistojnë sot filluan në të vërtet në SHBA në vitin 1960.[130] Në vitin 1973 nga 147 Fakultete të Drejtësisë në SHBA, 125 raportohej të kishin Klinikën Ligjore.[131]

Studentët në bazë të programit të Klinikës në Universitetin e Drejtësisë në Kolumbi, nën mbikëqyrjen e pedagogve-avokatë[132], ofrojnë ndihmë ligjore falas në shumë fusha të drejtësisë. Studentët të cilët bëhen pjesë e Klinikës janë studentët me kohë të plotë të vitit të dytë dhe të tretë si dhe studentët me kohë të pjeshëm që ndjekin Fakultetin e Drejtësisë në vitë të tretë dhe të katërt.[133]

Ndihma ligjore falas ofrohet për komunitetin e gjere të cilët nuk kanë ose kanë pak[134] mundësi ekonomike për të siguruar vetë mbrojtjen ligjore. Ndihma ligjore falas ofrohet nga studentët e Klinikës edhe për organizata jo fitimprurëse dhe për bizneset e vogla të cilat nuk kanë mundësi ekonomike të paguajnë për shërbime ligjore. Studentët dëgjojnë çështjen, përpilojnë ndihmën ligjore falas dhe i edukojnë klientët me përgjegjegjësitë e tyre si drejtues të biznesit dhe organizatave jofitimprurëse.[135]

Puna e studentëve në Klinikën Ligjore në Kolumbi nuk përfundon me dhënien e opinionit ligjor ndaj klientit të tyre. Studentët vendosen në rolin e një avokati të vërtet dhe e mbrojnë klientin e tyre edhe përpara Gjykatës Federale të Kolumbisë, madje, qoftë për çështje civile apo penale, studentët i mbrojnë interesat dhe të drejtat e klientëve të vet edhe në Gjykatën Supreme të Kolumbisë.[136]

Qëllimi i programit të Klinikës në Universitetin e Drejtësisë në Kolumbi është nga njëra anë ofrimi i ndihmës ligjore falas nga studentët dhe nga ana tjetër edhe përgatitja e studentëve për tu bërë avokatë bindës, reflektivë dhe të përgjegjshëm.

Duke punuar nën mbikëqyrjen e supervizorve studentët fitojnë aftësi kritikuese në komunikim, mbledhje informacioni, bindje, në analizat ligjore dhe fakultative të cilat i përgatisin studenëtë për të adresuar çështjet e klientëve të tyre në shumë aspekte.[137]

Pjesmarrja në Klinikën Ligjore bën që studentë më qëllime të ndryshme të fitojnë aftësi të vërteta dhe të kenë perspektiva kritikuese për mënyrën se si ligji duhet të zbatohet përpara se të nisin karrierën e tyre ligjore. Eksperienca në Klinikën e ligjit jo vetëm që i bën studentët që të kuptojnë më mirë dhe më saktë ligjin por edhe u krijon studentëve më shumë avantazhe në punësim në krahasim me kolegët e tyre që kanë mungesë

[129] J. Rahl & K. Schwerin, "Northwestern School of Law - A Short History", fq 28
[130] Richard Lewis, " Clinical Legal Education Revisited", fq 16
[131] M. Zander, "Clinical Legal Education", fq 181
[132] http://www.law.udc.edu/?page=ClinicIntro

[133] Po aty
[134] Mesirow & Stravitz, PLLC, Legal Clinics in the DC Metro Area
[135] www.web.law.columbia.edu
[136] Mesirow & Stravitz, PLLC, "Legal Clinics in the DC Metro Area "
[137] www.web.law.columbia.edu

experience.[138] Si rrjedhojë studentët e Klinikës janë të vetmit student vërtet të përgatitur për tregun e punës menjëherë pas diplomimit.[139]

Puna e studentit në Klinikën e Kolumbisë përfshin shumë fusha të së drejtës. Përmendim këtu:

- Klinika e zhvillimit komunitarë;
- Klinika Ligjore e HIV/AIDS;
- Klinika Ligjore e konsumatorve;
- Klinika Ligjore e të drejtave të njeriut dhe emigracionit;
- Klinika legjislative
- Klinika Ligjore e taksapaguesve;
- Klinika për përgjegjësinë qeveritare;
- Klinika e ligjit për të miturit dhe arsimin special.[140]

Klinika e ligjit e Fakultetit të Kolumbisë u ofron studentëve mundësinë e trajnimeve jashtë Klinikës. Praktika u lejon studentëve që të punojnë bashkë me avokatët në çështje të interesit publik, agjencitë qeveritare ose në gjykatat federale. Studentët të cilët marin pjes në këtë trajnim kanë mundësinë e rralle që të shpenzojnë një semsetër të tërë në Ëashington D.C, duke punuar në agjencitë federale siç janë Departamenti i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore, Departamenti i Edukimit, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti i Drejtësisë.[141]

Në programin e Klinikës së Ligjit në Kolumbi përfshihet edhe gjykata imituese. Gjykatat imituese simulojnë të gjitha aspektet e një gjykimi. Studentët bëjnë kërkime, përpilojnë opinionet dhe argumentojnë çështjet e tyre përpara një trupi gjykues. Pjesëmarrja në gjyqe imituese u mundëson studentëve përmirësimin e aftësive të tyre orale. Studentët më të mirë marin pjesë në kompeticione prestigjoze ndërkombëtarë të gjyqeve imituese.

Klinika e ligjit në Kolumbi ka revistat e veta. Ekzistojne rreth 14 revista të Klinikës në të cilat studentët publikojnë shkrime, shumica prej këtyre shkrimeve i përkasin fushave të së drejtës të cilat janë në programin e Klinikës.[142]

Studentët të cilët dëshirojne që të marin sa më shumë kredite në praktiken ligjore kanë mundësi që të bëhen pjesë e trajnimeve të Klinikës. Këto trajnime janë gjatë periudhës së vjeshtës dhe studentët përfitojnë katër kredite duke realizuar 180 ore dhe përkatësisht 14

[138] http://www.law.udc.edu/?page=ClinicIntro
[139] www.web.law.columbia.edu
[140] Mesiroë & Stravitz, PLLC, "Legal Clinics in the DC Metro Area "
[141] www.web.law.columbia.edu
[142] Po aty

orë në javë në zonën ku janë vendosur, ndërsa studentët që përfshihen në trajnimet verore përfitojnë 4-8 kredite duke tealizuar 270 dhe përkatësisht 30 orë në javë në zonën ku janë vendosur. Gjatë periudhës së verës vetëm një ose dy programe të Klinikës janë të hapura për studentët, ndërkohë që gjatë periudhës së vjeshtës janë të hapura të tetë programet e Klinikës dhe studentët kanë mundësi zgjedhje.[143]

Programet trajnuese i krijojnë studentëve mundësinë të:

- Zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre ligjore;

- Përmirësim në zgjidhjen e problemeve dhe aftësive menaxhuese profesionale;

- Përfshirja në mendime kritikuese rreth profesionit dhe rolin e tyre si praktikues;

- Zbulojnë zona të karrierës që kanë një interest të veçant dhe;

- Zhvillojnë një model profesioni të jetes së tyre.[144]

Klinika e ligjit në Harvard është hapur për herë të parë në vitin 1979 ku fillimisht ajo është quajtur Institiuti i Shërbimeve Ligjore. Ky institutë u hap me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore falas për familjet në nevojë. Ndihma ligjore falas jepej nga studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Harvard. Puna e tyre mbikëqyrej nga pedagogët e Institutit të cilët janë ekspert në praktikë dhe puna e studentëve vlerësohej individualisht. Nga viti 1983-1985 Instituti mori emrin Qëndra e Shërbimeve Ligjore.[145]

Misioni i Qëndrës së Shërbimeve Ligjore është edukimi i studentëve me aftësi profesionale dhe praktike si edhe ofrimi i shërbimeve ligjore falas ndaj komunitetit. Statistikat tregojnë se rreth 1200 persona në vitë marin ndihmë ligjore nga Qëndra.

Qëllimet kryesore të qëndrës së shërbimeve ligjore janë:[146]

- të ofrojë ndihmë ligjore falas për zonat komunitare më në nevojë;

- të jetë një ndikim pozitiv për komunitetin;

- t'u ofrojë banorve të komunitetit mundësi për tu njohur me sistemet ligjore që ndikojnë në jetën e tyre dhe mundësinë sesi ata ti përdorin në favor të tyre;

- për të edukuar dhe informuar gjykatën në lidhje me jetën dhe të drejtat ligjore të klientëve të qëndrës.

Puna e studentit në Klinikën e ligjit fokusohet në shumë fusha të së drejtës, ku mund të përmëndim:[147]

[143] http://www.law.udc.edu/?page=ClinicIntro
[144] http://www.law.udc.edu/?page=ClinicIntroi
[145] http://www.legalservicescenter.org/
[146] http://www.legalservicescenter.org/about-the-legal-services-center/mission/
[147] http://law.harvard.edu/academics/clinical/clinics/inhouse.html

- Klinika e ligjit në të drejtën penale;

- Klinika e ligjit për familjen dhe dhunën në familje;

- Klinika e ligjit mbi shëndetin;

- Klinika e ligjit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

- Klinika e ligjit për mbrojtjen e refugjatëve.

Gjatë ekpseriencës dhe punës së tyre në Klinikë studentët përfitojnë aftësi në:[148]

- intervistimin dhe këshillimin e klientëve;

- përfaqësimin e klientëve në gjykatë;

- kërkime dhe shkrimin e dokumentave ligjore;

- investigimin dhe analizimin e fakteve;

- zhvillimin e aftësive negocuese dhe;

- bashkëpunimin me studentë të tjerë dhe avokatë.

Pra, siç e pamë edhe më lart puna e studentit në Klinikën e Harvardit nuk fokusohet vetëm në dhënien e opinionit ligjor por edhe në mbrojtjen dhe përfaqëimin e tyre në gjykatë duke u vendosur kështu në rolin e avokatit të specializuar. Pra, puna në Klinikën e ligjit e rrit studentin profesionalisht dhe e bën atë të aftë për rrugën e tij profesionale menjëherë pas diplomimit.

Klinika e Harvardit ka të përfshirë edhe programin për trajnime verore për studentët e interesuar për praktikë. Praktikantët e verës angazhohen për të punuar 35-40 orë në javë. Praktika e ofruar nga Klinika gjatë verës është pa pagesë. Ky program mbikëqyret nga instruktorët më të mirë të Klinikës të cilët dallohen për aftësitë e tyre si pedagogë dhe si praktikantë.[149]

Në programin e vet Klinika e Harvardit përfshin edhe pjesëmarrjen e studentëve në gjyqet imituese.[150] Studentët në gjyqet imituese aftësohen në shkrimet dhe oralitetin e tyre para një trupi gjykues duke u vendosur në rolin e avokatit dhe prokurorit.

Qëndra e edukimit klinik ligjor ndodhet në Universitetin e Drejtësisë Palacky, fokusimi i së cilës është ligji në veprim. Klinika e ligjit në Universitetin e Palacky u hap në vitin 1996 dhe ky ishte universiteti i parë në Europën Qëndrore që përfshiu në programin e tij klinikën ligjore dhe ende është i vetmi në Republikën Çeke studentët e të cilit mësojnë në një gamë të gjerë bazat e edukimit klinik.[151]

[148] http://law.harvard.edu/academics/clinical/clinics/index.html
[149] http://www.legalservicescenter.org/students-clinics/summer-fellows-program/
[150] http://www3.law.harvard.edu/orgs/mootcourt/
[151] http://www.Centre_for_Clinical_Legal_Education_(Palack%C3%BD_University,_Faculty_of_Laë)

Klinika e ligjit në republikën çeke ka një program mjaftë të gjerë të fushave të së drejtës në të cilën studentët e saj ofrojnë ndihmë ligjore falas ndaj komunitetit në nevojë. Fushat e së drejtës[152] në të cilat ofrohet ndihmë ligjore janë:

- Klinika e të drejtave të njeriut;
- Klinika Ligjore kundër diskriminimit;
- Klinika Ligjore e refugjatëve;
- Klinika Ligjore në fushën administrative;
- Klinika Ligjore për mbrojtjen e mjedisit;
- Klinika ndërkombëtare e arbitrazhit;
- Klinika Ligjore për sigurimet shoqërore;
- Klinika Ligjore për të drejtën e komunikimeve elektronike;
- Klinika Ligjore për bizneset e vogla.

Në programin e Klinikës Ligjore në Çeki parashikohet pjesëmarrja e studentëve në gjyqe imituese. Gjyqet imituese në Çeki janë të ndara në tre grupe dhe çdo grup ka në krye një tutor i cili përgatit studentët. Në grupin e parë të gjyqit simulues trajnohen studentët e vitit të 3, 4 dhe 5. Në gjyqin simulues të grupit të dytë futen studentët e vitit të 4 dhe 5 dhe në gjyqin simulues të grupit të tretë futen vetëm studentët e vitit të 5. Gjyqi imitues i përgatit studentët në aftësinë e tyre për të shkruajtur dhe paraqitjen e tyre para një trupi gjykues. Studentët duhet të përgatisin një shkrim me rreth 40-50 faqe ndërsa pjesa me gojë qëndron në paraqitjen e studentëve në gjyqet simuluese para një trupi gjykues në të cilën ata vendosen në rolin e avokatit dhe prokurorit dhe mbrojnë çështjen në favor të klientit të tyre.[153]

Studentët më të mirë në gjyqet simuluese kombëtare marin pjesë në kompeticionet ndërkombëtare të gjyqeve simuluese me studentë konkurrente të fakulteteve të drejtësisë në botë. Studentët e Çekisë kanë marë pjesë tre herë në të tilla kompeticione ndërkombëtare.[154]

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë trajtuar si vendi i parë ku lindi dhe u zhvillua klinika. Natyrisht, duke qënë udhërrëfyes për shtetet e tjera dhe për shkak të përvojës shumë-vjeçare modelet që ofron sistemi arsimor amerikan ia vlejnë të studiohen për shumë arsye. Ato janë programe ku klinika aplikohet më gjerësisht se në çdo shtet tjetër. Gjithashtu ajo aty apikohet në shumë të degë të së drejtës të cilat variojnë nga një universitet në tjetrit. Klinika në SH. B. A ofron ndihmë aktive dhe të vazhdueshme për zgjidhjen e çështjeve që shqetësojnë komunitetin. Madje më lart janë përmendur disa

[152] Po aty
[153] http://law-in-english.upol.cz/moot-courts-1-2-3/
[154] http://www.mzv.cz/hongkong/en/archive_of_news_and_events/czech_team_at_the_international_student.htm

çështje të rëndësishme të cilat janë përfaqësuar dhe kanë gjetur zgjidhje pikërisht për shkak të klinikës. [155]

Franca është zgjedhur si një vend tipik i sistemit civil- laë nga i cili ne kemi huazuar një pjesë të madhe të legjislacionit tonë. Pikërisht për shkak të kësaj dhe faktit që ne jemi pjesë e sistemit civil-laë por edhe afërsisë gjeografike si edhe ndikimit të madh prej Francës, ajo është trajtuar në kuadër të programit të klinikave të ligjit që ofron.

Italia është gjithashtu një vend i sistemit civil law me të cilën kemi lidhje të afërta gjeografike. Italia, ashtu si Franca ka shërbyer dhe ka dhënë një ndikim të madh në hartimin e legjislacionit shqiptar. Për këtë arsye edhe Italia është përfshirë në trajtimin e klinikës ligjore.

Polonia është vendi i parë në Europën Lindore e cila ka implementuar në një masë të konsiderueshme klinikën e ligjit si pjesë të sistemit të saj akademik. Madje në këtë vend programet e klinikës mbështeten edhe nga qeveria dhe po i kushtohet një rëndësi e madhe për zhvillimin e sistemit arsimor polak. Polonia ka një projekt bashkëpunimi mjaft efikas dhe të frytshëm me vendin tonë. Madje ajo ka organizuar projekte trajnimi për klinikën e ligjit ku kanë qënë të ftuar edhe pedagogët shqiptarë të klinikës së ligjit. Për këtë arsye, edhe klinika e ligjit në Poloni ka qënë objekt trajtimi i këtij punimi.

Megjithatë në këtë punim po trajtojmë në fromë grafike rajonet në botë ku klinika e ligjit aplikohet më shumë dhe zë vend të pandarë në sistemin akademik universitar. Më poshtë janë përfshirë në studim vende si; Amerika, Europa Perëndimore, Europa Lindore dhe Europa Jug-Lindore apo rajoni i Ballkanit ku bën pjesë edhe vendi ynë, në lidhje me



Fig. 3

[155] Legal clinic, Serving people improving justice – Open society justice Initiative, Hungari 2009, fq 5;

klinikën e ligjit. Ky trajtim i referohet klinikës së zbatueshme në aspektin sasior, pra se sa universitete e përfshijnë klinikën si pjesë të programit akademik, por edhe cilësor, pra cilësia edhe efektiviteti që ka klinika në këto vende jo vetëm për studentët por edhe për komunitetin.

Siç vërehet edhe nga grafiku, Shtetet e Bashkuara janë vendi lider për klinikën e ligjit si program akademik. Kujtojmë këtu se klinika ka lindur për herë të parë në SH. B. A dhe ky vend lider në lidhje me klinikën jo vetëm në apsketin sasior por edhe atë cilësor. Këtu klinika jep një ndihmë të madhe jo vetëm për studentët por edhe për anëtarët e komunitetit duke i ardhur atyre në ndihmë në lidhje me çështje të ndryshme ligjore. Klinika e ligjit është pjesë e programit shkollor në çdo univeristet të Sh. B. A dhe nuk mund të konceptohet studimi i së drejtës nga studentët pa u përfshirë në klinikën e ligjit dhe pa dhënë kontributin e tyre për një sërë çështjesh ligjore në degë të ndrsyhme të së drejtës.

Europa Perëndimore është një rajon ku klinika po gjen zhvillim të madh. Këtu përmednim edhe Britaninë e Madhe e cila ka pasur ndikim nga SH. B. A edhe për shkak të përkatësisë së tyre në sistemin ligjot të Common – laë. Klinika e ligjit është e përhapur edhe në shumë shtete të tjera të Europës Perëndimore, edhe pse nuk janë përmendur në punim. Përmendim këtu Gjermaninë, Hollandën, Danimarkën, Belgjikën, Zvicrën etj.

Në lidhje me Europën Lindore u përmend më lart se këtu një progres të madh në këtë drejtim ka bërë Polonia me zhvillim të konsiderueshëm të kliniës së ligjit.

Në lidhje me rajonin e Ballkanit, ku bën pjesë edhe Shqipëria, progresi është më i ngadaltë megjithëse mund të themi se jemi në hapa të sigurt rreth implementimit dhe konsolidimit të saj si pjesë të sistemit akademik shqiptar. Në vende fqinje si Maqedonia, Greqia, Kosova etj githashtu nuk hasim një progres të madh, por edhe këtu mund të flasim për një angazhim të këtyre vendeve rreth njohjes dhe përfshirjes së klinikës si pjesë të sistemit të tyre arsimor. Edhe në Ballkan klinika po njihet, po vlerësohet dhe po përfshihet në programet akademike në fushën e të drejtës, për të përfituar edhe ne nga eksperiencat dhe avantazhet e saj.

Kapitulli VI

Modelet e klinikës së ligjit

Përmbajtja : 6. 1 Ku aplikohet klinika?; 6. 2 Kush mund të jetë një klient klinike?; 6. 3 Format e ndihmës ligjore të ofruara nga klinika;; 6. 4 Klinika për të miturit; 6. 6 Klinika për organizatat jo-fitimprurëse; 6. 7 Klinika për të drejtën e mjedisit; 6. 8 Klinika per të drejtat e njeriut; 6. 9 Klinika e ligjit për çështjet penale; 6. 10 Klinika për të drejtën civile; 6. 11 Klinika e ligjit për të drejtën migratore.

6. 1 Ku aplikohet klinika?

Klinika synon praktikën e ligjit dhe ofrimin e ndihmës ligjore falas në komunitet. Si e tillë, ajo mund të aplikohet në çdo fushë të së drejtës. Kjo, pasi secila fushë ka nevojë që studentët të provojnë në praktikë atë që realisht mësojnë në teori, por gjithashtu edhe anëtarët e komunitetit kanë nevojë për këshillim apo ndihmë ligjore falas në çdo fushë të së drejtës. Problemet ligjore që lindin janë nga më të ndryshmet, në çdo fushë të së drejtës, prandaj gjithmonë ka vend për ndihmën e klinikës. Prandaj, klinika si disiplinë do të gjejë vend në çdo fushë të së drejtës. Megjithatë, normalish janë disa fusha që konsiderohen si më tipiket ku klinika mund të gjejë zbatim, bazuar edhe në praktikën e programeve të klinikës të implementuara në fakultetet e ndryshme të drejtësisë. Megjithatë, më poshtë do të trajtohen fushat më të spikatura ku mund të aplikohet klinika, kjo e parë edhe në dritën e përvojës shqiptare, pra të atyre programeve që do të aplikoheshin më së miri në Fakultetin tonë të Drejtësisë.

6. 2 Kush mund të jetë një klient klinike?

Kontakti i parë me një person në kërkim për ndihmë juridike me një klinikë ligjore, duke pasur parasysh rregullat e një klinike, është e rezervimi që ai i bën çështjes në zyrën e sekretarit ose të kontaktit me studentët. Ata marrin përsipër shqyrtimin paraprak të një rasti dhe të kërkojnë informacionin e nevojshëm që do të jetë i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes.

Të gjitha të dhënat të cilat do të shërbejnë për zgjidhjen e çështjes do t'i nënshtrohen procedurave të tjera në klinikë. Në këtë rast supozohet që çdo person që aplikon për ndihmë ligjore, plotëson kërkesat e specifikuara që rrjedhin më poshtë, domethënë : është i varfër, nuk është duke përdorur shërbimet e një avokati ose një këshilltari ligjor dhe që plotëson kushte të tjera të specifikuara në çdo program klinike. Në fakt përmbushja e këtyre kritereve është kusht paraprak dhe thelbësor që ky individ të përfitojë nga ndihma e klinikës dhe të përfshihet në të. Më poshtë po përmendim disa kushte të domosdoshme për të fituar cilësinë e një klienti të klinikës ligjore : [156]

- **Mungesa e mjeteve monetare**

Në aplikimin e mbuluar për këshillim ligjor të interesuarit duhet të deklarojnë që janë të varfër. Gjendja financiare e aplikantit është një kërkesë e rëndësishme për të justifikuar ofrimin e ndihmës ligjore falas. Në kuadrin e programit mësimor të studimeve duke dhënë këshillim ligjor për të varfërit synohet të ofrohet një shërbim i vlefshëm për komunitetin, por në mnëyrë që kjo ndihmë të përfitohet duhet që inidividët të bëjnë pjesë në këtë kategori. Para ofrimit të ndihmës juridike duhet verifikuar që personi ose personat që kanë plotësuar aplikimin për ndihmën juridike, vërtetë nuk mund të përballojë financiarisht shërbimet e një këshilltari ligjor ose një avokati. Verifikimi i kushteve të tilla duhet bërë që në fillimin e bisedës, ose më vonë në kohën e pranimit të çështjes për shqyrtim nga klinika apo kohën e ndarjes së çështjes për studentët. Klienti është i detyruar të nënshkruajë një deklaratë me efektin e mësipërm, pra ku ai deklaron se nuk është duke marrë një këshillim ligjor nga një avokat dhe gjithashtu se nuk ka mundësi të përballojë një të tillë.

Vetëm në raste të veçanta, për shembull në qoftë se pamja e personit ose makina, apo element të tjerë tregojnë se ai nuk bën pjesë në këtë kategori, klientit mund t'i kërkohet të japë konfirmim me shkrim për pagën dhe të ardhura të tjera që mund të marrë, informacion mbi pensionin e invaliditetit apo pensionin nëse ka mbushur moshën, ose një certifikatë nga agjencia e punësimit, duke theksuar se një dokumentacion i tillë shërben qëllimit për të kualifikuar ata subjekte që vërtet kanë nevojë për përfitimin e ndihmës juridike falas. Vlen të theksohet se të gjitha provat që kërkohen, i shërbejnë qëllimit final, pra kategorizimit të subjektit si kategori në nevojë dhe për rrjedhojë përfitimin e ndihmës ligjore falas të ofruar nga programi i klinikës.

Gjithashtu mund të ndodhë që personi që aplikon për shërbimet e klinikës nuk i plotëson kërkesat e përfitimit dhe të përpiqet për të fshehur këtë fakt. Një sjellje e tillë duhet të konsiderohet e pandershm në klinikë, dhe duhet të rezultojë në refuzimin e kërkesës për dhënien e ndihmës ligjore. Zbulimi i faktit se klienti ka mashtruar në të dhënat e deklaruara në klinikë mund të shërbejë si arsye për të mohuar ofrimin e kësaj ndihme në të ardhmen.

[156] The legal clinic- The idea, organization, methodology – botim i The legal clinic Foundation, Warsaw 2005, fq 48

Çështja e statusit financiar të klientit është shumë e komplikuar dhe delikate. Elementë të tilla si veshje ose makina e zotëruar prej tij, jo gjithmonë japin dëshmi të pasurisë së një njeriu. Disa prej këtyre mallrave mund të ketë qenë blerë në të kaluarën, dhe disa prej pasurive të paluajtshme për shembull, jo gjithmonë gjenerojnë të ardhura. Prandaj një person i cili zotëron një apartament me një vlerë të madhe la mun dësi që edhe nuk mund të përballojë shërbimet e një përfaqësuesi profesional ligjor. Megjithatë, sigurisht që një nivel i të ardhurave që duhet të shkaktojë refuzimin e shërbimit mund të supozohet. Gjykatat e bazojnë vendimin e tyre për lirimin nga pagesat e tarifave në gjykatë në një deklaratë të paraqitur me kërkesë të klientit për të paraqitur dokumente për të provuar gjendjen financiare të tyre. Megjithatë kjo praktikë, duhet të trajtohet si një përjashtim, jo rregull në klinikën e ligjit. Hetim tepër këmbëngulës në verifikimin e gjendjes financiare të klientit nuk favorizon elementin e besimit, i cili është I domosdoshëm në ofrimin e ndihmës ligjore.

- **Mungesa e përfaqësimit nga një avokat**

Përfaqësimi profesional juridik nuk mund të jetë njëkohësisht i aplikuar në rastin e paraqitur nga kërkuesi që dëshiron të përfitojë shërbimet e klinikës. Pra, një nga kushtet që duhet të plotësohet është që aplikanti të mos jetë duke marrë këshillim ligjor apo të jetë duke u përfaqësuar nga një avokat. Kjo kërkesë është e natyrshme, sepse kjo tregon se ai nuk është në gjendje të paaftësisë, pra ka mundësi të përballojë asistencën juridike të një avokati. Ajo që duhet të mbahet mend është se aktiviteti i klinikës ligjore nuk duhet të jepet në bazën e praktikave të padrejta si nga pikëpamja e ligjit apo e etikës. Prandaj është e arsyeshme për të pyetur jo vetëm në lidhje me përfaqësimi por edhe të ndonjë konsultim paraprak të rastit me një avokat ose persona të tjerë ose institucionet të cilat mund t'i kenë ofruar klientit asistencë ligjore. Një deklaratë e tillë do të përmbushë si kërkesën që subjekti të jetë klinet i klinikës por edhe çështjen e besimit klinikë – klient. Në rast se konstatohet se një konsultim i tillë ka ndodhur, përpjekje duhet të bëhen për të kontaktuar një person të tillë, i cili mund të ndihmojë duke treguar për rastin në fjalë si edhe duke shpjeguar karakterin e klinikës. Qëllimi i kontakteve të tilla duhet të jetë për të marrë mendimin e avokatit të konsultimit në lidhje me çështjen dhe ndihmën ligjore të ofruar nga klinika. Rastet në të cilat përfaqësimi ligjor ka qenë i pranishëm nuk duhet të pranohen për shqyrtim nga klinika. Një situatë e tillë është e mundur kur gjatë shqyrtimit të rastit nga klinika, klientit i është caktuar një avokat për shkak të detyrës zyrtare, ose klienti vetë kërkon përfaqësim ligjor. Në një situatë të tillë ndihma juridike falas duhet të refuzohet menjëherë. Nëse kohën kur kjo konstatohet, çështja është në shqyrtim nga klinika, përfaqësimi i saj duhet të ndërpritet pa vonesë.

Është thelbësore që klienti të informohet rregullisht për arsyen e lidhur me mospranimin e rastit të tij apo përfundimin e ofrimit të ndihmës nga ana e klinikës. Kur ndihma ligjore e ofruar nga klinika konsiston në hartimin e kërkesës për të caktuar sipas detyrës zyrtare përfaqësim ligjor, ndihma klinike do të konsiderohet një ndihmë e kompletuar me pranimin e ndihmës profesionale juridike të një avokati ose një këshilltari ligjor nga ana e klientit. Në qoftë se, sipas detyrës zyrtare përfaqësimi nuk mund të ofrohet, përveç nëse

ndihma e një avokati është e detyrueshme, klinika e ligjit mund të vazhdojë të kryejë rastin.

Një tjetër shembull i një situate ku klinika mund të vazhdojë për të përfaqsuar një rast edhe pse një avokat ose një këshilltar ligjor ishte i përfshirë tashmë në të, është kur ndihma juridike profesionale është ndërprerë, për shembull është revokuar përfaqësimi ligjor, dhe klienti nuk është më në kushtet e marrjes së ndihmës në momentin e marrjes përsipër të përfaqësimit ligjor nga ana e klinikës.

6. 3 Format e ndihmës ligjore të ofruara nga klinika

Një shumëllojshmëri e formave të ndihmës juridike të dhënë nga klinikat ligjore varet në një masë të madhe nga faza e zhvillimit të klinikës. Klinikat më të vjetra, ato që i kanë kosoliduar arritjet, për shembull klinikat në universitetet amerikane, ofrojnë spektër më të madh të shërbimeve. Këto klinika nuk e kufizojnë veten për dhënien e opinioneve ligjore me shkrim, ata gjithashtu përfaqësojnë klientët e tyre, për shembull, përpara organeve të administratës publike. Një zgjerim i fushës së veprimtarisë së një klinikë duhet të shkojë paralelisht me përsosjen e organizative dhe strukturat me përvojë të klinikës por edhe me garantimin dhe mbikëqyrjen e duhur të stafit të fakultetit ose avokatëve në kuadër të ushtrimit të profesionit ligjor. [157]

6. 3. 1 Këshillimi ligjor

Forma themelore e aktivitetit të klinikës ligjore është dhënia e këshillave juridike me shkrim nga studentët e ligjit nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të profesorëve të tyre. Një opinion ligjor është përgjigje me shkrim për pyetje të dorëzuara në klinikë nga klienti dhe duke iu referuar të drejtave ose detyrimeve të klientit, sipas rregullimeve të caktuara ligjore. Një opinion përbëhet nga pjesë, të cilat e bëjnë atë transparente për lexuesit. Për shembull, një mendim mund të jetë i përbërë nga elementët e mëposhtëm : [158]

- Përshkrimi i fakteve të çështjes,
- Citimi i pyetjeve të klientit,
- Përshkrimi i çështjes ligjore,
- Konkluzionet

Një opinion mund të fillojë me pyetjet e paraqitura nga klienti, duke i paraprirë përshkrimit të fakteve të çështjes. Një model i tillë megjithatë do të përfshijë kontrollin e ndergjegjesimit të mendimit të studentit dhe do të lejojë vazhdimësi logjike duke qënë se klienti gjithmonë do të fillojë me përshkrimin e fakteve të çështjes dhe vetëm pastaj do të bëjë pyetje për të drejtat dhe detyrimet e tij.

Rëndësia e mendimit të klientit është një element i rëndësishëm për zhvilimin e mendimit juridik. Klienti mund të përdori arsyetimin e përdorur në opinionin e tij në paraqitjen e

[157] The legal clinic- The idea, organization, methodology – botim i The legal clinic Foundation, Warsaw 2005, fq 126
[158] Legal clinic, Serving people improving justice – Open society justice Initiative, Hungari 2009, fq 9

pretendimeve para gjykatës apo një organi të administratës publike, si dhe në marrëdhënie me subjektet privatë.

6. 3. 2 Paditë

Forma tjetër e ofrimit të ndihmës ligjore nga klinikat ligjore është hartimi i parashtresave në bazë të fakteve të çështjes të ofruara nga klienti dhe dokumentet shoqëruese. Shumë shpesh kjo formë e ndihmës juridike është një plotësues ose shtojcë të mendimit ligjor me shkrim të cilat çojnë drejt pranimit të të drejtave specifike të klientit, duke rezultuar në nevojën për të kërkuar ose të mbrojtur të drejtat e klientit në gjykatë në çështje qoftë penale ose civile, ose në procedurën jashtë gjykatës. Prandaj, studentët e klinikave ligjore hartojnë padi, përgjigjen për këto padi, kundërshtime në lidhje me urdhërpagesat apo dënimet. Shpesh ata hartojnë kërkesë për caktimin e mbrojtjes ligjore *ex-officio* ose për të kërkuar caktimin e kujdestarit të trashëgimisë.

Para hartimit të një padie studentët duhet të njihen me rregullat e sigurimit të kërkesave ligjore që rregullojnë padinë dhe rregullat e formulimit të tyre. Argumentimi i përdorur në këto padi duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, dhe argumentet e përfshira duhet të jenë të hartuar në mënyrë të saktë. Argumentet më të forta duhet të paraqiten më parë, të ndjekura nga argumentet me më pak rëndësi. Në vijim mund të themi se kontakti dhe bashkëpunimi me mbikëqyrësit që ushtrojnë profesionin ligjor është esencial këtu, pasi ata mund të shpjegojnë standardet e hartimit të padive dhe të ndihmojnë në përzgjedhjen e taktikave të duhura gjyqësore

Fjalori ka nevojë edhe për zgjedhjen e fjalëve në mënyrë të kujdesshme. Studenti nuk duhet të kufizohet aq shumë sa gjatë hartimit të një opinion ligjor, megjithtë ata mund të përdorin një fjalor të shfrenuar të terminologjisë juridike.

Paditë e hartuara duhet të jenë të plotësuara me kërkesat proceduriale për t'u dërguar në gjykatë. Gjithashtu duhet të tregohen të gjitha veprimet që do të ndërmerren, hapat proceduralë dhe pasojat që do të vijnë pasi ajo është dorëzuar në gjykatë. Shpjegimi duhet të përfshijë tarifat e regjistrimit, shpjegimin e efekteve ligjore të moszbatimit të urdhrave të gjykatës apo letërthirrjeve. Kur dorëzon një padi në emër të një klienti, studenti duhet të sigurojë klientin me shpjegimin e çështjeve të mësipërme. [159]

6. 3. 3 Përfaqësimi i klientit në gjykatë ose organet e administratës publike

Ndonjëherë është praktikuar që studentët të ndihmojnë klientin e tyre duke i shoqëruar ata gjatë vizitave të tyre në gjykatë ose organet e administratës publike. Studentët mund të marrin pjesë në procedurat gjyqësore, si spektatorë, ose persona me besim, ata mund të shoqërojnë dhe ndihmojnë klientin duke e trajuar problemin në këndvështrimin e tyre ose duke lexuar shënimet ose dokumentet gjyqësore. Kjo i lejon studentët që të kontrollojë rrjedhën e çështjeve si dhe për të marrë pjesë në çështjet administrative duke kontaktuar me zyrat e ndryshme të administratës publike, për shembull administrata në bashki, zyra e sigurimeve shoqërore apo zyra e punësimit, me të cilat klienti mund të kenë një

[159] Po aty.

konflikt të caktuar. Duhet të theksohet se veprime të tilla nuk qëndrojnë në kundërshtim me kërkesën që të gjitha procedurat të ekzekutohen me shkrim. Kjo pasi studenti paraprakisht takohet me klientin duke diskutuar atë që nevojitet për gtrajtimin e çështjes administrative dhe vetëm pastaj të bëjë gjithë diskutimin dhe të marrë informacionin e nevojshëm, dhe më pas shoqërohet klienti para organit të administratës. Nga ana tjetër, në qoftë se një student shoqëron një klient gjatë takimit të klientit, për shembull në një zyrë të administratës lokale, ai e bën këtë për të ndihmuar klientin të kuptojë të drejtat dhe detyrimet e tij. Kjo nuk është këshillë që i referohet zgjidhjes së problemit ligjor, por ka të bëjë me shpjegimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve, apo rrugët e mundshme të zgjidhjes, si edhe pasojat apo problemet që mund të vijnë nga zbatimi i ligjit.

6. 3. 4 Ndihma të tjera

Klinikat ligjore mund të ofrojnë edhe forma të tjera të ndihmës ligjore, më shumë se analiza ligjore të një çështje. Për shembull zyra e klinikës mund të ofrojë të dhëna për të pasur kontakt me zyrat e ndryshme që ofrojnë shërbime sociale apo bamirësie, si adresën, numrat e telefonit etj, duke dhënë një ndihmë të konsiderueshme për njerëzit në nevojë.

Gjithashtu mund të jepet informacion apo të krijohet mundësi kontakti me organizatat të cilat japin ndihmë juridike, të shoqatave të viktimave të krimeve etj. Për më tepër, ndihma mund të përbëhet në dorëzimin e padive dhe ankimeve në gjykatë apo organet e administratës publike. Gjithashtu mund të tërhiqen formularë të ndryshëm nga gjykata dhe të plotësohen nga klienti vetë. Kjo asistencë mund të përfshijnë përgjigjies së pyetjeve në lidhje me përmbajtjen e ligjeve, ku në secilin rast studentët mund të këshillojnë klientët e klinikës ose t'i japin informacion se ku ata mund të gjejnë botime sqaruese, si biblioteka, qendra të ndihmës etj.

6. 4 Klinika për të miturit

Sot, gjithmonë e më shumë po i kushtohet rëndësi mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për shkak të rritjes së ndërgjegjies publike për mbrojtjen e tyre dhe forcimit të lobimit global në lidhje me këto të drejta. Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim, mund të japë edhe klinika, duke ofruar ndihmë ligjore falas në një sërë çështjes që prekin fëmijët dhe të drejtat e tyre.

Klinika për të miturit dhe projektet për përfaqësimin e adoleshentëve fokusohet në përfaqësimin e tyre në çështjet e kujdestarisë, përgjegjegjësinë prindërore, stehimin apo probleme të tjera që mund të prekin të miturit. Klientët variojnë nga moshat nga 14-23 vjeç dhe përfaësimi e tyre shtrihet në një spektër çështjesh si strehimi, ndalimi i dhunës në familje, kujdesi shëndetësor për të miturit, arsimimi, trajnimi në punë, kushte të favorizuara të punës për ta, planifikimi financiar, mbështetja ekonomike si edhe të drejtat e të miturve që i përkasin komunitetin LGBT.

Në një kohë kur të dy politikbërësit, si ata lokalë dhe kombëtarë po i kushtojnë një vëmendje gjithmonë e në rritje mbrojtjes të të miturve, studentët e klinikës së të miturve kanë mundësi për të ndihmuar klientët dhe të ndikojnë në politikat dhe praktikat që janë gjithmonë në evoluim. Studentët punojnë në ekipe dhe përfaqësojnë klientët për zgjidhjen

e problemeve të ndryshme juridike. Gjithashtu kjo klinikë bashkëpunon me organizata që kanë në fokus mbrojtjen e të rinjve dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

Për të zgjeruar pikëpamjet e tyre dhe për të përmirësuar aftësitë e procesit të avokatisë, studentët e klinikës ndjekin një seminar javore me studentët e diplomuar nga disiplina të tjera të tilla si mjekësi, edukimi, sociologjia dhe psikologjia. Këto seminare përqëndrohen dhe kanë në fokus të miturin duke e parë atë në këndvështrime të ndryshme.

Studentët gjithashtu të marrin pjesë në një sërë projektesh, politika dhe trajnime, duke përfshirë prezantime të të drejtave të të rinjve, studime kërkimore ndërdisiplinore në përmirësimin e modeleve aktuale të mbrojtjes së adoleshentit, rekomandimet e përfaqësimit, dhe synohet gjithashtu reformimi i ligjit nga politikëbërësit dhe ligjvënësit.

Gjatë aplikimit të kësaj klinike, është e domosdoshme puna me specialistë të fushës. Dihet se në çështjet me të mitur, kërkohet prania e detyrueshme e psikologut si edhe e prindit, apo përfaqësuesit ligjor. Gjatë zbatimit të klinikës, natyrisht që do të kërkohet bashkëpunim me ta por edhe specialistë të fushave të tjera. Këtu do të përmendim bashkëpunimin me mjekë pediatër në rastin kur i mituri ndodhet në kushte të vështira shëndetësore. Gjithashtu mund të nevojitet prania e sociologëve, logopedëve, mësuesve, punonjësve socialë etj.

Me anë të klinikës për të mitur mund të ofrohet ndihma ligjore në një shumëllojshëmri çështjes me të cilat i mituri mund të përballet, por kryesoret janë :

- Akuzat penale ndaj të miturve, procedimi penal i tyre si për krime ashtu edhe për kundravajtje;
- Çështjet e kujdestarisë të të miturit që ndodhet jashtë përgjegjësisë prindërore;
- E drejta për shkollim, strehim apo të drejta të tjera sociale;
- Kujdesi shëndetësor për të miturit;
- Ndërmjetësimi si mënyra kryesore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ku përfshihen të miturit;
- Kontrata e punës e lidhur nga i mituri, mbrojtja e veçantë që ligji i rezervon të miturit në lidhje me kushtet e punës dhe trajnimin e veçantë në punë;
- Informimi i të miturit në lidhje me të drejtat e tij civile, ekonomike apo politike në mnëyrë që ai të jetë i njohur me të drejtat themelore të tij në marrëdhënie të caktuara juridike.

Klinika e ligjit mund të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e të drejtave të të miturve, në informimin e popullsisë në lidhje me to si edhe në ndërmarrjen e politikave të reja aktive në këtë fushë. Gjithashtu ndihma e saj mund të jetë konkretisht duke i dhënë këshillim ligjor të miturve, duke i ndihmuar ata të bëjnë një aplikim apo një kërkesë drejtuar një institucioni të caktuar, duke i përfaqësuar në gjykim sin ë çështjet civile ashtu edhe ato penale etj. Informimi gjithashtu është një ndihmë e rëndësishme që jep klinika në këtë drejtim, ndihmë kjo që mund të

ndihomjë të miturit jo vetëm të njohin por edhe të kërkojnë zbatimin në praktikë të të drejtave të tyre.

6. 5 Klinika e organizatave jo-fitimprurëse

Kjo klinikë ofron ndihmë ligjore falas për ato organizata jo-fitimprurëse që veprojnë në mbrojtje të komunitetit apo të interest public dhe që nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet për ndihmë profesionale juridike. Asistencë ligjore për klinikën e organizatave që punojnë në favor të komunitetit është shpesh e diskutuar dhe e parë me sy kritik në lidhje me suksesin e saj. Studentët në këtë klinikë ofrojnë ndihmë për organizatat jofitimprurëse dhe bizneset e vogla që nuk mund të përballojë për të paguar për shërbimet ligjore duke i ndihmuar ato të kthejnë objektivat e tyre të kthehet në realitet. Çelësi i suksesit qëndron në planifikimin. Studentët punojnë për të kuptuar aspiratat e klientëve, të ndihmojnëata të parashikojnë dhe të zgjidhin problemet, dhe kontribuojnë në edukimin e tyre për përgjegjësitë e tyre si krerë të OJF-ve ose bizneseve.

Studentët gjithashtu kanë si qëllim të ndihmojnë që të ndërmerren reforma të ligjit në drejtim të krijimit të lehtësirave për veprimtarinë e këtyre organizatave. Synohet gjithashtu që të ndihmohen në çështjet e taksave dhe tatimeve, mosmarrëveshjet që kanë me organet e administraës publike etj. Gjithashtu ndihma mund të jepet me anë të përfaqësimit falas në gjyq në çështje të ndryshme ku ata janë palë, ose me anë të kruerjes falas të veprimeve të rregjistrimit pranë Rregjistrit të OJF-ve në gjykatë, një detyrim i parashikuar nga ligji për të gjithë personat juridikë që ushtrojnë veprimtari jo-fitimprurëse në Shqipëri.

Klinika është me interes të veçantë për ata subjekte që janë të interesuar në nxitjen e zhvillimit të komunitetit dhe klinika i ndihmon në arritjen e objektivave të tyre duke bërë për shembull përfaqësimin e klientëve në transaksione.

Disa nga klientët e klinikës janë organizata jo-fitimprurëse të sapo krijuara që kanë nevojë për ndihmë në krijimin e strukurave ligjore sipas përcaktimeve të ligjit. Një ndihmë të tillë mund të jepet nga studentët e klinikës.

Organizatat në fjalë kanë nevojë për ndihmë në çështjet ligjore që dalin nga ndryshime të tilla si zgjerimin, krijimin e një programi kombëtar, apo inicimi i të ardhurave si edhe gjenerimin e aktiviteteve. Shumë nga klientët janë organizata që ndjekin si qëllim ndihmën ndaj komuniteti në nevojë dhe oeprojnë në zona të varfra të vendit duke siguruar ushqim, strehim, dhe trajnim për banorët në nevoje të qytetit. Duke i dhënë ndihmë atyre, klinika jep kontributin e saj në favor të komunitetit dhe indirect ndihmon këto shtresa të varfra të popullsisë.

Studentët e klinikës përgatiten për klientin e tyre në punë duke mësuar të drejtën materiale të rëndësishme për formimin e personave juridikë që veprojnë pa qëllim fitimi si organizatat dhe bizneset e vogla. Ato asistohen me anë të menduarit përmes intervistimit të veçantë, këshillim, dhe trajnim për çështjet etike që lindin në

përfaqësimin e organizatave dhe duke ushtruar aftësitë e avokatisë. Pra, karahas ndihmës që ofrohet, studentët gjithashtu përfitojnë prej klinikës.

6. 6 Klinika për të drejtën e mjedisit

Studentët në klinikën për të drejtën e mjedisit kanë mundësi unike që të angazhohen në praktikën e ligjit dhe të punojnë për çështje lokale, shtetërore, rajonale, dhe globale me të cilat përballet planeti ynë dhe për probleme të ngutshme që ndikojnë në mospërfaqësimin e duhur ligjor të komuniteteve të varfra. E drejta e mjedisit lidhet drejpërdrejt me cilësinë e jetës në komunitet. Sa më aktive të jetë klinika në këtë drejtim, aq më të pakta do të jenë problemet me të cilat përballet komuniteti, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Në fokus të punës së klinikës së ligjit për çështjet e mjedisit janë çështje të tilla si :

- Lufta kundër ngohjes globale;
- Ndalimi dhe ndëshkimi i subjekteve fajtorë për ndotjen e tokës, ujit, ajrit;
- Parandalimi i kompanive të shpimit të gazit natyror apo naftës nga infektimi I ujit të pijshëm;
- Mbrojtja e vendeve të rrezikuara dhe specieve në zhdukje;
- Ndikimi i ndryshimve klimatike në ekonomi, shëndetësi etj;
- Masat mbrojtëse që mund të merren për të zgjidhur problemet e mjedisit;
- Bashkëpunimi me prganizata jo-qeveritare që kanë në fokus mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e një dëmi më të madh.

Të gjitha këto janë çështje në objekt të klinikës për mjedisin, e cila si pasojë e ndryshimeve të sotme, mund të themi se ka një rëndësi vërtet të madhe. Studentët angazhohen të japin kontributin në zgjidhjen e çështjeve të tilla, pasi ato kanë lidhje të menjëhershme në cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e disa të drejtave themelore të njeriut siç është mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të njeriut.

Çështjet e ngritura nga klientët e klinikave si dhe lajmet e shumta nga bota që tregojnë për një degradim të mjedisit kanë bërë që studentëve të klinikës t'u paraqiten për zgjidhje shumë çështje në lidhje me të drejtën e mjedisit. Kemi shumë raste në praktikë të nfitjes së padive ndaj kompanive të mëdha naftë-nxjerrëse apo industrive të tjera me efekt në mjedis të cilat duke mos respektuar procesin biologjik të mjedisit kanë shkaktuar një dëm të madh dhe të pariparueshëm. Një prej rasteve të bujshme ka qënë fitimi i çështjes nga Klinika e ligjit për çështjet e mjedisit në Tulane, Universiteti i Merilendit, Kundër një prej kompanive më të mëdha të vendit, Perdue. Kjo kompani do të paditej nga klinika e ligjit për shkak të impaktit negativ që shkaktonte në mjedis mbetjet me suplementet që pulat e kësaj kompanie, në ushqeheshin cënim të hapur të rregullave në vend. Gjykata e Luizianës vendosi se kjo kompani kishte shkelur detyrimet e saj duke shkaktuar dëm në mjedis dhe i ngarkoi asaj një faturë të lartë dëmshpërblimi për dëmin e shkaktuar. [160]

[160] Kontradiktoriteti, konflikti dhe klinika e ligjit- Adam Babich, botim në Përmbledhjen e klinikës së ligjit të Universitetit të New York, pranverë 2011, fq 472.

Duke punuar në çështje gjyqësore, studentët japin edhe këtu kontributin për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe ndihmojë që të ndërmerren reforma rregullatore dhe impelmentimin e ligjeve të reja për fushën. Studentët e së drejtës kanë testuar aftësitë e tyre në arenën ndërkombëtare, projektet e trajtimit të ofruara nga Kombet e Bashkuara, Banka Botërore dhe një mori të shteteve të ndryshme. Në çështjet e brendshme, studentët e klinikave punojnë për çështje të ndryshme ku janë përfshirë organet administrative, qëndrore dhe vendore dhe bëjnë përfaqësimin e klientëve të tyre në gjykatat e rrethit dhe ato të apelit si edhe në Gjykatën e Lartë. Ata përfaqësojnë njerëz të varfër dhe komunitetet e pakicave në përpjekjet për parandaluar fenomene të ndryshme negative në mjedis si lagjet e tyre nga të qënit të pushtuara nga objektet e toksike, të tilla si mallet me mbeturina apo kanalet e ujërave të zeza.

Aftësitë e avokatisë të zhvilluara dhe përmirësuara në klinikën mbi çështjet mjedisore janë të aplikueshme për çdo fushë të së drejtës apo karrierë që një student vendos të aplikojë. Klinika thekson aftësi të domosdoshme në çështje gjyqësore si hartimi i ankesave apo kërkesë-padive, përpilimi i mocioneve duke argumentuar, aftësitë këshilluese dhe negociuese për çështje të ndryshme të së drejtës mjedisore, si edhe trajtimi në aspektin ligjor të shumë çështjeve që kanë aplikime të gjera përtej ligjit mjedisor. Gjithashtu një theks të rëndësishëm kjo klinikë vë në bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me klientin duke e bërë atë actor të rëndësishëm në zgjidhjen e problemit.

Klinika mëson studentët me aftësitë e avokatisë si edhe trajnon grupet e komunitetit se si të ballafaqohen dhe të zgjidhin çështjet e tyre në mënyrë të realizojnë sa më mirë qëllimet e tyre dhe të drejtat.

Në seminare javore studentët zhvillojnë diskutime strategjike se si të zgjidhin ndryshimet që shkakton zbatimi jo i mirë i ligjit apo anashkalimi i tij nga personat fizikë por edhe kompanitë e mëdha të cilat shkaktojnë dëme të konsiderueshme në mjedis. Klinika gjithashtu trajton bashkëveprimin e çështjeve sociale dhe ekonomike në zhvillimin e mjedisit, mbrojtjen e tij si dhe ndikimi e ndotjes në cilësinë e jetës në komunitet apo në problem të tjera që mund të vijnë prej saj. Ndihma jepët kryesisht për persona të komunitetin romë, apo grupet e pafavorizuara ekonomikisht, të cilat e kanë të vështirë të kenë akses në drejtësi në mënyra të tjera përveç ndihmës të ofruar nga klinika.

Studentët gjithashtu ndihmojnë qendrat për reforëm e ligjit në përpjekjet për të zhvilluar një trup të ri të ligjit për të trajtuar në një konteskts tjetër dhe më të favorshëm problemet globale të ndryshimeve klimatike.

6. 7 Klinika për të drejtat e njeriut

Kjo klinikë, përveç se është shumë e domosdoshme dhe e aplikueshme në një spektër të gjerë çështjesh është edhe shumë interesante. Madje klinika e ligjit për të drejtat e njeriut është e aplikueshme edhe në Fakultetin tonë të Drejtësisë dhe trajton një shumëllojshëmri çështjesh që lidhen me të drejtat e njeriut.

Normalisht këtu baza ligjore do të jetë Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i rëndësishëm i hartuar nga Këshilli i Europës i cili në vendin tonë në lidhje me kufizimin e të drejtave të njeriut është në të njëjtin nivel me Kushtetutën.

Klinika për të drejtat e njeriut ekspozon studentët me praktikën e ligjit nëdërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe kontekstin ndër- kulturor të të drejtave në çështje të ndryshme gjyqësore dhe në kuadër të procesit të avokatisë. Seminare intensive shqyrtojën në aspektin kritik lëvizjen për të drejtat e njeriut duke u kombinuar dhe përshtatur posaçërisht meushtrime dhe simulimet për të future studentët e të drejtave ndërkombëtare të njeriut në aspektin praktik të problemit. Përveç hulumtimit dhe shkrimit, klinika nxit zhvillimin e aftësive themelore të avokatisë, duke përfshirë teknikat e intervistimit, punën bashkëpunuese në projekt dhe aplikimin e metodave të reja për të gjetur zgjidhje për problemin. Klinika për të Drejtat e Njeriut ofron trajtim të problemeve të ndryshme në teori dhe praktikë, duke siguruar studentët me përvojë praktike në vazhdim të projekteve. Studentët mësojnë të punojnë në partneritet me avokatët me përvojë dhe organizatat e angazhuara në të drejtat e njeriut.

Aktivizmi synon humultimin për të drejtat në vend dhe jashtë vendit dhe në këtë mënyrë arrihet të kontribuojnë në të ndikuar në një ndryshim pozitiv në nivel lokal dhe global si dhe në përmirësimin e aftësive të tyre profesionale.

Projektet e klinikës mbulojnë gamën e plotë të avokatisë mbi të drejtat e njeriut, me theks në :

- Përmirësimin e mjeteve ndërkombëtare në avokatinë e të drejtave të njeriut për të adresuar problemet në vendin tonë;
- Çështjet e të drejtave të njeriut në forumet ndërkombëtare dhe
- zhvillimin dhe zbatimin e mjeteve për të adresuar problemet në kryqëzimin e interesave midis biznesit dhe të drejtave të njeriut.

Studentët mund të përfaqësojnë falas në gjyq njerëz të varfër të dëbuar nga shtëpitë e tyre, ose anëtarë të komunitetit romë, fëmijë, të moshuar që janë cënar në të drejtat e tyre etj. Me pak fjalë mund të ndihmohen të gjithë ata që janë cënuar në të drejtat e tyre dhe nuk kanë mundësi që ta kërkojnë këtë në gjykatë. Synohet në këtë mënyrë që këtyre njerëzve t'u ofrohet akses në drejtësi apo një shërbim mimimal ligjor që ata nuk kanë mundësi ta sigurojnë vet. Duke qënë se këta njerëz kanë mjete shumë të pakta monetare, ata janë edhe më të prirur për të qënë viktimë të cënimit të të drejtave të njeriut. Prandaj ndihma e tyre duhet të jetë një prioritet i klinikës së ligjit.

Edhe pse në vendin tonë, kjo formë e klinikës nuk është aq e zhvilluar, në SH. B. A klinika për të drejtat e njeriut gjatë një semestri mund të çojë disa student në vende të ndryshme që kanë probleme me shkeljen masive të të drejtave të njeriut. Këtu përmendin vende të Afrikës, si Libia, Iraku, apo edhe shtete të tjera si Azerbajxhan, Peru etj. Në këtë mënyrë studentët njihen dhe përballen me cënimin e të drejtave të njeriut dhe kanë

mundësi të ndihmojnë vërtet njerëz që janë në vështirësi dhe përballen çdo ditë me shkeljen e të drejtave të tyre.

Rastet e shkeljes të të drejtave të njeriut mund të jenë nga më të ndryshmet dhe kjo i angazhon studentët për të marrë pjesë në çështje të llojeve të ndryshme. Megjithatë rastet tipike variojnë nga një vend në tjetrin, të diktuara këto edhe nga ndryshimet midis faktorëve socialë, ekonomikë, politikë, historikë apo kulturorë të një vendi. Për shembull në Shqipëri, hasen raste të shumta të dhunimit të të drejtave të fëmijëve, puna e detyruar ndaj tyre dhe kjo është një çështje që mund të merret përsipër nga klinika, pasi këta të mitur kanë pak mundësi të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre. Studentët e klinikës mund të përfaqësojnë këta të mitur në kallëzimin penal që ata mund t'i bëjnë personave që i detyrojnë të bëjnë punë të detyruar. Megjithatë në këto raste mund të kërkohet edhe bashkëpunimi me organet e rendit apo specialistë të fushës pasi kemib të bëjmë me çështje delikate për të cilat studentët nuk janë të trajnuar.

Gjithashtu raste të shumta janë ato të dhunës në familje, kryesisht femra dhe fëmijë. Duke qënë se urdhri i mbrojtjes i lëshuar nga gjykata shqiptare nuk rezulton shpesh herë i suksesshëm për parandalimin e dhunës, është e nevojshme edhe ndihma e dhënë nga klinika e ligjit. Mund të përfaqësohen falas femrat e dhunuara apo mund t'u jepet këshillim ligjor falas për t'i ndihmuar në zgjidhjen e çështjes së tyre. Megjithatë këtu ndërhyjnë edhe dispozitat e të drejtës familjare, pra mund të kemi një ndërthurje midis klinikës të të drejtave të njeriut dhe asaj familjare, në lidhje me metodat e ndjekura dhe të drejtën materiale të aplikueshme.

Në praktikën juridike shqiptare hasen shumë probleme të çështjeve të pronësisë. Mbivendosjet e pronave, mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore apo rrethana të tjera behën shkaktarë që inidivdëve të shumtë t'i shkelet një nga të drejtat themelore që është e drejta e pronës. Në këtë aspekt mund të jepet një ndihmë e madhe nga studentët e klinikës, duke përfaqësuar këta individë në proceset gjyqësore falas, duke i dhënë këshillim ligjor falas në lidhje me të drejtën material të zbatueshme apo procedurën e ndjekur në rastin e tyre.

Pra, klinika e ligjit për të drejtat e njeriut mund të jetë shumë e vlefshme në ndihmën juridike për një sërë çështjesh ligjore duke ndihmuar kategori të caktuara të popullsisë në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre.

6. 8 Klinika e ligjit për çështjet penale

Një fushë tjetër ku aplikohet klinika e ligjit është në rë drejtën penale. Kjo klinikë operon në fushën e procedimeve penale duke ndihmuar individë të ndryshëm të akuzuar nga organet e procedimit penal por edhe duke ndihmuar subjekte të dëmtuar për të bërë kallzim penal dhe të kërkojnë të drejtat e tyre. Kjo klinikë operon edhe në Fakultetin e Drejtësisë dhe ka tërhequr një vëmendje të madhe nga studentët. Krahas ambicieve për marrje për përfaqësim falas të çështjeve penale me të pandehur që nuk kanë mjete për të përballuar ndihmën ligjore, kjo klinikë ka organizuar edhe gjyqe imituese për të zhvilluar aftësitë praktike të studentëve.

Studentët e regjistruar në Klinikën e ligjit penal marrin përsipër të mbajnë përgjegjësi të plotë për rastet e tyre, ndërsa janë në mbikëqyrje të vazhdueshme nga pedagogë të fakultetit. Studentët që marrin pjesë në klinikën e ligjit penal mund të marrin pjesë në disa faza të procedimit penal duke kryer hetime për të formuluar strategjinë që do të përdoret në gjyq, paraqesin mocione para-gjyqësore, marrin pjesë në bisedime me klinentin e tyre, diskutojnë në grup duke paraqitur alternativa për zgjidhjen e çështjes dhe përfaqësimin sa më mirë të klientit. Studentët duhet të ndjekin rastet e tyre nga fillimi në fund dhe ata mund të marrin pjesë në mbrojtjen që i bëhet klientit në gjyq edhe pse ata vetë nuk mund ta mbrojnë atë, duke qënë se nuk janë avokatë. Megjithatë, edhe pse ata janë të përjashtuar nga mrojtja mund të kryejnë një sërë detyrash të tjera të dobishme dhe të japin kontributin e tyre të vlefshëm.

Ata mund të bëjnë humultime duke kërkuar raste të praktikës në funksion të mbrojtjes që do të realizohet në gjyq si edhe duke kërkuar dispozitat ligjore favorizuese për klientin. Studentët mund të këshillojnë falas klientin, t'i bëjnë një panoramë të situatës ku ai ndodhet, të së drejtës materiale në fuqi, të aspekteve proceduriale të rëndësishme që duhen zbatuar si edhe t'i përgjigjen çdo pyetje apo paqartësie që klienti ka në lidhje me çështjen konkrete.

Gjatë kësaj klinike, fakulteti ofron bashkëpunim me organet e procedimit penal, duke bërë të mundur që studentët të realizojnë praktika pranë prokurorisë apo gjykatave dhe duke parë nga afër zhvillimin e procesit penal. Me anë të këtyre praktikave, studentët njihen nga afër me të gjitha fazat e procedimit penal duke mësuar nga praktika. Ata gjithashtu kanë mundësi të bëjnë pyetje në lidhje me raste konkrete dhe të kryejne detyra specifike të cilat do t'i ndihmojnë pa masë. Gjithashtu praktikat mund të realizohen edhe pranë zyrave të avokatisë të specializuara në çështjet penale, të cilat mund të angazhojnë studentët në çështjet e tyre dhe duke i dhënë disa detyra të caktuara. Praktika mund të realizohet edhe në Shërbimin e Provës, duke bërë të mundur që studentët të shohin nga afër dhe të fitojnë eksperiencë në lidhje me dënimet alternative dhe zbatimin e tyre në praktikë. [161]

Një nga eksperiencat më të suksesshme të klinikës së ligjit në Fakultetin tonë është realizimi i gjyqit imitues, një projekt në bashkëpunim me USAID. Këtu u angazhuan studentë të vitit të tretë bachelor dhe ata u përfshinë në një punë disa javore për të realizuar me sukses detyrat e dhëna. Në fund të projektit ata jo vetëm që ishin shumë të kënaqur me punën e tyre por edhe fituan aftësi të reja praktike. Gjyqi imitues iu dha atyre mundësi të preknin nga afër një sallë gjyqi dhe të bëheshin pjesë e një përvoje të re. Në fund ata u pajisën me çertifikata vlerësimi nga misioni i USAID në Tiranë.

Klinika e ligjit e Departamentit Penal ka si objekt përfaqësimin e klientëve që nuk kanë mundësi të përballojnë ndihmën profesionale dhe këshillimin e tyre. Kjo klinikë mbulon çështjet penale, si ato që ndiqen kryesisht por gjithashtu ato të të dëmtuarit akuzues. Madje klinika synon t'i ofrojë ndihmë ligjore pikërisht këtyre subjekteve, pra të dëtuarëve

[161] Avokatia – Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, vëllimi 1, janar 2012, fq 25.

akuzues që bëjnë kallëzim penal duke kërkuar të realizojnë të drejtat e tyre dhe mbajtjen e përgjegjësisë penale nga personat fajtorë që i kanë cënuar një të drejtë të caktuar apo i kanë shkaktuar një dëm. Duke qënë se këta individë shpesh herë mund të jenë pa të ardhura, apo kategori vunerabël e popullsisë që nuk ka mundësi të sigurojë vet akses në drejtësi, atëherë vjen në ndihmë klinika e ligjit. Studentët e kësaj klinike mund të jenë shumë të dobishëm duke dhënë një kontribut të vlefshëm në një sërë mënyrash. Ata mund të fillojnë që nga humultimi apo kërkimi mbi zgjidhjen e një çështje të caktuar, këshillimi ligjor i klientit, hartimi i dokumenteve ligjorë, e deri të përfaqësimi në gjyq i klientit. Normalisht që studentët nuk mund të përfaqësojnë klientin në gjyq për shkka të mungesës së licencës së avokatit, megjithatë ata mund të asistojnë në sallën e gjyqit, si ndihmës, duke përgatitur dokumentet e nevojshme, mbrojtjen apo elementë të tjerë të domosdoshëm në zgjidhjen e çështjes.

Projektet e klinikës së Departamentit Penal janë projekte shumë ambicioze. Synohet marrja në përfaqësim e çështjeve konkrete penale, mbrojtja e kategorive vunerabël të popullsisë si edhe përmirësimi real i dijeve praktike të studentëve. Me hapa të ngadaltë por bindës, kjo klinikë po fiton terren në programin akademik duke u bërë një pjesë thelbësore e edukimit juridik të studentëve të drejtësisë.

6. 9 Klinika e ligjit për të drejtën familjare

Në fakt kjo është një klinikë pjesë e degës së madhe të së drejtës civile por që ushtron aktivitetin e saj në fushën e të drejtës familjare. Kjo klinikë është e fokusuar në trajtimin e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga martesa, çështjet e kujdestarisë, rregjimit pasuror, përgjegjësia prindërore etj. Klinika e ligjit për të drejtën familjare ofron ndihmë në një gamë të gjerë çështjesh.

Studentët orientohen të japin ndihmë juridike për atë bashkëshort që dëshiron të zgjidhë martesën por nuk ka mjete financiare për të përballuar ndihmën ligjore. Gjithashtu mund të ofrohet këshillim falas për bashkëshortët në lidhje me rregjimin pasuror të tyre, mënyrën e ndryshimit të tij, efektet e tij etj. Gjithashtu mund të përfaqësohen të miturit gjatë proceseve gjyqësore në lidhje me kujdestarinë apo heqjen e përgjegjësisë prindërore. Madje të miturit zënë një vend të veçantë në ndihmën e ofruar nga klinika, sepse ata shpesh janë kategori e pambrojtur që nuk kanë mjete monetare por edhe mund të bien pre e abuzimeve dhe keqtrajtimeve qoftë edhe nga prindërit e tyre. Prandaj studentët e klinikës mund të ofrojnë një ndihmë të dobishme për fëmijët pse të rinjtë që kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet e të drejtës familjare.

Gjithashtu ndihma e klinikës mund të ofrohet për femrat e dhunuara, të cilat kërkojnë urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes në gjykatë dhe që natyrisht janë kategori në nevojë pasi jo vetëm mund të ndodhen në mungesë të mjeteve monetare por gjithashtu mund të jenë pjesë e presioneve apo kërcënimeve të mundshme. Ata jo vetëm që mund të ofrojnë këshillim për to, por gjithashtu mund të përfaqësojnë falas në gjykim, apo t'i ndihmojën në hartimin e dokumenteve ligjore. Gjithashtu klinika mund të

jetë faktor nxitës për bashkëpunimin edhe me organet e rendit në çështje të tilla, duke i ndihmuar drejtpërdrejt ata në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Studentët në klinikën e të drejtës së familjes përfaqësojnë viktimat e abuzimit në familje, dhe individë të tjerë me çështje problematike në të drejtën familjare, si zgjidhje e martesës dhe rate të marrjes në kujdestari të fëmijëve. Studentët punojnë nën mbikëqyrjen e ekspertëve të së drejtës familjare për të ofruar ndihmë juridike në të gjitha fazat e përfaqësimit. Puna zakonisht përfshin këshillim intensiv, gjetje e strategjive mbi raste të ndryshme dhe negocim, për të cilën studentët ofrojnë akses në drejtësi për klientët dhe përfitojnë përvoja të reja në praktikën e ligjit.

Klinika mbi të drejtën familjare zakonisht i ofron studentëve mundësi për të punuar në një shumëllojshmëri të llojeve të rasteve në lidhje me të drejtën familjare me disa klientë të ndryshëm gjatë semestrit të tyre në klinikë. Partnerët e kësaj klinike janë profesorë të së drejtës, avokatë dhe organizata të shumta të cilat ofrohen për të mbështetur këtë punë, duke përfshirë edhe Shërbimet Sociale, Qendra Për Nisma Ligjore Qytetare apo organizata jo-fitimiprurëse që ndjekin këtë qëllim. Projektet e politikave publike janë gjithashtu një aspekt i punën së klinikës, që përfshin partneritete të reja dhe nisma për ndryshime të mundshme në legjislacion, si pasojë e boshllëqeve apo parregullsive ligjore që evidentohen nga studentët gjatë punës së tyre në klinkën e ligjit.

Studentët e klinikës në të drejtën familjare i ofrohet një mundësi për t'u angazhuar plotësisht në përfaqësimin e klientit në bazë të rregullave mbi praktikën e studentëve dhe pjesmarrjen e tyre në procese gjyqësore. Ata pritet të punojnë ngushtë me klientët e tyre për të zhvilluar qëllimet në zgjidhjen e çështjeve, por edhe për të zhvilluar qëllimet e tyre për përvojën e tyre klinike dhe të marrë pjesë në ato gjatë gjithë semestrit. Klinika thekson mësimin pasqyrues, dhe të menduarit kritik në lidhje me taktikat gjyqësore dhe këshillimeve të klientit. Studentët janë trajnuar drejt arritjes së standardeve të larta ku përfshihen aftësitë e tyre me shkrim dhe me gojë të avokatisë të cilat zhvillohen nga përvoja e tyre si dhe duke analizuar opsionet e çdo klienti me një sy në drejtim të fuqizimit të klientit dhe drejtësisë. Klinika përfshin një komponent praktike krahas orëve teorike ku studentët marrin pjesë drejpërdrejt në çështje të së drejtës familjare. [162]

Klinika e së drejtës familjare adreson çështjet e kujdestarisë, të drejtat e takimit me fëmijët, mbështetje e fëmijëve dhe bashkëshortëve, mbështetje në rastet e paaftësisë paguese për detyrimet e përbashkëta, çështjet e sigurimit shëndetësor dhe të sigurimit të jetës, ndarjen e barabartë të pasurisë martesore në rastin e rregjimit të bashkësisë ligjore, zgjidhjen e martesës apo pasojat e zgjidhjes së martesës, kërkesat për birësimin e të miturve, çështjet e njihjes vullnetare të atësisë dhe amësisë, vërtetimi gjyqësor, kujdestaria e fëmijëve që ndodhen jashtë kujdesit prindëror etj. Studentët që marrin pjesë në klinikën e të drejtës familjare gjithashtu kanë mundësi për të punuar në rastet e dhunës në familje, ndërmjetësime apo çështjet më të diskutuara në të drejtën familjare. Këtu mund të përfshijmë të drejtën për martesë të personave të të njëjtin seks, të

[162] Programi i Klinikës të së drejtës familjare në Universitetin Dikson të drejtësisë, Në Pensilvani, SH.B.A

transeksualëve, si edhe të drejtën për të ndrsyhuar gjininë në rregjistrin e gjendjes civile. Në të gjitha rastet klinika ka prioritet përfaqësimin e prindërve në lidhje me çështjet e përgjegjësisë prindërore duke kërkuar për të maksimizuar burimet, të ardhurat dhe standardin e jetesës së familjes dhe mundësitë e ofruara për fëmijët.

Në këtë klinikë, studentët realizojnë intervista dhe këshillim ligjor falas për klientët, kryejnë hetime faktike dhe hulumtim ligjor, ndihmojë në zhvillimin e strategjive të zgjidhjes së çështjeve, mbledhin informacion dhe analizojnë dokumentet, hartojnë drafte dhe kërkesat drejtuar organeve shtetërore apo kërkesë. paditë drejtuar gjykatës dhe mbledhin të gjitha faktet e nevojshme që do të sherbejnë për zgjidhjen e çështjeve. Në rrjedhën e një semestri, studentët mund të kenë paraqitje të shumta gjyqësore duke praktikuar të drejtën, kërkojnë lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, marrin pjesë në seancat paraprake dhe përfaqësojnë klientët që nuk kanë mundësi ta sigurojnë ndihmën vet. Studentët negocionjë direkt me avokatët e palës kundështare, duke synuar ta zgjidhin çështjen me ndërmjetësim dhe duke diskutuar për të gjetur një zgjidhje që të realizojë sa më mirë interesat e të dyja palëve.

Klinika e të drejtës familjare mund të ndahet në disa programe të fokusuara në fusha të caktuara apo në çështjet me problematike të së drejtës familjare. Ka programe të klinikës për të drejtat e komunitetit LGBT, për mosmarrëveshjet që lindin nga martesa, përgjegjësia prindërore dhe të drejtat e të miturve etj. Zhvillimi i këtyre kurseve mund të bëhet përgjatë një semestri dhe kurset e ofruara mund të variojnë edhe në varësi të interesit të studentëve për një program të caktuar. [163]

Për shembull, Universiteti i Harvardit në Sh. B. A ka një klinikë të veçantë për komunitetin LGBT. Kjo klinikë është e fokusuar në mbrojtjen e të drejtave të këtij komuniteti. Ajo fokusohet në çështje të tilla si; e drejta e tyre për martesë, e drejta për birësimin e fëmijëve, ndryshimi i seksit, ndalimi i diskriminimit etj.

6. 10 Klinika e ligjit për të drejtën migratore

Kjo klinikë është e fokusuar në atë të degë të së drejtës publike që është e drejta migratore. Klinika për të drejtën migratore është e fokusuar në mbrojtjen dhe përfaqësimin ligjor të emigrantëve, personave që kërkojnë azil në një shtet tjetër. Në fakt kjo klinikë ofron një mbrojtje të konsiderueshme për njerëz të cilët shpesh kategorizohen si kategori vunerabël. Ata mund të jenë emigrantë të huaj, persona që kanë nevojë për azil në një shtet tjetër, njerëz që duan të bashkohen me familjen e tyre jashtë shtetit etj. Mungesa e dijenisë së gjuhës, mosnjohja e ligjeve, procedurave nga këta individë, diskriminimi për shkak të racës, etnisë, përkatësisë fetare, janë të gjithë faktorë që ndikojnë që këta individë ta kenë të vështrirë të arrijnë të kenë akses në drejtësi.

Ndihma e ofruar ndaj këtyre personave konsiston në këshillimin ligjor falas, hartimi i dokumentave dhe kërkesave drejtuar organeve kompetente, përfaqësimi ligjor falas në

[163] Programi i klinikës së ligjit në të drejtën familjare në Departamentin e ligjit në Universitetin e Harvard në SH.B.A

gjyq etj. Këta individë shpesh nuk arrijnë t'i realizojnë dot të drejtat e tyre dhe për këtë vjen në ndihmë klinika e ligjit. Studentët mund të jenë shumë të dobishëm në këtë drejtim, pasi ndihma e tyre mund të jetë shumë e dobishme. Kjo mund të fillojë që nga këshillimi ligjor falas duke i njohur emigrantët apo kategoritë e tjera të njerëzve me ligjet ne fuqi në atë vend, procedurat që duhet të ndiqen, kostot financiare, pasojat e zgjidhjeve të ndryshme etj. Pas këtij këshillimi ata do të jenë të njohur me situatën ku ndodhen, do të jenë familjarë me ligjin e zbatueshëm dhe kjo do të jetë ndihma e parë për ta dhe do t'ja lehtësojë situatën. Më pas ndihma mund të vazhdojë në forma të tjera deri në përfaqësimin falas në gjyq apo pranë organeve kompetente.

Klinika e ligjit mbi emigracionit siguron përfaqësim ligjor për njerëzit e varfër që nuk gëzojnë shtetësinë në një shtet të caktuar në procedurat para gjykatave apo oragneve të ndrsyhme. Megjithatë kjo ndihmë është edhe më evidentë në shtete të mëdha si Shtetet e Bashkuara ku ka edhe një dyndje të emigrantëve apo edhe probleme më të mëdha në këtë fushë. Aty klinika i përfaqëson klientët para gjykatave të migracionit, para Bordit të Ankesave për Imigracionin dhe gjykatat federale. Klinika ofron shërbime të nevojshme për komunitetet e emigrantëve, duke ofruar këshillim dhe shërbime ligjore për emigrantët të ardhur nga vende të tjera dhe që përballen me deportimin duke u mundësuar studentëve që të fitojnë përvojë praktike duke i prekur nga afër çështjet e të drejtës migratore. Studentët e klinikës kanë mundësi të marrin pjesë në të gjitha aspektet kryesore të procesit gjyqësor, duke përfshirë intervistimin e klientëve dhe dëshmitarët, duke përgatitur kërkesa ligjore, hartimin e shkresave dhe mocionet, dhe duke argumentuar çështjet komplekse ligjore. Studentët rregullisht kryejnë studime dhe seminare të tjera ligjore në komunitet, angazhohen në projekte më të gjera të procesit të avokatisë në lidhje me ndalimin dhe deportimin e emigrantëve, dhe përpiqen të sigurojnë respektimin e të drejtave të drejtave të tyre në qendrat e paraburgimitku ata mund të mbahen në pritje të dëbimit për në vendin e tyre.

Klinka e ligjit për të drejtën migratore mund të shërbejë dhe ofrojë ndihmën e saj në këto fusha :

- Emigracioni dhe Avokatia për Refugjatët
  Studentët e kësaj klinike marrin rolin udhëheqës në përfaqësimin e klientëve nga e gjithë bota të cilët janë duke kërkuar mbrojtje nga të qenit subjekt në shkelje të të drejtave të njeriut në vendin e tyre të origjinës, si dhe ata që janë duke kërkuar mbrojtje nga mërgimi pas viteve të që jetojnë në vendin ku kërkohet mbrojtja.
- Crimmigration - Kryqëzimi i Ligjit Penal dhe Ligjin për Imigracionin
  Crimmigration është një term që përdoret për të treguar ndërthurjen midis ligjit penal dhe të drejtës migratore. Studentët në këtë klinikë ndahen në grupe dhe realizojnë përfaqësimin e personave të paraburgosur që kërkojnë të kthehen në vendin e tyre apo që janë në pritje të dëbimit. Gjithashtu kjo klinikë ofron mbrojtje për ata persona që pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre në procesin penal për shkak të qënies të huaj.
- Azili politik.

Klinika e ligjit mund të ofrojë ndihmë edhe për ata persona që kërkojnë azil në një shtet tjetër kur pretendojnë se në shtetin tjetër po diskriminohen për shkak të bindjeve të tyre politike duke i ndihmuar për të përgatitur dokumentat e nevojshme apo për të realizuar të drejtën e tij dhe të merret në mbrojtje.

Kjo klinikë nuk është e aplikuar në Shqipëri, për shkak të kushteve të veçanta ekonomike dhe politike, e sociale të vendit tonë. Duke qënë se këtu nuk kemi një numër të madh emigrantësh, normalisht edhe problematikat që hasen në këtë drejtim janë të pakonsiderueshme në krahësim me probleme të tjera ligjore në Shqipëri. Klinika e ligjit për të drejtën migratore gjen një aplikim të madhe në vende si Shtetet e Bashkuara apo Britania e Madhe ku numri i emigrantëve dhe azil. kërkuesve është shumë i madh.

Në Shqipëri janë të aplikueshme forma të tjera të klinikës si klinika në çështjet penale, civile dhe të drejtat e njeriut sepse këto janë edhe fushat kryesore të së drejtës ku ka shumë probleme juridike të tilla. Madje, mund të themi se janë pikërisht këto tre klinika që gjejnë zbatim aktualisht në Fakultetin e Drejtësisë në Universtetin e Tiranës, me ambiciet dhe projektet për ta zgjeruar klinikën në fusha të tjera. Megjithatë me zhvillimin e programit akdemik të klinikës, njohjen dhe promovimin e tij në shoqëri dhe komunitet dhe forcimin e kapaciteteve akademike dhe profesionale për mbështetjen e klinikës, natyrisht që klinika do të gjejë zhvillim edhe më të madh në Shqipëri.

Kapitulli VII

Klinika dhe planifikimi i karrierës

Përmbajtja : 7. 1 Roli i klinikës në krijimin e një plani karriere; 7. 2 Procesi i reflektimit; 7. 3 Mbikëqyrja; 7. 4 Hapat për planifikimin e karrierës;

7. 1 Roli i klinikës në krijimin e një plani karriere

Shumë studentë e nisin fakultetin e drejtësisë duke menduar se ajo do t'i ndihmojë të qartësojnë idetë për të ardhmen dhe të krijojnë një plan karriere. Megjithatë, ata edhe pasi mbarojnë shkollën e gjejnë veten në një labirint zgjidhjesh pa ide për të ardhmen dhe atë që realisht duan të bëjnë. Në mënyrë të kurajshme disa hyjnë dhe realizojnë praktika duke sfiduar veten e tyre dhe marrë përsipër përgjegjësi për kënaqjen e vetes së tyre dhe ambicieve profesionale. Kërkon kurajë të hysh në fusha të caktuara të së drejtës dhe të arrësh përsipër përgjegjësi. Kërkon kurajë për të marrë përsipër përgjegjësi për të cilat studentët shpesh nuk janë të përgatitur. Por, studentët që marrin përsipër këto inisiativa do të marrin edhe frytet.

Në fakt çdo avokat që mund të pyetet do të tregojë për pasojat positive dhe nxitëse që ka pasur të karriera e tij modeli i karrierës së ndjekur nga një avokat me të cilin ata kanë pasur përvojë në zyrën ku kanë zhvilluar praktikën. Një person i tillë me të cilin merr kontaktet e para në profesion do të shërbejë si model frymëzimi dhe do të ketë ndikim të konsiderueshëm në karrierën e çdo juristi të ri. Zakonisht planifiki i karrierës kërkon kohë. Juristët e rinj do të duhet të kalojnë eksperienca të shumta, sprova dhe vështirësi në mënyrë që ata vet të arrijnë të vendosin se në çfarë fushe duan të konsolidohen dhe e ndiejnë veten të realizuar profesionalisht. Praktika është një pjesë themelore e procesit të të mësuarit me anë të përvojës ku aftësitë dhe eksperienca fitohen me anë të marrjes së vendimeve. [164]

[164] Learning from practice – J.P.Ovigly, L.Wortham, L.G.Lerman, vellimi 2, fq 401

Me anë të reflektimit dhe vlerësimit të ndershëm, pratkika shndërrohet në një laborator ku mund të testohen një grup i madh hipotezash në lidhje me karrierën profesionale. Ky proces reflektimi fillon me hartimin e një letre ku përcaktohen të gjitha motivet dhe objektivat që dëshirohen të arrihen. Kjo do të shërbejë si një hartë për të treguar cilat janë prioritetet dhe objektivat që i janë vendosur vetes, cilat janë interesat e ardhshëm dhe qëllimet e së ardhmes. [165]

Nëse fillohet puna, qoftë edhe në një praktikë, student fiton idenë e parë rreth preferencave të tij në lidhje me fushat e së drejtës që e tërheqin por dhe që ai është më i apasionuar dhe më i vlefshëm. Studenti është i aftë të kuptojë se cilat fusha të së drejtës e bëjnë të ndihet më i përmbushur profesionalisht, ku ai ndihet i dobishëm, ku e shijon më shumë punën dhe ku dëshiron të shfyrtëzojë aftësitë e veta dhe kapacitetin. Praktika i tregon studentit se cilat janë përpjekjet që ai duhet të bëjë, ku duhet të fokusohet më shumë për të zhvilluar aftësitë e tij profesionale dhe të bëhet më i aftë. Praktika, me pak fjalë mund të konceptohet si një guidë e ndërtuar nga vet personi dhe që rezulton si mjeti më efektiv për ta udhërrëfyer atë në lidhje me hapat profesionalë që duhet të ndjekë dhe se si aim und të arrijë suksesin. Shumë prej aftësive profesionale të cilat kanë qëndruar të fshehura, ambicieve, dëshirave, apo mundësive të gjithsecilit mund të njihen dhe fitohen vetëm me anë të praktikës.

Praktika është një element shumë i rëndësishëm në formimin juridik të studentëve të së drejtës. Ata jo vetëm që praktikojnë të drejtën por mësojnë të njohin më mirë veten. Njohin aftëstë e tyre, të metat, dëshirat, mundësitë që kanë dhe në cilat situate kanë aftësi të përshtaten më mirë dhe të jenë edhe efektivë. Praktika i ndihmon studentët jo vetëm në aspektin profesional por edhe atë personal. Ata mësojnë aftësi dhe përvoja të domosdoshme që do të kërkohen nga punëdhënësit e tyre të ardhshëm. Gjithashtu kanë mundësi të hartojnë një plan karriere dhe të marrin masa për ta vënë atë në praktikë. Që në praktikën ata fillojnë sfidat për formimin profesional, për zhvillimin e aftësive të tyre dhe ndërtimin e një karriere të mirëfilltë.

Në praktikën e tyre studentët do të mësojnë mbi të gjitha. Disa prej mësimeve do të jenë edhe negative, por kurrsesi nuk mund të themi që ato nuk janë të vlefshme. Gjatë praktikës ata do të mësojn vlerën e parimeve të etikës gjatë ushtrimit të profesionit. Do të mësojnë sa i rëndësishëm është detyrimi i konfidencialitetit apo i shmangies së konfliktit të intreesave. Në fillim ata do të gabojnë duke mos ia ditur vlerën shumë gjerave, por ky gabim do të jetë thelbësor për mësimin e tyre dhe shndërrimin në profesionistë të aftë në të ardhmen. Ata do të mësojnë gjithashtu se shpesh herë është e rëndësishme të konsultohesh me eprorët për vendime të rëndësishëm sepse përvoja është një mësues i madh që të ndihmon të marrësh vendime të drejta. Gjithashtu ata mund të nxjerrin zbulime të rëndësishme në lidhje me prirjet e tyre profesionale. Ata mun dtë zbulojnë se nuk kanë prirje në fushën e të drejtës penale, madje që ajo as i tëheq duke u fokusuar totalisht në të drejtën civile. Gjithashtu të tjerë mund të mësojnë se nuk i tërheq avokatia,

[165] Po aty.

por prokuroria dhe kjo do të bëjë që ti përqëndrojnë gjithë përpjekjet e tyre në këtë fushë. Zbulime të tilla gjatë praktikës do të jenë shumë të rëndësishme, madje mund të jenë vendimtare për karrierën profesionale të studentëve të së drejtës. Prandaj përvoja e fituar nga praktika do të jetë e rëndësishme jo vetëm në drejtim të aftësive të përfituara por edhe sepse këtyre studentëve mund t'u japë drejtimin e jetës.

Megjithatë, studentët duhet ta dinë që përvoja e fìtuar gjatë praktikës, nuk mund të jetë kurrsesi një vijë e drejtë drejt" punës së ëndrrave". Kjo, pasi që të gjendet kjo punë duhet punë, mundim, sfida, ngritje por edhe rënie të shumta. Praktika vërtet ndihmon drejpërdrejt në krijimin e një plani karriere por kjo nuk do të thotë se ajo është zgjidhja. Në rradhë të parë rruga e ndjekur do të jetë një mundim i vazhdueshëm. Çdo student i ri do të jetë në përballje të vazhdueshme me sfida dhe vështirësi profesionale por edhe personale të cilat do të ndikojnë në mënyrë të pashmangshme në karrierën e zgjedhur prej tij. Megjithatë praktika do të ketë vlerë edhe në varësi të masës se sa gjithsecili do të dijë të përfitojë prej saj. Ka student që nuk janë të aftë të përfitojnë prej mësimeve që marrin, të paktën jo që herën e parë. Disa do ta bëjnë disa herë një gabim, derisa të përfitojnë një përvojë prej tij dhe të nxjerrin një mësim të vlefshëm. Gjithashtu kemi të bëjmë edhe më një çështje vullneti, kurajo dhe vendosmërie. Ka studentë që do të ndalen që në pengesën e parë në një fushë të caktuar edhe do të kërkojnë të provojnë diku tjetër. Të tjerë, janë të vendosur për të dalë fitimtarë dhe nuk do të ndalen as me disa disfata të vazhdueshme. Prandaj edhe përfitimi nga praktika është një çështje vetjake dhe do të varet në një masë të madhe edhe nga vet praktikanti, aftësitë, ambiciet dhe dëshirat e tij.

Të mësosh më shumë për veten, duke përfshirë këtu dëshirat, vlerat, aftësitë, interesat, stilin e komunikimit dhe preferencat personale është një pjesë helbësore e të përdorurit të mësimit nga përvoja drejt caktimit të qëllimeve afatgjatë nga ana e juristëve të rinj. Praktika shërben si një katalizator në hartimin e një plani karriere. Studentët pas përvojës praktike të realizuar prej tyre do të jenë të aftë të caktojnë qëllimet e tyre dhe të planifikojnë karrierën që duan ta realizojnë. Pasi ta kenë bërë këtë, ata do të përqëndrojnë gjithë përpjekjet e tyre në arritjen e rezultatit të dëshiruar dhe plotësimit të objektivave që i kanë vënë vetes.

Praktika mund të shihet edhe si një mundësi e mirë për të kaluar kohë duke imagjinuar veten si një profesinosit i ardhshëm. Kjo do të vlejë në fakt për studentët pasi do të shtojë ambiciet dhe dëshirat e tyre për t'u realizuar profesionalisht dhe do t'i bëjë edhe më kërkues ndaj vetes. Cila është puna perfekte? Kjo është një pyetje që secili student duhet t'ia bëjë vetes së tij. Nëse njohim veten mund të planifikojmë edhe dëshirat dhe ambiciet e së ardhmes. Një njeri që ka plane, dëshira dhe ide ka shumë më tepër mundës të jetë i realizuar profesionalisht se dikush që ia lë çdo gjë në dorë rastësisë. Edhe për juristët e rinj veln e njëjta gjë. Ata duhet ta shohin veten e tyre të përfshirë në tregun e punës. Natyrisht që ka shumë mundësi që puna e parë të mos jetë ajo perfektja, madje të jetë shumë larg saj. Por kjo është normale. Të gjithë profesionistët janë përballuar më sfida madje edhe zhgënjime në fillimet e tyre. Por, kjo nuk duhet të jetë një pëngesë për të vendosur objektiva edhe më ambiciozë për të ardhmen dhe për të bërë përpjeke për t'i

vënë ato në praktikë. Përkundrazi, duhet të shërbejë si një sfidë personale për të arritur atë që secili do dhe synon.

Si përfundim, mund të themi se praktika jep një ndihmë të konsiderueshme në hartimin dhe konsolidimin e një plani karriere. Megjithatë, praktika dhe përvoja që fitohet prej saj duhet shfyrtëzuar në mnëyrë maksimale që edhe out-putet të jenë ato të dëshiruara. Studentët e së drejtës duhet të përfshihen në praktika profesionale, në fushën që duan të praktikojnë të drejtën. Kjo praktikë më pas mund t'i sjellë plane dhe idë të reja, por e rëndësishme është që të mësohet prej saj dhe çdo përvojë e realizuar të shndërrohet në një të vlefshme dhe të nxirret përfitim.

7. 2 Procesi i reflektimit

Një prej elementëve bazë në mësimin nga praktika është procesi i reflektimit. Të reflektosh mbi përvojën dhe dijet e fituara të ndihmon të mësosh më shumë prej tyre, të nxjerrësh rezultatet e dëshiruara dhe të kuptosh nëse përvoja ka qënë e vlefshme. Reflektimi është një proces i cili ndihmon edhe në hartimin e një plani karriere. Studentët që përfshihen në klinikën e ligjit do të prekin nga afër eksperienca në fusha të ndryshme të së drejtës dhe ata do të kutpojnë nëse kjo është ajo që duan të bëjnë në karrierë apo jo. Reflektimi pas përvojës klinike do t'i ndihmojë ata të kuptojnë nëse ndihen të realizuar në një fushë të caktuar të së drejtës. Ata do të jenë të aftë të dallojnë aftësitë dhe dobësitë e tyre, mënyrën e komunikimit, fushat e së drejtës që i tërheqin më shumë dhe aty ku ata ndihen më të realizuar profesionalisht. Për shembull, nëse një student përfshihet në klinikën e të drejtave të njeriut dhe aty konstaton se ai tërhiqet shumë prej kësaj fushe, është shumë i përkushtuar për këta lloj klientësh dhe gjithashtu i kryen detyrat me efektivitet, atëherë ka shumë mundësi që ai të zgjedhë këtë fushë të së drejtës ku do të ushtrojë profesionin dhe do të ndërtojë karrierën e vet profesionale.

Pra reflektimi si një proces i të menduarit dhe vlerësimit kritik brenda vetes jep një ndihmë të madhe në hartimin e një plani karriere. Në mnëyrë që zgjedhjet të jenë ato të duhura dhe të realizohen më sukses, është e rëdnësishme që çdo jurist i ri të reflektojë brenda vetes së tij se cila është ajo që do dhe se çfarë mund të bëjë më mire. Megjithatë jo vetëm dëshirat dhe ambiciet janë vendimtare në hartimin e një plani karriere. Një rol të konsiderueshëm këtu duhet të luajnë aftësitë vetjake, prirjet dhe vlerat e secilit. Një student mund të jetë më shumë i prirur për të ndjekur çështje penale se një tjetër. Gjithashtu studentë të caktuar janë të apasionuar pas çështjeve të së drejtës kushtetuese, të tjerë pas të drejtave të njeriut e kështu me rradhë. Aftësitë dhe vlerat ndikojnë në një masë të madhe në profesionin dhe karrierën profesionale që do të zgjedhë dhe aplikojë secili student. Në të kundërt të gjithë do të ishin të suksesëhm njësoj. Suksesi dhe arritjet profesionale varen në një amsë të madhe prej aftësive dhe kjo duhet dhe ka mundësi të zbulohet që në semestrin e klinikës së ligjit. Të paktën mund të thuhet që studentit i jepet një mundësi e tillë, për të kuptuar se ku ai është efiçent dhe i suksessëhm më shumë se të tjerët. Por varet prej tij, prej vëmendjes, përkushtimit dhe refketimit që ai bën për të kuptuar dhe arritur në marrjen e vendimeve të drejta.

Klinika e ligjit ndihmon studentët jo vetëm të fitojnë aftësi të pazëvendësueshme që do t'i duhen gjatë jetës së tyre profesionale por gjithashtu ata mund të kuptojmë më shumë rreth vetes dhe mundësive të tyre, duke u bërë të aftë të hartojnë një plan karriere. Reflektimi është një prej proceseve me anë të së cilit mund të përfitohet më shumë prej përvojës klinike, avantazhet e të cilit janë përmendur më lart në punim. Ajo që duhet thelsuar në këtë kapitull është se reflektimi krahas avantazheve të tjera që ofron, jep një ndihmë të madhe edhe në hartimin dhe planifikimin e karrierës nga juristët e rinj.

Gjatë klinikës së ligjit, studentët vazhdimisht duhet të ndalen për të reflektuar rreth asaj që po bëjnë dhe po përjetojnë. Reflektimi ndihmon edhe në rastet e vendimeve të gabuara gjatë kryerjes së detyrave. Reflektimi të ndihmon për ta kryer më mirë detyrën herën tjetër. Nëse ke kryer disa gabime apo pasaktësi këto mund të rregullohen nëse refletohet në lidhje me to, nëse mendohet se cila do të ishte rruga më efikase e zgjedhur e cila do të shoqërohet edhe me rezultate më positive.

Duke aplikuar përvojën e mëparshme në një detyrë te rë, ti fillon një proces të ri të mësuari. Ti mësosh të vlerësosh çdo eksperincë, qoftë edhe negative, nxjerr mësime prej saj dhe e bën atë të vlefshme në një farë mënyre për ty. Gjithashtu reflktimi është i domosdoshëm edhe për të kuptuar se cila fushë e së drejtës të përshtatet më shumë. Ti mund të vlerësosh se ku je më efikas, cilat janë situatat që të favorizojnë dhe ato që nuk I përballon dot me efektshmëri. Mëson cilat aftësi të tuat janë pika e fortë dhe cilat pika e dobët. Mëson të përmirësohesh, të rritesh, të behësh më i zoti.

Reflektimi është një element i procesit të të mësuarit që mund të realizohet në çdo pikë të ciklit. Mund të refletohet mbi planifikimin dhe performancën për çdo detyrë të dhënë gjatë programit të klinikës. Mësimi është shumë më efikas nëse çdo detyrë, çdo hap i hedhur shoqërohet me procesin e reflektimit.

Vendi i praktiës apo përvojat klinikë janë një ambient shumë i mirë i të mësuarit. Studentët kanë mundësi të vëzhgojnë, të veprojnë dhe në fund të kuptojnë cila mund të jetë puna e tyre e ardhshme apo prioritetet e karrierës së tyre. Edhe pse gjatë jetës profesionale mund të merren vendime të shumta dhe të ndërrohen fushat ku kanë dëshirë të ushtrojnë profesionin, juristët në fillim mund të kuptojnë se ku ata mund të realizohen më mirë profesionalisht. Për këtë ndihmon jo vetëm reflektimi por edhe biseda dhe konsultimi me persona të tjerë. Për shembull mund të flitet me profesorët, me koleget, me prindërit. Të gjitha këto do të shërbejnë si një busull orientimi për studentit që diplomohet për drejtësi, pasi në momentin e diplomimit ai mund të ndihet konfuz dhe i pasigurt në lidhje me dëshirat dhe ambiciet që ka.

Klinika ofron një avantazh të madh edhe se i krijon studentëve siguri në vetvete dhe i rrit vetbesimin. Ata duke prekur nga afër profesionin e tyre dhe duke parë që mund të jenë të suksesshëm dhe t'i kryejnë detyra me sukses, arrijnë të fitojnë besim ne vetvete dhe të kuptojnë rëndësinë e kësaj. Klinika i bën më të pavarur, më të prirur të besojnë në aftësitë e tyre si edhe në forcën që ka avokatia për të zgjidhur problemet e njerëzve dhe të gjithë komunitetit.

Reflektimi është një faktor ndihmës për hartimin e planit të karrierës dhe këtë e bën në disa mënyra. Studentët shikojnë punën në një zyrë avokatie, apo mënyrën se si ndërveprojnë palët në një proces gjyqësor dhe kjo i ndihmon të kuptojnë rolet e palëve në çështjet e ndrsyhme gjyqësore. Ata mund të vëzhgojnë sjelljet e ndryshme profesionale dhe me anë të gjykimit të tyre të vlerësojnë nëse ato janë të duhura apo jo. Edhe pse janë të rinj në fushë studentët janë mjaft të aftë të kuptojnë gabimet apo parregullësitë në një proces gjyqësor por jo vetëm. Duke qënë se ata vijnë direkt nga bankat e shkollës dhe i kanë mësuar gjërat teorikisht janë më të prirur t'i zbatojnë dhe të kërkojnë të zbatohen ligjet siç duhet. Gjithashtu ata kanë pasionin dhe idelaet e një student drejtësie dh kjo bën që ata t'i shohin gjërat me sy kritik dhe të mos tolerojnë parregullësi. Reflektimi mbi atë që kanë dhe përjetuar gjatë përvojës klinike, bisedat, kontaktet, marrëveshjet me njerëz të tjerë, profesionistë apo jo, do të jetë një mënyrë që ata të kuptojnë jo vetëm se si funksionon një ambient i caktuar profesional, për shembull një zyrë avokatie, si edhe nëse ata duan të pjesë e saj apo të përfshihen në një profesion të tillë.

Reflektimi i ndihmon studentët edhe të kuptojnë më mirë aftësitë dhe vlerat e tyre. Ata mund të kuptojnë nëse i pëlqen më shumë puna në grup apo ajo individuale. Gjithashtu mund të kuptojnë nëse i përshtatet roli i liderit në një projekt apo jo. Reflektimi i ndihmon të nxjerrin përfundime mbi pikat e forta apo të dobëta dhe cilat janë mënyrat për të përmirësuar veten. Nëse ata kanë pasur konflikte me udhëheqësin e klinikës ata duhet të reflektojnë mbi këtë, për të kutpuar cilat kanë qënë shkaqet dhe si mund të parandalohej, si edhe cila duhet të jetë sjellja në një situatë të ardhshme analoge për të shmangur një konflikt të tillë. Reflektimi është një proces përmirësimi i vazhdueshëm. Vetëm duke reflektuar mund të kuptohen gabimet, mangësitë dhe të kërkohet përmirësimi. Gjithashtu nëse një student merr një vendim të gabuar gjatë programit të klinikës ai duhet të reflektojë në lidhje me të për të nxjerrë mësim dhe kuptuar shkaqet. Për shembull ai mund të kërkojë të gjejë arsyet se pse zgjidhja e tij dështoi, cili do të ishte vendimi më i drejtë si edhe masat që mund të merren për të minimizuar pasojat negative. Reflektimi mund të realizohet vetëm por edhe në bashkëpunim me profesorin mbikqyrës të klinikës në mnëyrë që të merret një mendim profesional në këtë aspekt. Mënyra se si avokatët veprojnë dhe punojnë në vendin e punës, sjelljet e tyre, vendimet që marrin, të gjitha këto mund të ndihmojnë studentët në procesin e reflektimit për të kuptuar dhe vendosur në lidhje me karrierën e vet profesionale.

Mënyra se si avokatët trajnohen ndikon gjithashtu në mënyrën si ata veprojnë, punojnë dhe janë apo jot ë suksesshëm. Edhe avokatë më të mirë të fushës nuk linidn ekspertë, ata bëhen të tillë. Mënyra e trajnimit të tyre, eksperiencat e tyre ndikojnë në këtë drejtim. Mënyra se si trajnimi ndikon në aftësitë e përfituara mund të ndikojë drejpërdrejt në mënyrën se si praktikohet e drejta dhe mund të influencojë vendimet në lidhje me karrierën. Në fillim mund të rezultojë e vështirë të zbulohet se si avokatët e fitojnë eksperiencën dhe dijet në vendin e punës megjithatë mund t'ia vlejë të zbulohet. Kjo mund të shërbejë edhe në reflektimin e juristëve të rinj dhe t'i ndihmojë ata në hartimin e planit të vet profesional. Në këtë mënyrë mund të krijohen edhe modele sjelljesh të cialat mund të jenë të arrira për t'u ndjekur në fillim, por më pas natyrisht që secili jurist me

eksperiencën dhe përvojën e vet do të krijojë modelin e vet origjinal, i cili do të jetë unik ashtu siç është unik edhe përvoja vetjake e gjithsecilit. Pasi vëzhgohet procesi i punës dhe modelet e sjelljes së avokatëve në vendin e punës, hapi tjetër është reflektimi i aftësive vetjake. Kështu mund të kuptohet nëse student ka mundësi të përshtatet në atë ambient pune, si do të ishte kjo përshtatje dhe cili do të isjte profesioni dhe fusha e së drejtës më e përshtatshme për të.

A ka ndonjë fushë ku e keni ndjerë veten në vështirësi? Në cilën fushë apo detyrë ndiheshit më i aftë? Cilat detyra janë realizuar me më shumë sukses? A përjetuat kënaqësi profesionale dhe u ndjetë i realizuar gjatë përvojës tuaj?

Këto janë disa pyetje që mund t'i bëjë secili vetes për të kuptuar më shumë rreth përvojës dhe aftësive vetjake për t'u përshtatur në atë vend pune. Nëse në një detyrë dalin vështrësi të caktuara duhet të bëhen përpjekje për të kuptuar nëse bëhet faktorë objektivë apo subjektivë. Nëse edhe në detyrat e tjera hasen të njëjtat vështirësi, atëherë ka shumë mundësi që problemi të gjednet te vetë student. Ai duke reflektuar mund të kuptojë se si mund të ndryshojë dhe përmirësimet që mund të bëjë në këtë drejtim. Duke reflektuar mund të kuptohet se cilat aftësi duhet të fitohen apo përmirësohen për të qënë më efektivë në atë fushë të së drejtës. Kjo do të bëjë që edhe përpjekjet të fokusohen në atë drejtim për të çuar në një përmirësim të mundshëm. Nëse edhe pas përpjekeve të caktuara studeni rezulton jo i aftë në atë fushë të së drejtës, atëherë kjo mund të shërbejë si një faktor që tregon se kjo fushë ndoshta nuk është më e përshtatshmja ku ai duhet të bëjë plane dhe të ndërtojë një plan karriere.

Plani i karrierës do të përfshijë atë profesion që konsiderohet si më i dashur dhe më i përshtatshëm nga student. Gjithashtu ai duhet të përmbajë edhe fushat e së drejtës ku a shfaq ambicie dhe aftësi më të mëdha. Shoqëruar me të duhet të përfshihet edhe një listë e atyre aftësive që konisderohen si më të përshtatshme dhe të vyera në këtë profesion sipas vlerësimit të studentit. Këtu mund të përshihen aftësi të ndryshme si; aftësi të mira komunikimi, vendosmëria, besimi, menaxhimi i mirë i situatës, aftësitë bindëse, kërkimi ligjor etj. Gjithashtu mund të përfshihen vlera apo çdo veçori vetjake që sipas mendimit personal është i domosdoshëm për atë profesion po fushë të së drejtës. Në krah të këtyre aftësive duhet të përshihet edhe një listë me disa aftësi që janë të nevojshme për taë profesion por që nuk zotërohen prej tij dhe mënyrat se si mund të përfitohen. Kjo do ta bëjë planin e karrierës më të plotë dhe vërtet të efektshëm për karrierën e ardhshme të studentit. Megjithatë ky plan mund të përmirësohet vazhdimisht edhe si pasojë e përvojave të reja, aftësive të reja të fituara dhe mësimeve të fituara prej tyre. Plani i karrierës ka si qëllim që të shërbejë si një udhërrëfyes për karrierën e ardhshme të studentit dhe ta ndihmojë ata të ecë hap pas hapi në drejtim të realizimit të qëllimeve të tij. Për këtë shërben në një masë të konsiderueshme reflektimi, i cili duhet të shoqërojë çdo përvojë, eksperiencë apo mësim të fituar.

7. 3 Mbikëqyrja

Një prej zgjedhjeve më të zgjuara që mund të bëjë student gjatë klinikës është të gjejë një profesor mbikqyrës. Mbikëqyrja është një fazëë esenciale që klinika të funksionojë dhe të japë rezultatet e dëshiruara. Gjatë përvojës së tij student do të gjendet jo rrallë herë në situata të vështira, në udhëkryqe ku ai nuk do të dijë se çfarë zgjidhje të marrë apo në problem që jo vetëm nuk i ka hasur por as edhe i ka imagjinuar ndonjëherë. Kështu që ai vazhdimisht do të ketë nevojë për ndihmë dhe këshilla nga një profesionist i fushës. Kjo detyrë mund të ushtrohet shumë mirë, ashtu siç duhet dhe me përkushtrimin e nevojshëm dhe t'i forojë ndihmën e nevojshme studentit.

Mbikëqyrja është një fazë pjesë përbërëse e klinikës, por gjithashtu është edhe një mënyrë për t'i ardhur në ndihmë studentëve jo vetëm që t'i kryejnë detyrat sa më mirë por edhe për të mësuar prej saj. Kjo do të thotë që mbikëqyrja e duhur në programin e klinikës rrit mundësitë që rezultatet të jenë më të suksesshme dhe studentët të dalin të kënaqur prej saj. Mbikëqyrja do t'i vijë në ndihmë studentëve edhe në fazën kur ata do të duhet të vendosin dhe planifikojnë për karrierën e tyre të ardhshme. Këshillimi me një ekspert të fushës, i cili në fund të fundit ka qënë vet dikur një student dhe ka kaluar në të njëjtat vështirësi do të jetë një ndihmë por edhe një mbështetje e madhe për studentët duke u ofruar atyre një orientim të vlefshëm për fushën.

Studentët mund të kërkojnë këshilla profesionale nga pedagogu i tyre mbikqyrës si edhe mund të shfyrtëzojnë njohjet e tij për të krijuar mundësi opër veten. Për shembull pedagogu i tyre mund t'i rekomandojë ata për një praktikë apo një vend pune kur ai mendon se ata janë të përshtatshëm dhe kanë aftësitë e nevojshme për të bërë atë si duhet. Pedagogu në këtë rast duhet të tregohet mbështetës dhe mirëkuptues për studentët, pasi ai mund të jetë hallka e parë drejt krijimit dhe kosnsolidimit të karrierës së tyre profesionale. Gjithashtu pedagogu i tyre mbikqyrës duhet të tregohet i vëmendshëm që përvojën e klinikës t'ia u bëjë atyre sa më të bukur por edhe domethënëse sepse prej kësaj mund të varet në një masë të madhe perceptimi që ata fitojnë për profesionin e tyre të ardhshëm, për ëndrrat, planet, karrierën e tyre. Prandaj mund të themi se edhe mbikqyrja është një element bazë që ndikon në krijimin e një plani karriere për studentët. Nëse ajo është e mirë, e kujdesshme dhe efektive atëherë ka shumë mundësi që studentët e klinikës të bëjnë zgjedhjet e duhura në të ardhmen dhe përveç një pedagogu klinike të fitojnë edhe një mik. Mbikqyrja mund të japë rezultatë të paimagjinueshme nëse ajo ushtrohet siç duhet dhe shoqërohet me kujdesin dhe përkushtimin e nevojshëm.

Disa prej detyrave apo funskioneve të pedagogut mbikqyrës gjatë klinikës që lidhen drejpërdrejt me hartimin e një plani karriere janë :

- Këshillimi se sit ë veprohet në vendin e punës për të përfituar sa më shumë prej kësaj experience;
- Paraqitja e sugjerimeve dhe këshillave se sit ë veprohet për të krijuar përshtypje sa më të mirë të kolegët e tjerë;

- Përshkrimi i punës apo i zyrave dhe aktorëve të tjerë pjesmarrës në atë fushë të së drejtës për të krijuar një ide se si mund të bëhesh pjesë e atij ambienti, aftësitë dhe kushtet që duhen plotësuar për t'u realizuar kjo;
- Sugjerimi mbi punën e ardhshme apo ide të vlefshme se ku student mund të jetë më i efektshëm apo ka mundësi të përparojë më shumë në aspektin professional;
- Diskutimi mbi planin e karrierës, dhënia e ideve se ku aim und të ndrsyhohet apo përmirësohet në përputhjem em aftësitë personale por edhe kërkesat e tregut të punës të cilat mund të mos jenë shumë të njohura nga studenti.

Të gjitha këto mund të jenë mendime, këshilla, ide, sugjerime të cilat mund të kryhen nga pedagogu mbikqyrës për studentin pjesmarrës në klinikë. Megjithatë është e këshillueshme që vet student të kërkojë mendim për çdo gjë që ai ka nevojë. Ai mund të kërkojë ide, këshilla, sugjerime, jo vetëm për çështjet profesionale apo detyrat që i janë ngarkuar në klinikë, por për çdo çështje tjetër ku ai ndjen se ka vështirësi dhe kërkon një mendim të arsyeshëm. [166]

Megjithatë, edhe pse inkurajohen të gjithë profesorët e klinikës për të qënë mbikqyrës për studentët e tyre, mbikqyrja si marrëdhënie është e karakterit personal dhe jo të gjithë janë të gatshëm për të hyrë në një marrëdhënie të tillë. Ajo në fakt kërkon përkushtim dhe investim sin ë kohë edhe në energjin në lidhje me studentët e mbikqyrur, prandaj jo të gjithë do të ishin të gatshëm të merrnin përsipër diçka të tillë. Por praktika e realizauar në një zyrë avokatie apo në ambiente të tjera profesionale mund të kriojë mundësi shumë të mira për të krijuar një marrëdhënie të shëndoshë mbikqyrës-student. E rëndësishme është që student të përfitojë prej këtyre mundësive sa më shumë. Ai mund të kërkojë ndihmë nga një koleg i tij me të cilin ka marrëdhënie të mira dhe ai mund të bëjë edhe rekomandime në lidhje me këtë. [167] Karriera profesionale apo e ardhmja në këtë drejtim mund të influencohen drejpërdrejt prej mbikqyrësit apo mendimeve dhe sugjerimeve të përfituara prej tij. Prandaj është e rëndësishme që kjo marrëdhënie të krijohet në mënyrë sa më të shëndetshme që edhe përfitimi prej saj të jetë i tillë.

5. 4 Hapat për planifikimin e karrierës

Planifikimi i karrierës është një çështje shumë e rëndësishme, madje mund të themi se ajo ka një rëndësi jetike. Studentët duhet të planifikojnë karrierën e tyre për të qënë më të përshtatur më tregun e punës dhe të përgatiten për punën që do të kryejnë. Në pamje të parë duket sikur në momentin që kemi zgjedhur të studiojmë drejtësi, kemi zgjedhur edhe karrierën tonë. Por kjo nuk është aspak e vërtetë, pasi fusha e drejtësisë përfshin në vetvete një numër shumë të madh profesionesh apo fushat ku mund të ushtrohet profesioni. Duke studiuar drejtësi mund të jesh në hapat e parë për t'u bërë avokat, jurist, prokuror, oficer i policisë gjyqësore, gjyqtar, noter, përmbarues gjyqësor, ndërmjetës, politika, ambasador, nëpunës i administratës publike, përfaqësues i organizatave jo-fitimprurëse e shumë profesione të tjera. Në fakt studimi i së drejtës është vetëm hapi i

[166] -Manual për profesorët e klinikës së ligjit - botim i Shoqatës për Edukimin e klinikës ligjore, maj 2009, fq 54
[167] Learning from practice – J.P.Ovigly, L.Ëortham, L.G.Lerman, vellimi 2, fq 428

parë, më pas rruga e ndjekur do të jetë e gjatë dhe ajo do të variojë edhe nga zgjdhjet e bëra.

Studentë inkurajohen të bëjnë planifikimin e karrierës dhe kjo në fakt do të ndikojë pozitivisht në të ardhmen e tyre. Madje kësaj i shërbejnë edhe hapja e zyrave ër këshillimin e karrierës në ambientet e fakulteteve ku persona të specializuar këshillojnë studentët në lidhje me hapat që duhet të marrin dhe zgjedhjet e bëra. Këto zyra publikojnë edhe mundësi praktike për studentët dhe mundësi punësimi.

Klinika e ligjit jep një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim sepse ajo bën përballjen e parë të studentëve me ambinetin e punës dhe i përgatit ata për përvojat e ardhshme profesionale. Ata jo vetëm që do të mësojnë vet dhe mund të shkathtësohen me anë të përvojave të përjetuara por kanë mundësi të amrrin ndihmë të drejtëpërdrejtë nga pedagogu i tyre mbikëqyrës, çështje kjo e trajtuar më lart.

Më poshtë po përmendim shkurtimisht hapat në të cilat kalon procesi i planifikimit të karrierës, të cilat do t'i vijnë në ndihmë studentëve të klinikës gjatë përvojës së tyre në klinikë :

- **Vet-vlerësimi.**
  Vet-vlerësimi është ai proces ku vet individi mundohet që me mënyra të ndrsyhme të marrë informacion në lidhje me veten. Me anë të tij mësohet rreth interesave vetjake, vlerave që lidhen me punën, personalitetit dhe sjellejve. Gjithashtu mund të kuptohet më shumë rreth ambienteve të preferuara të punës, nevojat për zhvillim dhe asaj që dëshirohet të arrihet në realitet. Duke vlerësuar të gjitha këto mund të kuptohet cili do të ishte profesioni më i përshtatshëm për të dhe ai që do ta realizojë më mirë profesionalisht.
- **Eksplorimi i karrierës**
  Ky është një hap që synon të zgjedhë nga tërësia e profesioneve ato që i përshtaten më mirë personit bazuar në vlerat dhe aftësitë personale. Mund të zgjidhen punët që duken më interesante. Mund të përcakothen gjithashtu fushat ku dëshirohet të punohet si edhe vlerësimi i tregut të punës. Pas kësaj përzgjedhje mund të eleminohen ato profesione që nuk duken të përshtatshme apo nuk janë në përputhje me veçoritë personale të subjektit. [168]
- **Përputhja**
  Kjo fazë lidhet pikërisht me përshtatjen e atyre profesioneve që i vijnë më shumë për shtat individit bazuar në aftësitë e tij, vlerat, prirjet dhe sjelljet në atë ambient pune. Këtu duhet të zgidhet ai profesion që individi e konsideron si më të vlefshëm dhe interesant por gjithashtu të përcaktohen cilat janë mënyrat për t'u përgatitur më mirë për të dhe bërë më i përshtatshëm.
- **Veprimi**

[168] Learning from practice – Teacher's Manual, J.P.Ovigly, Leah Wortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II, fq 41

Në fund pasi bëhet një vlerësim i gjatë dhe i mirëmenduar, kalohet në planin e veprimit për të marrë masa direkte dhe efektive në lidhje me zbatimin e tij. Në këtë fazë përfshihet plani i karrierës i cili duhet të hartohet me shkrim dhe ai përmban

- Identifikimi i qëllimeve afatgjata dhe afatshkurtra;
- Aplikimi në kurse, trajnime apo shkolla nëse është e nevojshme. Për shembull nëse pasi mbaron studimet në drejtësi një student vendos të bëhet avokat ai duhet të kryejë provimin e avokatisë për t'u pajisur me liçencë në mnëyrë që të ushtroje këtë profesion;
- Zhvillimi i një strategjie pune;
- Shkrimi i një përmbledhje;
- Identifikimi dhe marrja e informacionit për vende të ndryshme pune;
- Hartimi i letrave të motivimit
- Përgatitja për intervistë pune.

Këto ishin hapat të cilat të çojnë në planifikimin e karrierës, të cilin studenti do ta bëjë vet por që është edhe e këshillueshme marrja e mendimeve dhe sugjerimeve nga profesorë, kolegë, prindër në mënyrë që zgjedhjet të jenë sa më të përshtatshme dhe të sjellin rezultatet e dëshiruara.

Kapitulli VIII

Klinika e ligjit në Shqipëri

Përmbajtja : 8. 1 Sa njihet klinika e ligjit në Shqipëri?; 8. 1. 1 Njohja e klinikës nga studentët e së drejtës; 8. 1. 2 Njohja e klinikës nga komuniteti; 8. 2 Klinika e ligjit në Fakultetin e Drejtësisë

8. 1 Sa njihet klinika e ligjit në Shqipëri

Klinika e ligjit përbën një risi për sistemin arsimor shqiptar. Ajo nuk ka qënë një nga lëndët e aplikueshme në fakultetet e së drejtës dhe gjithashtu nuk njihej nga komuniteti si një mënyrë për të përfituar akses në sistemin e drejtësisë. Sistemi arsimor në Shqipëri për një kohë të gjatë u ndikua nga modeli rus i mësimdëhnies i cili u bazua në mësimet teorike dhe të një shkalle të lartë vështirësie për nxënësit por edhe studentët në universitete. Metodat tradicionale të mësimdhënies janë metoda të cilat shpesh kanë krijuar frustrim te studentët duke i bërë ata të kenë frikë auditorin dhe provimet. Këto metoda të bazuara në mësimet vetëm në auditorë, seminaret dhe provimet e vështira shpesh nuk kanë rezultuar aq efektive duke bërë që studentët të fokusohen te marrja e një note të mirë më shumë se te procesi i të mësuarit dhe të nxënit të dijeve. Megjithatë duke parë përvojat e huaja që bazohen në një të mësuar më fleksibël, mësimdhënie më pranë nevojave të studentëve dhe jo metoda të ashpra vlerësimi por inkurajuese, edhe sistemi arsmior shqiptar po synon një reforimim në këtë drejtim. Synohet që procesi i mësimdhënies të jetë i fokusuar në mësimin e vërtetë të studentëve duke ia bërë atyre dijen më të lehtë, më të bukur dhe interesante. Këtë objektiv ka edhe klinika e ligjit. Ajo ka në fokus praktikën e ligjit për të gjitha degët e së drejtës duke bërë që studentët të ndihen të kënaqur dhe të motivuar gjatë mësimit. Ata me anë të klinikës kanë mundësi të

përfshihen realisht në profesionet ligjore, të marrin detyra dhe përgjegjësi reale, dhe kjo i ndihmon të mësojnë shumë më tepër. Gjithashtu ata jo vetëm mësojnë rreth profesionit të ardhshëm, por mësojnë edhe ta duan të drejtën dhe ligjin, të jenë të motivuar për të mbrojtur çështje reale dhe kauza të rëndësishme në drejtim të mbrojtjes të së drejtave të komunitetit.

Pikërisht në mënyrë që të kemi një progres në sistemin universitar sidomos në atë të drejtësisë, klinika ka filluar të përfshihet në programin akademik të Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës. Megjithatë fillimisht është e rëndësishme të trajtohet klinika e ligjit në apsektin se sa njihet nga studentët shqiptarë. Në fillim është e nevojshme njohja e klinikës prej studentëve dhe më pas prej komunitetit të gjerë. Kjo, pasi ajo do të aplikohet dhe do të vihet në zbatim pikërisht prej studentëve të drejtësisë. Ata duhet ta njohin, ta vlerësojnë dhe të angazhohen duke u përfshirë në programin e saj në mnëyrë që më pas ta promovojën atë te të tjerët.

8. 1. 1 Njohja e klinikës nga studentët e së drejtës

Në një studim të realizuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë është synuar të njihet në rradhë të parë informacioni që kanë studentët e së drejtës në lidhje me klinikën e ligjit dhe mendimi apo perceptimi që kanë ata për të. Ky studim u nda në dy pjesë. Në rradhë të parë u pyetën studentët që e kanë zgjedhur klikën e ligit si lëndë me zgjedhje, por që janë ende në fillim të programit akademik, pra njohuritë e tyre nuk vijnë kryesisht nga programi akademik, por kemi të bëjmë me njohuri të përgjithshme që ata i kanë përfituar në mënyra të tjera, nga burime të ndryshme informacioni. Pjesa e dytë e studimit në ambientet e fakultetit u fokusua te studentët e së drejtës që nuk janë pjesë e programit të klinikës, duke dashur të zbulohet sa e njohin dhe e mirëkuptojnë ata klinikën e ligjit.

Nga një studim mbi klinikën në Fakultetin e Drejtësisë rezultoi se shumica e studentëve që përfshihen dhe e zgjedhin klinikën si lëndë me zgjedhje e njohin atë dhe i pranojnë avantazhet që ajo sjell. Madje kjo është edhe e arsyeshme, sepse ata e zgjedhin klinikën pikërisht për këtë arsye, për të përfituar prej avantazheve që ajo sjell. Duke dashur të praktikojnë të drejtën dhe të mësojnë më shumë aftësi profesionale ata i drejtohen klinikës duke u angazhuar aktivisht në programin që ajo ofron. Pikërsisht për të kuptuar masën në të cilën njihet klinika, perceptimin që kanë studentët për të dhe misionin që ajo ndjek është realizuar një studim për të marrë mendimin e tyre në lidhje me këtë çështje.

Përpara se të analizojmë rezultatet e studimit po paraqesim anketën e drejtuar studentëve të drejtësisë në lidhje me klinikën e ligjit, si lëndë e re në fakultetin e drejtësisë.

Ankete

Ju lutemi të shënoni me kryq hapësirën sipas përgjigjes së dëshiruar. Kjo është një anketë dhe ju nuk keni pse të jepni informacion mbi identitetin tuaj.

1. A e njihnit klinikën e ligjit para se ta frekuentonit atë si lëndë me zgjedhje?

a. Po b. Jo

2. Klinika e ligjit ka në fokus :

a. Ofrimin e ndihmës falas për kategori vunerabël të popullsisë

b. Ofrimin e praktikës të së drejtës për studentët e drejtësisë

c. Nxjerrjen e fitimeve ekonomike nga ndihma ligjore që ofron

d. A dhe b

3. Cilat janë avantazhet që mendoni se përfitoni nga klinika :

a. Fitoni aftësi të mira komunikimi

b. Mësoni të zgjidhni çështje ligjore në mënyrë profesionale

c. Fitoni kontakte që do t'ju duhen për të ardhmen

d. Planifikoni karrierën tuaj

e. Fitoni aftësi të nevojshme për profesionin që doni të ushtroni

4. Cilat janë degët e së drejtës ku mendoni se klinika do të ishte me e përshtatshme për t'u aplikuar :

a. E drejta penale

b. E drejta civile

c. E drejta familjare

d. Të drejtat e njeriut

e. E drejta e konsumatorit

5. Mendoni se klinika e ligjit është një fushë e nevojshme për sistemin akademik shqiptar :

a. Po b. Jo

6. A do të donit që klinika e ligjit të ishte lëndë e detyrueshme e programit akademik :

a. Po b. Jo

7. A ju pëlqen përvoja e deritanishme në klinikë dhe ju rezulton e vlefshme :

a. Po b. Jo

8. A do t'ia rekomandonit klinikën kolegëve tuaj më të rinj në moshë :

a. Po b. Jo

9. Cilat nga përvojat e mëposhtëme i konsideroni si më të përshtatshme për t'u praktikuar në orën e klinikës :

a. Marrja për përfaqësim falas të një çështje ligjore që ka palë individë që nuk mund ta përballojnë ndihmën ligjore

b. Këshillimi falas i popullsisë për probleme të ndryshme juridike që ata kanë

c. Diskutimi në klasë në lidhje me problemet e zbatimit të ligjit në praktikë

d. Organizimi i gjyqeve imitues

10. A e njohin të afërmit apo miqtë tuaj klinikën e ligjit :

a. Po b. Jo c. Disa prej tyre d. Pjesa më e madhe

Ju falenderojmë për bashkëpunimin. Punë të mbarë !

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten në mënyrë grafike njohuritë që kanë studentët pjesë e klinikës për klinikën e ligjit, misionin dhe objektivat që ajo ndjek.



Fig. 4

Siç mund të shihet në grafikun e mësipërm, klinika e ligjit njihet në një masë shumë të madhe nga studentët e klinikës. Megjithatë kjo është e natyrshme, sepse ekziston një arsye se pse ata e kanë zgjedhur klinikën si lëndë. Megjithatë po t'i referohemi njohurive rreth misionit të saj ata nuk janë shumë të qartë. Shumë prej tyre mendojnë se misioni i vetëm është praktika e ofruar për studentët. Të tjerë mendojnë se misioni i klinikës është vetëm të ofrojë ndihmë juridike falas për njerëzit në nevojë. Ata edhe pse janë pjesë e

klinikës nuk janë shumë të qartë për misionin e saj, objektivat dhe qëllimet që ndjek. Në lidhje me avantazhet shumica e studentëve ishin të qartë rreth avantazheve që merrnin prej saj, pikërisht sepse ata po i përjetojnë vet këto ndryshime pozitive. Edhe pse kishte kategorizime të ndryshme në lidhje me aftësitë që ata merrnin prej klinikës, ata përgjithësisht ishin të qartë në këtë pikë. Megjithëse vlerësimi i tyre varionte mbi aftësi që ata personalisht i konsideronin më të rëndësishme, studentët mund të identifikonin avantazhet që klinika sillte për ta dhe për komunitetin. Në lidhje me pritshmëritë këto mund të them se janë shumë të larta. Studentët e vlerësojnë klinikës dhe e mendojnë atë si një lëndë të vlefshme me përfitime të shumta. Ata shprehën dëshirën që ajo të bëhej pjesë e pandarë e programit akademik sepse e shihnin të vlefshme praktikën e ofruar prej saj. Gjithashtu ata rekomandonin që klinika të aplikohej për të gjithë brezat e ardhshëm në mënyrë që edhe atyre t'u jepej mundësia të përjetonin eksepriencat që ata po kalojnë si edhe të fitonin aftësi që ata i vlerësojnë si shumë të rëndësishme për profesionin e avokatit.

Megjithatë mund të themi se rezultatet te studentët e klinikës janë mjaft pozitive duke amrrë parasysh që ajo është një lënde e re me përvojë disa-vjeçare në fakultetin e drejtësisë, jo të njëjtat rezultate shfaqen në studimin e realizuar në studentë në përgjithësi të fakultetit. Aq më pak shpresëdhënëse janë rezultate po t'i referohemi njihirve dhe perceptimit që kanë për klinikës njerëz të thjeshtë të komunitetit, pa formim juridik.

Krahas studimit në lidhje me klinikën për studentët e kliniës e ligjit, u realizua studimi në pjesën e tij të dytë te studentët e drejtësisë, por që nuk janë pjesë e programit klinik. Duke qënë se ne Fakultetin e Drejtësisë klinika e ligjit është ende një lëndë me zgjedhje, atyre iu jepet mundësia ta zgjedhin atë duke u përfshirë në programin e saj ose jo.

Grafiku i mëposhtëm do të japë informacion në lidhje me mendimin dhe njohuritë që kanë këta studentë në lidhje me klinikën e ligjit.



Fig. 5

Ashtu siç mund të vërehet në këtë grafik, shohim se njohuritë e studentëve në lidhje me klinikën e ligjit janë shumë të pakta se studentët e klinikës. Madje, edhe kur ata e njohin klinikën, nuk kanë informacion të saktë në lidhje me misionin e saj apo avantazhet që ajo sjell. Kjo tregon për nevojën e madhe për të përhapur informacion në lidhje me klinkën që ajo të njihet, të kuptohet dhe vlerësohet në fakultet. Nëse studentët do të jenë të interesuar për të atëherë do të bëhen pjesë e saj dhe do të zhvillojnë edhe më shumë klinikën si një program akademik. Gjithashtu ata do të kenë mundësi të përfitojnë prej saj, si eksperienca të vlefshme ashtu edhe aftësi dhe vlera dhe do të kenë mundësi të ndihen të vlefshëm në komunitet.

Ndërsa në lidhje me pritshmëritë ato ishin mjaft pozitive dhe kjo është mjaft e vlefshme në klinikë. Sapo ata marrin dijeni ëpr klinikën dhe asaj që ajo ofron ata janë të gatshëm të bëhen pjesë dhe mendojnë se është e nevojshme përfshirja e saj si pjesë e programit akademik. Kjo është një arsye e mirë për zhvillimin e klinikës dhe një faktor nxitës për klinikën e ligjit në ambientet universitare.

Të gjithë këta faktorë tregojnë se edhe pse nuk ka shumë informacion për klinikën në ambientet e fakultetit të drejtësisë, studentët janë të prirur ta mbështesin dhe të bëhen pjesë e programit të saj.

8. 1. 2 Njohja e klinikës nga komuniteti

Po t'i referohemi të njëjtin studim por të drejtuar te komuniteti në pëegjithësi, te njerëzit e thjeshtë që nuk kanë njohuri juridike, rezultatet nuk janë kaq shpresëdhënëse. Të njëjtat anketa u realizuan në një studim drejtuar anëtarëve të thjeshtë të komunitetit dhe ata dhanë përgjigje në lidhje me njohuritë që kanë mbi klinikën, sa e njohin atë dhe perceptimin që kanë mbi të në përgjithësi. Rezultatet e këtij studimi paraqiten më poshtë :



Fig. 6

Siç mund të shihet nga grafiku i mësipërm, tregon se klinika e ligjit njihet shumë pak nga komuniteti i gjerë. Shumica e të anketuarve nuk kishin dijeni se çfarë ishte klinika. Gjithashtu ata nuk arrinin as ta identifikoni atë si një lëndë në fakultetin e drejtësisë, por nga emri i saj kishin një perceptim se i referohej fushës mjekësore. Gjithashtu ata edhe më pak kishin dijeni për misionin dhe objektivat që ajo ndjek. Kjo në fakt është e natyrshme, pasi duke qënë se ata nuk kishin dijeni për klinikën aq më pak do të kishin dijeni për misionin që ajo ndjek. Në lidhje me avanyazhet që ajo sjell, ata mund të identifikonin disa përfitime për studentët në lidhje me praktikën që klinika i ofron atyre.

Veçori karakteristike në këtë studim është fakti që në momentin që atyre i shpjegohej çfarë është klinika dhe misionin që ajo ndjek, ata shprehën shumë entuziazëm në lidhje me të. Pra siç shihet nga grafiku pritshëmritë e komunitetit në lidhje me klinikën janë shumë të mëdha. Por këto pritshëmri ekzistojnë vetëm pasi atyre u jepet informacion në lidhje me klinikën, informacion të cilin nuk e kanë vet. Ata vlerësuan se klinika do t'i ndihmonte në zgjidhjen e problemeve ligjore me të cilat ata përballen shpesh dhe që nuk kanë mundësi t'i zgjidhin për shkak të problemeve në lidhje me aksesin në drejtësi. Ata shprehen se ndihma ligjore falas për kategori vunerabël do të ishte një ndihmë shumë e madhe për komunitetin shqiptar, ku problemet ekonomike dhe ligjore ndërthuren me njëra tjetrën. Këtu mund të përfshihet ndihma për njerëzit e moshuar që nuk kanë përkrahje apo mjete monetare për të siguruar ndihmën e një avokati. Gjithashtu mund të ndihmohen fëmijët e mitur që kanë probleme me drejtësinë, apo që janë në mungesë të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe kanë nevojë për t'u vendosur në kujdestari. Ndihmë ligjore falas e parë në kontekstin e realitetit shqiptar mund të ishte ndihma ofruar ndaj femrave të dhunuara që kërkojnë lëshimin e urdhrit të mbrojtjes apo urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe kanë nevojë për ndihmë juridike falas. Kjo ndihmë mund të ofrohet edhe për organizatat jo-fitimprurëse që kanë si objektiv mbrojtjen e këtyre individëve. Gjithashtu mund të ndihmohet çdo individ që ka një mosmarrëveshje apo një problem të caktuar ligjor, që ndodhet në kushtet e cënimit të të drejtave të njeriut dhe nuk mund t'i drejtohen drejtësisë për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Pikërisht për shkak të ndihmës së madhe që klinika mund të ofrojë në shërbim të komunitetit, anëtarët e saj u shprehën shumë entuziastë në lidhje me të. Ata gjithashtu shprehën mendimin se klinika do t'i shërbejë jo vetëm shoqërisë, por edhe studentëve të drejtësisë që do të kenë mundësi të praktikojnë të drejtën dhe do të fitojnë aftësi reale.

Pra, mund të themi se pavarësisht se klinika njihet shumë pak në shoqëri për shka të mungesës së informacionit, pritshmëritë në lidhje me të janë mjaft të mëdha. Pikërisht për këtë arsye është e nevojshme që klinika të përhapet si një mjet për ndihmë ligjore falas në komunitet, duke i dhënë atyre një ndihmë reale dhe të vlefshme në këtë drejtim. Megjithatë këtu e domosdoshme është përhapja e informacionit për klinikën në mënyrë që ajo të njihet në të gjithë shoqërinë. Vetëm në këtë mënyrë klinika do të shërbejë si një mjet efektiv për ndihmën ligjore, pasi nëse ajo nuk njihet nuk do të shërbejë. Individë të ndryshëm të komunitetit mund t'i drejtohen asaj vetëm nëse kanë informacion në lidhje me të. Prandaj informimi i komunitetit përbën një domosdoshëmri për klinikën e ligjit në

mënyrë që ajo të shërbejë jo vetëm si një program akademik në ndihmë të studentëve, por edhe që të afirmohet si mjet për t'i ardhur në ndihmë kategorive vunerabël të popullsisë. Për këtë janë përgatitur borshura dhe fletë-palosje informuese nga klinika e ligjit në fakultetin e drejtësisë me ndihmën dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të USAID. Megjithatë pavarësisht kësaj, nevojitet më shumë punë që shoqëria shqiptare të njihet me klinikën, misionin dhe avantazhet që ajo sjell dhe t'i drejtohen asaj për probleme të caktuara ligjore me të cilat ata përballen. Gjithashtu hapa të rëndësishëm duhen ndërmarrë edhe për informimin në zonat rurale të vendit, në fshatra, zonat periferike, aty ku informacioni depërton me më shumë vështirësi, por që këto gjithsesi janë zona me probleme të mëdha dhe mundësi të pakta ekonomike.

8. 2 Klinika e ligjit në Fakultetin e Drejtësisë

Së fundmi po trajtojmë zbatimin dhe implementimin e klinikës së ligjit në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, si një prpgram risi por shume premtues në lidhje me programin akademik në drejtësi. Fakulteti ynë i Drëjtësisë prej një periudhe 4 vjeçare aplikon klinikën e ligjit si një prej lëndëve me zgjdhje, të cilat nuk bëjnë pjesë në kurrikulat e detyrueshme. Studentët e klinikës kanë mundësi që me dëshirën e tyre të zgjedhin klinikën e ligjit, si lënëdë që dëshirojnë ta frekuentojnë dhe vetëm pas kësaj ata kanë mundësi të bëhen pjesë në programin akademik që ajo ofron.

Klinika e Ligjit e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (FDUT) ofron ndihmë juridike falas për personat në pamundësi ekonomike për të përballuar ndihmë nga avokati. Ajo e mbështet veprimtarinë e saj në punën vullnetare të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë.

Ndihma juridike ofrohet nga studentët e Klinikës nën kujdesin e pedagogut përgjegjës të lëndës "Klinika e Ligjit" në të drejtën publike, penale dhe civile.

Pra, Klinika është një mekanizëm përmes të cilit synohet përsosja e mëtejshme e procesit të edukimit të studentëve të drejtësisë në programin "Master" përmes harmonizimit të dijeve teorike me praktikën e zbatimit të ligjit.

Studentët që përzgjedhin lëndën "Klinika e Ligjit" kanë mundësi të përfshihen në përgatitjen e opinioneve ligjore, përpilimin e dokumenteve apo akteve juridike.

Ata mund të punojnë drejtpërdrejt me klientë si dhe të përfitojnë nga trajnimet e aftësimit praktik të ofruara për këtë qëllim. Klinika e Ligjit funksionon në bazë të një statuti dhe rregulloreje të posaçme.

Klinika e Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), po vazhdon zbatimin e projektit "Fuqizimi i lëndës së Klinikës së Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe aftësive praktike të studentëve në ofrimin e shërbimit ligjor për shtresat në nevojë" mbështetur nga Programi i USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST). Duke synuar forcimin e mëtejshëm të Klinikës së Ligjit dhe rrjedhimisht, të

grupeve në nevojë, përmes ofrimit të shërbimit ligjor, rritjes së kapaciteteve dhe aftësive praktike të studentëve të Klinikës në dhënien e ndihmës ligjore falas, për shtresat në nevojë, janë realizuar deri disa veprimtari dhe aktivitete, të cilat paraqiten përmbledhtazi, më poshtë:

- Ofrimi i shërbimit ligjor falas për grupet në nevojë, në mënyrë të veçantë për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Studentët kanë informuar, këshilluar dhe kanë përgatitur opinione ligjore për rastet konkrete që i janë referuar Klinikës së Ligjit nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. Për informimin, këshillimin dhe përgatitjen e opinioneve ligjore ata kanë punuar nën mbikëqyrjen e Avokateve të QNL-së dhe pedagogut përkatës të lëndës. Përmes këtij angazhimi të drejtpërdrejtë të studentëve është mundësuar forcimi i njohurive dhe aftësive praktike.

2.Organizimi i trajnimeve me studentët e Klinikës së Ligjit. Këto trajnime kanë kontribuar në rritjen dhe forcimin e aftësive të studentëve të Klinikës së Ligjit. Për këtë qëllim janë organizuar dy trajnime 2-ditore me temë: ”Strengthening of practical skills of the students of Legal Clinic.” Prezantimet e mbajtura nga Prof.As.Dr. Evis Alimehmeti, Prof.As.Dr.Orjona Muçollari, Prof. Alban Koçi dhe Avokatet e QNL-së, trajtuan njohuri teorike dhe praktike të temave përkatëse. Gjithashtu pjesë e rëndësishme e këtyre trajnimeve ishin edhe diskutimet

interaktive, të cilat i ndihmuan studentët e klinikës së ligjit që tëpasqyronin problematikat e hasura gjatë shërbimit që ata ofrojnë në klinikë.

3. Organizimi i bisedave të ndryshme me studentë të Fakultetit të Drejtësisë mbi Klinikën e Ligjit dhe aktivizimi i tyre në veprimtaritë e Klinikës. Organizimi i këtyre bisedave ka për qëllim që të promovojë veprimtaritë që zhvillohen në kuadër të këtij projekti, me qëllim rritjen e informimit mbi lëndën e Klinikës së Ligjit dhe të aktivitetit të saj, si dhe aktivizmit studentor në të. Në këtë kuptim janë organizuar disa takime informuese jo vetëm me studentë të Fakultetit të Drejtësisë, po edhe me institucione të tilla si: Gjykata e Apelit, Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj. Ajo çfarë vlen të përmendet është fakti se të gjithë studentët që kanë marrë pjesë në këto biseda informuese kanë shprehur interes në lidhje me aktivitetin e Klinikës së Ligjit dhe mundësitë për t’u angazhuar pranë saj.

Klinika e ligjit në fakultetin e drejtësisë funksionon në bazë të statutit dhe rregullores së klinikës së ligjit. Rregulorja e miratuar nga bordi i klinikës, është akti që rregullon organizimin e punës në Klinikën e ligjit të fakultetit të drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Rregullorja i shtrinë efektet mbi bordin, studentët dhe pedagogët e klinikës.

Rregullorja, në bazë të nenit 3 të saj përçakton rregullat në lidhje me :

1. Kushtet e dhënis së ndihmës juridike
2. Ndarjen e çështjeve që vijn pranë klinikës

3. Mbrojtjen e të dhënave personale të klientëve

4. Kushtet e punës

5. Të drejtat e detyrimet të studentëve dhe bordit të klinikës.

Ashtu si në të gjitha klinikat ligjore edhe në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, studentët e klinikës e ofrojnë ndihmën juridike vetëm nën kujdesin e pedagogut përgjegjës. Klinika i bënë të qartë klientit se çështja do të ndiqet nga një student, dhe për këtë çështje nuk mund të ketë vepruar më parë një këshilltar tjetër ligjor apo edhe një avokat. Gjithmonë në mbrojtje të interesit publik, klinika vetëm çështjet e personave të çilët nuk mund të mbulojnë shpenzimet për përfitimin e një ndihme tjetër të speçializuar juridike.

Ndryshe nga disa klinika të tjera, klinika nuk bën përfaqësimin e klientëve në gjykatë. Ajo kufizohet vetëm në dhënien e opinionit dhe këshillimit juridik. Ky opinion jepet vetëm me shkrim. Në asnjë mënyrë opinion i përgatitur apo shkresa procedurale nuk mund ti paraqitet klientit pa u aprovuar fillimisht nga pedagogu përgjegjës. Në raste kur studentët hasin vështirësi në lidhj me një çështjë të çaktuar kërkojnë ndihmën e pedagogut ose bordit të klinikës.

Studentët e Klinikës janë të detyruar të ruajnë sekretin e të dhënave personale të Klinikës,si edhe të dhënat personale të klientëve. Pedagogu i lëndës është dhe pedagogu përgjegjës i klinikës. Ai bashkëvepron me studentët në mbarë vajtjen e punës,në mësimin sa më efektiv të metodave praktike,si dhe në mbrojtjen e interesit më të lartë,interesit të klientit.

Edhe pse një metodë e re praktike,Klinika e Ligjit në Fakultetin e Drejtësisë,është një hap shumë i rëndësishëm në përmirësmin e edukimit praktik ligjor te studentëve dhe në mbrojtjen e interesit më të lartë publik.

Përvec Klinikës Ligjore të Fajuktetit të Drejtësisë, së fundmi me mbështjetn financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ultëta në Tiranë, Shkolla e Magjistraturës do të fillojë realizimin e projektit të Klinikës ligjore dhe kërkimore në bashkpunim me universitetin e Utrechtit, Hollandë.

Projekti synon të kontibuojë në transparencën e sistemit gjyqësor në Shqipëri, dhe gjithashtu për rritjen e besimit të qytetarëve tek sistemi gjyqësor dhe shteti is ë drejtës.

Qëlimi i klinikës është ofrimi i konsulencës juridike në formën e nje pune kërkimore e shkencore për Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë dhe Prokurorinë e Përgjithshmë ne lidhje me cështje konkrete të komplikuara, të cilat kërkojnë përgjigje me natyrë krahasuese dhe juridike. Produkti final i programit të Kliniks Ligjore dhe Kërkimore do të jenë memorandumet ligjore që do të vihen në dispozicion të institucioneve të mësipërme.

Një ndër objektivat e këtij program është futja e programit të Klinikës Ligjore dhe Kërkimore në kurrikulumin e detyruar të magjistratëve në Shkollën e Magjistraturës.

Shkolla e Magjistraturës në këtë ndërrmarjë do të ndihmohet nga Shkolla e Drejtësisë e Universitetit të Utrechtit, e cila ka një përvojë shumë të madhe ne edukimin klinik sepse jep konsulencë ligjore pro bono për Gjykatën e Hagës dhe Gjykatën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Pervec kesaj,klinika ligjore ka nje rendesi te vecante,si mjet i ndihmes ligjore,ne programet qe i jane ofruar Shqiperise ne periudha te veshtira ligjore qe ajo ka hasur. Per shembull, në planet strategjike të OSFA-s, Programi i Drejtësisë përfshin një plan veprimi të gjerë në disa nivele njëherësh. Si fillim, gjatë vitit 1997, me rishfaqjen e dukurisë së vetëgjyqësisë dhe të një klime të përgjithshme konflikuale në shoqërinë shqipare, OSFA nisi të mbështesë çështjet e zgjidhjes së konflikteve dhe të edukimit qytetar me parimet e dialogut. Krahas kësaj, nisi mbështetja edhe për çështjet e konsolidimit të shtetit, institucioneve publike e shtetit të së drejtës dhe përmirësimi i fragmentimit dhe disintegrimit social. Programi i Drejtësisë, veçanërisht për vitet 2000-2005, parashikoi si një nga qëllimet e tij të rëndësishme "Aksesin në drejtësi". Ky qëllim dhe objektivat e tij përkatëse kishin si tregues kryesor hapjen dhe forcimin e klinikave të ndihmës ligjore, rritjen e numrit të klientëve në këto qendra, rritjen e bashkëpunimit me kanalet televizive dhe radiot për realizimin e emisioneve të veçanta mbi ligjin, botimin e teksteve "street laë", rritjen e interesit nga aktorët dhe donatorët e tjerë. "Aksesi në drejtësi" u përcaktua si një nga shtyllat e Programit të Drejtësisë të OSFA-s. Kjo ndërhyrje do të zbatohej, kryesisht, përmes punës për krijimin dhe forcimin institucional të qëndrave të ndihmës ligjore, mbështetjes së operatorëve të të drejtave të njeriut në Shqipëri, të Fondacionit për Zgjidhjen e Konflikteve dhe Ndërmjetësimit, si dhe përmes mbështetjes së projekteve të veçanta që do të kishin të bënin me "Aksesin në drejtësi".

Duke njohur rolin e klinikave ligjore në vendet në zhvillim në rritjen dhe përmirësimin e "Aksesit në drejtësi" dhe në luftën kundër varfërisë, Programi i Drejtësisë i OSFA-s ka synuar që klinikat ligjore të bëheshin një mjet i rëndësishëm në zbatimin e reformës ligjore për përmirësimin e aksesit në drejtësi, luftës ndaj korrupsionit dhe në zbatimin e strategjisë së përgjithshme për uljen e varfërisë në Shqipëri. Këto zhvillime kërkonin një rivlerësim të strategjive dhe të veprimtarive konkrete të shoqërisë civile, veçanërisht, të organizatave të të drejtave të njeriut si Komiteti i Helsinkit dhe Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut. Në mënyrë të veçantë, në planin strategjik të OSFA-s ishte përcaktuar mbështetja për Fondacionin Zgjidhja e Konflikteve dhe e Ndërmjetësimit, duke synuar uljen e numrit të vetëgjyqësisë. Do të jepej ndihmë ligjore dhe sociale për individët dhe grupet sociale në konflikt. Ndërhyrja e OSFA-s u bazua kryesisht në këtë plan strategjik por edhe duke mbajtur një qëndrim elastik ndaj tij për shkak të nevojave dhe prirjeve të reja të publikut shqiptar të vëna re nga vetë klinikat e krijuara dhe mbështetura nga OSFA, nga FZKM, Komiteti i Helsinkit dhe Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, si dhe në raport të ngushtë me politikat e integrimit europian të vendit.

Përdorimi dhe përfitimi nga të drejtat dhe liritë e parashikuara me ligj nuk është i njëjtë për të gjithë individët dhe shtresat shoqërore. Në varësi të shkallës së arsimimit dhe kushteve shoqërore, shërbimi ligjor në Shqipërinë e tranzicionit nuk u përgjigjej dot të gjitha shtresave dhe individëve. Këtë boshllëk do të duhej ta mbulonin sipas përvojës perëndimore klinikat ligjore. Këto klinika, që nisën të krijohen gjatë vitit 1999, të ndërtuara me mbështetjen e Programit të Drejtësisë të OSFA-së, janë pjesë e skemës joqeveritare të ndihmës ligjore në Shqipëri. Ato do të vepronin në ato fusha ku kishte mangësi të shërbimit të avokatisë si psh: për raste që kanë të bëjnë me sistemet e përfitimit të ndihmës sociale, çështje të së drejtës familjare (raste divorcesh, detyrimi ushqimor, etj), të së drejtës së punës, etj. Shërbimet ligjore falas, tashmë u krijojnë mundësi njerëzve dhe grupeve në nevojë, të përdorin në mënyrë të organizuar legjislacionin dhe ndihmën e strukturave të shtetit për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Që në fillimet e këtij projekti OSFA synoi që shërbimet ligjore në Shqipëri të zhvillohen të pavarura nga shteti. Financimi i tyre, krahas financimit të konsiderueshëm kryesor të OSFA, ka qënë tërësisht nga donatorë të huaj. Nëpërmjet krijimit, forcimit institucional dhe ndërtimit të kapaciteteve të këtyre klinikave ligjore, Programi i Drejtësisë i OSFA-së ka ndikuar drejtpërsëdrejti në:

- rritjen e cilësisë së gjykimit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut edhe në çështjet civile, në zbatimin real të së drejtës për një proces të rregullt;

- ndërtimin e një klinike alternative të ndihmës ligjore për çështjet penale në Shqipëri e cila u krijua dhe u mbështet nga Programi i Drejtësisë i OSFA-së dhe njihet si klinika e ligjit.

Po kështu, OSFA ka mbështetur klinikat ligjore që krahas shërbimit ligjor të ofrojnë edhe shërbim paraligjor duke mundësuar kështu aksesin e individëve dhe grupeve në nevojë edhe në organeteadministratësshtetërore.

Llojet e shërbimeve të janë të shumëllojshme si: këshilla ligjore të thjeshta, përpilimi i dokumenteve të ndryshme (si kërkesë-padi, etj), përfaqësime në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor dhe në Gjykatën Kushtetuese, duke siguruar kështu një premisë të rëndësishme për aksesefektiv. Programi i Drejtësisë i OSFA-së, në bashkëpunim me klinikat ligjore, ka punuar për lidhjen formale midis ndihmës ligjore dhe shërbimeve ligjore private, për ndërgjegjësimin e komunitetit të juristëve, veçanërisht të gjyqtarëve dhe avokatëve privatë për rëndësinë e klinikave ligjore. Kohët e fundit, shërbimet ligjore falas kanë tërhequr edhe shërbime vullnetare nga avokatët apo zyrat private të avokatisë. Gjithashtu, pjesëmarrja e Dhomës Kombëtare të Avokatisë në përpjekjet e klinikave ligjore për përfshirje në ligj të detyrimit të avokatëve për ofrim të ndihmës ligjore mund të cilësohet si një ndër arritjet e sukseshme të mbështetura nga OSFA. Klinikat ligjore të ngritura dhe mbështetura nga OSFA gjatë viteve 2000 – 2005 kanë qënë: Shërbimi Ligjor

Falas, Tiranë (TLAS), Klinika e Ligjit, Klinika e të Miturve, Projekti i Ndihmës Ligjore, Vlorë, etj.

Midis grupeve që kanë përfituar nga ndihma dhe shërbimet e klinikave ligjore, Bashkësia Rome ze një vend të rëndësishëm. Që në fillim të veprimtarisë së tyre, klinikat ligjore të mbështetura nga Programi i Drejtësisë kanë patur një kujdes të veçantë për plotësimin e nevojave ligjore të këtij komuniteti. Duke qenë se problemi i mosregjistrimit të lindjeve të fëmijëve romë ishte evidentuar qartë nga Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom në Shqipëri, klinikat ligjore nisën punën për të dhënë ndihmesën e tyre edhe në këtë çështje

Klientët dhe individët romë që kanë përfituar nga zbatimi i shërbimeve të mirëfillta ligjore të ofruara nga klinikat ligjore arrijnë në më shumë se 500 veta. Psh vetëm në një prej klinikave ligjore, në Shërbimin Ligjor Falas, Tiranë (TLAS), janë mbaruar procedurat gjyqësore dhe administrative për regjistrimin e lindjeve për më shumë se 150 individë romë. Nga puna e klinikave ligjore, ky komunitet ka përfituar të gjithë radhën e shërbimeve ligjore. Po kështu, nëpërmjet organizimit të seminareve, janë ndërgjegjësuar përfaqësues të shoqatave rome mbi të drejtat dhe detyrat e tyre, për rëndësinë e forcimit dhe mirëfunksionimit ligjor të shoqatave. Më tej, klinikat ligjore kanë bërë edhe regjistrimin ligjor të shoqatave me anëtarë nga komuniteti rom.

Ndërhyrja e klinikave ligjore të mbështetura nga Programi i Drejtësisë dhe veçanërisht, e Klinikës së të Miturve dhe Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) për regjistrimin e komunitetit rom ka qenë shumë e rëndësishme. Mosregjistimi për këtë komunitet, por jo vetëm për ta, thellon më tej dallimin në integrimin social e politik të këtij komuniteti. Por, si një ndër pasojat më të rënda, veçohet mundësia që personat e paregjistruar të jenë potencial trafikimi i patreguar askund. Mbështetja e OSFA-s ka bërë të mundur zbutjen e këtyre pasojave, së paku, për personat e regjistruar drejtpërdrejt nga klinikat ligjore.

Ndërgjegjësimi i komunitetit rom mbi pasojat që sjell mosregjistrimi i lindjeve ka qënë një nga prioritetet e klinikave ligjore. Kështu, krahas aktiviteteve me anëtarët e disa shoqatave rome, klinikat ligjore kanë zhvilluar edhe aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut të tipit "street law" në zonat periferike të Tiranës, Fushë-Krujës, Lushnjës, etj, zona ku ka përqëndrime të mëdha romësh.

Shërbimet ligjore falas kanë ndikuar në përmirësimin dhe në rritjen e kulturës demokratike të qytetarëve si në ndërgjegjësimin e strukturave shtetërore për probleme të rëndësishme të individëve dhe grupeve në nevojë e pa përkrahje. Nëpërmjet shërbimeve ligjore falas, qytetarët janë informuar dhe mësuar si të mbrojnë të drejtat e tyre ligjore, si të komunikojnë me strukturat shtetërore dhe si të përdorin legjislacionin me mjete demokratike dhe institucionale, në interes të tyre. Shërbimet ligjore falas, nëpërmjet botimeve të shumëllojshme të tyre, të cilat janë përgatitur për grupet e synuara përkatëse, dhe nëpërmjet veprimtarive të tipit "street law" kanë dhënë informacion mbi të drejtat ligjore të shtetasve dhe i kanë ndërgjegjësuar ata se legjislacioni është për të gjithë dhe duhet të jetë i zbatueshëm në mënyrë të barabartë për të gjithë.

Një tregues i qartë i rolit të shërbimeve ligjore falas në ndërgjegjësimin e shtetasve për zgjidhjen e problemeve të tyre me mjetet që u jep shteti dhe ligji është ulja e rasteve të vetëgjyqësisë në këto kategori në nevojë, si rrjedhim i mundësisë së përdorimit të shërbimeve ligjore falas. (Ky përfundim është nxjerrë nga informacionet e marra nga pyetësorët e përgatitur, shpërndarë dhe përpunuar nga klinikat ligjore dhe të plotësuara nga klientët e klinikave ligjore). Po kështu, nëpërmjet botimeve, të cilat bazohen në të dhëna statistikore të mbledhura nga puna e përditshme e qendrave të shërbimeve ligjore falas, janë ndërgjegjësuar edhe shumë struktura shtetërore dhe joshtetërore jo vetëm për shumë probleme ligjore të grupeve dhe individëve në nevojë por, edhe për nevojën e shërbimeve ligjore për njerëzit në nevojë.

Ndihma ligjore e ofruar nga klinikat ligjore ka dhënë kontribut edhe në fuqizimin e grupeve në nevojë dhe pa përkrahje duke mundësuar organizimin dhe regjistrimin ligjor të tyre në shoqata të veçanta. Kështu, gjatë viteve 2000-2005, vetëm Shërbimi Ligjor Falas në Tiranë (TLAS) ka regjistruar mbi 20 shoqata të individëve dhe grupeve në nevojë. Ndihma ligjore ka ndihmuar në ndërtimin e besimit se shoqëria nuk i ka lënë pas dore njerëzit në nevojë dhe pa përkrahje, por i respekton ata si qënie njerëzore me të drejta dhe liri universale. Ofrimi i ndihmës ligjore nga klinikat ligjore në këto vite ka patur ndikimin e saj për vetë gjykatën, shtetin dhe për komunitetin e juristëve.

Klinika e Ligjit është futur si lëndë më zgjedhje në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Tiranës për herë të parë në vitin 2011. Në fillim Klinika e Ligjit ka qënë një lëndë teorike ashtu si gjithë lëndët e tjera të Fakultetit të Drejtësisë, por qëllimi kryesor i Fakultetit ishte zhvillimi i Klinikës në mënyrën e saj të plotë, një lëndë praktike e cila u mundëson studentëve që dijet e tyre teorike ti zbatojnë tashmë në praktikë.

Falë bashkëpunimit që Fakulteti i Drejtësisë ka me USAID-in, Projekti JuST, Klinika po arrin të marë zhvillimin e saj si një lëndë praktike. Klinika filloi të hartojë dhe të realizojë në gjirin e saj projekte për studentët që zgjedhin Klinikën e Ligjit si lëndë me zgjedhje.

Një ndër projektet më të rëndësishme që ka realizuar dhe vazhdon të realizojë Klinika në bashkëpunim me Projektin JuST është organizimi i gjyqit imitues. Prokurorë të vërtët i kushtojnë kohën e tyre studentëve të Klinikës, për një periudhë intensive një javore, dhe i trajnojnë ata duke hedhur mbi këta studentë bazat e praktikës. Secili prej studentëve vendoset në rolin e avokatit, prokurorit dhe të dëshmitarit dhe gjatë trajnimit ata aftësohen për mënyrën e prezantimit të çështjeve në gjyq.

Prokurorët u mësojnë studentëve aftësitë e mirefillta të profesionit të avokatëve dhe të prokurorit, u mësojnë mënyrën e prezantimit dhe qëndrimit të tyre para trupit gjykues. Studentët aftësohen në shkrimin e parashtrimit hyrës para trupit gjykues, të paraqitjes së provave, pyetjes së drejtpërderejt, të tërthort dhe rehabilitimit të dëshmitarve, shkrimit dhe paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare para trupi gjykues.

Studentët të cilët marin pjesë në gjyqin imitues në fund pajisen edhe me një çertifikatë e quajtur " Trial Advocacy Skills", çertifikatë e cila realizohet nga bashkëpunimi i Fakultetit të Drejtësisë me Projektin JuST të USAID-it.

Në vitin shkollor 2013-2014 Klinika e Ligjit hodhi një hap shumë të rëndësishëm që përkon pikërisht dhe me qëllimin e krijimit të saj, asaj të marrjes së çështjeve të vërteta nga klientë të vertët. Klientët janë paraqitur pranë Klinikës, kanë treguar rrethanat e çështjes së tyre, çështje të cilën si fillim e ka marë sekretaria e Klinikës dhe më pas e ka shpërndarë te grupi i studentëve të caktuar prej saj. Studentët të cilët kanë marë dhe kanë dhënë opinionet e tyre juridikë janë studentë të sistemit Bachelor viti tretë dhe të sistemit Master Shkencor dhe Profesional viti dytë.

Në Klinikën e Ligjit janë paraqitur dhe zgjidhur shumë çështje ligjore të Departamentit Penal dhe Civil ku mund të përmendim zgjidhje martese, detyrim për ushqim, mospërmbushje e detyrimit për ushqim, nxjerje e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, zgjidhje e kontratës së punës pa paralajmërim etj.

Pra, zhvillimi që ka marë Klinika Ligjore në fillim të këtij viti ka qënë aspekti më i rëndësishëm i zhvillimit të saj sepse pikërisht ky është edhe qëllimi kryesor i Klinikës, marrja e çështjeve nga klientë realë dhe zgjidhja e tyre nga vetë studentët e Klinikës.

Klinika e Ligjit është një strukturë e organizuar brenda Fakultetit të Drejtësisë. Klinika e Ligjit u jep mundësi studentëve të Fakultetit të Drejtësisë të aplikojnë në praktikë dijet e tyre teorike, duke u përballur me probleme të klientëve të vërtet, klientë të cilët nga pamundësia ekonomike për të sigurur një mbrojtje juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme paraqiten pranë Klinikës ku u sigurohet ndihmë juridike falas nga studentët e Klinikës.

Studentët janë pjesë shumë e rëndësishme për organizimin dhe mirëfunksionimin e Klinikës Ligjore. Studenti është ai i cili e merr çështjën nga fillimi dhe kryen veprimet e nevojshme deri në hapin final, atë të dhënies së opinionit juridik. Kështu, studenti bën intervistën me klientin, dëgjon rrethanat e çështjes të paraqitura nga klienti, i bën pyetje klientit për të qartësuar detaje të caktuara në rrethanat e çështjes, mban kontakte të vazhdueshme me klientin jo vetëm për rrethanat më të detajuara të çështjes por edhe për të vënë në dijeni klientin për vazhdimësinë e çështjtes së tij, përpilon dokumenta ligjore, bën kërkime shkencore për të dhënë një opinion juridik sa më cilësor dhe efektiv për çështjen e vet dhe jep opinionin juridik për çështjen e klientit të vet.

Një tjetër subjekt i rëndësishëm për mirëfunksionimin e Klinikës së Ligjit është edhe pedagogu përgjegjës. Pedagogu përgjegjës mbikëqyr punën e studentit në Klinikën e Ligjit si dhe vendos për pranimin ose jo të çështjes në Klinikë dhe si rrjedhojë edhe të dhënies ose jo të opinionit juridik nga ana e studentëve.

Puna e bërë nga studentët udhehiqet dhe kontrollohet nga pedagogu përgjegjës i departamentit përkatës penal, civil apo publik. Në momentin që studenti që ka marë

çështjen e ka studiuar atë dhe është gati që ti japë opinionin juridik klientit të tij, e bisedon dhe e diskuton çështjen më parë edhe me pedagogun përgjegjës dhe më pas përpilon opinionin juridik i cili para se ti jepet klientit studiohet edhe njeher nga pedagogu përgjegjës i cili mund ta konfirmojë të plotë ose ta korrigjoj dhe të bëj plotësimet e veta duke bërë të mundur që opinioni juridik është sa më i drejt dhe efektiv ndaj klientit.

Klinika e ligjit në Shqipëri është në hapat e parë të zhvillimit të saj dhe studentëve ende nuk u është dhënë mundësia, ashtu siç realizohet në të gjitha Klinikat në vënde të ndryshme të botës, të përfaqësojnë klientin dhe ta mbrojne para gjykatës ashtu si avokati bën në të vërtet. Në Shqipëri puna e studentit është e limituar deri në momentin e dhënies së opinionit juridik. Por, mbrojtjen e klientit në gjykatë e bën pedagogu përgjegjës në rast se ai ushtron profesionin e avokatit ose në të kundërt klienti e bën vetë mbrojtjen e tij në gjykatë nëpërmjet opinionit juridik të dhënë nga studenti i Klinikës.[169]

Gjithashtu me qëllim që të mbrohen dhe përfaqësohen interesat dhe të drejat e klientvë edhe në gjykatë, Klinika mund të bashkëpunojë edhe më organizata të ndryshme, avokatët e të cilave vazhdojnë çështjen në gjykatë.

Në fakt kjo është realizuar këtë vit në Klinikën tonë. Pasi studentët dhanë opinionin juridik ndaj klientve të tyre dhe në pamundësi të përfaqësimit të klientve në gjykatë, Klinika bashkëpunoi me "Qëndrën Për Nismën Ligjore", avokatët e saj kanë vazhduar mbrojtjen e klientve të Klinikës në gjykatë.

Fillimisht klinika e ligjit u aplikua si një lëndë në Departamentin e të Drejtës Penale dhe më pas në dy departamentet e tjera, atë civil dhe publik. Klinika e ligjit i ka zhvilluar kurrikulat e saj hap pas hapi duke fituar popullaritet dhe mbështetje të konsiderueshme jo vetëm nga studentët por gjithë stafi akademik. Vit pas viti klinika e ligjit është zhvilluar, është përhapur dhe përmrësuar me punën e përbashkët të studentëve, pedagogëve të klinikës por edhe të partnerëve mbështetës, si USAID. Sot, mund të falsim për një klinikë të mirëfilltë si një lëndë me zgjedhje që operon në programet bachelor dhe ato master të fakultetit, ku studentët kanë mundësi të përfshihen në mënyrë vullnetare të programet e saj dhe të marrin eksperienca jo vetëm të paharrueshme por edhe të vlefshme për karrierën e tyre profesionale.

Aktualisht klinika ka laboratorin e vet në ambientet e fakultetit, si edhe një sallë gjyqi imitues në të cilën studentët mund të perforomojnë gjyqe imituese, një eksperiencë kjo shumë e vlefshme për ta. Klinika e ligjit vepron si një lëndë në të drejtën penale, ku objekti i saj është praktika e ligjit në fushën penale si edhe ofrimi i ndihmës ligjore falas për anëtarë të komunitetit që kanë nevojë për një ndihmë të tillë. Gjithashtu klinika e ligjit vepron si një lëndë me zgjedhje në të drejtën civile, e cila mbulon praktikën e ligjit civil dhe ndihmën ligjire fals në këtë fushë. Në departamentin e të drejtës publike klinika e ligjit operon në lëndën e të drejtave të njeriut dhe fokusohet kryesisht në çështjet që

[169] Rregullore e Klinikes se Ligjit .

lidhen me cënimin e të drejtave themelore të njeriut që parashikohen në Kushtetutë por edhe Konventën Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në lidhje me të drejtat e njëriut është në një hierarki me Kushtetutën e vendit.

Megjithatë, pavarësisht se klinika e ligjit është një projekt i ri në programin akademik të së drejtës, ajo është implementuar me mjaft sukses dhe parashikon rezultate shumë premtuese. Jao jo vetëm njihet në një masë të madhe në ambientet akademike të fakultetit por gëzon edhe një mbështetje shumë të madhe. Për shkak të huazimit të përvojave më të mira ndërkombëtare, ajo është kuptuar dhe përshtatur siç duhet. Gjithashtu një vëmendje e madhe i është kushtuar aftësive që ajo perfeksionon për studentët duke i bërë më të aftë në rrugën e tyre profesionale. Duke parë avantazhet që klinika e ligjit ka sjellë në vende të tjera që kanë një përvojë shumë-vjeçare në këtë drejtim, është parë me vend implementimi i saj edhe në Shqipëri, duke marrë parasysh edhe nevojën e madhe që ka komuniteti ynë për ndihmë ligjore apo këshillim falas për çështje të ndryshme ligjore me të cilat përballet.

Çështja konsiderohet e pranuar në Klinikën e Ligjit në momentin që klienti plotëson Formularin e Deklarimit të Çështjes.[170] Ky Formular i jepet klientit për tu plotësuar nga studenti që bën intervistimin e klientit.[171] Fjalën e fundit për pranimin e çështjes në Klinikë e ka profesori përgjegjës i cili pasi informohet për çështjen vendos për pranimin ose jo të çështjes në Klinikë brenda 7 ditëve nga moment i marrjes së Formularit të Deklarimit të Çështjes. Disa prej rasteve në të cilat pedagogu përgjegjës merr vendim për mospranimin e çështjes në Klinikë janë:

- Karakteri i çështjes. Jo të gjitha çështjet pranohen në Klinikën e Ligjit. Ato çështje të cilat janë kopmlekse për tu zgjidhr apo janë të një rrezikshmërie të theksuar kriminale nuk mund të pranohen në Klinikën e Ligjit pasi Klinika do e ketë shumë të vështirë që të japë një opinion juridik. Dihet që ndihma juridike në Klinik ofrohet nga studentë të sistemit Bachelor viti i tret dhe nga studentë të Masterit Professional dhe Shkencor të cilët nuk kanë eksperienc juridike ndaj dhe nuk janë në gjëndje të japin një opinion ligjor për një çështje komplekse e cila këkron ndihme juridike profesionale.

- Sjellja e klientit. Klienti duhet të jetë i gatshëm të bashkëpunojë me studentin që ka marrë çështjen, duke i treguar gjithë të vërtetën dhe me detaje rrethanat e çështjes duke mos e genjyer, shpifur apo mos treguar detaje të cilat mund të jenë të vogla por të rëndësishme për çështjen. Nëse klienti nuk vepron si më sipër çështja e tij nuk do të pranohet sepse dhe opinioni juridik nuk do të jete efektiv dhe i drejt.

- Periudha e shkurtër e shqyrtimit të çështjes, për shkak të afateve. Në Rregulloren e Klinikës së Ligjit përcaktohet në mënyrë të qart se opinioni juridik jepet brenda 21 ditëve. Në rast se çështja e sjell në Klinikë është e kufizuar në afate të tjera të ndryshme nga afati i përmendur më sipër dhe ky afat është shumë më i shkurtër se afati 21 ditor dhe

[170] Rregullore e Klinikës së Ligjit, neni 6.
[171] Po aty, neni 8.

opinioni juridik nga studentët nuk mund të jepet brenda afateve të çështjes atëherë çështja nuk do të pranohet në Klinikë.

- Një numër i madh çështjesh të marra nga Departamenti Klinik. Në rast se në Klinikë janë marrë një numër i madh çështjesh dhe marrja e çështjeve të reja nuk mund të përballohet atehërë çështjet e reja që do të paraqiten nuk do të merren nga Klinika.

- Konflikti i interesave.

- Periudha e kohëzgjatjes së pushimeve vjetore. Data 1 korrik deri më datën 20 tetor parashikohet nga Rregullorja e Klinikës së Ligjit pushime vjetore. Puna në Klinikën e Ligjit mbyllet dhe gjatë kësaj kohe nuk mund të merren dhe të pranohen çështje në Klinik sepse fillojnë pushimet vjetore për studentët, subjekti kryesor për funksionimin e Klinikës së Ligjit. Por nga ky rregull i përgjitjshëm ekziston një përjashtim. Edhe gjatë pushimeve vjetore mund të merren çështje me miratimin e studentit që i është ngarkuar çështja.[172]

 Pedagogu i lëndës ka të drejtën e pezullimit të çështjes kur rezulton se klienti kërkon të përfitojë nga ndihma juridike në mënyrë që nuk përkon me qëllimet dhe parimet e saj . Pezullimi i çështjes ndodh gjithashtu edhe kur:

a. Klienti vështirëson procedurën për ndjekësin e çështjes, veçanërisht kur ai refuzon të japë informacionet që janë të domosdoshme për zgjidhjen e saktë tëçështjes;

b. Kur nuk mund të përcaktohet gjëndja faktike;

c. Kur mungojnë kontaktet me klientin. Studenti duhet të jetë gjithmonë në kontakt me klientin e vet për nevoja të ndryshme rreth çështjes, si plotësim dokumentash, pyetje të detajuara rreth një rrethane të rëndësishme për fatin e çështjes për ta vënë klientin në dijeni për vazhdimësinë e çështjes etj. Në momentin që mungojnë kontaktet me klientin atëherë dhe çështja do të pezullohet deri në momëntin që të rivendosen kontaktet me klientin për kryerjen e veprimeve të ndryshme.

d. Zbulohen rrethana që provojne se klienti është duke përfituar apo ka përfituar në të shkuarën nga ndihma e avokatit apo këshilltarit ligjor ose që klienti ka mundësinëqë të angazhojë një ndihmë juridike me pagesë. Qëllimi kryesor i Klinikës së Ligjit është dhënia e ndihmës juridike falas nga studentët e Universitetit të Drejtësisë për persona të cilët gjenden në vështirësi ekonomike dhe si rrjedhojë në pamundësi për të siguruar një ndihmë juridike për të mbrojtur një të drejt apo interes legjitim të tyre.

Shpërndarja e çështjeve që vinjë në Klinikë bëhet nga sekretari i Klinikës. Çdo çështje i jepet një grup studenti numri i të cilit është dy ose më shumë por asnjëher një person. Studentët gjithmonë punojnë në grup. Çdo grupi studenti i jepet në fillim me radhë nga një çështje dhe pasi plotësohen të gjitha grupet me nga një çështje, kalohet në dhënien e çështjes së dytë me radhë derisa të gjitha grupet të pajisen me tre çështje, që është dhe

[172] Po aty, neni 15.

numri maksimal i çështjeve që do të ketë çdo grup studenti. Asnjë grup studenti nuk mund të marrë njëkohësisht më shumë se 3 çështje sepse kjo do të thot një ngarkim pune për studentët e Klinikës. Në rast se të gjitha grupet janë plotësuar me nga 3 çështje atëherë çështjet e reja që do të vijnë në Klinikë nuk do të pranohen me arsyen e ngarkimit të Departamentit Klinik.

Çdo çështje në momentin e paraqitjes së saj pajiset me një dosje dhe me një numër të posaçëm, i cili është numri i çështjes që ka ardhur. Në dosje shënohet edhe data e sakt kur çështja ka ardhur në Klinik, muaji dhe viti i ardhjes së çështjes. Përveç dosjes së sipërpërmendur, të dhënat e çështjes mbahen edhe në një regjistër evidence të veçantë nga sekretaria e Klinikës së Ligjit. Sekretaria në të njëjtën kohë pajis studentin i cili merr çështjen me kartelën e ruajtjes së çështjes për mbajtjen e të dhënave përkatëse. Studenti është i detyruar ta plotësojë në mënyrë të plotë dhe të saktë kartelën, duke mbajtur shënim të gjithë hap pas hapi ecurinë e ngjarjes që nga momenti i marrjes së saj deri në momentin final atë të dhënies së opinionit juridik.[173]

Për të kupuar rëndësinë e klinikës në vendin tonë duhen marrë parasysh edhe rezultatet e studimit të realizuar në komunitet. Me anë të këtij studimi të prezantuar më sipër, u arrit të kuptohej informacioni që ka publiku në lidhje me klinikën por edhe pritshëìmëritë që kanë prej saj. Pavarësisht se informacioni në lidhje me klinikën është i paktë, pritshmëritë në lidhje me të ishin maksimale. Kjo tregon domosdoshmërinë për të rritu ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me klinikën, misionin e saj, mundësitë që ajo i ofron atyre dhe mënyrës se si mund të bien të kontakt me klinikën për të marrë përfitimin prej saj. Për këtë nevojitet një angazhim më i madh i studentëve të cilët duhet të përfshihen në mënyrë aktive në programin e klinikës. Ata duhet të ndërmarrin fushata sensibilizuese për njohjen e klinikës duke ofruar informacionin bazë për të, duke shpërndarë broshura informuese dhe duke iu përgjigjur pyetjeve që i drejtohen nga publiku.

Nëse kemi një angazhim të gjithëanshëm për përshtatjen dhe impelmentimin siç duhet të klinikës në Shqipëri, atëherë ajo mund të arrijë në nivele mjaft të larta duke konkurruar edhe përvojat e vendeve fqinje. Gjithashtu, klinika për shkak të domosdoshmërisë së saj dhe përfitimeve të shumëanshme që ofron, do të ishte një zgjidhje e mirë shndërrimi i saj në një lëndë të detyrueshme të programit akademik. Në këtë mënyrë ajo do të bëhej pjesë e pandarë e sistemit arsimor të së drejtës dhe do të ofronte përvojat e saj dhe përfitimet në nivelin më maksimal, ashtu siç ndodh në klinikat e huaja.

Megjithatë, pavarësisht sfidave, klinika e ligjit po bën hapa progresivë si lëndë në fakultetin e drejtësisë. Ky punim trajtoi në disa aspekte klinikën e ligjit dhe shërben për t'u ardhur në ndihmë edhe studentëve për ta kuptuar atë dhe të bëhen pjesë e saj duke kontribuar kështu në zhvillimin jo vetëm të formimit të tyre profesional por edhe duke dhënë kontribut të vlefshëm në ndihmë të komunitetit.

[173] Po aty, neni 25.

Përfundime dhe Rekomandime

Në përfundim të këtij punimi po paraqes disa rekomandime në lidhje me klinikën e ligjit, kryesisht në lidhje me zbatimin e saj në vendin tonë. Këto rekomandime kanë rezultuar nga studimi i kryer gjatë hartimit të këtij punimi.

- Klinika e ligjit është pjesë e rëndësishme e edukimit ligjor të studentëve të së drejtës. Gjatë studimeve në drejtësi ata kanë nevojë jo vetëm ta mësojnë të drejtën por edhe ta zbatojnë ata. Në këtë mënyrë do të bëhen juristë të aftë.
- Zbatimi i klinikës kërkon ndjekjen e disa hapave të rëndësishëm të cilët e bëjnë efektive punën në klinikë por gjithashtu lehtësojnë arritjen e rezultateve.
- Gjatë klinikës kemi një përfitim të dyfishtë; nga njëra anë studentët përfitojnë aftësi të reja ose perfeksionojnë ato ekzistueset dhe nga ana tjetër i vihet në ndihmë asaj pjese të komunitetit që ka nevojë për ndihmë ligjore por që nuk mund ta përballojë vet atë.
- Aftësitë e përfituara nga klinika e ligjit janë shumë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme për zbatuesin e të drejtës. Studentët fitojnë aftësi llogjikuese, mësojnë të hartojnë dokumenta ligjorë, të jenë bashkëpunues, të punojnë në grup, të punojnë me njerëz të dijeve dhe kulturave të ndryshme.
- Gjatë zbatimit të klinikës studentët kanë detyrimin të respektojnë normat e etikës ligjore, si detyrimi i konfidencialitetit, shmangia e konfliktit të interesave etj. Detyrimet e Kodit Etik të Avokatit vlejnë edhe për studentët e klinikës së ligjit.
- Gjatë zbatimit të klinikës në fakultet duhet të merren parasysh disa nga përvojat më të mira ndërkombëtare të klinikës së ligit. Këtu përfshihet edhe bashkëpunimi me universitete të huaja si edhe me partnerë ndërkombëtarë. Kjo ndihmon edhe në planifikimin e karrierës së studentëve të rinj dhe në vlerësimin e arritjeve që do të kenë në të ardhmen.
- Klinika e ligjit në Shqipëri është ende në hapat e parë, megjithatë interesimi dhe vlerësimi për të ka qënë i madh. Pavarësisht se komuniteti ende nuk ka njohuri të mjaftueshme në lidhje me të, në ambientet universitare studentët preferojnë të bëhen pjesë e klinikës së ligjit duke përfituar nga avantazhet e saj.
- Klinikës së ligjit mund t'i jepet më tepër autonomi akademike dhe financiare për të mundësuar drejtpërdrejt kontaktimin e përfaqsuesve ligjorë të brendshëm apo të jashtëm me cuarjen e cështjeve në gjykim si edhe mundësinë e krijimit të një lënde të detyrueshme me kredite stimuluese sipas eksperiencave më të mira ndërkombëtare.

Bibliografia :

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nr. 8417 datë 21. 10. 1998, i ndryshuar;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Kodi i Procedurës Penale nr. 7905, datë 21. 3. 1995 i ndryshuar;
- Kodi i Procedurës Civile nr 8116 datë 29. 03. 1996, i ndryshuar;
- Kodi Etik i Avokatit;
- Kodi i Etikës së gjyqtarit;
- Ligji nr. 9109 datë 17. 7. 2003 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" i ndyshuar;
- Ligji nr. 9887, datë 10. 3. 2008"Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Ligji" Për mbrojtjen e konsumatorit" nr. 9902, datë 17. 04. 2008;
- Udhërrëfyes për mbrojtjen e të dhënave personale- Për Subjektet e të dhënave- Publikim i Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Manual për profesorët e rinj të klinikës – botim i Shoqatës për Edukimin e klinikës së ligjit- maj 2009;
- Street Law: To understand law and legal issues - Copyright © 2011 botim i The McGraë-Hill Companies, Inc;
- Cf. H. Brayne" Is legal aid a human right?" botim në The Law Society Gazette" 25 janar, 1989;
- Learning from practice – J. P. Ovigly, Leah Wortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II;
- Learning from practice – Teacher's Manual, J. P. Ovigly, Leah Wortham, Lisa G. Lerman, vëllimi II
- Neë Skills, Neë Learning: Legal education and the promise of technology- studim i Berkman center for internet & society, Universiteti i Harvardit, shkolla e së drejtës;
- Përfitimet e klinikës së ligjit - Botim i Michael Pinard, profesor i klinikës së ligjit në Universitetin e Maryland në SH. B. A, janar 2012;
- Adam Babich – Controversal, conflicts and law clinics, artikull i botuar në Clinical law Review, vol 17. Nr 2, Pranverë 2011, Fakulteti i Drejtësisë New York;
- Helen A. Andersen – I foluri ligjor dhe shqetësimi mbi konflitet potenciale;
- Gary Belloë & Jeanne Kettleson-From Ethics to Politics: Comfronting Scarcity and Fairness in Public Interest Practice;
- Studim i shkollës së ligjit bazuar në klinikën e ligjit – Botim i Forumit për klinikën e ligjit në rajonin e Azisë;
- Clinica legale, imprarare il diritto attraverso casi reali – botim i Universitetit të Breshia-s, Itali;
- The legal clinic- The idea, organization, methodology – botim i The legal clinic Foundation, Warsaw 2005;

- Avokatia – Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë në Shqipëri, vëllimi I, janar 2012;
- Manual për profesorët e klinikës së ligjit - botim i Shoqatës për Edukimin e klinikës ligjore, maj 2009;
- Legal clinics review – botim i Shkollës të së drejtës në Universitetin e Neë York në SH. B. A, vëllimi 17, numër 2, pranverë 2011;
- Legal clinics review, botim i Universitetit Tennese, vëllimi 75, numër 2, dimër 2008;
- "Clinical education and experiental learning"– botim i Universitetit të Kolumbisë, në Neë York, SH. B. A, 2013.
- Legal Clinics and the better trained Lawyer : A history of clinical education at Northwestern- Copyright 2006 by Northwestern University School of Law Printed in U. S. A. , Northwestern University Law Review Vol. 100, No. 1;
- Legal Clinics and Law Students: Rocks and Cement for Better Legal Education- John S. Bradway, Professor of Law at Duke University;
- Clinical Anthrology. Readings for live-client clinics – A. J. Hurder, F. S. Bloch, S. L. Brooks, S. L. Kay. Anderson Publishing Co, Ohio;
- Legal clinic, Serving people improving justice – Open society justice Initiative, Hungari 2009;
- Civil Law Forum for South East Europe, Collection of studies and analyses. Second Regional Conference, Skopje 2012, Volume I;
- Fundamentals of European Civil Law – Martin Vranken, second edition, 2010;
- Aiken, H. J. The Clinical Mision of Justice Readiness, 2012;
- Ansari, H. A. Clinical Legal Education: Benefitting From the Bararas Experience, Journal of Applied Sciences, 2011:
- Barnhizer, R. D. The Clinical Method of Legal Instruction: Its Theory and Implementation, 30 J. LEGAL EDUC. 67, 1979;
- Barny, M. M. Question of Mission: Catholic Law School's Domestic Violence, 1994§;
- Bryant, S. Collaboration in Law Practice: A Statisfyng and Productive Process For a Diverse Profesion, VT. L REV 459, 1993;
- Bryant, S. & Milstein, S. E. Rounds: A Signature Pedagogy for Clinical Education?, 14 CLIN. L. REV, 2007;
- Carpenter, E. E. The Project Model of Clinical Education: Eight Principes to Maximize Student Learning and Social Justice Impact,
- Czernicki, F. The Polish Legal Program and The Role of Polish Legal Clinics Foundation, REVISTA DE EDUCACION Y DERECHO, 2001;
- Giddings, J. Contemplating the Future of Clinical Legal Education, Grifith Law Review, 2008;

- Goode, M. V. There is A Method (Ology) to This Madness: A Review and Analisys of Feedback in the Clinical Process, 53 OKLA. L. REV. 2000;
- Grimes, R. The Theory and Practice of Clinical Legal Education, 1996;
- Grose, C. Beyond Skills Training, Revisited: The Clinical Education Spiral,
- Hoffman, T. P. Clinical Scholarship and Skills Training, 1 CLIN. L. REV., 1994;
- Hyams, R. On Teaching Students to Act Like a Lawyer: What Sot of Lawyer?, Journal of Clinical Legal Education 21, 2008;
- Kruse, K. Biting off What They Can Chew: Strategies For Involving Student in Problem-Solving Beyond Individual Client Representation, CLIN. L. REV, 2002;
- Land, A. Laëyering Beyond Without Leaving Individual Clients Behind, CLIN. . REV. 2011;
- Lewis, R. Clinical Legal Education Revisited;
- Mesirow & Stravitz, Legal Clinic in the DC Metro Area;
- Mlyniec, J. W. Where to Begin? Training New Teachers in the Art of Clinical Pedagogy, CLIN.L. REV. 2012;
- O'Grady, G. C. Preparing Students For the Profesion: Clinical Education, Collaborative Pedagogy, and the Realities of Practice For the New Lawyers, CLIN. L.REV. 485, 1998;
- Ovigly, P. J. Worthman, L. & Lerman, G. L. Learning From Practice, vellimi 2,
- Qafisheh, M. M. The Role of Legal Clinics in Leading Legal Education: A Model From the Middle East, Legal Education Review,
- Rahl, J. & Schwerin, K. Northwestern School of Law- A Short History, 1960
- Srikantiah, J. & Koh, L. J. Teaching Individual Representation Alongside Institutional Advocacy: Pedagogical Impliciations of a Combinied Advocacy Clinic, CLIN. L. REV. 2010;
- Rregullore e Klinikës së Ligjit.
- Shanahan, C. & Benfer, A. E. Adoptive Clinical Teaching, CLIN. L. REV. 517, 2013
- Zander, M. Clinical Legal Education, NEW L J, 1972.

Abstrakt

Objekt i këtij punimi është klinika e ligjit, e cila lindi si një metodë mësimdhënie për t'u zhvilluar më pas në nivelin e një shkence që duke përdorur aksiomën *" të mësosh nga praktika"* synon të krijojë jurist të aftë por nga ana tjetër ofron shërbime *pro bono* në ndihmë të komunitetit. Është paraqitur një panoramë e qartë e klinikës së ligjit, çfarë është ajo, si lindi dhe u përhap duke u bërë pjesë e pandarë e programit akademik të Fakulteteve të Drejtësisë lider në botë. Gjithashtu trajtohet mënyra e zbatimit të klinikës së ligjit në praktikë, hapat që ndiqen për të ofruar një program të gjithanshëm të klinikës, modelet e saj si edhe përfitimet që rrjedhin nga klinika e ligjit. Aftësitë e zhvilluara me anë të prekjes nga afër të rasteve praktike janë të papërfitueshme në asnjë mënyrë tjetër. Gjithashtu trajtohen problemet etike që hasen në klinikën e ligjit si konfidencialiteti apo konflikti i interesit, Janë paraqitur disa nga modelet më të mira të klinikave të ligjit në botë, duke u munduar të krijohet një përqasje edhe me klinikën e ligjit në Fakultetin e Drejtësisë së Tiranës, ku edhe pse në hapat e parë klinika po merr një rëndësi dhe vlerësim të konsiderueshëm.

Fjalë kyçe: *Klinika e ligjit, përfitimet, shërbime falas, etika, modelet e klinikës, risi*

Abstract

The object of this thesis is the legal clinic , which originated as a teaching method to be developed later in the level of a science that using the axiom *" learning from practice "* aims to create professional lawyers , but also provides *pro bono* services to help the community .Here is provided a clear picture of the legal clinic , what is it , how it was born and developed , thus becoming an integral part of the academic programs of the leader Faculties of Law in the world . There are also addressed ways of implementing legal clinic , the steps to be followed to provide a comprehensive clinical program , its models and the benefits derived from the legal clinic . The skills developed by working with practical cases can not be learned in any other way . There are also provided some ethical problems encountered in the legal clinic as confidentiality or conflict of interest , also are presented some of the best models of legal clinics in the world , trying to create an approach with the legal clinic at the Law Faculty of Tirana , where although we are in the first steps is receiving a considerable importance.

Key words: *Legal clinic, benefits, pro bono work, ethics, legal clinic models, innovation*